



## **KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**

Raporti përfundimtar i auditimit i ushtruar në “Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit”  
(MTM)

# **RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI**

**“AUDITIM FINANCIAR DHE PËRPUTHSHMËRIE MBI  
VEPRIMTARINË E MINISTRISË SË TURIZMIT DHE  
MJEDISIT”**

**Tetor 2023**

## PËRMBLEDHJE

<b>I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE</b> .....	3
<b>I.1. Përshkrim i shkurtër i Raportit të Auditimit.</b> .....	3
<b>I.3. Konkluzioni dhe Opinioni i Auditimit.</b> .....	9
II. Hyrja .....	13
1. Objektivat dhe qëllimi i auditimit: .....	13
3. Identifikimi i çështjes:.....	14
<b>4. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar lidhur me çështjen nën auditim:</b> .....	15
5. Përgjegjësia e Audituesve të KLSH:.....	15
6. Kriteret e vlerësimit: .....	16
7. Standardet e Auditimit .....	17
8. Metodatat e auditimit .....	17
9. Dokumentimi i auditimit.....	18
<b>III. PËRSHKRIMI AUDITIMIT</b> .....	18
2. Rezultatet e auditimit sipas drejtimeve të auditimit:.....	19
2.1 Hartimi dhe zbatimin i buxhetit të shtetit. ....	19
2.2 Zbatimi i dispozitave ligjore për marrëdhëniet e punës dhe pagave.....	36
2.3 Zbatimi i dispozitave ligjore për administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetare. ....	47
2.4 Auditimi i llogarive vjetore.....	58
2.5 Prokurimet e fondeve publike.....	76
2.6 Vlerësimi i funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit.....	128
2.7 Probleme të ndryshme që mund të dalim gjatë auditimit. ....	138
<b>IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET</b> .....	156
V. ANEKSE.....	175

# I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

## I.1. Përshkrim i shkurtër i Raportit të Auditimit.

Mbështetur në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Kontrolli i Lartë i Shtetit auditori Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, më poshtë e emërtuar “MTM”, për periudhën nga data 01.01.2020 deri në 31.12.2022, me objekt “Mbi auditimin financiar dhe të përputhshmërisë”.

Auditimi kishte në fokus gjashtë drejtime kryesore, sipas programit të miratuar me nr. 325/1, datë 25.04.2023, dhe në të u angazhuan 4 (katër) auditues të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Auditimi u përqendrua kryesisht në aktivitetin e MTM mbi planifikimin dhe përdorimin e fondeve buxhetore, menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm të njësisë, procedurat e prokurimit publik, zbatimin e kontratave, mbajtjen e evidencës kontabël dhe menaxhimin e aktiveve.

Grupi i auditimit të KLSH shqyrtoi, analizoi dhe arriti në konkluzione mbi secilin prej drejtimeve të auditimit, në bazë të dokumentacionit të kërkuar dhe të vënë në dispozicion, me zgjedhje, për të arritur në një siguri të arsyeshme në dhënien e opinionit të auditimit.

Gjatë zhvillimit të këtij auditimi, janë mbajtur në konsideratë Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISSAI), Manuali i auditimit të përputhshmërisë dhe financiar të KLSH, Rregullorja e funksionimit organizativ dhe administrativ të KLSH, Rregullorja e procedurave të auditimit, Kodi i etikës, si dhe praktikatat më të mira audituese të fushës.

Bazuar në rezultatet e auditimit të MTM për periudhën nga data nga data 01.01.2020 deri në 31.12.2022, grupi i auditimit me një siguri të arsyeshme ka dhënë opinion të kualifikuar të përputhshmërisë dhe opinion të kualifikuar për pasqyrat financiare.

Grupi i auditimit ka hartuar këtë Raport Përfundimtar auditimi, duke reflektuar edhe komentet e subjektit, sa i takon projektraportit të auditimit. Rezultatet dhe çështjet kryesore të këtij auditimi janë trajtuar në vijim të raportit përfundimtar, së bashku me konkluzionin e përgjithshëm dhe opinionin e auditimit.

## I.2. Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve.

NR.	PËRMBLEDHJE E GJETJES	REFERENCA NË RAPORTIN PËRFUNDIMTAR	RËNDËSIA	REKOMANDIMI
A/1	Nga auditimi u konstatua se nga 65 investimet që janë referuar që prej planifikimit buxhetor afatmesëm dhe deri në realizimin e tyre për vitin 2022, 24 prej tyre ose 37% në shumën 78,974,000 lekë nuk janë planifikuar në PBA 2022-2024, nga të cilat 2 investime janë planifikuar dhe miratuar në buxhetin fillestar të vitit 2022. Ndër këto investime të paplanifikuara në PBA 2022-2024, pjesën kryesore ose e zë projekti i investimit “Pajisje dhe pjesë këmbimi për 7 stacionet e monitorimit të ajrit” në vlerën 37,480 mijë lekë. Veprimet në kundërshtim me Ligjin nr. 9936 datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, VKM 185, datë 29.03.2018 “Për procedurat e menaxhimit të investimeve publike”, pika 7 dhe Udhëzimin e MFE nr. 7, datë 28.02.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm” Pika 8.	<i>Më hollësisht trajtuar në pikën 1 faqe 19-36 të Raportit të Auditimit</i>	E lartë	- Titullari i Institucionit në bashkëpunim me Grupin e Menaxhimit Strategjik, të marrin masat e nevojshme, që në periudhat në vijim të eliminohen praktikatat e çeljes së projekteve të reja pa kaluar në procedurat e ciklit të menaxhimit të investimeve publike, me qëllim respektimin e disiplinës buxhetore, si dhe të respektohen projektet e investimeve të parashikuara në PBA.
A/3	Nga auditimi i buxhetit për periudhën 01.01.2020 deri në 31.12.2022 u konstatua se: Fondet e akorduar për rindërtimin në shumën 200,000 mijë lekë, për Agjencinë Kombëtare të Bregdetit për vitin 2020 fillimisht nuk kanë qenë të evidentuar në një	<i>Më hollësisht trajtuar në pikën 1 faqe 19-36 të Raportit të Auditimit</i>	E lartë	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit të marrë masa për përmirësimin e procesit të planifikimit dhe raportimit, për efekt të hartimit dhe monitorimit të planit buxhetor

	<p>produkt të veçantë me objektiv të lidhur me rindërtimin, por i inkorporuar në kodin e produktit 92603AB “Monitorime të kryera gjatë vijës bregdetare” të Agjencisë Kombëtare të Bregdetit, si dhe nuk u konstatua raportim për këtë produkt në numër përfituesish (personash të akomoduar); duke cënuar konceptin e produktit dhe programit në kundërshtim me Ligjin nr. 9936 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor”, i ndryshuar, Pikat 27, 31 dhe 32 “Program buxhetor”.</p> <p>Në raportet e monitorimit për vitin 2020 mungonte raportimi për këtë produkt si në relacionin shpjegues dhe në Aneksin nr. 3 "Raporti përmbledhës i realizimit të treguesve të performancës/produkteve të programit", veprime në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 22, datë, 17.11.2016 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit për njësitë e qeverisjes qendrore”, Pjesa I, Pika 4, dhe Pika 5; dhe Udhëzimin nr. 7, datë 28.02.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së PBA” Pjesa 2.5.</p> <p>- Për vitin 2020 bazuar në VKM nr. 378, datë 8.5.2020 “Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2020, miratuar për Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, për mbulimin e shpenzimeve të akomodimit të personave që riatdhesohen”, në vlerën 95,200 mijë lekë, për të cilat përgjatë vitit 2020 janë përdorur 70,444 mijë lekë, rezultoi se nga MTM nuk është çelur një kod i ri për riatdhesimin, si dhe nuk disponohet informacion mbi numrin e personave të akomoduar, duke bërë që raportimi i këtij shpenzimi të humbasë gjurmën e auditimit dhe transparencën në raportim. Veprime në kundërshtim me Udhëzimin plotësues të MFE nr. 2, datë 20.01.2020 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2020”, pika 9.</p> <p>- Për vitin 2021, në buxhetin e miratuar, në programin “Zhvillimi i turizmit”, në artikullin 602 (shpenzime operative), për Agjencinë Kombëtare të Turizmit, i është shtuar fondi prej 100,000,000 (njëqind milionë) lekësh, për përballimin e shpenzimeve për mbështetjen e turizmit shqiptar për promovimin në tregjet ndërkombëtare post COVID-19 dhe prezantimin e Shqipërisë si një destinacion mikpritës COVID-free. Efekti financiar, prej 100,000,000 (njëqind milionë) lekësh, është përballuar nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit për vitin 2021. Ky produkt nuk ka qenë i planifikuar në PBA 2021-2023 në programin “Zhvillimi i turizmit” dhe në monitorimin vjetor 2021 nuk është raportuar në lidhje me sasinë dhe koston për njësi. Veprimet e mësipërme janë kryer në kundërshtim me Ligjin nr. 9936 datë 26.06.2008, pikat 27, 31 dhe 32; Udhëzimin e MFE nr. 7, datë 28.02.2018, pjesa 2.5, pika 2; Udhëzimit të MFE nr. 22, datë, 17.11.2016, pika 49;</p>			<p>sa më të detajuar dhe transparente, duke përfshirë të gjitha njësitë përgjegjëse për buxhetin e programeve të administruara nga institucioni.</p>
A/7	Nga auditimi i analizave të llogarisë nr.28 “Caktime të Aktiveve Afatgjata” shuma prej	Më hollësisht trajtuar në pikën 1	E lartë	Drejtoria e Buxhetit dhe e Menaxhimit Financiar, të

	<p>235,323,285 lekë është mbartur përpara vitit 2017. Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar nuk ka informacion se cilat janë këto projekte/investime të zhvilluara përpara vitit 2017, si dhe nuk kanë emërtim, nuk paraqiten kartela inventariale dhe nuk dihet se çfarë përfaqësojnë. Veprimet në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, pikat 26, 28, 30, Kreu IV pika 75; Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar Kreu II pika 5 dhe Kreu III pika 30.</p>	<p><i>faqe 58-76 të Raportit të Auditimit.</i></p>		<p>marrë masa që të kryejë zbatimin e dokumentacionit financiar të trashëguar për nxjerrjen e të dhënave për projektet/investimet e mbartura në llogarinë nr.28 “Caktime të Aktiveve Afatgjata”, në mënyrë të tillë që të verifikohet, saktësohet dhe të analizohen vlerat e paraqitura në Pasqyrat Financiare dhe në rast pasaktësish të bëhen sistemimet e nevojshme në kontabilitet.</p>
A/13	<p>Nga auditimi i zërave të pasqyrës së aktivitetit për vitin 2022 u konstatua se: -MTM ka një regjistër elektronik për aktivitet afatgjatë, i cili nuk është përditësuar me vlerën aktuale të aktiveve që institucioni ka në pronësi. Mungesa e mbajtjes së regjistrit të aktiveve, sipas formatit të përcaktuar në Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” kapitulli III, ku në varësi të llojit të aktivitetit duhet të përmbajë datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim për secilin aktiv, vlerën e amortizimit të akumuluar ndër vite me qëllim verifikimin e vlerës së mbetur të aktiveve në dispozicion të institucionit, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes së tyre etj. si një faktor i rëndësishëm për miradministrim dhe mirëmenaxhimin e aktiveve në pronësi. Si rrjedhojë mungesa e regjistrit ka sjellë që edhe Amortizimi i aktiveve, i cili është përlllogaritur bazuar në Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03.2018 “Për Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, i ndryshuar pika 36; konstatohet se përlllogaritja e tij është bërë për aktivet në total dhe jo për secilin aktiv më vetë, <b>duke sjellë vështirësi në përcaktimin e vlerave reale të aktiveve (për artikull) që institucioni disponon.</b></p>	<p><i>Më hollësisht trajtuar në pikën 1 faqe 58-76 të Raportit të Auditimit</i></p>	E lartë	<p>Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar të marrë masa për krijimin e një regjistri të plotë të aktiveve të njësisë, duke specifikuar në mënyrë analitike secilin aktiv me informacione në lidhje me, datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datën e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpashme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia.</p>
A/18	<p>Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt: “Rehabilitimi i shesheve dhe zonave kryesore në afërsi të pikave doganore shqiptare” në vlerën 12,480,000 lekë pa TVSh realizuar në vitin 2021 u konstatua se: - Nga MTM nuk rezultoi të jetë kryer një studim paraprak për nevojat e realizimit të këtij investimi si prioritet i parashikuar në PBA 2022-2024, me ndryshimet e bëra në PBA me datë 18.10.2021. Ky projekt është planifikuar pa patur një studim paraprak dhe arsyetim se pse është përfshirë si prioritet për vitin 2022, veprime në kundërshtim me VKM nr.185, datë 29.03.2018, “Për procedurat e menaxhimit të investimeve publike” pika 7. - Në këtë procedurë janë përfshirë: a) Porti i Durrësit, i cili është dhënë me koncesion dhe operon në Shqipëri që nga Viti 2013.</p>	<p><i>Më hollësisht trajtuar në pikën 1 faqe 76-128 të Raportit të Auditimit</i></p>	E lartë	<p>- Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, personat përgjegjës të parashikimit të investimeve, të marrin masa në vijimësi për realizimin e studimeve paraprak në bashkëpunim me autoritetet përkatëse pjesë e projekteve, me qëllim mirëmenaxhimin e fondeve publike, evitimin e ndryshimit të prioriteteve të projekteve, si dhe cënimin apo favorizimin e projekteve specifike. - Titullari i Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit të marrë masa për ngritjen e një komisioni me specialist të fushës, me qëllim ndarjen dhe përcaktimin e vlerave që i</p>

	<p>b) Dega Dogana Kapshtice, për të cilën është bërë “<i>Projekti për rikonceptimin e hapësirave të Degës Doganore Kapshticë</i>” në vlerën 4,896,000 leka pa TVSh me kontratën e lidhur mes OE “Gj” shpk dhe AK “Drejtoria e Përgjithshme e Doganës” me nr. 6940/5, datë 04.07.2018 dhe amendimin e kontratës me nr. 19094, datë 17.08.2018. Projekti është finalizuar në datën 01.09.2018.</p> <p>c) “Aeroporti i Rinasit” ku me memon nr. 7980, datë 14.10.2021 nuk ka qenë i parashikuar, nga 12 pikat e kalimit të propozuar. Aeroporti është shtuar në “Terma reference” për projektin e zbatimit me objekt: “<i>Rehabilitim i shesheve dhe zonave kryesore në afërsi të pikave doganore shqiptare</i>”. Gjithashtu “Aeroporti të Rinasit” është nën administrimin e koncesionarit, i cili ka për detyrë për të administruar, operuar dhe mirëmbajtur të gjithë anën ajrore dhe <b>infrastrukturën</b> (përveç kontrollit të trafikut ajror). Sa më sipër përfshirja e tre pikave doganore në procedurën me objekt “<i>Rehabilitimi i shesheve dhe zonave kryesore në afërsi të pikave doganore shqiptare</i>”, sjell efekt financiar negativ në përdorimin e fondeve buxhetore.</p>			<p>përkasin tre pikave doganore për të cilat MTM nuk duhet ti kishte përfshirë në projekt.</p> <p>- Ministria e Turizmit dhe Mjedisit të informojë menjëherë Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave dhe Autoritetit Rrugor Shqiptar në lidhje me ndryshimet që do të kenë në projekt dhe pas finalizimit të dërgojë pikat doganore për të cilat nuk do të realizohet projekti.</p>
A/21	<p>Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt: “<i>Mbyllja, rehabilitimi i mbetjeve urbane nga venddepozitimet ekzistuese (Burrel, Kukës, Libohovë, Përmet, Krujë</i>” për vitin 2021 në vlerën 146,440, 165 lekë u konstatuan se:</p> <p>Dokumentacioni i dorëzuar nga OE, për plotësimin e pikës 4 “<i>Operatori ekonomik, të ketë të punësuar si staf teknik, përveç drejtuesve teknik të kërkuar në pikën 2, punonjësit si më poshtë...</i>” nuk përputhej me kriteret e kërkuar në DST në lidhje me profesionet e stafit.</p> <p>Mosrakordimi midis “<i>Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit</i>” dhe dokumentacionit të dorëzuar përben kusht skualifikimi sipas përcaktimeve të Ligjit nr. 162 datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, neni 76 “Kriteret detyruese për skualifikim” pika 3, shkronja “ë”. Në këto kushte, KVO ka vepruar në kundërshtim me VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 66/3. Veprime në kundërshtim me pikën 2/d të nenit 45 të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar. Në këto kushte, kjo shoqëri ndodhet në kushtet e parashikuara në nenin 13/3 të LPP.</p>	<i>Më hollësisht trajtuar në pikën 1 faqe 72-130 të Raportit të Auditimit</i>	E lartë	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Komisionet e Vlerësimit të Ofertave të marrin masa për eliminimin e praktikave të prokurimit me shkelje ligjore, dhe të shpallura fituese në kushtet e mosplotësimit të kriterëve të kërkuara në DST, me qëllim përdorimin me eficiencë dhe efektivitet të fondeve publike.
A/24	<p>Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt: “<i>Studim mbyllja, rehabilitimi i mbetjeve urbane nga venddepozitimet ilegale</i>” në vlerën 2,640,000 lekë pa TVSh realizuar në vitin 2021 u konstatua se:</p> <p>- Bashkëngjitur dosjes mungojnë shqyrtimi i planeve pranë Komitetit Ndërmënor për Mbetjet, veprime në kundërshtim me VKM-në nr. 846, datë 28.10.2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 452,</p>	<i>Më hollësisht trajtuar në pikën 1 faqe 76-128 të Raportit të Auditimit</i>	E lartë	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, të marrë masa në vijimësi që përpara fillimit të procesit për përmirësimin e venddepozitimeve të vlerësojë dhe të miratojë planin nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit, duke i kaluar për shqyrtim pranë Komitetit Ndërmënor për

	datë 11.7.2012, të Këshillit të Ministrave, “Për lëndfillet e mbetjeve”, të ndryshuar, pika 2 ku përcaktohet se: 25/1 “Në rast se operatorët e një venddepozitimi ekzistues nuk kanë burimet financiare ose aftësitë teknike për të përgatitur planin e përmirësimit të venddepozitimit me kërkesën e operatorit të venddepozitimit, plani i përmirësimit të venddepozitimit dhe rehabilitimi mund të kryhen nga ministria përgjegjëse për mjedisin. 25/2 “Planet e përmirësimit, të dërguara nga operatorët për miratim, pranë Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, pas datës 31 dhjetor 2018, vlerësohen dhe miratohen nga Agjencia dhe kalojnë për shqyrtim pranë Komitetit Ndërmnistror për Mbetjet, në përputhje me parashikimet e këtij vendimi.”; Pika 3.			Mbetjet, në përputhje me parashikimet ligjore.
A/33	Në kontratën me objekt “ <i>Mbyllja, rehabilitimi i mbetjeve urbane nga venddepozitimet ekzistuese (Burrel, Kukës, Libohovë, Përmet, Krujë)</i> ” nga verifikimi në venddepozitimet u konstatuan dëmtime të shtresave mbrojtëse dhe tubave të largimit të shllamit, konkretisht: Në Bashkinë Libohovë dhe Kukës u konstatua se gjeomembrana ishte e dëmtuar dhe ishte e zhvendosur nga era së bashku me shtresën e gjeotekstililit. Gjithashtu tubat e kullimit të llumit në bashkinë Libohovë ishin dëmtuar dhe nuk mund të kryenin funksionin për të cilin ishin vendosur. Shtresat mbrojtëse dhe sistemi i tubacionit për largimin e shllamit të dëmtuara nuk mund të kryejnë funksionin e tyre duke lejuar llumin të kontaminonj terrenin përreth. Në Bashkinë Krujë një pjesë e rrethimit ishte e dëmtuar dhe nuk krijonte një mbyllje të plotë të venddepozitimit dhe kjo bën të mundur hedhjen e mbetjeve nga subjekte të pa autorizuar dhe mbetje të rrezikshme që kërkojnë një trajtim të veçantë. Dëmtimet kanë ardhur si rezultat i keq menaxhimit të investimit nga ana e përfituesit. Mungesa e menaxhimit dhe monitorimit të landfilleve është në kundërshtim me ligjin nr.10463, datë 22.09.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, i ndryshuar; VKM nr.452, datë 11.07.2012 “Për lëndfillet e mbetjeve”.	<i>Më hollësisht trajtuar në pikën 1 faqe 101-109 të Raportit të Auditimit</i>	E lartë	Ministria e Turizmit e Mjedisit në bashkëpunim me sipërmarrësin e punimeve të marrë masa për riparimin e shtresave mbrojtëse të dëmtuara, sistemet e kullimit duke shmangur kontaminimin e mjedisit përreth si dhe rrethimet e dëmtuara për parandalimin e hedhjes së mbetjeve jo të lejuara, për minimizimin e kostove në të ardhmen me rritjen e jetëgjatësisë së landfilleve.
C.1/1	Nga auditimi i zbatimit të kontratës së lidhur midis Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit dhe OE “A. K.” shpk me nr.333/5Prot. datë 25.06.2021 me objekt “ <i>Mbyllja, rehabilitimi i mbetjeve urbane nga venddepozitimet ekzistues (Burrel, Kukës, Libohovë, Përmet, Krujë)</i> ” me vlerë 175,728,198 lekë me TVSH me afat përfundimi të punimeve 6 muaj, sipas dokumentacionit të dosjes teknike dhe verifikimit në terren të kryera nga ana e përfaqësuesve shtetërorë të KLSH në prezencë të përfaqësuesit të mbikëqyrësit (supervizori i punimeve) rezultuan se; Në librezat e masave dhe në situacionet përfundimtar, janë përfshirë volume punimesh të pakryera në fakt, për 2 (dy) zëra punimesh në shumën 264,170 lekë pa TVSH e cila përbën dëm ekonomik ndaj buxhetit të	<i>Më hollësisht trajtuar në pikën 1 faqe 101-109 të Raportit të Auditimit</i>	E lartë	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit të marrë masa, për arkëtimin e shumës 264,170 Lekë pa TVSH, e cila përbën dëm ekonomik në buxhetin e shtetit dhe njësisë vendore, duke ndjekur të gjitha procedurat nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit nga OE “A.K.” shpk sipas kontratës së lidhur me Nr.333/5Prot. datë 25.06.2021 për realizimin e punimeve civile.

	<p>shtetit. Sa më sipër është vepruar në kundërshtim me; Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7, Udhëzimi nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, Kreu II, Pika 8.1, Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar me Udhëzimin Nr. 1, datë 16.6.2011, Kreu I, pika 3, nënpikat 3.2 dhe 3.3; - Kontrata e shërbimit me objekt “Mbikëqyrje të objektit, ‘Mbyllja, rehabilitimi i mbetjeve urbane nga vend-depozitimet ekzistues (Burrel, Kukës, Libohovë, Përmet, Krujë)”, Nr. 2181/8 Prot. datë 16.06.2021.</p>			
C.2/1	<p>Në kontratën me objekt “Mbyllja, rehabilitimi i mbetjeve urbane nga vend-depozitimet ekzistuese (Burrel, Kukës, Libohovë, Përmet, Krujë)” nga verifikimi në vend-depozitim të Bashkisë Kukës mbetjet urbane nuk depozitoheshin në të, vetëm në hyrje të saj kishte një sasi të vogël mbetjesh inerte të cilat bllokoni hyrjen e landfillit. Nga ana e Autoritetit kontraktor nuk ka një monitorim të situatës se ku depozitohen mbetjet urbane të kësaj bashkie pasi objekti është në periudhën e garancisë dhe nuk ka kaluar si investim kapital përfituesit. Ndërtimi i vend-depozitimit është kryer si rezultat i situatës emergjente të mbetjeve në bashkinë Kukës. Nisur nga fakti se ky vend-depozitim nuk është vendosur në shfrytëzim edhe pse ka kaluar një vit nga përfundimi i punimeve dhe marrjes në dorëzim gjë që tregon se, situata e mbetjeve në Bashkinë Kukës nuk ka qenë emergjente dhe investimi i kryer nuk ka qenë efikas. Për sa më sipër vlera e investimit prej 27,921,485 lekë pa TVSH, të kryer në vend-depozitim në Bashkinë Kukës, nga grupi i auditimit konsiderohet shpenzim pa ekonomicitet, efikasitet dhe efektivitet të fondeve publike deri në këtë fazë të menaxhimit të landfillit. Sa më sipër është vepruar në kundërshtim me ligjin nr.10463, datë 22.09.2011 dhe VKM nr.452, datë 11.07.2012 dhe ligjit nr. 9336, datë 26.06.2008.</p>	<p><i>Më hollësisht trajtuar në pikën 1 faqe 101-109 të Raportit të Auditimit</i></p>	E lartë	<p>Ministria e Turizmit e Mjedisit në bashkëpunim Bashkinë Kukës të marrë masa të menjëhershme për verifikimin se ku depozitohen mbetjet urbane si dhe monitorimin e situatës se si menaxhohet trajtimi i tyre, duke shmangur ndotjen e ambientit e ruajtjen e shëndetit publik.</p>
C.2/2	<p>Nga auditimi i Vendimeve gjyqësore, të cilat kanë marrë formë të prerë është konstatuar se, për vitin 2022 është paguar shuma prej 8,145,706 lekë, për ekzekutimin dhe pagesën e 9 vendimeve gjyqësore me detyrimin për “Pagesë page deri në kthim në punë” për ish punonjës të larguar padrejtësisht nga puna, për të cilët vijon pagesa dhe nuk janë marrë parasysh gjatë procesit të ristrukturimit, për faktin se struktura e aparatit të MTM është shkurtuar me 7 punonjës në vitin 2022. Veprime në kundërshtim me Urdhrin nr. 5151, datë 28.10.2015 “Për zbatimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë nga institucionet e administratës shtetërore, të përfshira në fushën e zbatimit të ligjit për shërbimin civil”, me Ligjin nr.10296, datë</p>	<p><i>Më hollësisht trajtuar në pikën 1 faqe 36-47 të Raportit të Auditimit</i></p>	E lartë	<p>Nga Strukturat përgjegjëse të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, të merren masa në bashkëpunim me DAP, për rikthimin në punë të të gjithë punonjësve që kanë fituar këtë të drejtë sipas përcaktimeve të vendimeve gjyqësore të formës së prerë.</p>



	08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, me Ligjin nr.9936, datë 26.06.2008 ”Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”.			
--	---	--	--	--

### I.3. Konkluzioni dhe Opinioni i Auditimit.

Në përfundim të auditimit të përputhshmërisë dhe financiar, të ushtruar në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, për periudhën e veprimtarisë nga 01.01.2020 deri në 31.12.2022, në zbatim të Programit të Auditimit me nr. 325/1, datë 25.04.2023, miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, grupi i auditimit ka arritur në konkluzionin, si më poshtë:

Sa i përket auditimit të përputhshmërisë, subjekti i audituar, në disa raste nuk ka vepruar në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore, të cilat kanë shërbyer si kritere vlerësimi, duke u evidentuar mangësi në përcaktimin e kritereve të vendosura në procedurat e prokurimit, në monitorimin dhe zbatimin e kontratave, të cilat për nga rëndësia kanë rezultuar të jenë materiale, por jo të përhapura, duke mbështetur dhënien e një opinionit të kualifikuar.

Sa i përket auditimit financiar, gjatë auditimit kemi arritur në përfundimin se pasqyrat financiare përmbanin gabime materiale (por jo të përhapura), të cilat sipas gjykimit tonë, kanë efekt në rezultatin financiar të MTM, duke mbështetur dhënien e një opinionit të modifikuar.

### Opinion mbi pasqyrat financiare (i modifikuar<sup>1</sup>)

Grupi i auditimit të KLSH<sup>së</sup>, ka audituar pasqyrat financiare të aparatit të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit për periudhën ushtrimore 01.01.2021-31.12.2022, të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar, pasqyrën e performancës, pasqyrën e ndryshimeve në kapital, pasqyrën e fluksit të mjeteve monetare, pasqyrë mbi gjendjen dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata me koston historike dhe me vlerën neto dhe shënimet shpjeguese që shoqërojnë këto pasqyra.

Auditimi ka përfshirë ekzaminimin, në bazë testimesh, të dokumenteve që mbështesin shumat dhe shpalosjet në pasqyrat financiare, ku u bë vlerësimi i zbatimit të parimeve kontabël të përdorura dhe vlerësimeve të bëra nga drejtuesit, si dhe vlerësimi i paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Sipas opinionit tonë, përveç efekteve të çështjeve të përshkruara në paragrafin e “Bazës për Opinioni e modifikuar”, pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të subjektit më 31 dhjetor 2022, referuar Ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar; Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar; Udhëzimit të MFE me nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar, me Udhëzimin e MFE me nr. 5, datë 21.02.2022, mbi të cilat subjekti i audituar është mbështetur për përgatitjen e pasqyrave financiare. justifikon dhënien e një “Opinionit të modifikuar/kualifikuar”.

### Baza për opinionin:

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit, të INTOSA-it (ISSAI 2000). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen “Përgjegjësitë e audituesit” për pasqyrat financiare. Ne jemi të pavarur nga MTM-ja, në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Nën gjykimin profesional të audituesve të pavarur, duke marrë në konsideratë prapun e materialitetit sasior, të përlllogaritur për vitin 2022 (në masën 07-2% për të gjitha zonat e llogarisë

<sup>1</sup>- Sipas *Manualit të Auditimit Financiar* të KLSH-së, miratuar me vendim nr. 246, datë 29.12.2022, kapitulli 7.3.5 “Opinionet mbi auditimin financiar”, pika 4.2, “Opinion i Modifikuar me rezervë”, jepet në ato raste kur audituesi ka marrë dëshmi të mjaftueshme dhe datë përshtatshme të auditimit dhe arrin në përfundimin se: anomali të apo rasteve të mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale, por jo të përhapura, në llogaritë vjetore apo transaksionet në fjalë.

të planifikuara për t'u audituar) ose në vlerën 6,598 mijë lekë për shpenzimet, gjatë kryerjes së testeve të kontrollit është arritur në përfundimin që sistemi i kontrollit të brendshëm vlerësohen në nivel të mesëm.

*Opinionin e dhënë e mbështesim në faktin se gjatë auditimit kemi arritur në përfundimin se pasqyrat financiare përmbanin gabime materiale (por jo të përhapura), të cilat sipas gjykimit tonë, kanë efekt në saktësinë dhe plotësinë e transaksioneve dhe sistemit të raportimit financiar të MTM, të cilat argumentojnë dhënien e “Opinion të modifikuar”, sipas shpjegimeve në paragrafin e mëposhtëm:*

### **Përshkrimi i çështjeve kryesore:**

- Nga auditimi i detyrimeve dhe vendimeve gjyqësore rezultoi se këto detyrime nuk janë njohur në kontabilitet sipas parimit të të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara, por janë njohur në momentin e likuidimit.

Sa më sipër veprime në kundërshtim me nenin 61, të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, i ndryshuar, si dhe të Udhëzimit të MFE me nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar, paragrafi 34 dhe 42.

- Nga auditimi i analitik i zërave të nr.28 “Caktime të Aktiveve Afatgjata” shuma prej 235,323,285 lekë është mbartur përpara vitit 2017. Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar nuk ka informacion se cilat janë këto projekte/investime të zhvilluara përpara vitit 2017, si dhe nuk kanë emërtim, nuk paraqiten kartela inventariale dhe nuk dihet se çfarë përfaqësojnë.

- Nga auditimi analitik i llogarisë 230 “Investime në proces” gjatë vitit ushtrimor 2021, për 8 projekte në shumën 17,372,947 lekë kanë qenë aktive afatgjata jo materiale në proces ku investimi i tyre ka qenë i pa përfunduar. Këto projekte nuk janë paraqitur në Pasqyrat Financiare të vitit 2021 konkretisht në llogarinë nr.230 “Investime për aktive afatgjata jomateriale”, pasi kjo llogari është paraqitur në vlerën 0 lekë. Këto projekte të pa përfunduara në vitin 2021 duhet të pasqyroheshin në llogarinë nr.230 “Investime për aktive afatgjata jomateriale”, dhe në momentin e marrjes në dorëzim të kapitalizohen më pas tek klasa e aktiveve afatgjata materiale në vlerën e plotë kontabël të aktivitetit;

- Nga auditimi i llogarisë 466 “Kreditore për mjete nën ruajtje” e cila përbëhet nga 10 objekte nga të cilat për 7 objekte në vlerën prej 20,730,648 lekë, janë fonde që gjenden të ngurtësuara deri në vitin 2014, për të cilat është tejkaluar afati i garancisë dhe nuk është bërë zhblllokimi i tyre sipas kushteve të kontratave respektive. Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar nuk ka ndërmarrë asnjë veprim për të bërë zhblllokimin e këtyre fondeve dhe përdorimin e tyre në buxhetin e vet.

- Pasqyra së ndryshimeve në aktivet neto/ fondet neto dhe rakordimi me pasqyrimin e vlerave në pasqyrën e pozicionit financiar në rubrikën C ka një pasqyrim jo të drejtë të vlerave në pasqyrë. Aktivet neto nuk rakordojnë me fondet neto, dhe për disa zëra nuk ka informacion sesi sektori i financës ka arritur në rezultatet e mësipërme. Gjithashtu, në pasqyrën e ndryshimeve të aktiveve neto nuk janë plotësuar të gjithë zërat që përfaqësojnë ndryshimet e ndodhura në nga burimet e brendshme.

- Nga auditimi i procesit të inventarizimit konstatohet se nga strukturat e MTM-së paraqiten mangësi pasi nuk ka relacione shpjeguese për të cilat të jetë kryer vlerësimi i inventarëve, si edhe për këto diferenca të materialeve nëse janë propozuar për vlerësim, e më pas nxjerrje jashtë përdorimi, pra nga ana e MTM-së nuk është ngritur një komision i vlerësimit të aktiveve, rrjedhimisht nuk ka patur as komisione për nxjerrjen jashtë përdorimi/asgjësimi të aktiveve. Veprimet e mësipërme janë kryer në kundërshtim me Udhëzimin nr.30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pika 104.

- Për procedurat e inventarizimit të ngritur me Urdhër të SP komisioni i inventarizimit përbëhet nga tre anëtarë, ndër të cilët në përbërje të tyre ka patur Specialistin e Sektorit të Financës në

Drejtorinë e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar, si dhe Përgjegjës të Sektorit të Shërbimeve. Në këtë proces nuk u konstatua firmosja e deklaratave të mungesës së konfliktit të interesit;

- Nga auditimi i procesit të kalimit të aktiveve, mbështetur në Urdhrat përkatës kalim papagesë, u konstatua mungesë dokumentacioni si: kartela e llogaritjes së vlerës së amortizimit të akumuluar dhe të llogaritur nga subjekti deri në momentin e daljes nga pronësia, ku nga MTM-ja është regjistruar në kontabilitet vlera e kostos historike të tyre;

-MTM ka një regjistër elektronik për aktivet afatgjata, i cili nuk është përditësuar me vlerën aktuale të aktiveve që institucioni ka në pronësi.

### **Përgjegjësia e strukturave drejtuese të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit**

Strukturat drejtuese të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit janë përgjegjëse për përgatitjen dhe prezantimin e saktë të pasqyrave financiare në përputhje me kërkesat e “Kudrit rregullator” dhe kërkesat e tjera në kuadrin e raportimit financiar në fuqi, si dhe funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, i nevojshëm për përgatitjen e pasqyrave financiare, dhe për të shmangur gabimet apo mashtrimet. Staf i drejtues është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikën, ligjet dhe rregulloret e aplikuara (kriteret e vlerësimit). Personat përgjegjës për drejtimin janë përgjegjës për kontrollin e procesit të raportimit financiar. Staf i drejtues është përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me të gjitha ligjet dhe rregulloret në fuqi. Titullari i Institucionit, Sekretari i Përgjithshëm (në cilësinë e Nëpunësit Autorizues), janë përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar.

### **Përgjegjësia e audituesit të KLSH për auditimin e Pasqyrave Financiare Vjetore.**

Përgjegjësia e audituesit të KLSH, është që të shprehë një opinion për Pasqyrave Financiare Vjetore në bazë të auditimit të kryer. Përgjegjësia e audituesit të KLSH, lidhet me garantimin e sigurisë së arsyeshme, nëse pasqyrat financiare në tërësi, nuk paraqesin anomalie materiale, për shkak të gabimit apo mashtrimit, kështu si pasaktësi apo gabime që mund të kenë ekzistuar, nëse veprimtaria e subjektit të audituar është zhvilluar në përputhje me kriteret, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin një opinion. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesi i KLSH, gjithashtu aplikon edhe gjykimin dhe skepticizmin e tij profesional në punën e audituesit. Në gjithashtu: Gjatë vlerësimit të risqeve, audituesi merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga subjekti, në mënyrë që të përcaktojë procedura auditimi që janë të përshtatshme për rrethanat e subjektit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontroleve të brendshme të subjektit. Auditimi përfshin edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e përlogaritjeve kontabël të bëra nga subjekti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare. Identifikojmë dhe vlerësojmë risqet e anomalive materiale në pasqyrat financiare, për shkak të gabimeve ose mashtrimeve, projekteve dhe zbatimeve procedurë auditimi të cilat u përgjigjen këtyre rreziqeve, si dhe marrim evidence auditimi të plota dhe të mjaftueshme për të krijuar bazat e opinionit tonë.

### ***Opinion për auditimin e përputhshmërisë (Kualifikuar<sup>2</sup>).***

Mbështetur në, ISSAI 4000 “Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Përputhshmërisë”, Rregulloren e Procedurave të Auditimit të KLSH dhe Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë në auditim të përputhshmërisë e veprimtarisë së institucionit Ministria e Turizmit dhe Mjedisit me kriteret e vlerësimit përfshirë kuadrin ligjor, rregullat, rregulloret dhe marrëveshjet që lidhen dhe ndikojnë në përdorimin e fondeve/burimeve të këtij institucioni gjatë ushtrimit të aktivitetit përkatës.

<sup>2</sup> -Referuar Manualit të Auditimit të Përputhshmërisë të KLSH-së, (vendim nr. 245, datë 29.12.2022. fq.104), Kapitulli VII, pika 7.3.3 “Angazhimet e Vërtetimit me Siguri të Arsyeshme”, Konkluzionet/ Opinione të pakualifikuara: “Kur nuk janë gjetur apo konstatuar raste të mospërputhjeve materiale në një angazhim të sigurisë së arsyeshme, audituesi shpreh opinionin të pamodifikuar ose të pakualifikuar që informacioni i përgatitur, është në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e aplikueshme”.

*“Në opinionin tonë, bazuar në evidencat e auditimit dhe dokumentacionin e vënë në dispozicion kemi konstatuar se në veprimtarinë e MTM, janë evidentuar devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi, të përshkruara në paragrafin e “Bazës për Opinionin”, të cilat nën gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale por jo të përhapura dhe justifikojnë dhënien e një opinionit të kualifikuar të përputhshmërisë.*

### **Baza për opinionin e përputhshmërisë.**

Në kemi audituar veprimtarinë e subjektit Ministria e Turizmit dhe Mjedisit (MTM) në zbatim të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, ISSAI 4000 dhe ISSAI 100, paragrafi 42. Auditimi u krye në përputhje me kërkesat e Manualit të Auditimit të Përputhshmërisë të KLSH-së si dhe Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit të zbatueshme për Institucionet Supreme të Auditimit (ISSAI-s); me parimet INTOSAI-PI, “Deklarata e Limës”; INTOSAI P-10, “Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t”, si dhe INTOSAI P-12, INTOSAI P-20 dhe INTOSAI P-50, apo edhe çështje të tjera që lidhen me auditimin përputhshmërisë, të cilat janë përmendur në ISSAI-n 4000 “Standardi i Auditimit të Përputhshmërisë”. Në i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura, përfshirë këtu edhe Kodin e Etikës së KLSH-së, miratuar me Vendimin nr. 56, datë 30.04.2015, të Kryetarit të KLSH-së. Sipas kërkesave etike, të cilat janë relevante për auditimin tonë në institucionet publike, KLSH është e pavarur nga MTM dhe përgjegjësitë janë përmbushur në pajtim me këto kërkesa.

Në besojmë së dëshmitë e evidencës së auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për sigurimin e bazës për përgatitjen e *opinionit të kualifikuar* mbështetur në konstatimet në vijim:

- Nga auditimi u konstatua se nga 65 investimet që janë referuar që prej planifikimit buxhetor afatmesëm dhe deri në realizimin e tyre për vitin 2022, 24 prej tyre ose 37% në shumën 78,974,000 lekë nuk janë planifikuar në PBA 2022-2024, nga të cilat 2 investime janë planifikuar dhe miratuar në buxhetin fillestar të vitit 2022. Veprimet në kundërshtim me Ligjin nr. 9936 datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, VKM 185, datë 29.03.2018 “Për procedurat e menaxhimit të investimeve publike”, pika 7 dhe Udhëzimin e MFE nr. 7, datë 28.02.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm” Pika 8.

- Nga auditimi u konstatua se aparati i MTM, si njësi shpenzuese, nuk ka hartuar raporte monitorimi 4-8-12 mujore për të ndjekur realizimin e produkteve të buxhetit të saj, për të garantuar përmirësimin e procesit të planifikimit dhe menaxhimit të buxhetit, ndjekjen dhe arritjen e qëllimit dhe objektivave të synuara, sipas deklaratës së politikës së programit, si dhe krahasimin e treguesve të planifikuar të performancës me treguesit faktik.

- Nga auditimi i dokumentacionit të shpenzimeve të kryera për procedurat e prokurimit blerje me vlera të vogla rezultoi se mungonte dokumentacioni shoqërues për kërkesat e kërkuara në ftesën për ofertë, veprime në kundërshtim me Udhëzimin e APP-së nr. 3, datë 08.01.2018, pika 16.

- Nga auditimi i procedurave të prokurimit rezultoi se:

a) Kriteret e vendosura dhe të kërkuara nga AK nuk janë të argumentuar dhe kanë mbivendosje. NJP është mjaftuar vetëm me citimin e bazës ligjore, veprime në kundërshtim të VKM-së me nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” pika 2 e nenit 78 “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit”.

b) KVO ka kualifikuar OE, të cilët nuk plotësojnë kriteret e vendosura në DT veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

c) Komisioni i marrjes në dorëzim mallrave/shërbimeve kanë hartuar procesverbalin e marrjes në dorëzim, por plotësimi i tyre është thjesht formal, duke ju referuar faturës dhe kontratës pa një përshkrim të hollësishëm të zërave/analizave të mallrave/shërbimeve të marra në dorëzim.

d) Nga auditimi i zbatimit të kontratës “Mbyllja, rehabilitimi i mbetjeve urbane nga venddepozitimet ekzistuese (Burrel, Kukës, Libohovë, Përmet, Krujë)” rezultuan disa pasaktësi për

punime të pakryera, por të likuiduara dhe mbivendosje të zërave të punimeve në vlerën 264,170 lekë pa TVSH.

- Nga auditimi i projekteve për zhvillimit të turizmit rezultoi se:

a) Ministria e Turizmit dhe Mjedisit nuk ka zhvilluar proces studimi dhe planifikimi, sipas prioriteteve që ministria duhet të ketë çdo vit.

b) Komisioni i Përzgjedhjes së Projekteve në procesverbalet e mbajtura ndër vite nuk jep argumente në lidhje me projektet e përzgjedhura dhe të kualifikuara si fitues nëse ato kanë impakt në planin e zhvillimit turizmit.

c) Mungonte vendosja e logos së financuesit, përgjithësisht për pjesën e projekteve të cilat ishin në media vizive të shkruar apo elektronike të realizuara, veprime në kundërshtim me nenin 6, pika 3, të kontratave të lidhura mes përfituesit dhe Financuesit/MTM.

d) Nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit nuk ka asnjë plan monitorimi periodik me objektiva të qarta mbi këto projekte të finalizuar, e cila ka çuar në mungesën e një analize mbi impaktin që kanë pasur dhe kanë këto projekte në zhvillimin e turizmit.

- Nga auditimi i Vendimeve gjyqësore, të cilat kanë marrë formë të prerë është konstatuar se, për vitin 2022 është paguar shuma prej 8,145,706 lekë, për ekzekutimin dhe pagesën e 9 (nëntë) vendimeve gjyqësore me detyrimin për “Pagesë page deri në kthim në punë” për ish punonjës të larguar padrejtësisht nga puna, për të cilët vijon pagesa.

### **Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar lidhur me çështjet nën auditim:**

Drejtimi i Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit janë përgjegjëse për zbatimin e veprimtarisë në përputhje me politikat, ligjet dhe rregulloret e aplikuar.

### **Përgjegjësia e Audituesve të KLSH-së:**

Përgjegjësia jonë lidhet me garantimin e sigurisë së arsyeshme mbi përputhshmërinë e aktivitetit të MTM, në lidhje mbi menaxhimin e fondeve buxhetore vjetorë të saj, për sigurimin e kushteve të duhura për zbatimin me rigorozitet të të gjitha detyrimeve që rrjedhin nga kuadri ligjor ekzistues të personave me liri të kufizuar. Përveç standardeve ISSAI, audituesi i KLSH, gjithashtu aplikon edhe gjykimin dhe skepticizmin profesional në punën audituese.

Ne komunikojmë me drejtuesit ndër të tjera, edhe për planifikimin në kohë dhe përmbajtjen e auditimit si dhe konkluzionet/gjetjet. Ne identifikojmë çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin dhe i përshkruajmë ato në materialet e auditimit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

## **II. Hyrja.**

Mbështetur në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e KLSH”, në zbatim të Programit të Auditimit me nr. 325/1, datë 25.04.2023, në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, nga data 27.04.2023 deri më datën 14.07.2023, për periudhën e auditimit 01.01.2020-31.12.2022, u krye auditim Financiar dhe Përputhshmërie, nga grupi i auditimit me përbërje:

1. J.G, (përgjegjës grupi),
2. A. Gj, anëtar
3. I.I, anëtar
4. S. H, anëtar

### **1. Objektivat dhe qëllimi i auditimit:**

**Objektivat specifike të auditimit** është përputhshmëria e veprimtarisë së subjektit, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit me kuadrin rregullator në fuqi, duke përfshirë këtu procedurat e prokurimit dhe shpenzimet vjetore të institucionit.

Ligji nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të

Shtetit” në nenin 3 të tij ka përcaktuar se, “Auditim i përputhshmërisë nënkupton dhënien e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, mbi shkallën e ndjekjes nga subjekti i audituar të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat është rënë dakord”. Në nenin 12 “Auditimi i përputhshmërisë” të po këtij ligji është shprehur se: “Në auditimet e përputhshmërisë, Kontrolli i Lartë i Shtetit duhet të përcaktojë: nëse të ardhurat dhe shpenzimet kanë qenë në përputhje me ligjin e Buxhetit të Shtetit, me aktet përkatëse ligjore e nënligjore dhe me parimet e ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin; nëse janë zbatuar parimet e përgjithshme të sistemit të menaxhimit financiar të sektorit publik dhe të sjelljes së zyrtarëve të sektorit publik”. Në pikën 2 të po këtij neni ka përcaktuar se “Auditim financiar” nënkupton një vlerësim të pavarur, që rezulton në një opinion me siguri të arsyeshme, nëse gjendja e raportuar financiare e një subjekti të audituar, rezultatet dhe përdorimi i burimeve janë paraqitur në mënyrë të drejtë dhe në përputhje me kuadrin ligjor të raportimit financiar.

ISSAI 4000, paragrafi 23: Objektivi kryesor i auditimit të përputhshmërisë është t’i sigurojë përdoruesit të synuar informacione nëse entitetet publike të audituara ndjekin vendimet parlamentare, ligjet, aktet legjislative, politikat, kode të përcaktuara dhe terma të dakordësuar.

ISSAI 1700, paragrafi 4: Objektivi i audituesit është të formulojë një opinion mbi besueshmërinë e llogarive vjetore dhe bazuar në një vlerësim të përfundimeve të hartuara nga evidencat e marra të auditimit të shprehë qartë opinionin nëpërmjet një raporti të shkruar që shpjegon bazat e opinionit.

Objektivat e auditimit synojnë:

**a.** Dhënien e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacioni përputhen, në të gjitha aspektet materiale, me kriteret e aplikuara si: rregullat, ligjet, politikat, kodet e vendosura apo termat dhe kushtet, mbi të cilat është rënë dakord, ku mund të përmendim si burim të këtyre kriterëve: standarde, ligje, vendime të Këshillit të Ministrave, rregullore, buxhete, kontrata, marrëveshje, instrumente të tjerë që përmbajnë rregulla se si duhet të menaxhohen transaksionet dhe zbatohen buxhetet, etj.

**b.** njehëresh aspektet e rregullshmërisë (respektimi i kriterëve formale siç janë ligjet përkatëse, rregulloret dhe marrëveshjet) dhe ligjshmërisë (respektimi i parimeve të përgjithshme që rregullojnë menaxhimin e shëndoshë financiar dhe sjelljen e zyrtarëve publik).

**c.** promovimin e një qeverisje të mirë, duke identifikuar dhe raportuar devijimet nga kriteret, në mënyrë që të merren veprime korrigjuese si dhe të identifikojë personat përgjegjës për veprimet e tyre.

Dhënien e vlerësimeve të pavarura mbi funksionimin e sistemeve dhe nënsistemeve të kontrollit të brendshëm dhe komponentëve të menaxhimit financiar të subjektit, nëpërmjet përcaktimit nga ana e audituesve:

-nëse janë zbatuar parimet e përgjithshme të sistemit të menaxhimit financiar të sektorit publik dhe të sjelljes me integritet të zyrtarëve të sektorit publik.

-nëse të ardhurat dhe shpenzimet janë realizuar në përputhje me ligjin e Buxhetit të Shtetit, me aktet përkatëse ligjore e nënligjore dhe me parimet e ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin;

- verifikimin e përgjegjësisë financiare të subjekteve përgjegjëse, nëpërmjet ekzaminimit dhe vlerësimit të të dhënave financiare,

- auditimin e sistemeve financiare dhe transaksionet, duke përfshirë edhe vlerësimin e përputhshmërisë me ligjet dhe rregulloret;

**2. Qëllimi i auditimit** është vlerësimi nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacionet e raportuara janë në çdo aspekt material, në përputhje me ligjshmërinë dhe menaxhimin financiar, mbi bazën e të cilit ushtron veprimtarinë Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, në mënyrë për të bërë të mundur ndërmarrjen e veprimeve korrigjuese sipas rastit, me synim të mirë përdorimit të fondeve të financuara nga Buxheti i Shtetit.

**3. Identifikimi i çështjes:**

Raporti Përfundimtar synon të identifikojë përmbushjen e rolit dhe të përgjegjësive të institucionit

të Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, që burojnë nga kuadri ligjor dhe dispozitat nënligjore në fuqi, Fushëveprimi i këtij auditimi është vlerësimi me siguri të arsyeshme i veprimtarisë së “Ministritë së Turizmit dhe Mjedisit”, për periudhën objekt auditimi nga 01.01.2020 deri në 31.12.2022, në përputhje me aktet ligjore të cilat rregullojnë veprimtarinë e këtij institucioni. Përputhshmëria dhe rregullshmëria në procedurat e ndjekura nga ana e drejtorive përkatëse të MTM, të cilat realizojnë koordinimin dhe zbatimin e strategjive që orientojnë në hartimin dhe zbatimin e politikave të përgjithshme të institucionit.

Në funksion të këtij angazhimi, janë vlerësuar aktivitetet që kanë të bëjnë me respektimin e kritereve mbi administrimin e shpenzimeve, buxhetimin dhe menaxhimin financiar, prokurimet publike, respektimin e organigramës dhe të strukturës organike, etj. Në fokusin e angazhimit janë përgatitja dhe miratimi i Pasqyrave Financiare Vjetore nga ana e këtij institucionit në mbështetje të dispozitave ligjore dhe akteve të tjera nënligjore në fuqi nënligjore në fuqi në fushën e kontabilitetit të sektorit publik dhe pasqyrave financiare, si dhe aspektet e zbatimit të kërkesave të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar e kontrollin”, i ndryshuar.

Aktivitetet që ishin objekt vlerësimi nga ana e grupit të auditimit, janë parashikuar sipas drejtimeve të miratuara nga Kryetari i KLSH-së, në programin e auditimit me nr. 325/1, datë 25.04.2023.

#### **4. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar lidhur me çështjen nën auditim:**

Niveli menaxherial i Ministritë së Turizmit dhe Mjedisit është përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikat, ligjet dhe rregulloret e aplikuara. Stafi menaxherial është përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me të gjitha ligjet dhe rregulloret në fuqi.

#### **5. Përgjegjësia e Audituesve të KLSH:**

Audituesit e KLSH<sup>-së</sup> kanë përgjegjësi në dhënien e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacioni përputhen apo jo, në të gjitha aspektet materiale, me kriteret e paracaktuara, e shpreh nëpërmjet opinionit të auditimit, duke respektuar Standardet Ndërkombëtare të Auditimit sipas INTOSAI, si dhe kodin e etikës me qëllim që të arrihet niveli i arsyeshëm i sigurisë për dhënien e këtij opinionit.

Audituesit e KLSH<sup>-së</sup> kanë përgjegjësi të respektojnë kërkesat etike dhe të planifikojnë dhe kryejnë auditimin me qëllim që të arrijnë nivelin e sigurisë të arsyeshme për faktin nëse Pasqyrat Financiare, nuk kanë gabime materiale, pra pasqyrat në tërësi nuk përmbajnë gabime materiale qoftë nga mashtrimi ose gabimi. Siguria e arsyeshme i referohet një niveli të pranueshëm sigurie, por nuk garanton asnjëherë sigurinë absolute, dhe auditimi në pajtueshmëri (apo në përputhje) me standardet nuk presupozohet që të zbulojë gjithnjë një gabim material kur ai ekziston.

Audituesit e KLSH<sup>-së</sup> kanë përgjegjësi që nëpërmjet auditimit të realizuar, të krijojnë bindjet për të shprehur një opinionin mbi çështjet që janë nën auditim.

Audituesit e KLSH<sup>-së</sup> kanë përgjegjësi në dhënien e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacioni përputhen, në të gjitha aspektet materiale, me kriteret e aplikuara si: rregullat, ligjet, politikat, kodet e vendosura apo termat dhe kushtet, mbi të cilat është rënë dakord, ku mund të përmendim si burim të këtyre kritereve: standarde, ligje, vendime të Këshillit të Ministrave, rregullore, buxhete, kontrata, marrëveshje, instrumente të tjerë që përmbajnë rregulla se si duhet të menaxhohen transaksionet dhe zbatohen buxhetet etj;

- njëherësh aspektet e përputhshmërisë (respektimi i kritereve formale siç janë ligjet përkatëse, rregulloret dhe marrëveshjet) dhe ligjshmërisë (respektimi i parimeve të përgjithshme që rregullojnë menaxhimin e shëndoshë financiar dhe sjelljen e zyrtarëve publik);

- promovimin e një qeverisje të mirë, duke identifikuar dhe raportuar devijimet nga kriteret, në mënyrë që të merren veprime korrigjuese si dhe të identifikojë personat përgjegjës për veprimet e tyre.

Përgjegjësia jonë (*Audituesit e KLSH-së*) është që nëpërmjet auditimit të realizuar të krijohen bindjet, si dhe të shprehet opinioni i grupit të auditimit mbi aspektet që duhet të vlerësojë:

- a) nëse shpenzimet janë ekzekutuar në përputhje me ligjin e Buxhetit të Shtetit, me aktet përkatëse ligjore e nënligjore dhe me parimet e ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin;
- b) nëse janë zbatuar parimet e përgjithshme të sistemit të menaxhimit financiar të sektorit publik dhe të sjelljes së zyrtarëve të sektorit publik;
- c) nëse janë zbatuar kërkesat e përcaktuara në ligjet dhe aktet normative përkatëse, si Ligji Organik i Buxhetit apo Ligji i Prokurimit Publik, etj.
- b) nëse janë reflektuar shkeljet e institucionit të audituar, të evidentuara në auditimet e kaluara;
- c) Interesin publik ose pritshmëritë publike (p.sh. shkelje të identifikuar nga media, etj.)
- d) Fusha specifike që janë objekt i fokusit ligjvënës, etj;

Në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të INTOSAI-t, përkatësisht ISSAI 100 “Parimet themelore të auditimit në Sektorin Publik” (*rishikimi i vitit 2019*), paragrafi 41 “Materialiteti” dhe ISSAI 400 “Parimet e auditimit të përputhshmërisë”, (*rishikimi i vitit 2019*), paragrafi 47, ku nënvizohet se:

*“Audituesit duhet të marrin në konsideratë materialitetin gjatë gjithë procesit të auditimit. Përcaktimi i materialitetit është çështje gjykimi profesional dhe varet në interpretimin e auditorit të nevojave të përdoruesve. Një çështje mund të gjykohet material nëse njohuritë për të do të kishin të ngjarë të ndikonin në vendimet e përdoruesit e synuar. Ky gjykim mund të ketë të bëjë me një çështje individual ose me një grup të çështjeve të marra së bashku. Materialiteti shpesh konsiderohet në kuptim të vlerës, por gjithashtu ka aspekte të tjera sasiore si dhe cilësore. Karakteristikat e qenësishme një çështjeje ose grupi të çështjeve mund të jenë materiale nga vetë natyra e saj. Një çështje mund të jetë gjithashtu materiale për shkak të kontekstit në të cilin ndodh”*

Sa më sipër, audituesit aplikojnë konceptin e materialitetit në mënyrë korrekte gjatë planifikimit dhe kryerjes së auditimit. Auditimi përfshin kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi auditimi rreth praktikave administrative e financiare, rreth shumave dhe raportimit të shifrave në Pasqyrat Financiare. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i audituesit, duke përfshirë këtu edhe vlerësimin e rreziqeve nga gabimi material, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

## **6. Kriteret e vlerësimit:**

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Ligji organik i KLSH-së nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”;
- Ligji 10296, datë 08.07.2010 “Mbi menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, i ndryshuar me ligjin nr. 57, datë 02.06.2016;
- Ligji nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar;
- Ligji nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” i ndryshuar;
- VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”; i ndryshuar me VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”;
- VKM nr. 187, datë 08.03.2017 “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve, në kryeministri, aparatet e ministrive të linjës, administratën e presidentit, kuvendit, komisionit qendror të zgjedhjeve, gjykatën e lartë, prokurorinë e përgjithshme, disa institucione të pavarura, institucionet në varësi të kryeministrit, institucionet në varësi të ministrave të linjës dhe administratën e prefektit”;
- Udhëzimi MFE nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësisve të Qeverisjes së Përgjithshme”; i ndryshuar me Udhëzimin MFE me nr. 5, datë 21.02.2022.
- Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2012 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë



e sektorit publik”;

- Urdhër i MFE nr. 54, datë 15.07.2010 “Për miratimin e manualit të MFK”;

- Udhëzimi MFE nr. 37, datë 06.10.2020 “Për monitorimin dhe publikimin periodik të stokut të detyrimeve të prapambetura të qeverisjes së përgjithshme”;

- Udhëzimet standard të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, për planifikimin, monitorimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit.

- Rregullore e brendshme “Mbi Procedurat e auditimit në KLSH”, miratuar me vendimin nr. 107, datë 08.08.2017 të Kryetarit të KLSH<sup>se</sup> e ndryshuar;

## 7. Standardet e Auditimit

Auditimi është kryer në përputhje me procedurat e përgjithshme të pranura të kuadrit ligjor, rregullator dhe Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit. Projekt Raporti i auditimit është hartuar në përputhje me kërkesat e Rregullores së Procedurave të Auditimit në KLSH, mbështetur në:

- Ligjin nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”;

- INTOSAI – P - 1 “Deklarata e Limës”;

- INTOSAI – P – 10 - 99 “Parimet themelore të INTOSAI”;

- INTOSAI – P - 10 “Deklarata e Meksikës mbi pavarësinë e SAI”;

- INTOSAI – P - 12 “Vlerat dhe përfitimet e SAI – sjellja e ndryshimit në jetën e qytetarëve”;

- INTOSAI – P - 20 “Parimet e Transparencës dhe Llogaridhënies”;

- INTOSAI – P - 50 “Parimet e juridiksionit të SAI”;

- ISSAI 100 - 129 “Parimet themelore të auditimit të sektorit publik”;

- ISSAI 2000 - 2899 “Standardet e Auditimit Financiar”;

- ISSAI 400 “Parimet e Auditimit të Përputhshmërisë”;

- ISSAI 4000 “Standardet e Auditimit të Përputhshmërisë”;

- ISSAI 2705 “Modifikimet e opinionit në Raportin e Audituesit të Pavarur”;

- Manualin e Auditimit Financiar, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 246, datë 29.12.2022;

- Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 245, datë 29.12.2022.

## 8. Metodatat e auditimit

Mbështetur në **ISSAI 1315**, objektivi i audituesit është identifikimi dhe vlerësimi i risqeve e anomalive materiale në pasqyrat financiare si edhe nivelin e pohimeve, nëpërmjet të kuptuarit të njësisë dhe mjedisit të saj, duke përfshirë kontrollin e brendshëm të njësisë dhe duke krijuar kështu bazën për hartimin dhe implementimin e përgjigjeve kundrejt risqeve të vlerësuara të gabimeve materiale.

Nisur nga gjykimi profesional i audituesit dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, grupi i auditimit përcaktoi materialitetin në masën 07-2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t’u audituar, ku si bazë për përlllogaritjen e materialitetit janë marrë shpenzimet. Nga përlllogaritjet që grupi i auditimit kreu, për institucionin e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, niveli i materialitetit për vitin 2022 rezultoi në vlerën 6,598 mijë lekë.

Pas përcaktimit të nivelit të materialitetit, grupi i auditimit ka kryer vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm në institucion sa i takon: (a) hartimit; (b) implementimit; dhe (c) funksionimit të 5-të komponentëve të kontrollit të brendshëm. Vlerësimi i kontrollit të brendshëm është bazuar në kryerjen e testeve të kontrolleve. Gjatë kryerjes së testeve të kontrollit është arritur në përfundimin që sistemet e kontrollit të brendshëm paraqesin risk të ulët deri në të moderuar.

Metodat e auditimit janë bazuar tek kombinimi i testeve të ndryshme të auditimit; në funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm; në procedurat bazë dhe në procedurat analitike pas testeve të kryera me qëllim arritjen e objektivave të auditimit.

Në varësi të çështjeve të auditimit dhe vlerësimit të audituesve, janë përdorur veçmas ose të kombinuara, metodat dhe teknikat e mëposhtme:

a. *Verifikimi i transaksioneve* - duke marrë informacion për një rrethanë ose transaksion nga një

burim i caktuar, dhe krahasimin me një informacion të marrë për të njëjtat transaksione, por me origjinë nga një burim tjetër;

b. *Intervistimi* - duke marrë informacion nëpërmjet pyetjeve drejtuar personelit kyç të subjektit për një çështje të caktuar, e kombinuar kjo me shqyrtimin e evidencave përkatëse;

c. *Raporte dhe informacione* - shfrytëzimi i raporteve/ informacioneve relevante dhe të që kanë lidhje me objektivat e auditimit dhe specifiku drejtimeve të auditimit;

d. *Pyetësorët për vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm* - duke marrë informacionet e funksionimit të sistemit së kontrollit të brendshëm dhe menaxhimit financiar të subjektit;

g. *Modelimet e thjeshta statistikore* – në lidhje me përzgjedhjen sa më përfaqësuese të shembullit për shqyrtim në çështje të caktuara të auditimit;

h. *Verifikimi në sistem dhe në terren*- me përzgjedhje të çështjeve të veçanta të auditimit, sipas drejtimeve të auditimit;

g. *Të kombinuara*, sipas rastit dhe vlerësimit të audituesve.

Audituesit e KLSH janë përpjekur në çdo rast në përzgjedhjen e arsyeshme dhe të mjaftueshme të metodave dhe teknikave veçmas dhe/ose të kombinuara, si dhe shtrirjen e tyre për të dhënë siguri të arsyeshme në arritjen e konkluzioneve të auditimit.

Auditimi ynë ka përfshirë përputhshmërinë e aktivitetit të MTM, me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi lidhur me zbatimin e kriterëve në planifikimin e buxhetit, mbështetur në ligjet vjetore të buxhetit dhe udhëzimeve të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, mbi hartimin dhe zbatimin e buxhetit, identifikimin, zbatimin e kriterëve në çeljen e buxhetit sipas viteve, detajimin e planit fillestar, transferimet dhe rialokimet e fondeve buxhetore gjatë viteve ushtrimore, si dhe planin përfundimtar, parashikimin dhe realizimin e të ardhurave dytësore, planifikimin mbi identifikimin vlerësimin dhe menaxhimin e riskut nga institucioni, ruajtjen, arkivimin e informacioneve dokumenteve, procedurat për qarkullim e dokumentacionit, prokurimet duke filluar nga buxhetimi i fondit, hartimi i specifikimeve, komisionet e vlerësimit, kontraktuesi, zbatuesi i kontratës, procedurat për pagesat, etj.

### **9. Dokumentimi i auditimit**

Dokumentimi i rezultateve të auditimit u mbështetet në kërkesat e Manualit të Auditimit Përputhshmërisë miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së me nr. 245, datë 29.12.2022; Manualin e Auditimit Financiar, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së me nr. 246, datë 29.12.2022, si edhe në Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit ISSAI 1230 “*Dokumentimi i Auditimit*”.

Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore, rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra të auditimit, si dhe çështje të rëndësishme, që dolën gjatë auditimit, përfundimet e arritura në drejtim të tyre dhe gjykimet e rëndësishme profesionale të bëra në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e audituesve dhe shërbeu si një burim informacioni për përgatitjen e tyre.

Teknikat e kontrollit të përdorura gjatë auditimit janë; *kontrolli aritmetik, kontrolli me anë të pjesëve justifikuese, inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese, kontrolli i vlerësimit, konfirmim nga të tretët, kontrolli sipas një treguesi.*

## **III. PËRSHKRIMI AUDITIMIT**

### **1. Informacioni i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim:**

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, ka për mision hartimin dhe zbatimin e politikave që synojnë mbrojtjen e mjedisit, përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore, mbrojtjen e natyrës dhe të

biodiversitetit, zhvillimin dhe menaxhimin e qëndrueshëm të pyjeve dhe kullotave, monitorimin e cilësisë së ujerave, si dhe hartimin dhe zbatimin e politikave për turizmin.

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit e ushtron veprimtarinë e saj në këto fusha të përgjegjësisë shtetërore, në përputhje me legjislacionin përkatës:

a) Sektorin e Mjedisit, përfshirë politikën, standardet e trajtimit të mbetjeve dhe të efekteve që sjellin në drejtim të ajrit dhe mjedisit, cilësinë e ajrit, zhurmat, ndotjen industriale, kimikatet, ndryshimet klimatike dhe monitorimin e treguesve të mjedisit dhe të cilësisë së ujerave, vlerësimin e ndikimit në mjedis.

b) Natyrën dhe biodiversitetin, përfshirë florën dhe faunën, mbrojtjen e toke nga erozioni e degradimi, mbrojtjen e peizazhit natyror, mbrojtjen e faunës së egër e të specieve dhe zonat e mbrojtura.

c) Sektorin e Pyjeve dhe të Kullotave.

d) Harton dhe zbaton politika për një zhvillim të qëndrueshëm të turizmit, nëpërmjet nxitjes së investimeve në fushën e turizmit, ngritjes dhe monitorimit të sistemit të standardeve në turizëm dhe edukimit në vazhdim të biznesit në fushën e turizmit, promovimit të produktit dhe destinacioneve turistike, koordinimit dhe bashkëpunimit me strukturat shtetërore, pushtetin vendor dhe funksione të tjera, të cilat do të mbulohen nga institucionet e varësisë, aparati i ministrisë dhe degët territoriale.

## **2. Rezultatet e auditimit sipas drejtimeve të auditimit:**

### **2.1 Hartimi dhe zbatimin i buxhetit të shtetit.**

#### **1. Mbi hartimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit**

Në zbatim të pikës/ drejtimit 1 “Mbi hartimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit” u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- 1) *Programet Buxhetore Afatmesëm(PBA) 2021-2023, 2022-2024 dhe PBA-në 2023-2025;*
- 2) *Projektbuxheti për vitin 2020, 2021 dhe 2022, si dhe shkresat e ndryshimit të buxhetit gjatë vitit ushtrimor 2020, 2021, 2022;*
- 3) *Raportet e monitorimit të 4, 8 dhe 12-mujore të realizimit të buxhetit 2020, 2021, 2022;*
- 4) *Parashikimi dhe realizimi i të ardhurave dytësore.*

Auditimi u krye për vitin 2020, 2021 dhe vitin 2022, në zbatim të:

- Ligjit me nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar;
- Ligjit nr. 88/ 2019 “Për buxhetin e vitit 2020”,
- Ligjit nr. 137/2020 “Për buxhetin e vitit 2021”,
- Ligjit nr. 115/2021 “Për buxhetin e vitit 2022”, i ndryshuar,
- VKM nr. 523 datë 25.07.2019 “Për miratimin e tavaneve përgatitore të shpenzimeve për PBA 2020-2022”.
- VKM nr. 577, datë 22.07.2020 “Për miratimin e tavaneve përgatitore të shpenzimeve për PBA 2021-2023”.
- VKM nr.190. date 03.03.2021 "Për miratimin e tavaneve përgatitore të shpenzimeve për PBA 2022-2024".
- VKM nr. 440 datë 22.7.2021 “Për miratimin e tavanëve përfundimtarë të shpenzimeve të programit buxhetor Afatmesëm 2022-2024”.
- Udhëzimit nr. 7, datë 28.2.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm”,
- Udhëzimit nr. 28, datë 10.07.2020 “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2021 - 2023”,
- Udhëzimit nr. 8, datë 26.2.2021 “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2022 - 2024”,

- Udhëzimit nr. 22, datë 08.07.2022 “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2023 - 2025”;
- Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 119, datë 3.3.2021 “Për miratimin e tavaneve përgatitore të shpenzimeve të Programit Buxhetor Afatmesëm 2022 -2024”
- Udhëzimin e Ministrisë së Financave, nr. 22, datë, 17.11.2016 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit për njësitë e qeverisjes qendrore”;
- Udhëzimin plotësues nr. 1, datë 10.1.2022 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2022”;
- Udhëzimit të MFE nr. 36 datë 17.12.2019 “Për përgjegjësitë e përdoruesve në sistemin informatik të menaxhimit financiar për modulën e përgatitjes së buxhetit, modulën e menaxhimit të investimeve publike dhe modulën e monitorimit të buxhetit dhe portofolit të projekteve”
- etj.

Aparatit të Ministrisë dhe nëpërmjet saj institucioneve të varësisë i planifikohen nga buxheti i shtetit për çdo vit fonde buxhetore.

MTM ka në përbërje të buxhetit të saj katër programe:

- Programin nr. 1110 “Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi”;
- Programin nr. 5320 “Mbrojtja e Mjedisit”;
- Programin nr. 4260 “Administrimi i Pyjeve”;
- Programin nr. 4760 “Zhvillimi i turizmit”;

Njësi të varësisë të MTM për vitin 2020, 2021 dhe 2022 janë gjithsej 13 (trembëdhjetë) njësi dhe konkretisht:

- Agjencia Kombëtare e Mjedisit dhe 4 Agjencitë Rajonale;
- Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura;
- Agjencia Kombëtare e Bregdetit dhe 4 Agjencitë Rajonale;
- Agjencia Kombëtare e Turizmit;
- Agjencia Kombëtare e Pyjeve.

### **a. Zbatimi i kriterëve në planifikimin e buxhetit, mbështetur në ligjet vjetore të buxhetit dhe udhëzimeve të Ministrisë së Financave mbi hartimin dhe zbatimin e buxhetit.**

#### **Për vitin 2020**

Në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit vendimmarrjet mbi procedurat e miratimit të PBA, projektbuxhetit dhe monitorimit të zbatimit të buxhetit nuk janë kryer nga ana e Grupit të Menaxhimit Strategjik në kundërshtim me Pikën 8/b, Nenit 8 të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar. Për planifikimin e PBA dhe projekt buxhetit të vitit 2021 konstatohet të mos jetë ngritur Grupi i Menaxhimit Strategjik sipas Urdhrit të Ministrit, por konstatohet ngritje e Ekipit të Menaxhimit të Programeve buxhetore me Urdhrin e Ministrit nr. 5398 prot, datë 28.07.2020 “Për ngritjen e Ekipeve të menaxhimit të programeve buxhetore” janë caktuar drejtuesit dhe anëtarët e ekipeve të menaxhimit të katër programeve që administrojnë MTM, i ndryshuar me Urdhrin e Ministrit me nr. 334/ 8576 prot, datë 24.12.2020 “Për krijimin e Ekipeve të Menaxhimit të Programeve (EMP)” sipas këtij urdhri kanë ndryshuar drejtuesit e dy prej programeve buxhetore “Planifikim, Menaxhim dhe Administrim” si dhe “Mbrojtja e Pyjeve”.

Në institucionin e MTM caktimi i drejtuesit të EMP-së është bërë në përputhje me përcaktimet e pikës 2.5.1/a të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 7, datë 28.2.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm”, ku përcaktohet se: “1. Në varësi të organizimit të njësisë së qeverisjes qendrore drejtuesi i Ekipit të Menaxhimit të programit buxhetor është b) Në njësitë e qeverisjes qendrore që zbatojnë më shumë se një program buxhetor, drejtues programi si rregull konsiderohet drejtuesi i nivelit më të lartë në varësi direkte nga nëpunësi autorizues.

Nëpunësi zbatues ka përgatitur dokumentin përfundimtar të buxhetit konform Pikës 2/a dhe 3/a, Nenit 12 të Ligjit nr. nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar. Ky dokument është miratuar nga Nëpunësi autorizues dhe është dërguar MFE konform Pikës 4/d, Nenit 9 të Ligjit nr. nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar.

Nga auditimi i hartimit të PBA-ve për periudhën objekt auditimi u konstatua se, është hartuar deklarata e politikës së programit, produktet e programit si dhe aktivitetet e programit, ku çdo program ka të përcaktuar produktet e programeve buxhetore.

Çeljet e buxhetit vjetor 2020 i janë dërguar nga MFE me shkresën nr. 24325/39, datë 16.01.2020 “Dërgohet miratimi i detajimit të buxhetit për vitin 2020” sipas së cilës plani fillestar i buxhetit për vitin 2020 për shpenzimet korrente rezulton në shumën 1,310,630 mijë lekë. Miratimi i buxhetit për shpenzimet kapitale është dërguar me shkresën nr. 24325/236, datë 24.02.2020 “Dërgohet detajimi i buxhetit 2020-2022 për shpenzimet kapitale”, sipas të cilit rezulton se plani fillestar buxhetor për vitin 2020 për shpenzimet kapitale rezulton në shumën 930,400 mijë.

### **Buxheti fillestar, transferimet dhe monitorimi buxhetit për vitin 2020:**

Gjatë auditimit u konstatua se përgjatë vitit 2020 janë kryer gjithsej 30 (tridhjetë) rialokime si rezultat i Akteve Normative, VKM të veçanta që kanë prekur MTM, fondit të veçantë dhe rialokimeve të brendshme. Ndryshimet përfaqësojnë ndryshimet e planit të buxhetit në zbatim të VKM-së nr.95, datë 05.02.2020 ‘Për rishpërndarjen e numrit të punonjësve organikë dhe të fondeve buxhetore në Njësitë e Qeverisjes Qendrore, për vitin 2020’, VKM-së nr.88, datë 31.01.2020 “Për një shtesë fondi për rindërtimin, në buxhetin e miratuar, për akomodimin e përkohshëm të të dëmtuarve në qarqet Durrës, Tiranë e Lezhë”, VKM-së nr. 378, datë 08.05.2020 “Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2020, miratuar për Ministrinë e Turizmit, fondet e akorduara si fonde shtesë nga fondi i veçantë si edhe në zbatim të Aktit Normativ nr. 15, datë 15.04.2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr. 88/2019, Për Buxhetin e vitit 2020”, Aktit Normativ nr. 28, datë 02.7.2020 “Për disa ndryshime në Ligjin Nr. 88/2019, “Për buxhetin e vitit 2020”, të ndryshuar, Aktit Normativ nr. 34, datë 16.12.2020 “Për disa ndryshime në Ligjin Nr. 88/2019, “Për buxhetin e vitit 2020”, të ndryshuar.

Prej rialokimeve buxheti fillestar i akorduar MTM në shumën 2,241,030 mijë lekë është rritur në shumën 2,719,929 mijë lekë, pra 478,899 mijë lekë ose 21% më shumë se buxheti fillestar. Në këndvështrimin e programeve buxhetore për të cilat MTM realizon shpenzime konstatohet se rritjen më të lartë e ka patur programi “Zhvillimi i turizmit” në shumën 261,993 mijë lekë dhe programi “Administrimi i pyjeve” në shumën 201,150 mijë lekë.

*Tabela nr. 1 “Rishikimi i buxhetit të MTM dhe realizimi faktik për vitin 2020 sipas programeve”*

<i>Programi</i>	<i>Fakti 2019</i>	<i>Buxheti fillestar 2020</i>	<i>Buxheti rishikuar 2020</i>	<i>Ndryshimi buxhetit plan 2020</i>	<i>Fakt 2020</i>	<i>Realizim %</i>
Planifikim, Menaxhim Administrim	214,209	203,000	198,471	(4,529)	186,941	94%
Mbrojtja e mjedisit	762,706	967,088	987,373	20,285	884,288	90%
Administrimi pyjeve	683,955	576,812	777,962	201,150	687,682	88%
Zhvillimi i turizmit	582,948	494,130	756,123	261,993	645,255	85%
Shpenzime nga të ardhurat jashtë limitit	14,836	-	-	-	4,483	0%
<b>Total</b>	<b>2,258,654</b>	<b>2,241,030</b>	<b>2,719,929</b>	<b>478,899</b>	<b>2,408,649</b>	<b>89%</b>

*Burimi: MTM, përpunuar nga grupi i auditimit*

<b>Titulli i Gjetjes:</b>	Fondet e çelura në vitin 2020, për akomodimin e përkohshëm të të dëmtuarve nga tërmeti për qarqet Durrës, Tiranë e Lezhë” dhe “Riatdhesuarit prej Covid 19”.
<b>Situata:</b>	Gjatë auditimit të realizimit të buxhetit për vitin 2020 u konstatua se:

- Me VKM nr. 88, datë 31.01.2020 “Për një shtesë fondi për rindërtimin, në buxhetin e miratuar në MTM për vitin 2020, për akomodimin e përkohshëm të të dëmtuarve në qarqet Durrës, Tiranë e Lezhë” në mbështetje të shkresës së MTM me nr. 1102, datë 04.02.2020, MTM i janë akorduar fonde nga fondi rezervë dërguar nga MFE me shkresën nr. 2203/1, datë 05.02.2020 “Akordim fondesh në zbatim të VKM nr. 88, datë 31.01.2020” në shumën 200,000 mijë lekë si shpenzim korrent (602) për Agjencinë Kombëtare të Bregdetit në kodin e produktit 92603AB “Monitorime të kryera përgjatë vijës bregdetare”. Nga auditimi i raportit të monitorimit për vitin 2020 nuk u konstatua raportim për këtë produkt as në relacionin shpjegues dhe as në Aneksin nr. 3 “**Raporti përmbledhës i realizimit të treguesve të performancës/produkteve të programit**”, në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave, nr. 22, datë, 17.11.2016 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit për njësitë e qeverisjes qendrore”, Pjesa I, Pika 4, “*Monitorimi është një proces vlerësimi performance i cili realizohet nëpërmjet krahasimit të treguesve faktikë të performancës me ato të planifikuar*” dhe Pika 5 “*Monitorimi i produkteve bëhet në sasi dhe në vlerë*” IV Raporti i monitorimit: “*raporti i monitorimit konsiston në ...shpjegimet përkatëse lidhur me ndryshimet e buxhetit nga plani fillestar deri në atë përfundimtar, në nivel programi dhe artikulli*” dhe Udhëzimin nr. 7, datë 28.02.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së PBA” Pjesa 2.5. Përgjegjësitë e Drejtuesit të Ekipit të Menaxhimit të Programit Pika 2. “*Drejtuesit e Ekipit të Menaxhimit të programit janë përgjegjës dhe raportojnë, përpara nëpunësit autorizues, për hartimin e kërkesave buxhetore për programin përkatës, për realizimin e qëllimeve, objektivave, treguesve të performancës dhe produkteve të programit gjatë procesit të zbatimit të buxhetit*”.

Aneksi nr. 3 i mësipërm për vitin 2020 është plotësuar vetëm për investimet dhe nuk është plotësuar për gjithë produktet sipas programeve duke mos pasqyruar përdorimin e fondeve në dispozicion të shpenzimeve korrente në sasi dhe kosto, veprim i cili cënon sigurimin e informacionit për të përmirësuar procesin e menaxhimit të buxhetit por dhe transparencë në përdorimin e fondit rezervë të buxhetit për vitin 2020.

Akordimi i fondit për rindërtimin për vitin 2020 fillimisht nuk ka qenë i evidentuar në një produkt të veçantë me objektiv të lidhur me rindërtimin, por i inkorporuar në produktin “**Monitorime të kryera gjatë vijës bregdetare**” të Agjencisë Kombëtare të Bregdetit duke cënuar konceptin e produktit dhe programit, sipas përcaktimeve të Ligjit nr. 9936 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor”, të ndryshuar, Pikat 27, 31 dhe 32 “*Program buxhetor*” është një grup veprimtarish të njësisë së qeverisjes së përgjithshme, që administrohen efektivisht dhe kontribuojnë së bashku në prodhimin e produkteve të identifikueshme dhe të matshme, të cilat ndihmojnë, drejtpërdrejt ose tërthorazi, në arritjen e objektivave dhe të qëllimeve të politikës buxhetore së tij, dhe “*Produkte*” janë mallrat dhe shërbimet e siguruara nga kryerja e veprimtarive buxhetore të programit buxhetor. Produktet që nuk janë të ngjashme duhet të veçohen. Çelja e produktit të ri përkatës është bërë në fund të vitit 2020 me kod 92603AD “Të dëmtuar nga tërmeti të akomoduar përkohësisht” me konfirmimin e MFE me shkresë nr. 23038/1, datë 22.12.2020 “Mbi sistemimin e fondit të rindërtimit sipas kodeve të produkteve specifike”.

	<p><i>Megjithë çeljen e produktit të ri gjatë auditimit nuk u konstatua raportim i zbatimit të këtij produkti për vitin 2020 në Aneksin nr. 3 të raportit të monitorimit për vitin 2020, pasi pakësimi i fondeve nga produkti i parë 92603AB “Monitorime të kryera gjatë vijës bregdetare” të Agjencisë Kombëtare të Bregdetit është konfirmuar nga MFE me shkresën nr. 23038/2, datë 18.01.2021 “Mbi sistemimin e fondit të rindërtimit sipas kodeve të produkteve specifike”.</i></p> <p><i>- Nga MTM nuk është çelur <b>një kod i ri për riadhesimin</b> në kundërshtim me Udhëzimin plotësues nr. 2, datë 20.01.2020 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2020”, pika 9 për detajimin e fondeve buxhetore sipas klasifikimit buxhetor me kod produkti. Për riadhesimin sipas VKM nr. 378, datë 8.5.2020 “Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2020, miratuar për Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, për mbulimin e shpenzimeve të akomodimit të personave që riadhesohen” fonde e akorduara për MTM kanë kapur vlerën 95,200 mijë lekë, për të cilat përgjatë vitit 2020 janë përdorur 70,444 mijë lekë, ose 24,755 mijë lekë më pak se fondet e akorduara por, nga MTM nuk disponohet informacion mbi numrin e personave të akomoduara. Nga MTM raportohet për produktin “Monitorime të kryera gjatë vijës bregdetare” si për aktivitetin e monitorimit të kryer nga Agjencia Kombëtare e Bregdetit ashtu dhe për të riadhesuarit prej Covid 19, duke bërë që raportimi i këtij shpenzimi të humbasë gjurmën e auditimit dhe transparencën në raportim. Në Aneksin nr. 3 për programin “Zhvillimi i turizmit” mungojnë produktet e shpenzimeve korrente, si dhe nuk përshkruhen komente mbi produktet e raportuara. Produkte janë mallrat dhe shërbimet e siguruara nga kryerja e veprimtarive buxhetore të programit buxhetor. Ato duhet të jenë të ngjashme në natyrë dhe të orientuara drejt objektivave të caktuara të politikave dhe prioriteteve të qeverisë, kur është e përshtatshme. Nëse produktet nuk janë homogjene dhe nuk kontribuojnë për arritjen e një rezultati, si rregull, ato mund të ndahen në dy programe të veçanta buxhetore sipas përcaktimeve të dispozitave ligjore.</i></p> <p><i>Në realizimin e produkteve të shpenzimeve kapitale është konstatuar se është bërë krahasimi i tyre me planin e rishikuar buxhetor, por për produktet e shpenzimeve korrente për të gjithë programet e MTM nuk ka raportim në lidhje me sasinë dhe vlerën krahasuar me planifikimin buxhetor dhe realizimin progresiv në fund të vitit 2020, veprim që çënon gjurmën e auditimit dhe plotësinë e raportimit të realizimit të buxhetit në lidhje me Aneksin nr. 3, në kundërshtim me Udhëzimit të MFE nr. 22, datë, 17.11.2016 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit për njësitë e qeverisjes qendrore”, Pika 49 dhe UMF nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar”, Pika 267. “Raportet e monitorimit duhet të përfshijnë informacion mbi arritjet në terma sasiore dhe vlerore të produkteve të realizuara, të identifikojnë mosarritjet dhe të shpjegojnë shkaqet e tyre duke propozuar në të njëjtën kohë masa për përmirësimin e situatës”.</i></p>
<p><b>Kriteri:</b></p>	<p>Ligjit nr. 9936 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor”, të ndryshuar, Pikat 27, 31 dhe 32;</p> <p>Udhëzimin nr. 7, datë 28.02.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së PBA” Pjesa 2.5, pika 2;</p> <p>Udhëzimit të MFE nr. 22, datë, 17.11.2016 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit për njësitë e qeverisjes qendrore”, pika 49;</p>

	UMF nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar.
<b>Ndikimi/Efekti:</b>	Cenimi i sigurimit të informacionit për të përmirësuar procesin e menaxhimit të buxhetit, por dhe transparencë në përdorimin e fondit rezervë të buxhetit për vitin 2020. Humbja e gjurmës së auditimit, transparencën dhe plotësinë në raportim e realizimit të buxhetit.
<b>Shkaku:</b>	Mosplotësimi i anekseve dhe raporteve sipas ligjit dhe udhëzimit të buxhetit.
<b>Rëndësia:</b>	E lartë
<b>Rekomandim:</b>	Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar të marrë masa që në raportet e monitorimit të plotësohen të plotë anekset, sipas të gjitha produkteve të planifikuara në sasi dhe vlerë.

Raporti i monitorimit për vitin 2020 është dërguar MFE më shkresën nr. 9263, datë 29.03.2021 “Dërgohet raporti i monitorimit për vitin 2020” jashtë afateve të përcaktuara në UMF nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar”, Pika 270 “Nëpunësit autorizues të njëjësive të qeverisjes qendrore, duhet të paraqesin raportet e monitorimit tek Nëpunësi i Parë Autorizues, deri në fund të javës së katërt mbas përfundimit të katër mujorit dhe konkretisht deri në 30 Maj, 30 Shtator, ndërsa raporti vjetor deri në fund të muajit Shkurt të vitit të ardhshëm, sipas të dhënave përfundimtare, pas rakordimeve me Ministrinë përgjegjëse për Financat”.

Realizimi faktik i vitit 2020 për MTM rezulton në shumën 2,408,649 mijë lekë ose 89% kundrejt buxhetit të rishikuar dhe 107% kundrejt buxhetit fillestar, përmbledhur në tabelën e mëposhtme sipas artikujve buxhetorë:

Tabela nr. 2 “Realizimi i shpenzimeve për vitin 2020 sipas artikujve buxhetorë”

Artikujt buxhetorë	Fakti	Buxheti fillestar	Buxheti rishikuar	Fakti
	2019	2020	2020	2020
Paga (600)	729,050	866,000	708,892	614,938
Sigurime (601)	121,886	145,100	148,190	100,607
Mallra e shërbime (602)	553,336	286,170	604,170	518,368
Transferta korrente të brendshme (604)	4,048	7,000	7,000	4,350
Transferta korrente të huaja (605)	2,980	6,000	21,200	20,932
Transferta për buxhet fam e individë (606)	1,453	360	5,798	5,520
Kapitale (230-232) Të Brendshme	496,018	540,400	445,679	412,297
Kapitale (230-232) Të Huaja	335,047	390,000	779,000	727,154
Shpenzime nga të ardhurat jashtë limitit	14,836	-	-	4,483
<b>Totali</b>	<b>2,258,654</b>	<b>2,241,030</b>	<b>2,719,929</b>	<b>2,408,649</b>

Burimi: MTM, përpunuar nga grupi i auditimit

Për vitin 2020 me Aktin normativ nr. 34, datë 16.12.2020 për MTM u akordua fondi prej 60,000 mijë lekë për likuidimin e vendimeve gjyqësore i cili është përdorur për realizimin e shlyerjes së detyrimeve për vendimet gjyqësore dhe konkretisht 140 vendimeve të formës së prerë në shumën 80,623,172 lekë.

Projektet e investimeve me financim të brendshëm të realizuar për vitin 2020 janë përmbledhur në **Aneksi nr. 1/1: “Buxheti fillestar dhe Realizimi i shpenzimeve kapitale për vitin 2020 sipas programeve”**, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

## **Për vitin 2021**

Ashtu si në vitin 2020 edhe në këtë vit nuk ka një Urdhër të Ministrit të MTM mbi ngritjen e Grupit të Menaxhimit Strategjik në kundërshtim me Pikën 8/b, Nenit 8 të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar.



Me Urdhrin e Ministrit nr. 334, prot., 8576, datë 24.12 “Për ngritjen e Ekipeve të menaxhimit të programeve (EMP)” janë caktuar drejtuesit dhe anëtarët e ekipeve të menaxhimit të katër programeve që administrojnë MTM për vitin 2021.

### **Planifikimi buxhetor i vitit 2021-2023**

Në zbatim të Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 7, datë 28.02.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm”, MTM ka dërguar kërkesat për “Projekt Buxhetin për vitin 2021-2023”, mbështetur në formatin udhëzues për kryerjen e parashikimit të shpenzimeve.

Me shkresën nr. 2057/1, prot., datë 30.04.2021, MTM dërgon në MFE “Mbi Projekt Buxhetin Afatmesëm 2021 – 2023 për MTM” (faza e parë/ strategjike), dhe me shkresën nr. 5398/1, datë 31.08.2020 “Mbi Projekt Buxhetin Afatmesëm 2021 - 2023” janë dërguar kërkesat buxhetore të fazës së dytë/ teknike. Planifikimi buxhetor sipas PBA 2021-2023, faza strategjike dhe teknike krahasuar me buxhetin e vitit 2020 paraqitet si më poshtë:

*Tabela nr:3 “Planifikimi buxhetor afatmesëm 2021- 2023 faza teknike”*

*Në mijë lekë*

Planifikimi Artikujt	Buxheti 2020	PBA 2021 – 2023 Faza teknike		
		2021	2022	2023
Paga (600-601)	1,011,100	797,790	797,790	797,790
Korente të Tjera (602-606)	299,530	372,840	393,210	393,210
Kapitale (230-232) Të Brendshme	540,400	834,400	750,000	420,100
Kapitale (230-232) Të Huaja	390,000	590,000	590,000	390,000
<b>Totali</b>	<b>2,241,030</b>	<b>2,595,030</b>	<b>2,531,100</b>	<b>2,007,100</b>

*Burimi: MTM, Përpunuar nga grupi auditimit*

Planifikimi buxhetor strategjik në shumën totale 11,059,064 mijë lekë paraqitet për llogarinë 600 “paga” në shumën 1,982,400 mijë lekë, për llogarinë 601 në shumën 341,589 mijë lekë, për llogarinë 602 në shumën 1,579,365 mijë lekë, për llogarinë 605 “transfera të jashtme” në shumën 21,600 mijë lekë, llogarinë 606 “transfera për familjet e individët” në shumën 1,755,320 mijë lekë, llogarinë 230 “aktive të trupëzuara” në shumën 30,000 mijë lekë dhe llogarinë 231 “aktive të trupëzuara” në shumën 5,348,790 mijë lekë.

Planifikimi buxhetor faza e dytë paraqitet për llogarinë 600 dhe 601 “paga dhe sigurime” në shumën 797,790 mijë lekë dhe është bërë në zbatim të tavanit të miratuar dhe kategorive të 879 punonjësve në zbatim të VKM nr. 187, datë 08.03.2017, VKM nr. 202, datë 15.03.2017 dhe Urdhrave të Kryeministrit nr. 165, datë 05.10.2017 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së MTM” dhe Urdhrave të Kryeministrit që miratojnë strukturat e Agjencisë Kombëtare të Zonave të mbrojtura, Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, Agjencisë Kombëtare të Turizmit, Agjencisë Kombëtare të Bregdetit dhe Agjencisë Kombëtare të Pyjeve, për të cilat shpërndarja e fondit të pagave është bërë në programet përkatëse buxhetore. Fondi i pagave për vitet 2021-2023 paraqitet më i ulët në shumën 213,310 mijë lekë për arsye të ristrukturimit të MTM dhe Institucioneve të varësisë. Një pjesë e Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve, Ujërave dhe Turizmit me një përbërje prej 220 punonjësish kanë kaluar në varësi të Ministrisë së Brendshme, si dhe është bërë ristrukturimi i Agjencisë Kombëtare të Mjedisit dhe Agjencive të saj Rajonale, Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura si dhe krijimit të Agjencisë Kombëtare të Pyjeve.

Në planifikimin buxhetor për llogarinë 602 “Mallra e shërbime” në shumën totale 372,840 mijë lekë, janë planifikuar shpenzimet për: telefon, shërbim postar duke marrë parasysh ndryshimin e tarifave dhe rritjes së detyrimeve ndaj A., Shërbimit Postar, internetit; për shpenzime për udhëtime e dieta pasi puna e Ministrisë në vitet 2021-2023 planifikohet të përqendrohet akoma më shumë në kontrollin e mjedisit dhe pyjeve; rritjen e nevojave për karburant si rezultat i shtimit të numrit të kontrolleve dhe lëvizjeve në terren; rritjen e nevojave për energji elektrike si rezultat rritjes se

tarifave ndaj KESH, si dhe furnizimit me pellet për nevojat e ngrohjes; për rritjen e numrit të kontrolleve nga policia pyjore dhe strukturave të mbrojtjes nga zjarri në kushtet e thatësirës sezonale ciklike; për rritjen e numrit të pajisjeve dhe gatishmërisë për parandalimin dhe shuarjen e zjarreve në pyje dhe kullota; për pagesa sipas situacioneve për shuarjen e zjarreve; për pagesa për vendimet gjyqësore të formës së prerë. Në relacionin shoqërues të kësaj PBA konstatohet kërkesa shtesë për fondin prej 210,000 mijë lekë për likuidimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë për vitin 2021.

Planifikimi për llogarinë 605 “transferata të jashtme” është bazuar në kontributet në konventat, protokollet dhe organizma të tjerë në të cilat MTM është palë, për llogarinë 606 “transferata korrente të brendshme” është bazuar në kuotat e kompensimit të karburantit për stafin e MTM.

Projektet me investim të brendshëm të planifikuar nga MTM sipas programeve janë përmbledhur në tabelën e mëposhtme:

*Tabela nr. 4: “Planifikimi i shpenzimeve kapitale të aparatit të MTM me investim të brendshëm në PBA 2021-2023 Faza teknike”*

*Në mijë lekë*

<b>Programi</b>	<b>Shpenzime kapitale me investim të brendshëm</b>	<b>Vlerë plan</b>
1110	Pajisje e zyrave me pajisjet e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit	4.000
1110	Orendi pajisje për godinën e re	2.000
5320	Pasaporta dixhitale mjedisore	2.000
5320	Mbyllja, rehabilitimi i mbetjeve urbane nga venddepozitimet ekzistuese	27.300
4260	Tvsh e projektit "Shërbimet mjedisore"	40.000
4260	Hartimi i metodikës për rishikimin e planeve të menaxhimit në zonat e mbrojtura dhe zbatimi i saj në 5 zona pilot	39.900
4760	Fondi për zhvillimin e turizmit	34.000
4760	Masterplani për zonat me përparësi zhvillimin turizmit	55.845
4760	Sistemimi i zonës së pelegrinazhit në malin e Tomorrit	26.000

*Burimi: MTM, përpunuar nga grupi i auditimit*

Projektet me financim të jashtëm përfshihen në programet “Mbrojtja e mjedisit” dhe “Administrimi i pyjeve”. Këto projekte kanë donatorë të huaj si BE, Banka Botërore, KFW, SIDS, GIZ, UNDP, UNIDO dhe GEF. Projekte zbatohen nga njësitë e projekteve në zyrat e donatorëve. Kërkesat buxhetore për to për zërat si financim i huaj, kosto lokale dhe TVSh janë përfshirë në PBA ardhur nga zyrat e zbatimit të projekteve dhe bashkërenduan me të dhënat e financimit nga buxheti për planifikimit buxhetor të MTM.

Në programin “Zhvillimi turizmit” janë planifikuar kërkesa shtesë në llogarinë 602 “Mallra e shërbime” për promovimin e turizmit dhe organizimin e panairëve në shumën totale 90,000 mijë lekë. Për investime me këtë PBA janë paraqitur kërkesa shtesë në shumën totale 1,496,000 mijë lekë sipas **Aneksi nr. 1/2: “Kërkesat shtesë në PBA 2021-2023”** bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

### ***Transferimet dhe rialokimet e fondeve buxhetore për vitin 2021, si dhe realizimi i planit përfundimtar i buxhetit për vitin 2021***

Çelja e buxhetit për vitet 2021-2023 për shpenzimet korrente është dërguar nga MFE me shkresën nr. 23724/65, datë 14.01.2021 “Dërgohet miratimi i detajimit të buxhetit për vitet 2021-2023”, sipas së cilës buxheti fillestar 2021 për shpenzimet korrente të MTM rezulton në shumën 1,143,630 mijë lekë. Çelja e buxhetit për shpenzimet kapitale është dërguar nga MFE me shkresën 23724/209, datë 08.02.2021 “Dërgohet detajimi i buxhetit të vitit 2021-2023 për shpenzimet kapitale” sipas së cilës buxheti fillestar 2021 për shpenzimet kapitale të MTM rezulton në shumën 1,124,400 mijë lekë.

Detajimi i limitit mujor të fondeve të MTM është bërë mbështetur në ligjin nr. 137, datë 16.11.2020 “Për buxhetin e vitit 2021” dhe UMF nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” i ndryshuar.

Për të 4 programet e kësaj ministrie situata në lidhje me buxhetin fillestar dhe buxhetin me ndryshimet e ndodhura gjatë vitit, paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Tabela nr. 5: “Diferencat midis buxhetit fillestar dhe përfundimtar 2021”

Në mijë lekë

Programi	Buxheti Fillestar 2021	Buxheti i Rishikuar 2021	Diferencat
Planifikim, Menaxhim Administrim	198,000	241,271	43,271
Mbrojtja e mjedisit	1,031,000	1,008,636	-22,364
Administrimi pyjeve	502,900	759,300	256,400
Zhvillimi i turizmit	536,130	542,723	6,593
<b>Total</b>	<b>2,268,030</b>	<b>2,551,930</b>	<b>283,900</b>

Burimi: MTM, përpunuar nga grupi i auditivit

Diferencat lidhen me ndryshimet si rezultat i detajimit të Fondit të veçantë, në zbatimin e Aktive Normative dhe rialokimeve të miratuara nga MFE dhe rialokimeve të brendshme. Ndryshimet përfaqësojnë ndryshimet e planit të buxhetit në zbatim të VKM-së nr. 188, datë 25.03.2021 ‘Për rishpërndarje fondesh ndërmjet programeve buxhetore, në buxhetin e vitit 2021’, ndryshimet në zbatim të Aktit Normativ nr.15, datë 15.04.2021 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 137/2020, “Për Buxhetin e vitit 2021”, Aktit Normativ nr. 26, datë 22.06.2021 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 137/2020, “Për Buxhetin e vitit 2021”, në zbatim të VKM nr. 278 datë 15.05.2021 “Për një shtesë fondi në buxhetin e vitin 2021, miratuar për Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit për mbështetjen e Turizmit Shqiptar për promovimin në tregjet ndërkombëtare post Covid-19”, Aktit Normativ nr. 34, datë 03.12.2021 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 137/2020, “Për Buxhetin e vitit 2021”, si dhe fondet e akorduara si fonde shtesë nga fondi i veçantë.

Buxheti i rishikuar ka pësuar rritje në shumën totale 283,900 mijë lekë, si rezultat i rritjes së fondeve për programin “Administrimi i pyjeve” në shumën 256,400 mijë lekë.

Titulli i Gjetjes:	Mangësi në planifikimin dhe raportimin në sasi dhe kosto të projekteve.
<b>Situata:</b>	Nga auditimit i rialokimeve të buxhetit të MTM u konstatua se, Ministria së Turizmit dhe Mjedisit, në buxhetin e miratuar për vitin 2021, në programin “Zhvillimi i turizmit”, në artikullin 602 (shpenzime operative), për Agjencinë Kombëtare të Turizmit i është shtuar fondi prej 100,000,000 (njëqind milionë) lekë, për përballimin e shpenzimeve për mbështetjen e turizmit shqiptar për promovimin në tregjet ndërkombëtare post COVID-19 dhe prezantimin e Shqipërisë si një destinacion mikpritës COVID-free. Efekti financiar, prej 100,000,000 (njëqind milionë) lekësh, është përballuar nga <i>fondi rezervë i buxhetit të shtetit</i> për vitin 2021. Me shkresën e MFE me nr. 9534/1, datë 03.06.2021 “Mbi zbatimin e VKM nr. 278, datë 12.05.2021” MTM i janë akorduar fondet për produktin 92603AE “Promovim i turizmit shqiptar në tregjet ndërkombëtare Post Covid 19” në shumën 100,000,000 lekë. Ky produkt nuk ka qenë i planifikuar në PBA 2021-2023 në programin “Zhvillimi i turizmit” dhe në monitorimin vjetor 2021 nuk është raportuar në lidhje me sasinë dhe koston për njësi, por vetëm në realizimin në masën 99% duke mos u identifikuar realizimi i objektivave gjatë raportimit buxhetor për to.

<b>Kriteri:</b>	Ligjit nr. 9936 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor”, të ndryshuar, Udhëzimin nr. 7, datë 28.02.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së PBA” Pjesa 2.5, pika 2; Udhëzimit të MFE nr. 22, datë, 17.11.2016 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit për njësitë e qeverisjes qendrore”, pika 49; UMF nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar.
<b>Ndikimi/Efekti:</b>	Humbja e gjurmës së auditimit, transparencën dhe plotësinë në raportim e realizimit të buxhetit.
<b>Shkaku:</b>	Mungesë e detajimit të fondeve nga strukturat përgjegjëse.
<b>Rëndësia:</b>	E lartë
<b>Rekomandim:</b>	Drejtorja e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar të marrë masa që në raportet e monitorimit të plotësohen të plota anekset, sipas të gjitha produkteve të planifikuara në sasi dhe vlerë.

Gjatë auditimit u konstatua se me VKM nr. 332, datë 02.06.2021 “Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2021 miratuar për MTM për pagesën e studios për çështjen e anulimit të vendimit të arbitrazhit ICSID case nr. ARB/.....” janë miratuar fondet në shumën 43,000,000 lekë. Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, në buxhetin e miratuar për vitin 2021, në zërin 602 “Shpenzime korrente”, të programit buxhetor 01110 “Planifikim, menaxhim, administrim”, i është shtuar fondi prej 43,000,000 (dyzet e tre milionë) lekësh, për kryerjen e pagesës për detyrimet që rrjedhin ndaj Studios “G.....” WLG për procesin e anulimit të vendimit të arbitrazhit ndërkombëtar, datë 20.3.2020, ICSID Case No. ARB/, ndërmjet shoqërisë “A. A.” shpk dhe të tjerë, kundër Republikës së Shqipërisë. Në kërkesat shtesë të PBA 2022-2024 konstatohet se për llogaritë korrente konstatohet kërkesë në shumën 100,000 mijë lekë për procesin e arbitrazhit ndërkombëtar.

Nga krahasimi i planifikimit buxhetor dhe raportit të monitorimit për vitin 2021 u konstatua se, planifikimi buxhetor për projektin e investimit “Mbyllja, rehabilitimi i mbetjeve urbane nga venddepozitimet ekzistuese (Burrel, Kukës, Libohovë, Përmet, Krujë” në PBA faza teknike rezulton në shumën 27,300 mijë lekë, ndërsa në buxhetin fillestar 80,000 mijë lekë, ndërsa projektin e investimit “Blerje pajisje TIK” në shumën 4,000 mijë lekë.

Realizimi i shpenzimeve buxhetore për vitin 2021 paraqiten në shumën 2,448,736 mijë lekë ose 108% kundrejt buxhetit fillestar dhe 96% kundrejt buxhetit të rishikuar, sipas tabelës së mëposhtme dhe sipas artikujve buxhetorë:

Tabela nr. 6 “Realizimi i shpenzimeve për vitin 2021 sipas artikujve buxhetorë”

Në mijë lekë

Artikujt buxhetorë	Fakti	Buxheti fillestar	Buxheti rishikuar	Fakti
	2020	2021	2021	2021
Paga (600)	614,938	659,700	601,799	582,004
Sigurime (601)	100,607	118,090	108,833	96,159
Mallra e shërbime (602)	518,368	335,480	476,548	448,447
Transferta korrente të brendshme (604)	4,350	10,000	2,890	2,702
Transferta korrente të huaja (605)	20,932	20,000	20,000	16,040
Transferta për buxhet fam e individë (606)	5,520	360	2,060	1,434
Kapitale (230-232) Të Brendshme	412,297	534,400	471,500	454,696
Kapitale (230-232) Të Huaja	727,154	590,000	868,300	834,939
Shpenzime nga të ardhurat jashtë limitit	4,483			12,315
<b>Totali</b>	<b>2,408,649</b>	<b>2,268,030</b>	<b>2,551,930</b>	<b>2,448,736</b>

Burimi: MTM, përpunuar nga grupi i auditimit

Projektet me shpenzime kapitale të planifikuara për aparatën e MTM si “Orendi dhe pajisje” dhe “Pajisje TIK” kontrata e investimit dhe realizimi janë realizuar në masën 99% dhe 75% përkatësisht.

## Viti 2022

### Planifikimi buxhetor i vitit 2022-2024

Kërkesat buxhetore të PBA për vitin 2022-2024 të për fazën teknike janë dërguar me shkresën nr. 7342, datë 18.10.2021 “Raporti i PBA 2022-2024, faza e dytë”.

Planifikimi i kërkesave buxhetore afatmesme të PBA 2022-2024 për të dy fazat kundrejt buxhetit të vitit 2021 paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Tabela nr.7” Kërkesat buxhetore sipas PBA 2022 – 2024 për dy fazat për MTM”

Në mijë lekë

Planifikimi	Buxheti	Faza strategjike për v. 2022	Dif 2021-2020	PBA 2022 – 2024 Faza teknike		
				2022	2023	2024
<b>Artikujt</b>	<b>2021</b>	<b>2022</b>				
Paga (600-601)	777,790	797,790	20,000	797,790	797,790	797,790
Korrente të Tjera (602-606)	365,840	440,930	75,090	400,930	437,170	450,982
Kapitale (230-232) Të Brendshme	534,400	590,000	55,600	590,000	420,100	420,100
Kapitale (230-232) Të Huaja	590,000	590,000	0	590,000	390,000	390,000
<b>Totali</b>	<b>2,268,030</b>	<b>2,418,712</b>	<b>150,682</b>	<b>2,378,720</b>	<b>2,045,060</b>	<b>2,058,872</b>

Burimi: MTM, përpunuar nga grupi i auditimit

Artikujt buxhetorë 600 dhe 601 “Paga dhe sigurime” janë planifikuar në bazë të strukturës së miratuar prej 879 punonjësish duke bërë shpërndarjen e këtij fondi sipas programeve përkatëse. Tavani i miratuar i pagave përgjatë vitit 2021 nuk ka qenë i mjaftueshëm për shkak të ristrukturimit të Ministrisë dhe Institucioneve të varësisë në vitin 2020, sipas së cilit një pjesë e Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve, Ujërave dhe Turizmit e përbërë nga 220 punonjës kaluan në varësi të Ministrisë së Brendshme, si dhe ristrukturimit të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit dhe Agjencive Rajonale të saj, Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura si dhe krijimin e Agjencisë Kombëtare të Pyjeve.

Në planifikimin buxhetor për llogaritë e tjera korrente në shumën totale 400,930 mijë lekë për vitin 2022, janë planifikuar shpenzimet për: telefon, shërbim postar duke marrë parasysh ndryshimin e tarifave dhe rritjes së detyrimeve ndaj A., Shërbimit Postar, internetit; për shpenzime për udhëtime e dieta; rritjen e nevojave për karburant si rezultat i shtimit të numrit të kontrolleve dhe lëvizjeve në terren; rritjen e nevojave për energji elektrike si rezultat rritjes së tarifave ndaj KESH, si dhe furnizimit me pellet për nevojat e ngrohjes; për rritjen e numrit të kontrolleve nga policia pyjore dhe strukturave të mbrojtjes nga zjarri në kushtet e thatësisë sezonale ciklike; për rritjen e numrit të pajisjeve dhe gatishmërisë për parandalimin dhe shuarjen e zjarreve në pyje dhe kullota; për pagesa sipas situacioneve për shuarjen e zjarreve; për pagesa për vendimet gjyqësore të formës së prerë; monitorime të cilësisë së ajrit, të akustikës urbane; kuotave në konventat ndërkombëtare dhe organizma të tjerë, etj

Planifikimi për llogarinë 605 “transferta të jashtme” është bazuar në kontributet në konventat, protokollet dhe organizma të tjerë në të cilat MTM është palë, për llogarinë 606 “transferta korrente të brendshme” është bazuar në kuotat e kompensimit të karburantit për stafin e MTM.

*Planifikimi për shpenzime kapitale.*

Kërkesat e MTM në lidhje me shpenzimet kapitale për vitin 2022 janë listuar sipas **Aneksi nr. 1/3: “Kërkesat e MTM në lidhje me shpenzimet kapitale për vitin 2022”** bashkëlidhur Projekt Raportit. MTM ka përgatitur kërkesa shtesë për investime në shumën 3,197,354 mijë lekë dhe për shpenzime korrente (llogari 602 “Mallra dhe shërbime” në shumën 915,000 mijë lekë, sipas figurës së mëposhtme. Në kërkesat shtesë të llogarive korrente konstatohet kërkesë në shumën 100,000 mijë lekë për procesin e arbitrazhit ndërkombëtar. Në planifikimin afatmesëm 2022-2024 në fazën finale të PBA, u konstatua planifikim për produktin me kod 18BF301 “Vendepozitime të rehabilituara” për 5 vendepozitime, nga të cilat 1 për vitin 2021 në shumën totale 80,000 mijë lekë, 2 për vitin 2022 në shumën 50,000 mijë lekë dhe 2 vendepozitime për vitin 2023 në shumën 50,000 mijë lekë dhe nuk ka planifikim për vitin 2024.



Në planifikimi afatmesëm PBA 2022-2024 u konstatua mospërputhje shifrore midis shumave të planifikuara për investimet e programit “Zhvillimi i turizmit” sipas faqes nr. 12 të relacionit shoqërues të PBA dhe tabelave respektive, sipas të cilave investimet me financim të brendshëm rezultojnë në vlerën 375,500,000 lekë ndërsa sipas shumatores së secilit projekt rezultojnë në shumën 399,740,000 lekë. Shuma prej 375,500,000 lekë është mbledhur dhe në tabelën totale të kërkesave buxhetore, duke mos përfshirë diferencën prej 24,240,000 lekë, e cila i përkon projektit të investimit “Hartim projekti (Rehabilitim i shesheve dhe rrugëve kryesore në afërsi të pikave doganore shqiptare)”.

Gjatë auditimit u konstatua se në planifikimin buxhetor afatmesëm 2022-2024 megjithëse në relacionin shpjegues për programin “Mbrojtja e mjedisit” përshkruhet se investimet e planifikuara për vitin 2022 që do të mbulohej nga financimi i huaj kapin vlerën 390,000,000 lekë, sipas Formatit nr. 2 “Formati standart i përgatitjes së kërkesave buxhetore për programin “Mbrojtja e mjedisit” janë detajuar investimet e financimit të huaj në shumën 377,700,000 lekë, duke mos u pasqyruar vlera diferencë prej 12,300,000 lekësh.

### **Rialokimet përgjatë vitit 2022**

Çelja e buxhetit për vitet 2022-2024 për shpenzimet korrente është dërguar nga MFE me shkresën nr. 22922/52, datë 07.01.2021 “Dërgohet miratimi i detajimit të buxhetit për vitet 2022-2024”, sipas së cilës buxheti fillestar 2022 për shpenzimet korrente të MTM rezultojnë në shumën 1,368,720 mijë lekë. Çelja e buxhetit për shpenzimet kapitale është dërguar nga MFE me shkresën 1906/1, datë 08.02.2021 “Dërgohet detajimi i buxhetit të vitit 2022-2024 për shpenzimet kapitale” sipas së cilës buxheti fillestar 2022 për shpenzimet kapitale të MTM rezultojnë në shumën 1,070,740 mijë lekë.

Ndërsa buxheti fillestar vjetor i vitit 2022 paraqitet në vlerën 2 miliardë e 439 milionë lekë dhe buxheti përfundimtar vjetor në vlerën 2 miliardë e 267 milionë lekë, me një diferencë totale prej 172,182 mijë lekë më pak detajuar sipas programeve si më poshtë.

*Tabela nr. 8: “Buxheti fillestar dhe përfundimtar për vitin 2022”*

*Në mijë lekë*

<b>Emërtimi i programit</b>	<b>Buxheti fillestar 2022</b>	<b>Buxheti përfundimtar 2022</b>	<b>Diferencat</b>
Planifikim Menaxhim Administrimi	197,040	258,554	61,514
Administrimi i Pyjeve	951,320	905,952	(45,368)
Zhvillimi i Turizmit	417,700	359,338	(58,362)
Mbrojtja e Mjedisit	873,400	743,434	(129,966)
<b>TOTALI</b>	<b>2,439,460</b>	<b>2,267,278</b>	<b>(172,182)</b>

*Burimi: MTM, përpunuar nga grupi auditimit*

Ndryshimet nga buxheti fillestar deri në atë përfundimtar për MTM përfaqësojnë ndryshimet e planit të buxhetit në zbatim të Aktit Normativ nr. 3, datë 12.03.2022 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 115/2021, “Për Buxhetin e vitit 2022, të Aktit Normativ nr. 12, datë 29.07.2022 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 115/2021, “Për Buxhetin e vitit 2022, të Aktit Normativ nr. 17, datë 01.12.2022 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 115/2021, “Për Buxhetin e vitit 2022, , të Aktit Normativ nr. 19, datë 29.12.2022 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 115/2021, “Për Buxhetin e vitit 2022, në zbatim të VKM nr. 248, datë 20.04.2022 “Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2022, miratuar me Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit për vitin 2022”, në zbatim të Vendimit nr. 898, datë 29.12.2022, të Këshillit të Ministrave, “Për mbështetje financiare të menjëhershme të punonjësve të njëjësive të qeverisjes së përgjithshme dhe institucioneve të arsimit të lartë publik për zbutjen e impaktit të krizës”, si dhe nga fondet e akorduara si fonde shtesë nga fondi i veçantë.

### Realizimi i planit të buxhetit për vitin 2022

MTM ka dërguar në MFE raportet e monitorimit për 12 – mujorin 2022 me shkresën nr. 1546, datë 28.02.2022 “Monitorimi i realizimit të buxhetit 12 –mujor për vitin 2022” brenda afatit të parashikuar konform udhëzimit nr. 22, datë 17.11.2016 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit për njësitë e qeverisjes qendrore”.

Në vijim është audituar realizimi progresiv buxhetor për vitin 2022, për të cilin në tabelën e mëposhtme është përmbledhur realizimi sipas programeve.

Tabela nr.9: “Shpenzimet e MTM sipas programeve buxhetore për vitin 2022”

Në mijë lekë

Programet		Fakti vitit 2021	PBA 2022	Buxheti Vjetor	Buxheti Vjetor	Fakti
Nr	Emertimi			Plan Fillestar Viti 2022	Plan i Rishikuar Viti 2022	i Periudhës 12-mujore 2022
1	Planifikim Menaxhim Administrimi	232,642	215,040	197,040	258,554	213,777
2	Administrimi i Pyjeve	953,515	557,700	951,320	905,952	838,082
3	Zhvillimi i Turizmit	752,751	661,660	417,700	359,338	354,912
4	Mbrojtja e Mjedisit	497,513	944,320	873,400	743,434	699,439
<b>Shpenzime nga të ardhurat jashtë limitit</b>		<b>12,315</b>	-	-	-	<b>66,812</b>
<b>Totali</b>		<b>2,436,421</b>	<b>2,378,720</b>	<b>2,439,460</b>	<b>2,267,278</b>	<b>2,173,022</b>

Burimi: MTM, përpunuar nga grupi i auditimit

Tabela nr. 10: “Shpenzimet e MTM sipas artikujve ekonomikë sipas relacioni shoqërues të raportit të monitorimit për vitin 2022”

Në mijë lekë

Artikujt buxhetorë		Buxheti Vjetor	Buxheti Vjetor	Fakti
Nr	Emertimi	Plan Fillestar Viti 2022	Plan i Rishikuar Viti 2021	Periudhës 12-mujore 2021
1	Llogaria 600-601	797,790	706,845	686,402
2	Llogaria 602	540,570	537,623	478,175
3	Llogaria 604	10,000	7,040	3,557
4	Llogaria 605	20,000	20,000	16,975
5	Llogaria 606	360	16,531	15,428
6	Llogaria 230-231 (Financim i brendshëm)	580,740	550,240	534,196
<b>Totali</b>		<b>1,949,460</b>	<b>1,838,279</b>	<b>1,734,730</b>

Burimi: MTM, përpunuar nga grupi i auditimit

Tabela nr. 11: “Raporti i shpenzimeve të programeve sipas artikujve për vitin 2022 (pa përfshirë shpenzimet për të ardhurat jashtë limitit sipas Aneksit nr. 2”

Në mijë lekë

Artikujt buxhetorë		Buxheti Vjetor	Buxheti Vjetor	Fakti
Nr	Emertimi	Plan Fillestar Viti 2022	Plan i Rishikuar Viti 2021	Periudhës 12-mujore 2021
1	Llogaria 600-601	797,790	706,845	686,402
2	Llogaria 602	540,570	537,623	478,175
3	Llogaria 604	10,000	7,040	3,557
4	Llogaria 605	20,000	20,000	16,975
5	Llogaria 606	360	16,531	15,428
6	Llogaria 230-231 (Financim i brendshëm)	580,740	550,240	534,196
7	Llogaria 230-231 (Financim i huaj)	<b>490,000</b>	<b>429,000</b>	<b>371,478</b>
<b>Totali</b>		<b>2,439,460</b>	<b>2,267,279</b>	<b>2,106,211</b>

Burimi: MTM, përpunuar nga grupi i auditimit

Nga auditimi rezultoi se nuk ka konsistencë në përmbajtjen e gjithë raportit të monitorimit, kështu në relacionin e raportit të monitorimit nuk ka raportim të financimit të huaj dhe për shpenzimet nga të ardhurat jashtë limitit, por vetëm për financimin e brendshëm në shumën totale 1,949,460 të buxhetit fillestar dhe 1,734,730 mijë lekë të realizimit faktik, duke pasqyruar me një diferencë më pak në shumën 438,292 mijë lekë në krahasim me raportimin në Aneksin nr. 1 “Raporti i shpenzimeve sipas programeve” dhe Aneksin nr. 2 “Raporti i shpenzimeve sipas artikujve” sipas të cilave shpenzimet totale faktike të MTM për vitin 2022 rezultojnë në shumën totale prej 2,173,022 mijë lekë.

<b>Titulli i Gjetjes:</b>	Projekte të çelura për MTM pa kaluar në procesin ligjor të miratimit të Programit Buxhetor Afatmesëm.
<b>Situata:</b>	<p>Nga 65 investimet që janë referuar që prej planifikimit buxhetor afatmesëm dhe deri në realizimin e tyre për vitin 2022 konstatohet se 24 prej tyre ose 37% në shumën 78,974,000 lekë nuk janë planifikuar në PBA 2022-2024, nga të cilat 2 investime janë planifikuar dhe miratuar në buxhetin fillestar të vitit 2022. Ndër këto investime të paplanifikuara në PBA 2022-2024, pjesën kryesore/ose e zë projekti i investimit “Pajisje dhe pjesë këmbimi për 7 stacionet e monitorimit të ajrit” në vlerën 37,480 mijë lekë. Veprime në kundërshtim me Udhëzimin nr. 7, datë 28.02.2018 “Për procedurat standarte të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm” Pika 8 ku citohet... “Kërkesat buxhetore të çdo njësie të qeverisjes qendrore përmbajnë, por nuk kufizohen në f. shpenzimet kapitale, listën e projekteve të investimeve për çdo program me: iii. vlerën e parashikuar për t’u financuar në vitin buxhetor; iv. vlerën e mbetur për t’u financuar në vitet pasardhëse buxhetore, burimet e financimit.</p> <p>Mungesa e planifikimit të financimit të huaj në 14 nga 24 ose 58% e projekteve të investimit të paplanifikuara në buxhetin afatmesëm megjithë veçantinë që paraqet kundrejt kërkesave buxhetore me financim të brendshëm nuk justifikon mungesën e planifikimit në buxhetin afatmesëm.</p>
<b>Kriteri:</b>	<p>-Udhëzimi nr. 9, datë 20.03.2018, i MFE-së “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, pika 6 4;</p> <p>-Udhëzimi nr. 7, datë 28.02.2018 “Për procedurat standarte të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm” Pika 8</p> <p>-Ligjin nr. 137, datë 16.11.2020 “Për buxhetin e vitit 2021”;</p> <p>-VKM nr. 185, datë 29.03.2018 “Për procedurat e menaxhimit e investimeve publike”, pika 7, Aneksi 1- “Procedurat e Menaxhimit të Investimeve Publike” ku citohet se: <i>Diagrama e mëposhtme përshkruan fazat e Ciklit të Menaxhimit të Investimeve Publike. Identifikimi i projektit është procesi i identifikimit e shqyrtimit të ideve për projekte investimi të bazuara në analizën e nevojave publike, ndërhyrjeve të qeverisë dhe përshtatjes me strategjitë kombëtare dhe sektoriale.</i></p> <p><i>Hapi 5–Paraqitja e projekt-propozimit të investimit nga Institucionet Buxhetor Ministrisë përgjegjëse për Financat : Projekt-propozimet e investimeve përcillen në Ministrinë përgjegjëse për financat: - nëpërmjet paraqitjes normale të kërkesave për shpenzime sipas afateve të PBA-së/Buxhetit Vjetor; Hapi 7 Miratimi përfundimtar: Pas miratimit në KM të projekteve të investimeve në kuadër të PBA/buxhetit vjetor, lista e projekteve të investimeve paraqitet në Kuvendin e Shqipërisë vetëm si tabelë shoqëruese e paketës së PBA/Buxhetit vjetor, por që nuk miratohet nga Kuvendi.</i></p>
<b>Ndikimi/Efekti:</b>	Mos respektim i disiplinës buxhetore për t’u dhënë prioritet projekteve të planifikuara në PBA.
<b>Shkaku:</b>	Detajimi i projekteve të reja të investimit publik gjatë vitit buxhetor pa kaluar në procedurat e ciklit të menaxhimit të investimeve publike në hartimin e PBA-së.
<b>Rëndësia:</b>	E lartë



<b>Rekomandim:</b>	Titullari i Institucionit në bashkëpunim me Grupin e Menaxhimit Strategjik, të marrin masat e nevojshme në mënyrë që në periodat në vijim të eliminohen praktikat e çeljes së projekteve të reja pa kaluar në procedurat e ciklit të menaxhimit të investimeve publike, me qëllim respektimin e disiplinës buxhetore.
--------------------	---

Investimet që nuk kanë ndjekur ciklin standart buxhetor janë përmbledhur në *Aneksi nr. 1/5: "Investimet e paplanifikuara dhe realizuara për vitin 2022"* bashkëngjitur projekt raportit.

Realizimi faktik 2022 paraqitet në shumën 2,173,022 lekë, ose 89% e buxhetit fillestar dhe 96% e buxhetit të rishikuar. Realizimi i shpenzimeve korrente ishte 93% dhe i investimeve 92% e planit të rishikuar.

Udhëzimi nr. 7, datë 28.02.2018 "Për procedurat standarte të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm" Pika 8. *Kërkesat buxhetore të çdo njësie të qeverisjes qendrore përmbajnë, por nuk kufizohen në: d. planifikimin e shpenzimeve për çdo program sipas produkteve. 4 e. treguesit faktikë për vitin buxhetor paraardhës, treguesit buxhetorë të planifikuar për vitin buxhetor në vazhdim, si edhe për tri vitet e ardhshme buxhetore; f. shpenzimet kapitale, listën e projekteve të investimeve për çdo program me... iv. vlerën e mbetur për t'u financuar në vitet pasardhëse buxhetore, burimet e financimit.*

### **Planifikimi buxhetor i vitit 2023-2025**

Kërkesat buxhetore për planifikimin buxhetor të fazës teknike për vitet 2023-2025 janë dërguar me shkresën nr. 6526/1, datë 01.09.2022 "Raporti i PBA 2023-2025 Faza e dytë".

Sipas tij kërkesat buxhetore sipas artikujve paraqiten në tabelën e mëposhtme:

*Tabela nr. 12" Kërkesat buxhetore sipas PBA 2023 – 2025 për fazën teknike për MTM"*

*Në mijë lekë*

Planifikimi	Buxheti	PBA 2023 – 2025 Faza teknike		
Artikujt	2022	2023	2024	2025
Paga (600-601)	797,790	801,090	801,090	801,090
Korrente të Tjera (602-606)	570,930	566,910	411,910	422,910
Kapitale (230-232) Të Brendshme	580,740	507,100	507,100	357,100
Kapitale (230-232) Të Huaja	490,000	390,000	390,000	390,000
<b>Totali</b>	<b>2,439,460</b>	<b>2,265,100</b>	<b>2,121,100</b>	<b>1,971,100</b>

*Burimi: MTM, përpunuar nga grupi i auditimit*

Artikujt buxhetorë 600 dhe 601 "Paga dhe sigurime" janë planifikuar në bazë të strukturës së miratuar duke bërë shpërndarjen e këtij fondi sipas programeve përkatëse në bazë të VKM nr. 187/2017 dhe VKM nr. 202, datë 15.03.2017 për punonjësit me status civil dhe kod pune dhe urdhrave të Kryeministrit për strukturën e MTM dhe njësisë të varësisë. Për fondin e pagave llogarinë 600 janë kërkuar për MTM 8 milionë lekë në programin "Administrimi i pyjeve" pasi në këtë llogari nuk përputhet organika me buxhetin e çelur.

Në planifikimin buxhetor për llogaritë e tjera korrente në shumën totale 400,930 mijë lekë për vitin 2023, janë planifikuar shpenzimet për: telefon, shërbim postar duke marrë parasysh ndryshimin e tarifave dhe rritjes së detyrimeve ndaj A., Shërbimit Postar, internetit; për shpenzime për udhëtime e dieta; rritjen e nevojave për karburant si rezultat i shtimit të numrit të kontrolleve dhe lëvizjeve në terren; rritjen e nevojave për energji elektrike si rezultat rritjes së tarifave ndaj KESH, si dhe furnizimit me pellet për nevojat e ngrohjes; për rritjen e numrit të kontrolleve nga policia pyjore dhe strukturave të mbrojtjes nga zjarri në kushtet e thatësirës sezonale ciklike; për rritjen e numrit të pajisjeve dhe gatishmërisë për parandalimin dhe shuarjen e zjarreve në pyje dhe kullota; për pagesa sipas situacioneve për shuarjen e zjarreve; për pagesa për vendimet gjyqësore të formës së prerë; monitorime të cilësisë së ajrit, të akustikës urbane; kuotave në konventat ndërkombëtare dhe organizma të tjerë, etj.

Planifikimi për llogarinë 605 "transferta të jashtme" është bërë në bazë të prioriteteve të MTM në

lidhje me monitorimin e ujërave sipërfaqësore, të cilësisë së ajrit urban dhe zhurmave urbane në qytetet kryesore.

Planifikimi për llogarinë 605 “transferata të jashtme” është bazuar në kontributet në konventat, protokollet dhe organizma të tjerë në të cilat MTM është palë, për llogarinë 606 “transferata korrentë të brendshme” është bazuar në kuotat e kompensimit të karburantit dhe telefonisë si dhe rastet e dëmshpërblimit për dalje në pension ose fatkeqësive për stafin e MTM.

#### *Planifikimi për shpenzime kapitale*

Kërkesat e MTM në lidhje me shpenzimet kapitale për vitin 2023 kapin vlerën 897,100 mijë lekë, nga të cilat 57% ose 507,100 janë investime me financim të brendshëm dhe 43% ose 390,000 mijë lekë janë kërkesat për investime me financim të huaj. Ndër investimet e planifikuara me financim të brendshëm pjesën kryesore e zënë investimet në programin “Zhvillimi i turizmit” në shumën 315,500 mijë lekë ose 62% të investimeve me financim të brendshëm. Shpenzimet kapitale të këtij programi sipas PBA 2023-2025 paraqiten si më poshtë:

*Tabela nr.13” Kërkesat buxhetore sipas PBA 2023 – 2025 për fazën teknike për MTM”*

*Në mijë lekë*

Zhvillimi i turizmit	Buxheti 2022	PBA 2023 – 2025 Faza teknike		
Fondi për zhvillimin e turizmit	75,760	78,000	78,000	78,000
Mbështetje financiare BERZH	178,740	210,500	210,500	77,500
Përmirësimi i infrastrukturës dhe kthimi i parkut natyror “Syri i kaltës” në destinacion ekoturistik	50,000	-	-	-
Hartimi dhe zbatimi i projektit “Ujërat termale të Bënjës monument kulture brenda Parkut Kombëtar “Bredhi i Hotovës Dangëlli”	-	24,000	27,000	10,000
Due Mari TVSH	9,000	3,000	-	-
<b>Totali</b>		<b>315,500</b>	<b>315,500</b>	<b>165,500</b>

*Burimi: MTM , përpunuar nga grupi i auditimit*

#### *Parashikimi dhe realizimi i te ardhurave për vitin 2020, 2021 dhe 2022*

Përveç fondeve buxhetore MTM në zbatim të VKM nr. 432, datë 08.06.2006 “Për krijimin dhe administrimin e të ardhurave dytësore që krijojnë institucionet buxhetore”, si dhe VKM nr. 417, datë 25.6.2014 “Për miratimin e tarifave të lejeve të mjedisit” MTM realizon të ardhura dytësore. Parashikimi i të ardhurave për sistemin e MTM-së nuk është konstatuar të jetë kryer për çdo program buxhetor në anekset e pasqyrave të Projekt Buxheteve të vitit 2021, me klasifikimet përkatëse sipas burimit të krijimit të tyre, konkretisht sipas Shtojcës 1/A “Pasqyra shtesë për buxhetin vjetor në PBA 2020-2021, 2022-2024 dhe PBA 2023-2025. Në planifikimin buxhetor të MTM nuk u konstatua planifikim i të ardhurave buxhetore në kundërshtim me Udhëzimi nr. 7, datë 28.02.2018 “Për procedurat standarte të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm” Pika 8. Kërkesat buxhetore të çdo njësie të qeverisjes qendrore përmbajnë, por nuk kufizohen në: **h. Projektin e planit të arkës vjetor dhe të ndarë në muaj, si pjesë e projektbuxhetit vjetor dhe përfshin: i. Fluksin e të ardhurave të parashikuara për t’u mbledhur dhe arkëtime të tjera.**

Realizimi i të ardhurave dytësore u konstatua dhe u përmbodh sipas aktrakordimit me thesarin në fund të çdo viti buxhetor.

Programet Buxhetore	Viti 2020			Viti 2021			Viti 2022		
	Gjithsej	Institucioni	Derdhje ne buxhet	Gjithsej	Institucioni	Derdhje ne buxhet	Gjithsej	Institucioni	Derdhje ne buxhet
Të ardhura nga lejet dhe tarifat mjedisore	76,958,964		76,958,964	96,761,127		96,761,127	86,915,819		86,915,819
Korrigjime nga vitet e kaluara				10,915,600		10,915,600	157,800		157,800
Derdhje në buxhet teprica e mbylljes së llogarive				251,291		251,291	87		87
Derdhur gabim të vitit në vazhdim							453,878	453,878	-
Sponsorizime	21,581,522	21,581,522							
Grant	2,591,323	2,591,323		7,271,416	7,271,416				
<b>Totali</b>	<b>101,131,809</b>	<b>24,172,845</b>	<b>76,958,964</b>	<b>115,199,434</b>	<b>7,271,416</b>	<b>107,928,018</b>	<b>87,527,584</b>		<b>87,073,706</b>

Korrigjime nga vitet e kaluara janë sistemime të bëra nga thesari në lidhje me të ardhurat.

Gjatë auditimit u konstatua se realizimi i të ardhurave nga lejet dhe tarifat mjedisore përbën burimin kryesor të të ardhurave dytësore.

<b>Titulli i Gjetjes:</b>	Mbi raportet e monitorimit në MTM.
<b>Situata:</b>	<p>- Raporti i monitorimit përmban relacionin shpjegues dhe Aneksat detyruese sipas specifikimeve të Udhëzimit të MFE nr. 22, datë, 17.11.2016 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit për njësitë e qeverisjes qendrore”. Formatet e përcaktuara janë plotësuar për çdo program dhe në total për gjithë ministrinë, megjithatë është evidentuar se raportet e monitorimit për vitin 2020 dhe 2021 nuk janë të publikuara në faqen zyrtare të MTM, në kundërshtim me UMF nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” i ndryshuar”, Pika 45 “Nëpunësit autorizues të njërive të qeverisjes qendrore i paraqesin Nëpunësit të Parë Autorizues, sa herë që kërkohet, por jo më pak se tre herë në vit, raportet e monitorimit të zbatimit të buxhetit për performancën financiare, produktet dhe objektivat e realizuara për çdo program buxhetor të përcaktuar në vitin e parë të dokumentit përfundimtar të programit buxhetor afatmesëm. <i>Raportet e monitorimit e të zbatimit të buxhetit publikohen nga nëpunësi autorizues në faqen zyrtare të ministrisë përkatëse, brenda një muaji pas përfundimit të periudhës së raportimit</i>” dhe Pika 271 “Raportet e monitorimit të buxhetit publikohen në faqen zyrtare të çdo ministrie të linjës, të cilat shfaqen edhe në faqen zyrtare të Ministrisë përgjegjëse për Financat nëpërmjet lidhjes së vendosur me faqet zyrtare të ministrive”.</p> <p>- Nga auditimi u konstatua se aparati i MTM-së, si njësi shpenzuese, nuk ka hartuar raporte monitorimi çdo 4 muaj për të ndjekur realizimin e produkteve të buxhetit të saj, për të garantuar përmirësimin e procesit të planifikimit dhe menaxhimit të buxhetit, ndjekjen dhe arritjen e qëllimit dhe objektivave të synuara, sipas deklaratës së politikës së programit, si dhe krahasimin e treguesve të planifikuar të performancës me treguesit faktik. Nga MTM monitorimi është kryer për të gjithë programet e MTM-së pa hartuar raporte 4 mujore monitorimi sipas Udhëzimit nr. 22, datë 17.11.2016 “Për procedurat standarde të monitorimit të Buxhetit në NJQQ” dhe Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar të nenit 65. Nga MTM nuk është hartuar një udhëzues, për përcaktimin e procedurave apo rregullave specifike që duhet të ndjekin njësitë e varësisë së qeverisjes qendrore për procesin e monitorimit të buxhetit si dhe përcaktimi i afateve për paraqitjen e dërgimin e tyre pranë institucioneve eprorë, në zbatim të Udhëzimit të MFE-se nr. 22, datë 17.11.2016, pika 9.</p>
<b>Kriteri:</b>	Ligji nr. 9936 datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 19; Udhëzimi nr. 22, datë 17.11.2016 “Për procedurat standarde të monitorimit të Buxhetit në NJQQ”; Udhëzimi nr. 9, datë 20.03.2018 i Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë, “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”; Udhëzimi plotësues nr. 4, datë 25.01.2021 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2021”.
<b>Ndikimi/Efekti:</b>	<p>Si rezultat i mungesës së raporteve të monitorimit të buxhetit për aparatet e MTM-së:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>✓ nuk bëhet e mundur ndjekja e arritjes së qëllimit dhe objektivave të synuar, sipas deklaratës së politikës së programit, për shkak të mos krahasimit të treguesve të planifikuar të performancës me treguesit faktik.</li> <li>✓ nuk bëhet e mundur evidentimi nëse realizimi i produkteve të aparatit</li> </ul>

	<p>është në përputhje me planin, në mënyrë që të kryhen propozime/rekomandime për ndërmarrjen e veprimeve korigjuese nëpërmjet alokimit të burimeve.</p> <p>✓ nuk kryhet analiza krahasimore e realizimit të fondeve me periudhat e mëparshme.</p> <p>✓ nuk sigurohet informacion për përmirësimin e procesit të planifikimit dhe menaxhimit të buxhetit.</p>
<b>Shkaku:</b>	<p>Mungesa e raporteve të monitorimit të buxhetit për programet e menaxhuara nga aparati i MTM si njësi shpenzuese, por përfshirja e tyre në raportin përmbledhës për të gjitha programet e MTM-së.</p> <p>Mos publikimi i raporteve të monitorimit në faqen zyrtare të MTM-së.</p>
<b>Rëndësia:</b>	E mesme
<b>Rekomandim:</b>	<p>NA dhe NZ në MTM të marrin masat, për hartimin e raporteve të monitorimit të buxhetit çdo katër muaj për aparatin e MTM-së si njësi shpenzuese për produktet e buxhetit të administruara nga ana e saj, me qëllim përmirësimin e procesit të planifikimit dhe monitorimit të buxhetit, si dhe publikimin e tyre në faqen zyrtare të ministrisë.</p>

Për sa më sipër, ngarkohet me përgjegjësi z. T.V., në cilësinë e Drejtorit të Drejtorisë së Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar dhe znj. A. M., në cilësinë e Përgjegjësit të Sektorit, në Sektorin e Buxhetit, Drejtori e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar.

## 2.2 Zbatimi i dispozitave ligjore për marrëdhëniet e punës dhe pagave.

Në zbatim të pikës II/2 u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- Struktura organike dhe ndryshimet e saj për periudhën nën auditim, procesi i ristrukturimit të ndodhur në aparatin e MTM,
- Rregullorja e brendshme e funksionimit dhe ndarja e përgjegjësive sipas strukturës organike,
- Baza e të dhënave/data baza mbi personelin,
- Baza e të dhënave/Data baza e vendimeve gjyqësore për punonjësit e larguar.

Auditimi iu referua akteve ligjore e nënligjore në vijim:

- Ligji nr. 152/2013“Për Nëpunësin Civil” i ndryshuar;
- VKM nr. 108, datë 26.2.2014 “Për planin vjetor të pranimit në shërbimin civil”;
- VKM nr. 242, datë 18.03.2015 “Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese” i ndryshuar,
- VKM nr. 112, datë 02.03.2022 “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësive shtetërore të MTM”
- Urdhri i Kryeministrit nr. 165, datë 05.10.2017 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së MTM”;
- Urdhri nr. 127, datë 08.11.2021 “Për disa ndryshime në Urdhrin nr.165, datë 05.10.2017 të Kryeministrit “Për miratimin e strukturës dhe organikës së MTM”;
- Urdhri i Kryeministrit nr. 185, datë 15.11.2022 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së MTM”;
- Urdhri i Kryeministrit nr. 5151, datë 28.10.2015 “Për zbatimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë nga institucionet e administratës shtetërore, të përfshira në fushën e zbatimit të ligjit për shërbimin civil”.
- VKM nr. 112, datë 02.03.2022 “Për funksionimin e fushës së përgjegjësive shtetërore të MTM”
- Rregullore e brendshme, miratuar nga ministri 420/ 9034 prot, datë 07.11.2018
- VKM nr. 125, datë 17.2.2016 “Për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësve civilë”
- Udhëzimin e DAP me nr. 1, datë 01.03.2016 “Për krijimin, funksionimin dhe kompetencat e komisionit të ristrukturimit për shkak të mbylljes apo ristrukturimit të institucionit” i ndryshuar.
- etj.

Auditimi u fokusua në miratimin e Rregullores së brendshme të organizimit dhe funksionimit të MTM, respektimin e strukturës organike, procesin e ristrukturimit si dhe zbatimin e vendimeve gjyqësore për punonjësit e larguar nga puna dhe ekzekutimin e tyre.

**a. Miratimi i Rregullores së brendshme të organizimit dhe funksionimit të MTM, si dhe respektimi i strukturës organike të miratuar dhe krahasimi me faktin:**

Për periudhën në auditim dhe konkretisht vitet 2020-2021 MTM ka patur fushë përgjegjësie të miratuar me VKM nr. 509, datë 13.09.2017 “Për funksionimin e fushës së përgjegjësive shtetërore të MTM”, e ndryshuar me VKM nr. 112, datë 02.03.2022 “Për funksionimin e fushës së përgjegjësive shtetërore të MTM” duke shfuqizuar VKM e mëparshme me nr. 509/2017.

Në përputhje me fushën e përgjegjësive vendosur në VKM nr. 509/2017 është urdhëruar nga Ministri i MTM miratimi i Rregullores së brendshme për organizimin dhe funksionimin e MTM me urdhrin nr. 420/ 9034 prot, datë 07.11.2018 e cila ka qenë në fuqi dhe nuk ka pësuar ndryshime të mëtejshme përgjatë gjithë viteve 2020-2022 të cilat janë në auditim.

Struktura organike e MTM për periudhën objekt auditimi (01.01.2020 deri me datë 31.12.2022) ka funksionuar në zbatim të Urdhrit të Kryeministrit nr. 165, datë 05.10.2017 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së MTM”, Urdhrit nr. 127, datë 08.11.2021 “Për disa ndryshime në Urdhrin nr.. 165, datë 05.10.2017 të Kryeministrit “Për miratimin e strukturës dhe organikës së MTM” dhe Urdhrit të Kryeministrit nr. 185, datë 15.11.2022 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së MTM”.

<b>Titulli i gjetjes:</b>	Parregullsi në Rregulloren e brendshme
<b>Situata:</b>	Nga auditimi i përmbajtjes/ detyrave funksionale të përcaktuara në Rregulloren e brendshme dhe strukturave organike të miratuara me Urdhrat e kryeministrit nr. 165/2017, nr. 127/2021 dhe nr. 185/2022 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së MTM” konstatohet se nuk ka përshkrim të punës specifik për Drejtoritë e Përgjithshme, Drejtoritë dhe Sektorëve sipas emërimit të tyre në strukturën e miratuar, por vetëm një përshkrim të përgjithshëm për të gjitha drejtoritë dhe sektorët duke mos bërë pasqyrimin e detyrave dhe përgjegjësive sipas të gjitha pozicioneve të punës të miratuar në strukturë. Veprimi i mësipërm bie në kundërshtim me Nenin 7, të Ligjit nr. 9000 datë 30.01.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, Pika 4. “Rregullat e hollësishme të organizimit dhe funksionimit të ministrisë përcaktohen në rregulloren e brendshme, që miratohet nga ministri”, Ligjit nr. 90/2012 Neni 29, Pika 2. “Rregulloret që përcaktojnë metodat e brendshme të punës dhe sjelljen e personelit miratohen nga ministri përgjegjës për ministrinë, institucionet e varësisë dhe degët territoriale në varësi të tij”. dhe VKM Nr. 142, datë 12.3.2014 “Për përshkrimin, klasifikimin dhe vlerësimin e pozicioneve të punës për nëpunësit civilë”, i ndryshuar, Pika 13. “Përshkrimi i punës është një përmbledhje e misionit, qëllimit të përgjithshëm, detyrave kryesore dhe përgjegjësive kryesore të pozicionit respektiv të punës” dhe Pika 16. “Në rastet kur në institucion mungon analisti i punës, përshkrimi i punës hartohet nga drejtuesi i njësisë organizative përgjegjëse për menaxhimin e burimeve njerëzore, në bashkëpunim me eprorin direkt të pozicionit respektiv të punës”. Në rregulloren e brendshme nuk janë përfshirë përshkrimet e punës të hartuara nga Drejtoria e Burimeve njerëzore.
<b>Kriteri:</b>	Ligji nr. 9000 datë 30.01.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, neni 7, pika 4; Ligji nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e Administratës

	Shtetërore”, neni 29, pika 2; VKM Nr. 142, datë 12.3.2014 “Për përshkrimin, klasifikimin dhe vlerësimin e pozicioneve të punës për nëpunësit civilë”, i ndryshuar, pika 13 dhe pika 16; Rregullore e brendshme, miratuar nga ministri 420/ 9034 prot, datë 07.11.2018.
<b>Ndikimi:</b>	Rregullorja aktuale nuk ka përshkrim të punës specifik për disa pozicione të strukturës organike në fuqi, duke mos bërë pasqyrimin e detyrave dhe përgjegjësi sipas të gjitha pozicioneve të punës të miratuar në strukturë.
<b>Shkaku</b>	Mangësi dhe parregullsi në rregulloren e brendshme ka sjellë mos koherencë midis strukturës dhe rregullores, e cila krijon vështirësi në punën e institucionit.
<b>Rëndësia:</b>	E mesme
<b>Rekomandimi:</b>	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit të marrë masat për të përditësuar rregulloren e brendshme të ministrisë me qëllim përcaktimin e detyrave dhe përgjegjësi për të gjithë pozicionet e punës sipas strukturës organike në fuqi.

Rregullorja e brendshme e MTM është publikuar në faqen zyrtare të MTM në linkun <https://turizmi.gov.al/struktura/>.

Me Urdhrin e Ministrit të MTM me nr. 242, datë 08.08.2022 “Për rishikimin e rregullores së brendshme të MTM të miratuar me Urdhrin nr. 420, datë 07.11.2018 “Për miratimin e rregullores së brendshme për organizimin dhe funksionimin e MTM” është ngritur grupi i punës për rishikimin e rregullores së brendshme të organizimit dhe funksionimit të MTM, i cili duhet të përgatiste draft rregulloren e re brenda datës 30.09.2022. Deri në përfundim të auditimit në terren nuk ka një rregullore të re të miratuar.

Sipas urdhrin të Kryeministrit nr. 165, datë 05.10.2017 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së MTM” numri i punonjësve për aparatit e MTM paraqitet gjithsej 132 punonjës e cila ka pësuar ndryshim përgjatë periudhës në auditim. Përmbledhja e strukturave të miratuara për periudhën nën auditim është paraqitur në **Aneksin 2.1** “Përmbledhja e strukturave të miratuara për periudhën nën auditim” bashkangjitur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Nga auditimi u konstatua se me Urdhrin e Kryeministrit nr. 127/2021 nuk ka patur ndryshime në numrin total të punonjësve në ministri, por ndryshim në shtimin e një Zëvendësministri dhe shkurtimin e pozicionit të përgjegjës të sektorit në Sektorin e programit të mbrojtjes mjedisore dhe biodiversitetit të Drejtorisë së Programeve të Zhvillimit të mjedisit pjesë e Drejtorisë së Përgjithshme të Politikave dhe Strategjive të Mjedisit. Ndryshimet që ka sjellë Urdhri i Kryeministrit me nr. 185/2022 janë përmbledhur në tabelën e mësipërme, e cila përmban dhe ndryshimet në emërtimet e reja të disa drejtorive dhe sektorëve të cilat kanë qenë subjekt i këtij ndryshimi.

Me Urdhrin e Kryeministrit nr. 185/2022 numri i përgjithshëm i punonjësve të MTM është ulur nga 132 në 125, ose 7 punonjës më pak. Me këtë urdhër janë shkurtuar pozicionet e 12 Kryetarëve (kategori III-b) të Degëve Territoriale të Shërbimit të Turizmit, pjesë e Drejtorisë së Programeve të Zhvillimit të Turizmit si Drejtori e Drejtorisë së Përgjithshme të Politikave dhe Zhvillimit të Turizmit. Këto pozicione “Kryetar i degëve territoriale” nga struktura e Drejtorisë së Programeve të Zhvillimit të Turizmit janë shkurtuar prej MTM për tu përfshirë në strukturat e njësive rajonale të varësisë që mbulojnë fushën e turizmit, konkretisht në Agjencinë Kombëtare të Bregdetit, pasi është vlerësuar që produkti i siguruar nga këto pozicione pune është më funksional nëse sigurohet në njësitë rajonale të varësisë. Pas shkurtimit të kësaj drejtorie me 12 pozicionet e mësipërme të punës, janë shtuar sektorë të saj me përgjegjës sektori ndërkohë që struktura e mëparshme parashikonte në përbërje të sektorëve vetëm specialistë.

Drejtoria e Përgjithshme e Politikave dhe Zhvillimit të Mjedisit ka ndryshuar emërtim në Drejtoria e Përgjithshme për Zhvillimin e Mjedisit me ndryshim në punonjës nga 24 në 21, tek e cila është shtuar Drejtoria e Ekonomisë Qarkulluese me 8 punonjës dhe shkurtuar Drejtoria e Konceptimit dhe Fizibilitetit të Projekteve të Mjedisit me 10 punonjës. Detyrat e Drejtorisë së Konceptimit dhe Fizibilitetit të Projekteve të Mjedisit i kanë kaluar Sektorit të Projekteve me Financim të Huaj pjesë e Drejtorisë së Integritimit dhe Projekteve me Financim të Huaj. Janë shkurtuar: Sektori i Standarteve në Turizëm, Sektori i Standarteve Mjedisore dhe Sektori i Përpunimit të Informacionit dhe Statistikës, pjesë e Drejtorisë së Përgjithshme Rregullatore dhe Përputhshmërisë në Turizëm dhe Mjedis në total prej 6 punonjësish dhe është shtuar Drejtoria e Jetësimit të Prioriteteve dhe Statistikave me 5(pesë) punonjës në varësi direkte nga SP. Drejtoria e Politikave dhe Strategjive të Turizmit, Drejtoria e Ndryshimeve Klimaterike dhe Drejtoria e Jetësimit të Prioriteteve dhe statistikave dhe Drejtoria e Auditimit nuk kanë përbërje të tyre sektorë, por plotësojnë minimumin prej 5 (pesë) punonjësish, konform VKM nr. 893 datë 17.12.2014 “Për miratimin e rregullave të organizimit dhe të funksionimit të kabineteve ndihmëse, të organizimit të brendshëm të institucioneve të administratës shtetërore, si dhe për procedurat e hollësishme për përgatitjen, propozimin, konsultimin dhe miratimin e organizimit të brendshëm”, i ndryshuar. Sektori i programeve të zhvillimit të turizmit 3S (SEA, SAND, SUN) dhe Sektori i programeve të zhvillimit të turizmit 3C (CONFERENCE, CULTURAL, CLIMATECTERIC) janë ndryshuar përkatësisht në: Sektori i Programeve dhe Destinacioneve të Turizmit Gjithëvjetor dhe Sektori i Promovimit të Turizmit Kulturor dhe Gastronomisë, të cilëve në krahasim me strukturën e mëparshme janë shtuar me nga një pozicion pune të përgjegjës të sektorit të kategorisë III-a.

Ndryshimet strukturore në aparatën e MTM me 125 pozicione pune, nuk janë parashikuar të krijojnë kosto shtesë, kosto financiare e tyre është parashikuar të jetë me efekt zbritës 7,735 milionë lekë.

**Konstatim:** Për ndryshimet e mësipërme strukturore pas miratimit të tyre, është dërguar nga MTM kërkesa për krijimin e Komisionit të Ristrukturimit dërguar Departamentit të Administratës Publike (DAP) me shkresën nr. 8600 datë 22.11.2022 “Kërkesë për ngritjen e Komisionit të Ristrukturimit”. Kërkesa për krijimin e Komisionit të Ristrukturimit është bërë me një vonesë pesë ditore nga Urdhri i Kryeministrit me nr. 185, datë 15.11.2022 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së MTM”, i cili ka hyrë në fuqi menjëherë, prot me nr. 8473, datë 16.11.2022 në protokollin e MTM, pra në kundërshtim me Udhëzimin e DAP me nr. 1, datë 01.03.2016 “Për krijimin, funksionimin dhe kompetencat e komisionit të Ristrukturimit për shkak të mbylljes apo Ristrukturimit të institucionit” i ndryshuar, Kreu II “Krijimi dhe funksionimi i komisionit të Ristrukturimit” Pika 1- *“Jo më vonë se dy ditë pas hyrjes në fuqi të aktit që ka miratuar mbylljen apo Ristrukturimin e institucionit, nëpunësi më i lartë civil në institucionin në të cilin është/janë nëpunësi/t i/të emëruar në pritje për transferim, i kërkon njësisë përgjegjëse (DAP), nxjerrjen e aktit për krijimin e Komisionit të Ristrukturimit”. 1/1. Në rastin e shkurtimit/mbylljes/shkrirjes së ministrive, komisioni i Ristrukturimit ngrihet nga Departamenti i Administratës Publike në cilësinë e njësisë përgjegjëse, jo më vonë se dy ditë nga hyrja në fuqi e urdhrin të Kryeministrit për miratimin e strukturës dhe organikës së ministrisë/ministrive të reja, pa kaluar në procedurën e përcaktuar në pikën 1 të këtij kreu”.*

Në përgjigje të kërkesës drejtuar DAP është ngritur komisioni i Ristrukturimit në kuadër të Ristrukturimit në MTM me Urdhër nr. 493, datë 24.11.2022 “Për krijimin e Komisionit të Ristrukturimit në kuadër të Ristrukturimit të MTM” i përbërë nga një përfaqësues nga DAP, konkretisht një specialist i Sektorit të procedurave të Rekrutimit, në Drejtorinë e Procedurave të Rekrutimit në shërbimin civil si kryetar i Komisionit, dhe Sekretarin e përgjithshëm të MTM si dhe Drejtorin e Drejtorisë së Mirëadministrimit të Burimeve Njerëzore, Aseteve dhe Shërbimeve në Drejtorinë e Përgjithshme Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse në MTM si anëtarë.

Nga krahasimi i kërkesës së drejtuar nga MTM dhe urdhrin të ngritur nga DAP në lidhje me Komisionin e Ristrukturimit, konstatohet se kërkesa e dërguar nga MTM ka propozuar si kryetar të komisionit SP të MTM, ndërsa në urdhrin e DAP kryetar i këtij komisioni është caktuar



përfaqësuesi i DAP, i cili mban pozicionin e specialistit në Sektorin e procedurave të Rekrutimit, në Drejtorinë e Procedurave të Rekrutimit në DAP (zgj. M. H.). Urdhri i DAP është protokolluar në MTM me nr. 8600/1, datë 30.11.2022. Kryesimi i Komisionit të Ristrukturimit nga përfaqësuesi i DAP, edhe pse në pozicion hierarkik më të ulët është diktuar nga Udhëzimi i DAP me nr. 1, datë 01.03.2016 “Për krijimin, funksionimin dhe kompetencat e komisionit të ristrukturimit për shkak të mbylljes apo ristrukturimit të institucionit” i ndryshuar, Kreu II “Krijimi dhe funksionimi i komisionit të ristrukturimit”, Pika 3: “Komisioni i Ristrukturimit drejtohet nga përfaqësuesi i DAP”.

Detyrat e Komisionit të Ristrukturimit janë përcaktuar në VKM nr. 125 Pika 16. “Në rastet e mbylljes apo ristrukturimit, njësia përgjegjëse krijon një komision ristrukturimi, i cili *shqyrton mundësitë e sistemit të çdo nëpunësi civil në vendet e lira ekzistuese dhe propozon transferimin e nëpunësit në një pozicion të lirë të së njëjtës kategori apo përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil të nëpunësit*”, si dhe Udhëzimin e DAP me nr. 1, datë 01.03.2016 “Për krijimin, funksionimin dhe kompetencat e komisionit të ristrukturimit për shkak të mbylljes apo ristrukturimit të institucionit” i ndryshuar.

Njoftimi për fillimin e procedurës së ristrukturimit i është bërë punonjësve të aparatit të MTM më datë 23.11.2022 një ditë pas kërkesës për krijimin e komisionit të ristrukturimit drejtuar DAP në kundërshtim me Ligjin nr. 152/2003 “për nëpunësin civil”, i ndryshuar, Neni 50, Pika 7: “Nëpunësit që i përkasin institucionit që do të ristrukturohet apo mbyllet njoftohen 1 muaj përpara për fillimin e kësaj procedure”.

Pas ngritjes së Komisionit të ristrukturimit më datë 24.11.2022 konstatohet se vendimi i komisionit i është propozuar DAP me shkresën nr. 1074/1, datë 13.02.2023 “Dërgohet vendimi i Komisionit të Ristrukturimit të MTM lidhur me transferimin e përhershëm të nëpunësve civil, në kuadër të ristrukturimit”, me një afat kohor prej 81 (tetëdhjetë e një) ditësh dhe jo 15 (pesëmbëdhjetë) ditë, në kundërshtim me Udhëzimin e DAP me nr. 1, datë 01.03.2016 “Për krijimin, funksionimin dhe kompetencat e komisionit të ristrukturimit për shkak të mbylljes apo ristrukturimit të institucionit” i ndryshuar, Kreu II “Krijimi dhe funksionimi i komisionit të ristrukturimit” Pika 16. “Pas këtij procesi Komisioni, brenda 15 ditësh nga momenti i krijimit të tij:a) i propozon njësisë përgjegjëse (DAP), transferimin e nëpunësit/ve në një nga pozicionet e lira sipas procedurave më sipër;b) i dërgon njësisë së burimeve njerëzore të institucionit vendimin për përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil për shkak të mbylljes apo ristrukturimit sipas procedurave më sipër”.

Gjatë auditimit në terren u mor në shqyrtim dhe Vendimi i Komisionit të Ristrukturimit megjithëse është marrë në vitin 2023, për të audituar më të plotë procesin si dhe për faktin se ky vendim duhet të ishte marrë brenda vitit 2022.

**Konstatim:** Në vendimin e propozimit nuk u konstatua praktika e plotë me të cilën Komisioni i Ristrukturimit ka marrë vendimin e propozimit për transferim të përhershëm të 70 (shtatëdhjetë) punonjësve, në kundërshtim me Udhëzimin e DAP me nr. 1, datë 01.03.2016 “Për krijimin, funksionimin dhe kompetencat e komisionit të ristrukturimit për shkak të mbylljes apo ristrukturimit të institucionit” i ndryshuar, Kreu II “Krijimi dhe funksionimi i komisionit të ristrukturimit”, Pika 17. “Komisioni i Ristrukturimit, duhet ta shoqërojë vendimin e propozimit për transferimin e nëpunësit/ve në një nga pozicionet e lira dhe vendimin për përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil, me praktikën mbi bazën e së cilës është marrë vendimi”.

**Konstatim:** Në shkresën me nr. 814/1, datë 21.02.2023 “Mbi transferimin e përhershëm të nëpunësve në kuadër të ristrukturimit në MTM” DAP ka dërguar në MTM Vendimin mbi transferimin e përhershëm të nëpunësve në kuadër të ristrukturimit të aparatit të MTM bazuar në propozimin e Komisionit të Ristrukturimit. Sipas Vendimi të Komisionit të Ristrukturimit për 11 nga 70 pozicione ose 16% nuk është ruajtur e njëjta kategori, duke dalë jashtë kompetencave të Komisionit të Ristrukturimit i cili ka për detyrë vlerësimin e transferimit të pozicioneve të ndryshuara në një kategori të njëjtë me pozicionin e mëparshëm të punës, në kundërshtim me në VKM nr. 125 Pika 16. “Në rastet e mbylljes apo ristrukturimit, njësia përgjegjëse krijon një



komision ristrukturimi, i cili shqyrton mundësitë e sistemimit të çdo nëpunësi civil në vendet e lira ekzistuese dhe propozon transferimin e nëpunësit në një pozicion të lirë të së njëjtës kategori apo përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil të nëpunësit". Nga pozicionet e punës me kategori të ndryshme u konstatua se 5 (pesë) prej tyre janë ndryshuar në kategori më të lartë dhe 6 (gjashtë) prej tyre në kategori më të ulët.

Gjatë auditimit u konstatua transferimi i përhershëm për punonjësit e mëposhtëm në kategori të ndryshme përmbledhur në Aneksin 2/2: *“Punonjësit e transferuar në një kategori pune të ndryshme pas ristrukturimit në aparatën e MTM” bashkëngjitur projekt raportit.*

Nga gjithë organika e MTM janë transferuar në njësitë e varësisë 5(pesë) punonjës, nga të cilët 2 (dy) prej tyre me të njëjtën kategori dhe 3(tre) me kategori më të ulët. Për të gjithë punonjësit që janë prekur nga ristrukturimi është pranuar pozicioni i ri i punës, kështu edhe në rastet kur kategoria e pozicionit të ri ka rezultuar më e ulët.

Ristrukturimi në MTM dhe njësitë e varësisë është parashikuar të ketë një efekt financiar prej 2.8 milion lekësh, dhe sipas shkresës së MFE me nr. 18692/1, prot 7226/6, datë 24.10.2022 janë mbuluar nga buxheti i miratuar i MTM.

**Konstatim:** Prej miratimit të strukturës së re me Urdhrit të Kryeministrit nr. 185, datë 15.11.2022 *“Për miratimin e strukturës dhe organikës së MTM”* dhe deri më dakordësinë e punonjësve në lidhje me pozicionet e reja të punës më 23.02.2023, konstatohet se procesit të ristrukturimit i është dashur një periudhë kohore prej 100 (njëqind) ditësh dhe jo 30 (tridhjetë) ditë në kundërshtim me VKM nr. 893 datë 17.12.2014 *“Për miratimin e rregullave të organizimit dhe të funksionimit të kabinetëve ndihmëse, të organizimit të brendshëm të institucioneve të administratës shtetërore, si dhe për procedurat e hollësishme për përgatitjen, propozimin, konsultimin dhe miratimin e organizimit të brendshëm”*, i ndryshuar, Pika 38. *“Urdhri për miratimin e strukturës hyn në fuqi menjëherë, por fillon të prodhojë efektet financiare jo më vonë së 30 (tridhjetë) ditë nga data e hyrjes në fuqi, periudhë në të cilën duhet të përfundojnë të gjitha veprimet për sistemimin e punonjësve ekzistues në strukturën e re”*. Në Urdhrit të Kryeministrit nr. 185, datë 15.11.2022 *“Për miratimin e strukturës dhe organikës së MTM”* citohet se efektet financiare të strukturës së re do të nisin më datë 01.01.2023, ndërkohë që sipas Urdhrit të Ministrit të MTM me nr. 70, datë 24.02.2023 *“Për zbatimin e Urdhrit të Kryeministrit nr. 185, datë 15.11.2022”* struktura e re e MTM hyn në fuqi në datën 01.03.2023, në kundërshtim me Pikën 38 të VKM nr. 893/2014.

Shtyrja e afatit të procesit të ristrukturimit sipas MTM është bazuar nga një Vendim i Komisionit të Ristrukturimit me nr. 8600/2, datë 20.12.2022 *“Vendim për zgjatjen e afatit të procedurës administrative të ristrukturimit”* ku Komisioni i Ristrukturimit për punonjësit të cilëve u është shkurtuar vendi i punës i është dashur më shumë kohë për sistemimin e tyre në institucionet e varësisë të cilat janë gjithashtu në proces ristrukturimi dhe në bazë të Nenit 92 të Kodit të Procedurave Administrative ka shtyrë afatin e kësaj procedure administrative për 60 ditë të tjera (prej datës 20.12.2022 të këtij vendimi). Ndryshimi i afatit të përfundimit të procesit të ristrukturimit nie në kundërshtim me Ligjin nr. 44/2015 *“Për kodin e procedurave administrative”*, KREU V AFATET Seksioni 1 *“Afatet e veprimeve procedurale për palët, shtyrja dhe rivendosja në afat”* Neni 53 *“Përcaktimi dhe shtyrja e afateve procedurale”* Pika 1. Afatet për kryerjen e një veprimi procedural nga palët, të quajtura në vazhdim *“afatet procedurale”*, përcaktohen nga ligji ose aktet nënligjore.. 2. *Përveçse kur parashikohet ndryshe në këtë Kod, nëse ligji ose aktet nënligjore nuk parashikojnë një afat të caktuar për kryerjen e një veprimi procedural, organi publik që kryen procedurën cakton me vendim të veçantë një afat të arsyeshëm, sipas çështjes konkrete dhe në përputhje me parimin e ushtrimit të ligjshëm të diskrecionit.* 3. Afati procedural i caktuar nga ligji ose aktet nënligjore mund të zgjatet vetëm nëse kjo parashikohet shprehimisht nga ligji ose akti nënligjor, ndërsa afati i caktuar nga organi publik mund të zgjatet me kërkesë të justifikuar të palës së interesuar, të paraqitur përpara mbarimit të afatit. Duke qenë se Komisioni i Ristrukturimit nuk ndodhet në kushtet e vendosjes së afateve vetë, por i diktohen nga VKM nr. 893 datë 17.12.2014 *“Për miratimin e rregullave të organizimit dhe të funksionimit të kabinetëve*

ndihmëse, të organizimit të brendshëm të institucioneve të administratës shtetërore, si dhe për procedurat e hollësishme për përgatitjen, propozimin, konsultimin dhe miratimin e organizimit të brendshëm”, i ndryshuar, Pika 38. “Urdhri për miratimin e strukturës hyn në fuqi menjëherë, por fillon të prodhojë efektet financiare jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga data e hyrjes në fuqi, *periudhë në të cilën duhet të përfundojnë të gjitha veprimet për sistemimin e punonjësve ekzistues në strukturën e re*”. Pika 40. Fillimi i prodhimit të efekteve financiare të strukturës së re fillon, sipas rastit, në momentin e:

a) konfirmimit nga Departamenti i Administratës Publike të propozimit për ripozicionimin e të gjithë punonjësve në strukturën e re, por jo më vonë se afati i përcaktuar në pikën 38, të këtij vendimi;

b) lëshimit të urdhrin nga titullari i institucionit për njësinë e financës, për rastet e punonjësve që nuk janë subjekt i legjislacionit për shërbimin civil, por jo më vonë se afati i përcaktuar në pikën 38, të këtij vendimi.

Kjo VKM nuk parashikon shtyrje të afateve duke deduktuar se shtyrja e afatit për propozimin e vendeve të punës nga komisioni i Ristrukturimit është jashtë afateve që diktojnë dispozitat ligjore. Sipas VKM 893/ 2014 e ndryshuar Pika 33. Institucioni, i cili propozon ndryshimin e strukturës, dërgon në Departamentin e Administratës Publike të dhënat e mëposhtme:

a) Arsytet e hollësishme të nevojës për ndryshime;

b) Mendim për efektet financiare të ndryshimeve të kërkuara;

c) Përshkrimet e punës dhe kërkesat specifike për çdo pozicion pune të ri, të krijuar apo të prekur nga propozimi;

ç) Analizën sasiore për burimet e nevojshme për kryerjen e funksioneve të caktuara;

d) Një raport për pasojat që mund të ketë ristrukturimi mbi nëpunësit e institucionit dhe shpenzimet e personelit, *si dhe një parashikim për sistemimin e nëpunësve*, pozicionet e të cilëve preken, si pasojë e ristrukturimit.

34. *Departamenti i Administratës Publike nuk shqyrton dhe nuk përgatit për Kryeministrin asnjë propozim, që nuk paraqitet në përputhje me pikën 33, të këtij vendimi, dhe që nuk shoqërohet me mendimin e Ministrisë së Financave për efektet financiare.*

Në dosjen e procesit të ristrukturimit në aparatin e MTM nuk u konstatua një raport përpara ndryshimit të strukturës.

Për vitin 2022, numri total i punonjësve në strukturë është **132** (plani) i ndryshuar me urdhrin e Kryeministrit nr. 185/2022 i cili ka hyrë në fuqi në vitin 2023 faktikisht ndërsa numri faktik/nr. mesatar i punonjësve rezultoi **100** (fakti) deri në Dhjetor 2022.

**Planifikimi rekrutimeve dhe procedurat e ndjekura për rekrutimin e punonjësve në shërbimin civil.**

Në zbatim të nenit 18, të Ligjit Nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*” i ndryshuar, si dhe VKM Nr. 108, datë 26.2.2014 “*Për planin vjetor të pranimin në shërbimin civil*”, përgatitet plani vjetor i pranimin në shërbimin civil për pozicionet e administrimit të përgjithshëm dhe të posaçëm, si dhe për pozicionet e nivelit të ulët dhe të mesëm drejtues.

Për vitin 2020, nga MTM, me shkresën nr. 10884/1 prot., datë 07.01.2020 prot., është kthyer përgjigje shkresës nr. 7538 prot., datë 18.12.2019 të Departamentit të Administratës Publike (DAP) “*Mbi planifikimin e nevojave për pranim në shërbimin civil për vitin 2020*”, jashtë afatit 27.12.2019 përcaktuar në këtë shkresë. Planifikimi përmban 9 pozicione total për aparatin e MTM, nga të cilat 2 Drejtorë drejtorie, 1 përgjegjës sektori dhe 6 specialistë. (nevojat për rekrutim në shërbimin civil janë për **17** (shtatëmbëdhjetë) vende për MTM dhe njësitë e varësisë)

Për vitin 2021, nga MTM, me shkresën nr. 7947/1 prot., datë 18.12.2020 prot., është kthyer përgjigje shkresës nr. 6336/1 prot., datë 27.11.2020 të Departamentit të Administratës Publike (DAP) “*Mbi planifikimin e nevojave për pranim në shërbimin civil për vitin 2021*”, brenda afatit 21.12.2020 përcaktuar në këtë shkresë. Sipas shkresës nevojat për rekrutim në shërbimin civil janë për **90** (nëntëdhjetë) vende për MTM dhe njësitë e varësisë, është dërguar kërkesa për rekrutim të 14 pozicioneve vakante në aparatin e MTM, nga të cilat 2 (dy) Drejtorë të Përgjithshëm, 3 Drejtorë

Drejtorie, 3 përgjegjës sektori dhe 6 specialistë.

Për vitin 2022, nga MTM, me shkresën nr. 9197/5 prot., datë 11.01.2022 “*Mbi planifikimin e nevojave për pranim në shërbimin civil për vitin 2022 për MTM dhe institucionet e varësisë*”, është dërguar në DAP plani i nevojave për rekrutim për vitin 2022.

Referuar këtij plani për vitin 2022, nevojat për rekrutim në shërbimin civil janë për **95** (nëntëdhjetepesë) vende për MTM dhe njësitë e varësisë, nga të cilat aparati ka kërkuar 14 rekrutime, nga të cilat 3 Drejtorë të Përgjithshëm, 1 Drejtor Drejtorie dhe 10 specialistë, nga të cilët 5 me kategori IV-a dhe 5 specialistë me kategori III-b.

Sektori i Burimeve Njerëzore në zbatim të detyrimit ligjor të parashikuar në VKM Nr. 242, datë 18.03.2015 “*Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese*” i ndryshuar, pika 3, 5 dhe 8, Kreu II, bën shpalljet për plotësimin e vendeve të lira/vakante për punonjës në shërbimin civil në sistemin e HRMIS (*Sistemi Informativ i Menaxhimit të Burimeve Njerëzore*) dhe më pas në sistemin on line të rekrutimit, në platformën administrata.al.

<b>Titulli i gjetjes:</b>	Parregullsi gjatë procedurave të ndryshimeve në Strukturën e MTM
<b>Situata:</b>	<p>- Ministria e Turizmit dhe Mjedisit ka patur ndryshime në Strukturën, ku pas miratimit të tyre, MTM ka dërguar kërkesën për krijimin e Komisionit të Ristrukturimit dërguar Departamentit të Administratës Publike (DAP), e cila është dërguar me një vonesë pesë ditore nga miratimi i strukturës, në kundërshtim me Udhëzimin e DAP nr. 1, datë 01.03.2016, Kreu II, Pika 1, ku citohet: “<u>Jo më vonë se dy ditë pas hyrjes në fuqi të aktit</u> që ka miratuar mbylljen apo rristrukturimin e institucionit, nëpunësi më i lartë civil në institucionin në të cilin është/janë nëpunësi/t i/të emëruar në pritje për transferim, i kërkon njësisë përgjegjëse (DAP), nxjerrjen e aktit për krijimin e Komisionit të Ristrukturimit”. 1/1. Në rastin e shkurtimit/mbylljes/shkrirjes së ministrive, komisioni i rristrukturimit ngrihet nga Departamenti i Administratës Publike në cilësinë e njësisë përgjegjëse, <u>jo më vonë se dy ditë nga hyrja në fuqi e urdhrin të Kryeministrit</u> për miratimin e strukturës dhe organikës së ministrisë/ministrive të reja, pa kaluar në procedurën e përcaktuar në pikën 1 të këtij kreu”.</p> <p>- Gjatë procedurës së rristrukturimit, njoftimi i punonjësve të aparatit të MTM është dërguar një ditë pas kërkesës për krijimin e komisionit të rristrukturimit drejtuar DAP në kundërshtim me Ligjin nr. 152/2003, i ndryshuar, Neni 50, Pika 7, ku citohet: “Nëpunësit që i përkasin institucionit që do të rristrukturohet apo mbyllet <u>njoftohen 1 muaj përpara për fillimin e kësaj procedure</u>”.</p> <p>- Vendimi i komisionit i është propozuar DAP me shkresën nr. 1074/1, datë 13.02.2023 është dërguar me një afat kohor prej 81 (tetëdhjetë e një) ditësh dhe jo 15 (pesëmbëdhjetë) ditë, në kundërshtim me Udhëzimin e DAP nr. 1, datë 01.03.2016, Kreu II, pika 16.</p> <p>- Në vendimin e propozimit nuk u konstatua praktika e plotë me të cilën Komisioni i Ristrukturimit ka marrë vendimin e propozimit për transferim të përhershëm të 70 (shtatëdhjetë) punonjësve, në kundërshtim me Udhëzimin e DAP me nr. 1, datë 01.03.2016, i ndryshuar, Kreu II, Pika 17, ku citohet: “Komisioni i Ristrukturimit, duhet ta shoqërojë vendimin e propozimit për transferimin e nëpunësit/ve në një nga pozicionet e lira dhe vendimin për përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil, <u>me praktikën mbi bazën e së cilës është marrë vendimi</u>”.</p> <p>- Vendimi i Komisionit të Ristrukturimit për 11 nga 70 pozicione ose 16% nuk është ruajtur e njëjta kategori, duke dalë jashtë kompetencave të</p>

Komisionit të Ristrukturimit i cili ka për detyrë vlerësimin e transferimit të pozicioneve të ndryshuara në një kategori të njëjtë me pozicionin e mëparshëm të punës, në kundërshtim me në VKM nr. 125, datë 17.2.2016, Pika 16. Nga pozicionet e punës me kategori të ndryshme u konstatua se 5 (pesë) prej tyre janë ndryshuar në kategori më të lartë dhe 6 (gjashtë) prej tyre në kategori më të ulët.

- Prej miratimit të strukturës së re deri më dakordësinë e punonjësve në lidhje me pozicionet e reja të punës, konstatohet se procesit të ristrukturimit i është dashur një periudhë kohore prej 100 (njëqind) ditësh dhe jo 30 (tridhjetë) ditë në kundërshtim me VKM nr. 893 datë 17.12.2014, i ndryshuar, pika 38, ku citohet: “Urdhri për miratimin e strukturës hyn në fuqi menjëherë, por fillon të prodhojë efektet financiare jo më vonë së 30 (tridhjetë) ditë nga data e hyrjes në fuqi, periudhë në të cilën duhet të përfundojnë të gjitha veprimet për sistemimin e punonjësve ekzistues në strukturën e re”.

- Shtyrja e afatit të procesit të ristrukturimit sipas MTM është bazuar nga një Vendim i Komisionit të Ristrukturimit me nr. 8600/2, datë 20.12.2022 “Vendim për zgjatjen e afatit të procedurës administrative të ristrukturimit” ku Komisioni i Ristrukturimit për punonjësit të cilëve u është shkurtuar vendi i punës i është dashur më shumë kohë për sistemimin e tyre në institucionet e varësisë, të cilat janë gjithashtu në proces ristrukturimi dhe në bazë të Nenit 92 të Kodit të Procedurave Administrative ka shtyrë afatin e kësaj procedure administrative për 60 ditë të tjera (prej datës 20.12.2022 të këtij vendimi). Ndryshimi i afatit të përfundimit të procesit të ristrukturimit bie në kundërshtim me Ligjin nr. 44/2015, kreu V, Seksioni 1, Neni 53, Pika 1. Duke qenë se Komisioni i Ristrukturimit nuk ndodhet në kushtet e vendosjes së afateve vetë, por i diktohen nga VKM nr. 893 datë 17.12.2014 “, i ndryshuar, Pika 38. “Urdhri për miratimin e strukturës hyn në fuqi menjëherë, por fillon të prodhojë efektet financiare jo më vonë së 30 (tridhjetë) ditë nga data e hyrjes në fuqi, periudhë në të cilën duhet të përfundojnë të gjitha veprimet për sistemimin e punonjësve ekzistues në strukturën e re”. Pika 40. Kjo VKM nuk parashikon shtyrje të afateve duke deduktuar se shtyrja e afatit për propozimin e vendeve të punës nga komisioni i Ristrukturimit është jashtë afateve që diktojnë dispozitat ligjore.

Në dosjen e procesit të ristrukturimit në aparatit e MTM nuk u konstatua një raport përpara ndryshimit të strukturës sipas përcaktimeve ligjore të përcaktuara në VKM 893/ 2014 e ndryshuar Pika 33. Institucioni, i cili propozon ndryshimin e strukturës, dërgon në Departamentin e Administratës Publike të dhënat e mëposhtme:

- a) Arsyet e hollësishme të nevojës për ndryshime;
- b) Mendim për efektet financiare të ndryshimeve të kërkuara;
- c) Përshkrimet e punës dhe kërkesat specifike për çdo pozicion pune të ri, të krijuar apo të prekur nga propozimi;
- ç) Analizën sasiore për burimet e nevojshme për kryerjen e funksioneve të caktuara;
- d) Një raport për pasojat që mund të ketë ristrukturimi mbi nëpunësit e institucionit dhe shpenzimet e personelit, si dhe një parashikim për sistemimin e nëpunësve, pozicionet e të cilëve preken, si pasojë e ristrukturimit; si dhe pika 34.

- Në listën e gjyq fituesve që ende paguhen dhe janë në listë pritje për

	rikthim në punë janë 9 ish punonjësit, të cilët nuk janë marrë parasysh gjatë procesit të ristrukturimit, për faktin se struktura e aparatit të MTM është shkurtuar me 7 punonjës në vitin 2022, ndërkohë që detyrimi që i paguhet këtyre gjyq fituesve vetëm për vitin 2022 rezulton në shumën 8,145,706 lekë.
<b>Kriteri:</b>	Ligji nr. 152/2003 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, neni 50, pika 7; Ligjin nr. 44/2015 “Për kodin e procedurave administrative”; Ligji nr. 9000 datë 30.01.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”; VKM Nr. 125, datë 17.2.2016 “Për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësve civilë”; VKM nr. 893 datë 17.12.2014 “Për miratimin e rregullave të organizimit dhe të funksionimit të kabineteve ndihmëse, të organizimit të brendshëm të institucioneve të administratës shtetërore, si dhe për procedurat e hollësishme për përgatitjen, propozimin, konsultimin dhe miratimin e organizimit të brendshëm”, i ndryshuar; Udhëzimi nr. 1 DAP, datë 01.03.2016 “Për krijimin, funksionimin dhe kompetencat e komisionit të ristrukturimit për shkak të mbylljes apo ristrukturimit të institucionit”, i ndryshuar, Kreu II, Pika 1.
<b>Ndikimi:</b>	Miratimi i strukturës së re është realizuar në tejkalim të afateve dhe me mangësi në dokumentacionin e procedurave.
<b>Shkaku:</b>	Tejkalimi i afateve ka ardhur si rezultat ristrukturimit edhe të institucioneve të varësisë.
<b>Rëndësia:</b>	E mesme
<b>Rekomandimi:</b>	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit të marrë masat për të respektuar afatet kohore për të gjitha procedurat në rastet e ndryshimeve në strukturë, të cilat shoqërohen me mbylljen apo ristrukturimin e institucionit, gjithashtu këto procedura të shoqërohen me praktikat respektive.

***b. Zbatimi i vendimeve gjyqësore mbi punonjësit e larguar nga puna dhe ekzekutimi i tyre.***

Në zbatim të Urdhrit të Kryeministrit nr. 5151, datë 28.10.2015 “Për zbatimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë nga institucionet e administratës shtetërore, të përfshira në fushën e zbatimit të ligjit për shërbimin civil”, Kreu II, pika 1, Sektori i Burimeve Njerëzore/ MTM-së ka krijuar “*bazën e të dhënave gjyqësore*” për gjyqëfituesit e larguar nga puna e si pjesë përbërëse e Regjistrit Qendror të Personelit.

Baza e të dhënave gjyqësore përfshin: informacionin mbi numrin dhe datën e vendimit gjyqësor, palët ndërgjyqëse objektin, dispozitivin e vendimit, aktin e largimit ose lirimit të nëpunësit nga shërbimi civil, fakte dhe rrethana të lidhura, në lidhje me pozicionin e punës, pas dhënies së vendimit gjyqësor të formës së prerë etj.

**Zbatimi i vendimeve gjyqësore.**

Me qëllim uljen e riskut dhe koston shtesë të pagesave të vonuara për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore, pranë çdo institucioni/njësie publike, në zbatim të Urdhrit Nr. 5151, datë 28.10.2015 të Ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike “Për zbatimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë nga institucionet e administratës shtetërore, të përfshira në fushën e zbatimit të ligjit për shërbimin civil”, Kreu IV, pika 1, krijohet Komisioni i Posaçëm i cili në zbatim të pikës 3, kryen këto detyra;

a-shqyrtimin e fakteve dhe rrethanave të reja të lindura pas marrjes së vendimeve gjyqësore të formës së prerë, në favor të kreditorit gjyqëfitues,

b- shqyrtimin e rasteve kur urdhrat e gjykatës përcaktojnë zbatimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë, nëpërmjet zgjidhjeve alternative për njësitë debitoare,

c- shqyrtimin e mundësisë së sistemimit të gjyqëfituesit në një pozicion të rregullt në shërbimin

civil.

Për periudhën nën auditim u konstatua se është ngritur Komisioni i posaçëm me Urdhrin nr. 153, datë 03.05.2018 “Për ngritjen e Komisionit të Posaçëm për zbatimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë të MTM i përfshirë në fushën e zbatimit të ligjit për shërbimin civil” i ndryshuar me Urdhrin e Ministrit të MTM me nr. 135, datë 08.04.2022 “Për një ndryshim në urdhrin nr. 153, datë 03.05.2018 “Për ngritjen e Komisionit të Posaçëm për zbatimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë të MTM”. Komisioni është kryesuar nga SP i MTM dhe ka patur në përbërje 5 anëtarë dhe sekretariatit teknik.

Si rezultat i shkrirjes së DSHP në vitin 2015 MTM që prej vitit 2017 ka patur një listë të gjatë të vendimeve gjyqësore të formës së prerë për të cilat sipas viteve janë likuiduar 519 ish punonjës (së bashku me ata që gëzojnë të drejtën e rikthimit në punë) vendime gjyqësore të formës së prerë konkretisht:

- Në vitin 2017 janë likuiduar 140 gjyqfitues
- Në vitin 2018 janë likuiduar 118 gjyqfitues
- Në vitin 2019 janë likuiduar 88 gjyqfitues
- Në vitin 2020 janë likuiduar 135 gjyqfitues
- Në vitin 2021 janë likuiduar 22 gjyqfitues
- Në vitin 2022 janë likuiduar 16 gjyqfitues

Në vitin 2020-2022 në nëpunësit civil gjyqfitues kanë patur të drejtën e dëmshpërblimit deri në momentin e rikthimit në punë si dhe rikthim në pozicionin e mëparshëm të punës apo të ngjashëm me të përkatësisht 5, 11 dhe 9 persona.

Spektori i financës nuk ruan të dhënat të ndara sipas shpenzimeve gjyqësore, përmbarimore dhe detyrimet ndaj gjyqfituesve, por i regjistron ato në total, si rezultat nuk mund të nxjerrim një përfundim në lidhje me shpenzimet përmbarimore për periudhën në auditim.

Bazuar në Udhëzimin e Përbashkët të Ministrit të Financave dhe Ministrit të Drejtësisë, nr. 1, datë 04.06.2014 “Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të njësisive të qeverisjes së përgjithshme në llogari të thesarit” pika 5:

*“Ekzekutimi i vendimeve gjyqësore që janë parashikuar të shlyhen nga buxheti përkatës, bëhet sipas radhës së paraqitjes zyrtare të tyre në vitin paraardhës dhe **grafiku i shlyerjes bëhet publik nëpërmjet publikimit në faqen on-line të njësisë shpenzuese, apo në forma të tjera të publikimit, që ju bëhen të ditura publikut. Përmbaruesi i përmbahet grafikut të shlyerjes së detyrimit të publikuar**”.*

Në respekt të këtij detyrimi ligjor MTM me publikimin on line në faqen zyrtare të saj, të grafikut të shlyerjes së detyrimeve sipas përcaktimit të bërë në këtë udhëzim, fillon likuidimin e detyrimeve duke njoftuar menjëherë gjyqfituesin, pasi në zbatim të pikës 2:

*“Njësitë e qeverisjes së përgjithshme janë përgjegjëse për zbatimin e vendimeve gjyqësore dhe për shlyerjen e detyrimeve që rrjedhin prej tyre”.*

Për vitin 2020, shpenzimet e kryera për vendimet gjyqësore deri më 31.12.2021 janë në vlerën **124,201,511** lekë për 135 persona.

Për vitin 2021, shpenzimet e kryera për vendimet gjyqësore deri më 31.12.2021 janë në vlerën **71,561,243** lekë për 22 persona.

Për vitin 2022, shpenzimet e kryera për vendimet gjyqësore deri më 31.12.2022 janë në vlerën **30,900,905** lekë për 16 persona.

Nga Spektori i Buxhetit janë kryer kontabilizimet për të gjitha detyrimet që lindin nga gjyqësfituesit e larguar nga puna për vitin 2020-2022.

<b>Titulli:</b>	Nuk është bërë ende sistemi për ish punonjësit e larguar padrejtësisht nga puna.
<b>Situata:</b>	Nga auditimi i Vendimeve gjyqësore, të cilat kanë marrë formë të prerë është konstatuar se, për vitin 2022 është paguar shuma prej në shumën 8,145,706 lekë për ekzekutimin dhe pagesën e 9 vendimeve gjyqësore me detyrimin

	për “Pagesë page deri në kthim në punë” për ish punonjës të larguar padrejtësisht nga puna, për të cilët vijon pagesa dhe nuk janë marrë parasysht gjatë procesit të ristrukturimit, për faktin se struktura e aparatit të MTM është shkurtuar me 7 punonjës në vitin 2022.
<b>Kriteri:</b>	Urdhri nr. 5151 datë 28.10.2015 “Për zbatimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë nga institucionet e administratës shtetërore, të përfshira në fushën e zbatimit të ligjit për shërbimin civil”. Ligji Nr.10296, datë 08.07.2010, i ndryshuar “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, Ligji nr.9936, datë 26.06.2008 ”Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”; Ligji nr152/2013 “Për nëpunësin civil”.
<b>Ndikimi:</b>	Rritje e kostove të buxhetit të shtetit me shlyerje pagash (likuidim vendimesh gjyqësore).
<b>Shkaku:</b>	Mosveprimi strukturave përgjegjëse
<b>Rëndësia:</b>	E lartë
<b>Rekomandimi:</b>	Nga Strukturat përgjegjëse të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, të merren masa në bashkëpunim me DAP, për rikthimin në punë të të gjithë punonjësve që kanë fituar këtë të drejtë sipas përcaktimeve të vendimeve gjyqësore të formës së prerë.

Për sa më sipër, ngarkohet me përgjegjësi znj. L.B. A., Sekretar i Përgjithshëm në cilësinë e kryetar të Komisionit të Ristrukturimit dhe znj. I. B., Drejtor i Drejtorisë së Mirëmenaxhimit të Burimeve Njerëzore në cilësinë anëtar të Komisionit të Ristrukturimit.

### **2.3 Zbatimi i dispozitave ligjore për administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetare.**

Në zbatim të pikës nr. 3 të programit të auditimit, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- Dokumentet bazë të kontabilitetit si: fletëhyrje, fletëdalje, faturë, mandatarkëtim, mandatpagesë, urdhër-shpenzim;
- Transaksionet e llogarive bankare;
- Pagesa për shërbime e blerje të vogla, të ndara në disa kontrata me disa grup mallrash apo shërbimesh të ngjashme.

Nga auditimi me zgjedhje i transaksioneve të kryera përgjatë viteve 2020; 2021 dhe 2022 mbi ligjshmërinë dhe saktësinë e plotësimit të dokumentacionit bazë të kontabilitetit (fletëhyrje, fletëdalje, faturë, urdhër shpenzim, etj.) të realizuara në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit se, veprimet janë kryer Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”.

Dokumentacioni i bankës është mbajtur dhe kontabilizuar konform rregullave të kontabilitetit si dhe udhëzimit për menaxhimin financiar dhe kontrollin. Urdhër-shpenzimet janë bazuar në dokumentacionin justifikues (si faturat, kontratat e lidhura për blerjet e shërbimet, proces verbalet dhe aktet e marrjes në dorëzim të mallrave apo shërbimeve) konform pikës 35, të Udhëzimit të Ministrisë Financave dhe Ekonomisë nr. 30, date 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik” dhe në çdo rast kanë nënshkrimin e personit të autorizuar në Degën e Thesarit.

Urdhër-shpenzimet e përzgjedhura u audituan në funksion të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorin publik”, veçanërisht sa i takon regjistrimit të veprimeve ekonomike në librat e kontabilitetit bazuar në dokumente origjinale që përdoren për këtë qëllim si dokumente autorizues, dokumente vërtetues, dokumente të kontabilitetit, etj.

## **a. Auditimi me zgjedhje i urdhër shpenzimeve**

Nga auditimi me zgjedhje i urdhër-shpenzimeve, duke i analizuar dhe me regjistrimin në sistemin SIFQ, për vitet 2020; 2021 dhe 2022, nga ana e Grupit të Auditimit u konstatua mosrespektim i afateve, sa i takon likuidimit të faturave, duke tejkaluar afatin ligjor prej 30 ditësh, të përcaktuar në UMFE nr. 9, datë 20.03.2018 “*Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit*”, pika 184 “*Nëpunësit zbatues të njërive shpenzuese të qeverisjes së përgjithshme paraqesin në strukturën përgjegjëse të thesarit dokumentacionin justifikues të shpenzimeve për rastet e pagesave ndaj operatorëve ekonomikë, brenda 30 ditëve nga data e faturës origjinale të operatorit ekonomik*”, si dhe Ligji nr.48/2014 “*Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare*”, neni 7, afatet për autoritet publike, pika a), parashikon që kalimi i likuiditetit tek kreditori duhet të bëhet brenda 60 ditëve kalendarike, duke parashikuar dhe 30 ditë për procedurat e aprovimit në njësinë shpenzuese dhe 30 ditë për procedurat e miratimit dhe procesimit të pagesës në degën e thesarit.” Tejkalmi i këtij afati ka krijuar detyrime të prapambetura për institucionin, ku sipas VKM-së nr. 50, datë 05.02.2014 “*Për miratimin e strategjisë për parandalimin dhe shlyerjen e detyrimeve të prapambetura e të planit të veprimit*” dhe UMFE nr. 37, datë 06.10.2020 “*Për monitorimin dhe publikimin periodik të stokut të detyrimeve të prapambetura të qeverisjes së përgjithshme*”, detyrime të prapambetura konsiderohen detyrimet e përcaktuara në një ligj/ marrëveshje/ vendim gjykatë të formës së prerë, që mbeten të papaguara 60 ditë, pas datës së lëshimit të faturës nga operatori ekonomik.

Krijimi i detyrimeve të prapambetura ndikon në riskun e realizimit të investimeve të reja, si dhe blerjen e mallrave dhe shërbimeve të planifikuara, për t’u realizuar në periudhat e ardhshme, pasi një pjesë e konsiderueshme e buxhetit vjetor shkon për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura të krijuara nga institucioni.

Krijimi i detyrimeve të prapambetura ka ardhur, ndër të tjera, edhe si rrjedhojë e si më poshtë:

- Mosidentifikimit të risqeve që pengojnë reduktimin, shlyerjen dhe parandalimin e detyrimeve të prapambetura;
- Mungesës së kontabilizimit të plotë dhe të saktë të të gjitha detyrimeve, që nga koha e krijimit të tyre, si dhe regjistrimit të faturave në kohë në sistemin SIFQ;
- Mungesës së Planeve të shlyerjes së detyrimeve të prapambetura dhe planifikimit të fondeve të dedikuara për pagesat;
- Mosrespektimit të qasjes FIFO në radhën e shlyerjes së detyrimeve.

Nga auditimi i faturave të likuiduara nga ana e MTM, me datën e faturës tatimore, nga ana e Grupit të Auditimit u konstatua se:

Për vitin 2020, janë kryer likuidime në tejkalm të afatit ligjor 30 ditor 42 fatura;

Për vitin 2021, janë kryer likuidime në tejkalm të afatit ligjor 30 ditor 36 fatura;

Për vitin 2022, janë kryer likuidime në tejkalm të afatit ligjor 30 ditor 10 fatura.

Sa më lart MTM ka vepruar në kundërshtim me Ligjin për “Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në RSH”, i ndryshuar, neni 52 ku citohet... : “*specifikohet se Nëpunësi zbatues i njërive shpenzuese të qeverisjes së përgjithshme paraqesin në strukturën e thesarit dokumentacionin justifikues të shpenzimeve për rastet e pagesave ndaj operatorëve ekonomikë, Brenda 30 ditëve nga data e faturës origjinale të OE-së*”, UMFE nr. 9, datë 20.03.2018 “*Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit*”, pika 184: Ligji nr. 48/2014 “*Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore tregtare*”, neni 7, VKM-së nr. 50, datë 05.02.2014 “*Për miratimin e strategjisë për parandalimin dhe shlyerjen e detyrimeve të prapambetura e të planit të veprimit*” dhe UMFE nr. 37, datë 06.10.2020 “*Për monitorimin dhe publikimin periodik të stokut të detyrimeve të prapambetura të qeverisjes së përgjithshme*”.

## **b. Auditimi i procedurave të prokurimit me vlerë të vogël.**

Auditimi i procedurave të prokurimit me vlerë të vogël, të kryera nga MTM, në cilësinë e AK u ushtrua bazuar në aktet ligjore/ nënligjore të prokurimit publik, si dhe në aktet ligjore/ nënligjore



që kanë lidhje me objektet e prokurimit.

Në zbatim të kësaj pike, grupi i auditimit shqyrtoi dokumentacionin, si më poshtë:

- Vlerësimin e hartimit të nevojave për mallra, punë dhe shërbime nga subjekti i audituar;
- Argumentimin dhe përllogaritjen e vlerës së fondit limit të kontratës, sipas nevojave konkrete për mallra dhe shërbime;
- Realizimin e procedurave të prokurimit, që nga momenti i nxjerrjes së urdhrin të prokurimit, deri në lidhjen e kontratës;
- Lidhjen dhe zbatimin e kontratave, deri në marrjen në dorëzim të mallrave, punëve dhe shërbimeve.

Grupi i auditimit ka përzgjedhur për të audituar procedurat për blerje mallra/ shërbime, sipas aneksit

Nga auditimi u konstatua se:

**1. Për procedurën:** *Kolaudim punimesh për objektin “Mbyllja, rehabilitimi i mbetjeve urbane nga venddepozitimet ekzistuese (Burrel, Kukës, Libohovë, Përmet, Krujë)”*

- Me Urdhrin e Prokurimit nr. 260, datë 06.09.2022, prot., 5198/2 është iniciuar procedura e prokurimit me vlerë 65,898 lekë pa TVSh me objekt “*Kolaudim punimesh për objektin “Mbyllja, rehabilitimi i mbetjeve urbane nga venddepozitimet ekzistuese (Burrel, Kukës, Libohovë, Përmet, Krujë)”*”, publikuar me REF-84210-01-18-2021, realizuar në vlerën 146,440,165 lekë pa TVSH”.

Me memon nr. 5198/1 prot., datë 04.08.2022, nga “grupi i punës për mbikëqyrjen dhe marrjen në dorëzim të punimeve” i ngritur me urdhrin nr. 170, prot., 330/10, datë 23.08.2021 të titullarit të Autoritetit Kontraktor është bërë kërkesa për realizimin e procedurës me objekt “*Kolaudim punimesh.....*”, në vijim të shkresës nr. 5189 datë 21.06.2022 “*Njoftim për përfundim punimesh*” përcjellë nga mbikëqyrësi “I.” shpk.

Në procesverbalin e datës 06.09.2022 është reflektuar kryerja e përllogaritjes së fondit limit në vlerën prej 65,898 lekë pa TVSH, mbështetur nenin 62 të VKM-së nr. 354, datë 11.05.2016 “*Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territorit, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim*” dhe Rekomandimin e Agjencisë së Prokurimit Publik (APP) Nr. 5585 Prot., datë 25.07.2017, “*Mbi mënyrën e përcaktimit të tarifave minimale të specifikuara në Vendimin nr. 354, datë 11.05.2016, të Këshillit të Ministrave*” me qëllim respektimin nga operatorët ekonomikë të normave minimale (vlerave minimale të lejuara), të specifikuara në këtë vendim.

Komisioni i prokurimit me vlerë të vogël ka mbajtur procesverbalin e datës 06.09.2022 mbi argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve

Nga auditimi i dosjes u konstatua se nga komisioni nuk është mbajtur procesverbal i vlerësimit të ofertave sa OE kanë marrë pjesë sa prej tyre janë skualifikuar dhe arsyet e skualifikimit.

Midis OE A.. shpk dhe AK është lidhur kontrata me nr. 5198/4, datë 13.09.2022, në vlerën 65,898 lekë. Fatura e realizimit të shërbimit me nr. 61/2022, datë 23.09.2022 është dorëzuar nga OE shoqëruar me certifikatën e marrjes në dorëzim të objektit dhe pas marrjes në dorëzim të shërbimit nga komisioni i ngritur nga titullari.

AK ka likuiduar OE për shërbimin e realizuar me urdhër shpenzimin nr .275, datë 07.06.2023 në vlerën 79,077 lekë. Likuidimi i OE është bërë me urdhër shpenzimin nr. 275, datë 07.06.2023 pas 11 muaj që ka dorëzuar shërbimin e realizuar.

**2. Për procedurën:** “*Shërbim konsulence për hartimin e Termave të Referencës për vlerësimin e basenit ujëmbledhës dhe ekosistemit lumor të lumit Vjosa me qëllim shpalljen “Park Kombëtar Lugina e Vjosës” dhe hartimin e Projekt-planit të nënzonimit të territorit të zonës së mbrojtur*”

- Me Urdhrin e Prokurimit nr. 130, datë 07.04.2022, prot., 3422 është iniciuar procedura e prokurimit me objekt “*Shërbim konsulence për hartimin e Termave të Referencës për vlerësimin e basenit ujëmbledhës dhe ekosistemit lumor të lumit Vjosa me qëllim shpalljen “Park Kombëtar Lugina e Vjosës” dhe hartimin e Projekt-planit të nënzonimit të territorit të zonës së mbrojtur*”

Me memon nr. 2514/2 prot., datë 10.03.2022, nga “Grupi i punës për koordinimin e procesit të

komponentëve mjedisor dhe potencialit social ekonomik të basenit ujëmbledhës dhe ekosistemit të lumit Vjosa” i ngritur me urdhrin nr. 80, prot., 330/10, datë 23.02.2022 të titullarit të AK është bërë kërkesa për realizimin e procedurës me objekt “Shërbim konsulence” për arsye të shtrirjes së zonës dhe kompleksitetit është e pamundur të realizohet nga vetë MTM prandaj kërkohet ekspertiza e ekspertëve të jashtëm. Në procesverbalin e datës 07.05.2022 është reflektuar kryerja e përllogaritjes së fondit limit në vlerën prej 906,667 lekë pa TVSH, bazuar në studimin e tregut dhe marrjen e ofertave ekonomike nga 3 OE.

Komisioni i prokurimit me vlerë të vogël, i ngritur nga Titullari i MTM, me Urdhrin nr. 11, datë 13.01.2022 kanë mbajtur procesverbalin e datës 07.04.2022 mbi argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve.

Komisioni i prokurimit me vlerë të vogël me datën 29.04.2021 ka mbajtur procesverbalin mbi vlerësimin e ofertave të paraqitura për këtë procedurë.

Në ftesën për ofertë nr. 3422/1, datë 07.04.2022 janë përcaktuar:

Bazuar në vendimin nr. 943, datë 28.12.2016, Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 759, datë 12.11.2014, të Këshillit të Ministrave, "Për licencimin profesional të individëve dhe personave juridikë që do të ushtrjnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim", Operatori Ekonomik duhet të paraqesë Liçensë individuale të kategorisë së parë për:

1. PROJEKTIM URBANIST

c- Plane të detajuara vendore.

2. PROJEKTUES ARKITEKT

a- Projektim arkitekturor për objekte banimi - objekte industriale - objekte turistike.

d- Projektim peizazhi, sistemim sipërfaqe të gjelbra, lulishte e parqe.

Për ekspertin/ët e mësipërm operatori ekonomik duhet të paraqesë kontratat e punës/shërbimit, diplomat, si dhe licencat profesionale individuale në përputhje me objektin e prokurimit, ku është dokumentuar kontrata e lidhur me datën 11.04.2022 me z. O.Gj., arkitekt.

- Operatori ekonomik duhet të vërtetojë me dokumente se ka kontrata të ngjashme të realizuara me sukses. Për këtë duhet të dorëzojë kontratën/faturën (të nënshkruar nga blerësi) të shoqëruar me vërtetimin e realizimit ose fatura të realizuara me subjektet private.

Punë të ngjashme të dorëzuar ka të më me shërbimin për hartimin e dokumentacionit tekniko ligjor për projektin me objekt “Rikonstruksioni i godinës së Agjencisë Kombëtare të Mjedisit”

Midis OE “I.D. & S.” shpk dhe AK është lidhur kontrata me nr. 3422/2, datë 13.04.2022.

Nga AK është ngritur komisioni i marrjes në dorëzim me urdhrin nr. 144, datë 13.04.2022 me anëtar E.V., E.S. dhe A. S.

Nga grupi i punës është mbajtur procesverbali me datë 28.04.2022 mbi marrjen në dorëzim të të dokumentacionit të dorëzuar nga OE prot me nr. 30 datë 26.04.2022.

AK ka likuiduar OE për shërbimin e realizuar me urdhër shpenzimit nr. 227, datë 30.05.2022 vlerën 725,000 lekë bazuar dhe në faturën nr. 8, datë 28.04.2022.

**3. Për procedurën** “*Shërbim konsulence për hartimin e Termave të Referencës për planin e menaxhimit dhe projektin e zbatimit për Parkun Natyror Liqeni i Ulzës dhe zona përreth tij*”.

- Me Urdhrin e Prokurimit nr. 141, datë 11.04.2022, prot., 3520 është iniciuar procedura e prokurimit me objekt “*Shërbim konsulence për hartimin e Termave të Referencës për planin e menaxhimit dhe projektin e zbatimit për Parkun Natyror Liqeni i Ulzës dhe zona përreth tij*”.

Me memon nr. 2747/3 prot., datë 18.03.2023, nga “Grupi i punës për koordinimin e procesit për hartimin e planit të menaxhimit dhe projektit të zbatimit për Parkun natyror” Liqeni i Ulzës dhe zonat përreth” i ngritur me urdhrin nr. 101, datë 15.02.2022 të titullarit të AK është bërë kërkesa për realizimin e procedurës me objekt “Shërbim konsulence” me ekspertë të jashtëm.

Në procesverbalin e datës 11.04.2022 është reflektuar kryerja e përllogaritjes së fondit limit në vlerën prej 846,667 lekë pa TVSH, bazuar në studimin e tregut dhe marrjen e ofertave ekonomike nga 3 OE.

Komisioni i prokurimit me vlerë të vogël, i ngritur nga Titullari i MTM, me Urdhrin nr. 11, datë 13.01.2022, ka mbajtur procesverbalin e datës 11.04.2022 mbi argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve.

Nga auditimi i dosjes u konstatua se nga komisioni është mbajtur procesverbali me datën 13.04.2022 të kalimit nga OE i parë tek OE i dytë me arsyetimin se OE i renditur i pari nuk është paraqitur për të dorëzuar dokumentacionin.

Nga komisioni është mbajtur procesverbali me datën 14.04.2022 të kalimit nga OE i dytë tek OE i tretë me arsyetimin se OE i renditur i dyti ka dërguar mesazh në SPE për përlogaritjen gabim të ofertës.

Në ftesën për ofertë nr. 3520/1 datë 11.04.2022 janë përcaktuar:

Bazuar në vendimin nr. 943, datë 28.12.2016, Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 759, datë 12.11.2014, të Këshillit të Ministrave, "Për licencimin profesional të individëve dhe personave juridikë që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim", Operatori Ekonomik duhet të paraqesë Liçensë individuale të kategorisë së parë për:

#### 1. PROJEKTIM URBANIST

c- Plane të detajuara vendore.

#### 2. PROJEKTUES ARKITEKT

a- Projektim arkitekturor për objekte banimi - objekte industriale - objekte turistike.

d- Projektim peizazhi, sistemim sipërfaqe të gjelbra, lulishte e parqe.

“Për ekspertin/ët e mësipërm operatori ekonomik duhet të paraqesë kontratat e punës/shërbimit, diplomat, si dhe licencat profesionale individuale në përputhje me objektin e prokurimit”, ku është dokumentuar kontrata e lidhur me datën 14.04.2022 me z. O.Gj., arkitekt. OE me personin në fjalë ka lidhë kontrata me datën 11.04.2022 me z. O. G., arkitekt për realizimin e “*Shërbim konsulence për hartimin e Termave të Referencës për vlerësimin e basenit ujëmbledhës dhe ekosistemit lumor të lumit Vjosa me qëllim shpalljen “Park Kombëtar Lugina e Vjosës” dhe hartimin e Projekt-planit të nënzonimit të territorit të zonës së mbrojtur*”.

#### **Sa më sipër kemi mbivendosje të kohës së realizimit të kontratave dhe dublim kontratash.**

Midis OE “I. D. & S. shpk dhe AK është lidhur kontrata me nr. 3520/2, datë 19.04.2022.

Nga AK është ngritur komisioni i marrjes në dorëzim me urdhrin nr. 148, datë 19.04.2022.

Nga grupi i punës është mbajtur procesverbali me datë 10.05.2022 mbi marrjen në dorëzim të dokumentacionit të dorëzuar nga OE prot., me nr. 26/1 datë 29.04.2022.

Pas shqyrtimit të shërbimit të dorëzuar grupi shprehet se është në përputhje me kërkesat dhe pranon faturën e lëshuar nga subjekti me nr. 11/2022, datë 10.05.2022.

AK ka likuiduar OE për shërbimin e realizuar me urdhër shpenzimin nr. 228, datë 30.05.2022 vlerën 710,000 lekë.

#### **4. Për procedurën “Program kompjuterik korrektimi gjuhësor të gjuhës shqipe në paketat ekzistuese.”**

- Me Urdhrin e Prokurimit nr. 364, datë 22.11.2022 është iniciuar procedura e prokurimit me vlerë 960,000 lekë pa TVSh me objekt “*Program kompjuterik korrektimi gjuhësor të gjuhës shqipe në paketat ekzistuese.*”.

Me shkresën nr. 8575 prot., datë 21.11.2021, Përgjegjësi i sektorit të të Shërbimeve, është bërë kërkesa për blerjen e këtij programi bazuar në kërkesat e ardhura nga Kabineti i Ministrit, drejtuar Drejtoria e Miradministrimit të Burimeve Njerëzore, Aseteve dhe Shërbimeve me qëllim lehtësimin në hartimin e shkresave, akteve ligjore dhe çdo dokumenti tjetër.

Në procesverbalin e datës 22.11.2022 është reflektuar kryerja e përlogaritjes së fondit limit në vlerën prej 940,000 lekë pa TVSH, mbështetur në tre oferta ekonomike të paraqitura nga 3 OE.

Komisioni i prokurimit me vlerë të vogël, i ngritur nga Titullari i MTM, me Urdhrin nr. 18, datë 24.05.2022, ka mbajtur procesverbalin e datës 22.11.2022 mbi argumentimin dhe miratimin e

specifikimeve teknike dhe kritereve.

Komisioni i prokurimit me vlerë të vogël ka mbajtur procesverbali me datën 24.11.2022 të kalimit nga OE i parë tek OE i dytë me arsyetimin se Operatori i parë i klasifikuar "L. S.", nuk dorëzoi dokumentacionin sipas kritereve të kërkuara dhe brenda afateve të përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor në Ftesën për Ofertë.

Për sa më lart, komisioni unanimitisht vendosi të njoftojë operatorin ekonomik të radhës nëpërmjet SPE. Komisioni shpalli fitues OE të renditur 2, i cili dorëzoi dokumentacionin brenda afatit të përcaktuar në ftesën për ofertë.

Midis OE "O." shpk dhe AK është lidhur kontrata me nr. 8575/3, datë 30.11.2022.

Kontrata e lidhur është prishur pasi nga AKSHI u është thënë se procedura e realizuar është në kundërshtim me pikën 6 të vendimit nr. 673, datë 22.11.2017 "Për riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit, i ndryshuar me Vendim nr. 36, datë 24.1.2018, me Vendim nr. 448, datë 26.7.2018, me Vendim nr. 872, datë 24.12.2019"

Nuk ka informacion nëse është mbajtur penalitet për prishje kontrate.

### **5. Për procedurën: "Blerje goma"**

- Me Urdhrin e Prokurimit nr. 52, datë 24.02.2020 është iniciuar procedura e prokurimit me vlerë 637,900 lekë pa TVSh me objektin "Blerje goma".

Me shkresën nr. 27.01.2020, Drejtoria e Miradministrimit të Burimeve Njerëzore, Aseteve dhe Shërbimeve ka bërë listën analitike të mallrave dhe shërbimeve që janë parashikuar për tu realizuar në vitin 2020, ku ndër to është dhe kërkesë për blerje gomash.

Në procesverbalin e datës 24.02.2020 reflektohet kryerja e përlllogaritjes së fondit limit në vlerën prej 347,222 lekë pa TVSH, mbështetur në tre oferta ekonomike të paraqitura nga 3 OE.

Pas vlerësimit të ofertave komisioni ka shpallur fitues OE të renditur në vend të shtatë **E. Sh.**

Në ftesën për ofertë është përcaktuar që OE i shpallur fitues duhet të dorëzojë:

1. Operatori ekonomik duhet të dorëzojë me deklaratë mbi origjinalitetin e produkteve dhe garancinë e tyre.
2. Operatori ekonomik duhet të provojë që është i autorizuar nga prodhuesi ose nga distributori i autorizuar nga prodhuesi, për tregtimin e mallrave objekt prokurimi. Në rast se do të paraqitet kjo e fundit, duhet të vërtetohet lidhja midis Distributorit të Autorizuar dhe Prodhuesit. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, e-mail, Website kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.
3. Operatori ekonomik të paraqesë **katalogë/ broshurë të gomave**, ku të përfshihen specifikimet teknike të tyre (të përkthyer në gjuhën shqipe dhe të noterizuar). Në katalogë/ broshura duhet të markohen (për lehtësi identifikimi) artikujt goma dhe specifikimet teknike sipas atyre të përcaktuara në ftesën për ofertë.

Në dokumentacionin pjesë të dosjes mungon *dokumentacioni shoqërues për kërkesat e mësipërme të kërkuara në ftesën për ofertë*, veprime këto në kundërshtim me pikë 17 të Udhëzimit të APP nr. 5, datë 08.01.2018, ku citohet se "Dokumentacioni i kërkuar nga autoriteti kontraktor në përmbushje të kërkesave të përcaktuara në Ftesën për Ofertë, duhet të dorëzohet nga operatori ekonomik i shpallur fitues, në Zyrën e Protokollit të autoritetit kontraktor".

Komisioni i marrjes së shërbimit në dorëzim ka mbajtur procesverbalet e marrjes së mallrave me datën 03.03.2020.

AK ka likuiduar OE për shërbimin e realizuar me urdhër-shpenzimin nr. 130, datë 08.04.2020, në vlerën 402,528 lekë.

### **6. Për procedurën: "Shërbime e riparime të grilave të jashtme të dritareve MTM"**

- Me Urdhrin e Prokurimit nr. 140, datë 12.06.2020 është iniciuar procedura e prokurimit me objektin "Shërbime e riparime të grilave të jashtme të dritareve MTM".

Me shkresën nr. 27.01.2020, Drejtoria e Miradministrimit të Burimeve Njerëzore, Aseteve dhe Shërbimeve ka bërë listën analitike të mallrave dhe shërbimeve që janë parashikuar për tu realizuar

në vitin 2020, ku ndër to është dhe kërkesë për “Shërbime e riparime të grilave të jashtme të dritareve MTM”.

Në dosje mungon procesverbali i përllogaritjes së fondit limit nga komisioni.

Mungon procesverbalin e argumentimit të specifikimeve teknike të kërkuar në ftesën për ofertë.

Pas vlerësimit të ofertave komisioni ka shpallur fitues OE të renditur në vend të shtatë **E. M. në vlerën 785,000 lekë pa tvsh.**

Në ftesën për ofertë është përcaktuar që OE i shpallur fitues duhet të dorëzojë:

- Vërtetim nga OSHEE që konfirmon shlyerjen e detyrimeve të energjisë elektrike

Në dosje mungon vërtetimi nga OSHE.

- Operatori ekonomik duhet të ketë Leje mjedisore dhe Licence të tipit 3.II.B.
- Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar në stafin tekniko-profesional të paktën Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar jo më pak se 8 (tetë) punonjës të siguruar sic e parashikon legjislacioni, për periudhën Janar -Maj 2020 vërtetuar me:
- **Kontratë pune të vlefshme, Diplomë për pozicionet që kërkojnë diplomën, CV të domosdoshme për kryerjen e punimeve.**

**b) Vërtetim lëshuar nga administrata tatimore për pagesën e sigurimeve shoqërore për periudhën Janar-Maj 2020 (siç e parashikon legjislacioni aktual).**

Të cilat nuk janë pjesë e dokumentacionit të dorëzuar sipas kërkesave të kërkuara në ftesën për ofertë.

Gjithashtu mungon deklarata “Operatori ekonomik duhet të garantojë cilësi punimesh, me dru importi të stazhionuar dhe të punuar duke iu përshtatur atyre ekzistuese, garanci për grilat e riparuar nëpërmjet deklaratës të nënshkruar nga vetë operatori ekonomik” dhe “Boja e vajit e përdorur duhet të ketë cilësi të lartë, origjinale dhe të jetë rezistuese ndaj reshjeve të shiut”.

Me datën 22.06.2020 është bërë marrja në dorëzim e punimeve, nga grupi i ngritur me urdhrin nr. 166, datë 17.06.2020 “Ngritje e grupit të punës të marrjes në dorëzim” nuk është cituar nëse punimet janë realizuar sipas specifikimeve teknike të kërkuar në ftesën për ofertë dhe nëse materialet e përdorura janë në përputhje me këto kërkesa, duke pranuar dhe faturën me nr. 17, datë 22.06.2020.

AK ka likuiduar OE për shërbimin e realizuar me urdhër-shpenzimin nr. 283, datë 17.07.2020, në vlerën 542,000 lekë.

## **7. Për procedurën: “Rikonstruksion i bodrumeve”.**

- Me Urdhrin e Prokurimit nr. 143, datë 10.06.2020 është iniciuar procedura e prokurimit me vlerë me objektin “Rikonstruksion i bodrumeve”.

Me shkresën nr. 27.01.2020, Drejtoria e Miradministrimit të Burimeve Njerëzore, Aseteve dhe Shërbimeve ka bërë listën analitike të mallrave dhe shërbimeve që janë parashikuar për tu realizuar në vitin 2020, ku ndër to është dhe kërkesë për “Rikonstruksion i bodrumeve”.

Në dosje mungon procesverbali i përllogaritjes së fondit limit nga komisioni.

Mungon procesverbalin e argumentimit të specifikimeve teknike të kërkuar në ftesën për ofertë.

Pas vlerësimit të ofertave komisioni ka shpallur fitues OE të renditur në vend të shtatë **E. M. në vlerën 740,000 lekë** pa tvsh me datën 12.06.2020.

Në ftesën për ofertë është përcaktuar që OE i shpallur fitues duhet të dorëzojë:

- Vërtetim nga OSHEE që konfirmon shlyerjen e detyrimeve të energjisë elektrike.

Në dosje mungon vërtetimi nga OSHE.

- Operatori ekonomik duhet të ketë Leje mjedisore dhe Licence të tipit 3.II.B.
- Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar në stafin tekniko-profesional të paktën Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar jo më pak se 10 (dhjetë) punonjës të siguruar sic e parashikon legjislacioni, për periudhën Janar -Maj 2020 vërtetuar me:
- **Kontratë pune të vlefshme, Diplomë për pozicionet që kërkojnë diplomën, CV të domosdoshme për kryerjen e punimeve.**

**b) Vërtetim lëshuar nga administrata tatimore për pagesën e sigurimeve shoqërore për periudhën Janar-Maj 2020 (siç e parashikon legjislacioni aktual).**

8. Operatorët ekonomikë duhet të disponojnë licencat e nevojshme për zbatimin e kontratës. Për këtë duhet të paraqesin licencën përkatëse të shoqërisë, bazuar në formatin e ri të miratuar me VKM Nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar, të paktën për vitin e fundit nga momenti i zhvillimit të tenderit. Të cilat nuk janë pjesë e dokumentacionit të dorëzuar sipas kërkesave të kërkuara në ftesën për ofertë.

Sa më sipër veprim në kundërshtim me pikën 16 të Udhëzimit të APP nr. 3, datë 08.01.2018, ku citohet se “*Dokumentacioni i kërkuar nga autoriteti kontraktor në përmbushje të kërkesave të përcaktuara në Ftesën për Ofertë, duhet të dorëzohet nga operatori ekonomik i shpallur fitues, në Zyrën e Protokollit të autoritetit kontraktor*”.

Pas procedurës “Rikonstruksion i bodrumeve” është realizuar procedura e mbikëqyrjes dhe kolaudimit.

Me datën 17.06.2020 është bërë marrja në dorëzim e punimeve, nga grupi i ngritur me urdhrin nr. 161, datë 12.06.2020 “Ngritje e grupit të punës të marrjes në dorëzim” bazuar dhe procesverbalin e kolaudimit tekniko-ekonomik, duke pranuar dhe faturën me nr. 16, datë 17.06.2020.

AK ka likuiduar OE për shërbimin e realizuar me urdhër-shpenzimin nr. 264, datë 21.07.2020, në vlerën 843,660 lekë, duke mbajtur 5% garanci.

**Nga auditimi mbi marrjen në dorëzim të mallrave/shërbimeve /punëve për të tre vitet 2020;2021 dhe 2022 u konstatua se:**

Komisioni i marrjes në dorëzim të mallrave/shërbimeve /punëve në çdo rast ka hartuar procesverbalin e marrjes në dorëzim por plotësimi i tij është thjesht formal, duke ju referuar faturës dhe kontratës pa një përshkrim të hollësishëm të mallrave/shërbimeve dhe punëve të marra.

Gjithashtu konstatohet se komisioni i marrjes në dorëzim të mallrave nuk ka në përbërjen e saj specialist të fushës, bazuar në mallrat/shërbimet/punët që do të merren në dorëzim, veprim në kundërshtim me UMF nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pika 43 ku citohet... “*Komisioni përbëhet nga specialistë të fushës sipas llojit të aktiveve dhe, në rast nevojë, edhe nga ekspertë të jashtëm. Në komision bëjnë pjesë jo më pak se tre veta, duke përfshirë edhe punonjës të punësuar me përgjegjësi materiale*”.

**c. Auditimi i procedurave të prokurimit “Blerje e biletave të transportit ajror ndërkombëtar”**

Autoriteti Kontraktor, në fillim të vitit buxhetor, ka ngritur Komisionin e Sistemit Dinamik (SD) për blerjen e biletave të përbërë prej 3 anëtarë, bazuar në Udhëzimin e APP nr. 4, datë 09.01.2018 “Mbi përdorimin e sistemit dinamik për blerjen e biletave të transportit ajror ndërkombëtar dhe zhvillimin me mjete elektronike” (për sa kohë ishte në fuqi) dhe në pikën 3 të Udhëzimit të APP nr. 3, datë 18.06.2021. Pas nxjerrjes së autorizimit për pjesëmarrje nga titullari/ ministri, titullari i AK/ personi i autorizuar prej tij, referuar pikës 4 të Udhëzimit ka nxjerrë Urdhret e Prokurimit përkatës.

Komisioni, në zbatim të pikës 5-6 të Udhëzimit, ka realizuar procedurën e prokurimit nëpërmjet sistemit të prokurimit elektronik (SPE).

Në të gjithë urdhër-shpenzimet e blerjes së biletave të transportit ajror ndërkombëtar të përzgjedhura për t’u audituar nga ana e grupit të auditimit, si dhe në disa urdhër-pagesa të shërbimeve-dieta jashtë vendit të punonjësve, të likuiduara nëpërmjet arkës, u konstatua *mungesa e ftesës së vendit pritës dhe draft agjenda e punimeve*. Me anë të këtij dokumentacioni, vërtetohet qëllimi dhe objekti i shërbimit si dhe pjesa e shpenzimeve që do të mbulojë organizatori dhe pjesa që do të mbulojë buxheti i shtetit, veprim në kundërshtim me Udhëzimin nr.22 të MFE datë 10.07.2013 “Mbi zbatimin e VKM nr. 870, date 14.12.2011 “*Për trajtimin financiar të punonjësve*

që dërgohen me shërbim jashtë vendit”, pika 4 dhe me Ligjin nr. 110/2015, datë 15.10.2015 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, nenin 4, pika 26 të ku citohet se “Dokument financiar është çdo informacion origjinal, plotësues, si dhe të dhënat kontabël të regjistruara në çdo lloj forme, të krijuara, të marra apo të mbajtura nga njësitë publike. Dokumenti financiar duhet të përshkruajë me vërtetësi veprimin ose ngjarjen, që ka për objekt të përmbajë të dhëna për shkakun e veprimit, datën dhe vendin e kryerjes, objektin, treguesit sasiorë e ato të vlerës, personat që kanë urdhëruar dhe ekzekutuar veprimin, e të tjera të dhëna të nevojshme që i japin dokumentit forcën e një prove ligjore ose administrative”, nenin 2, pika 16 “Gjurma e auditimit, e cila përfaqëson rrjedhën e dokumentuar të transaksioneve financiare dhe të transaksioneve të tjera, nga fillimi deri në përfundim të tyre...”, si dhe pikën 35, germa b “Dokumente vërtetues”, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorin publik.”

Titulli i Gjetjes:	Problematika në procedurat e prokurimit me vlerë të vogël.
<b>Situata:</b>	<p>Nga auditimi i dokumentacionit të shpenzimeve të kryera për procedurat e prokurimit blerje me vlera të vogla rezultoi se;</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Për procedurën: “Shërbim konsulence për hartimin e Termave të Referencës për vlerësimin e basenit ujëmbledhës dhe ekosistemit lumor të lumit Vjosa me qëllim shpalljen “Park Kombëtar Lugina e Vjosës” dhe hartimin e Projekt-planit të nënzonimit të territorit të zonës së mbrojtur” dhe “Shërbim konsulence për hartimin e Termave të Referencës për planin e menaxhimit dhe projektin e zbatimit për Parkun Natyror Liqeni i Ulzës dhe zona përreth tij”</li> </ul> <p>OE ka dorëzuar kontratën e lidhur me datën 14.04.2022 me z. O. Gj., arkitekt, ku po me personin në fjalë është lidhë dhe kontrata me datën 11.04.2022, arkitekt për realizimin e “Shërbim konsulence për hartimin e Termave të Referencës për vlerësimin e basenit ujëmbledhës dhe ekosistemit lumor të lumit Vjosa me qëllim shpalljen “Park Kombëtar Lugina e Vjosës” dhe hartimin e Projekt-planit të nënzonimit të territorit të zonës së mbrojtur”. Sa më sipër kemi mbivendosje të kohës së realizimit të kontratave dhe dublim kontratash.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Për procedurën: “Mbyllja, rehabilitimi i mbetjeve urbane nga venddepozitimet ekzistuese (Burrel, Kukës, Libohovë, Përmet, Krujë)”, në dosjes mungon procesverbali i mbajtur nga komisioni për vlerësimin e ofertave, se sa OE kanë marrë pjesë sa prej tyre janë skualifikuar dhe arsyet e skualifikimit.</li> <li>- Për procedurën: “Blerje goma” mungon dokumentacioni shoqërues për kërkesat e kërkuara në ftesën për ofertë nr. 1910, datë 24.02.2020.</li> <li>- Për procedurën: “Shërbime e riparime të grilave të jashtme të dritareve MTM” dhe “Rikonstruksion i bodrumeve” mungon procesverbali i përllogaritjes së fondit limit nga komisioni. Mungon procesverbali i argumentimit të specifikimeve teknike të kërkuar në ftesën për ofertë, si dhe dokumentacioni shoqërues për kërkesat e kërkuara në ftesën për ofertë. Sa më sipër veprim në kundërshtim me pikën 16 të Udhëzimit e APP nr. 3, datë 08.01.2018, ku citohet se “Dokumentacioni i kërkuar nga autoriteti kontraktor në përmbushje të kërkesave të përcaktuara në Ftesën për Ofertë, duhet të dorëzohet nga operatori ekonomik i shpallur fitues, në Zyrën e Protokollit të autoritetit kontraktor”.</li> <li>- Për të gjithë procedurat e blerjeve të vogla të audituara u konstatua se këto procedura në të gjitha rastet nuk ishin të inventarizuara e për pasojë të arkivuar, në kundërshtim me ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat”, si dhe nenit 21 “Norma tekniko-profesionale dhe metodologjike</li> </ul>

	<i>të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë”.</i>
<b>Kriteri:</b>	Udhëzimin nr. 3, datë 08.01.2018, “ <i>Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike</i> ”, i ndryshuar, pika 5,7,16. Udhëzimin nr. 05, datë 25.06.2021 “ <i>Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike</i> ”, pika 15 dhe 17. Udhëzimin nr. 30, date 27.12.2011 “ <i>Për menaxhimin e aktiveve</i> ”, i ndryshuar, pika 35, 42, 43. Ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003 “ <i>Për arkivat</i> ”, si dhe nenit 21.
<b>Ndikimi/Efekti:</b>	Mungesë gjurmë auditimi, për të verifikuar zbatimin e dispozitave ligjore dhe nënligjore.
<b>Shkaku:</b>	Mosdokumentimi dhe arkivimi i procedurave.
<b>Rëndësia:</b>	E mesme
<b>Rekomandim:</b>	- Nga Sektori i Prokurimeve, pranë Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit të marrë masa në vijimësi për dokumentimin e çdo procesi pune dhe dokumentimin e të gjithë dokumentacionit të kërkuar sipas ftesës për ofertë, si dhe të realizojë inventarizimin e dosjeve për të cilat janë përfunduar procedurat përkatëse, me qëllim krijimin e gjurmës së auditimit, si dhe sigurimin e dobishmërisë së përdorimit të fondeve publike.

<b>Titulli i Gjetjes:</b>	Mbi marrjen në dorëzim të mallrave/shërbimeve /punëve.
<b>Situata:</b>	Nga auditimi mbi marrjen në dorëzim të mallrave/shërbimeve /punëve për të tre vitet 2020;2021 dhe 2022 u konstatua se: Komisioni i marrjes në dorëzim mallrave/shërbimeve /punëve në çdo rast ka hartuar procesverbalin e marrjes në dorëzim por plotësimi i tij është thjesht formal, duke ju referuar faturës dhe kontratës pa një përshkrim të hollësishëm të mallrave/shërbimeve dhe punëve të marra. Gjithashtu konstatohet se komisioni i marrjes në dorëzim të mallrave nuk ka në përbërjen e saj specialist të fushës, bazuar në mallrat/shërbimet/punët që do të merren në dorëzim, veprim në kundërshtim me UMF nr. 30 datë 27.12.2011 “ <i>Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik</i> ”, pika 43 ku citohet... “ <i>Komisioni përbëhet nga specialistë të fushës sipas llojit të aktiveve dhe, në rast nevojë, edhe nga ekspertë të jashtëm. Në komision bëjnë pjesë jo më pak se tre veta, duke përfshirë edhe punonjës të punës me përgjegjësi materiale</i> ”.
<b>Kriteri:</b>	UMF nr. 30 datë 27.12.2011 “ <i>Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik</i> ”, pika 43.
<b>Ndikimi/Efekti:</b>	Mos verifikimi analitik i mallrave/shërbimeve /punëve të marra në dorëzim,, ndikon në mungesës e sigurisë që cilësia e mallrave është e njëjtë me cilësinë e premtuar në ofertë.
<b>Shkaku:</b>	Mos dokumentimi i procesit të punës nga komisioni i marrjes në dorëzim
<b>Rëndësia:</b>	E mesme



<b>Rekomandim:</b>	<p>Komisionet e marrjes në dorëzim mallrave/shërbimeve/punëve të ngritura nga Titullari i Institucionit të marrin masa në vijimësi që procesverbalet e mbajtura për marrjen në dorëzim të mallrave/shërbimeve /punëve të jenë të detajuara sipas kërkesave të përcaktuara në ftesën për ofertë dhe në kontratën e lidhur mes AK dhe OE fitues, me qëllim evidentimin e realizimit të mallrave/shërbimeve/punëve sipas kërkesave dhe cilësisë së kërkuar nga AK.</p> <p>Titullari i Institucionit të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit të marrë masa, që në urdhrin për ngritjen e komisionit të marrjes në dorëzim të mallrave/shërbimeve/punëve, në përbërje të tij, të paktën një nga anëtar të jetë specialistë i fushës bazuar në objektin e procedurës së prokurimit, me qëllim sigurimin e cilësisë së mallrave sipas specifikimeve.</p>
--------------------	--

<b>Titulli i Gjetjes:</b>	Shpenzimet për blerjen e biletave të transportit ajror ndërkombëtar në procedurat me sistem dinamik blerje.
<b>Situata:</b>	Në të gjithë urdhër-shpenzimet e blerjes së biletave të transportit ajror ndërkombëtar të përzgjedhura për t'u audituar nga ana e grupit të auditimit, si dhe në disa urdhër-pagesa të shërbimeve-dieta jashtë vendit të punonjësve, të likuiduara nëpërmjet arkës, u konstatua <i>mungesa e ftesës së vendit pritës dhe draft agjenda e punimeve</i> . Me anë të këtij dokumentacioni, vërtetohet qëllimi dhe objekti i shërbimit si dhe pjesa e shpenzimeve që do të mbulojë organizatori dhe pjesa që do të mbulojë buxheti i shtetit, veprim në kundërshtim me Udhëzimin nr. 22 të MFE datë 10.07.2013 “ Mbi zbatimin e VKM nr. 870, date 14.12.2011 “ <i>Për trajtimin financiar te punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit</i> ”, pika 4 dhe me Ligjin nr. 110/2015, datë 15.10.2015 “ <i>Për menaxhimin financiar dhe kontrollin</i> ”, nenin 4, pika 26 të ku citohet se “ <i>Dokument financiar është çdo informacion origjinal, plotësues, si dhe të dhënat kontabël të regjistruara në çdo lloj forme, të krijuara, të marra apo të mbajtura nga njësitë publike. Dokumenti financiar duhet të përshkruajë me vërtetësi veprimin ose ngjarjen, që ka për objekt të përmbajë të dhëna për shkakun e veprimit, datën dhe vendin e kryerjes, objektin, treguesit sasiore e ato të vlerës, personat që kanë urdhëruar dhe ekzekutuar veprimin, e të tjera të dhëna të nevojshme që i japin dokumentit forcën e një prove ligjore ose administrative</i> ”, nenin 2, pika 16 “Gjurma e auditimit, e cila përfaqëson rrjedhën e dokumentuar të transaksioneve financiare dhe të transaksioneve të tjera, nga fillimi deri në përfundim të tyre...”, si dhe pikën 35, germa b “Dokumente vërtetues”, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “ <i>Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorin publik.</i> ”
<b>Kriteri:</b>	Udhëzimi I MFE me nr. 22 datë 10.07.2013 “ Mbi zbatimin e VKM nr. 870, date 14.12.2011 “ <i>Për trajtimin financiar te punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit</i> ”, pika 4. Ligji nr. 110/2015, datë 15.10.2015 “ <i>Për menaxhimin financiar dhe kontrollin</i> ”, nenin 4, pika 26; nenin 2, pika 16.
<b>Ndikimi/Efekti:</b>	Mungesë gjurmë auditimi, për të verifikuar shpenzimet që do të mbulojë organizatori dhe pjesa që do të mbulojë buxheti i shtetit.
<b>Shkaku:</b>	Mosdokumentimi i ftesës së vendit pritës.
<b>Rëndësia:</b>	E mesme
<b>Rekomandim:</b>	Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar të marrë masa në vijimësi, që në të gjitha dokumentacionet e pagesave, të cilat kanë të bëjnë me praktikën për udhëtime dieta për jashtë shtetit, t'i bashkëngjitet ftesa e

## 2.4 Auditimi i llogarive vjetore.

Në zbatim të pikës 4 të programit të auditimit u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

1. Formati 1- Pasqyra e pozicionit financiar për vitin 2022;
2. Formati 2- Pasqyra e performancës financiare, ose pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve për vitin 2022;
3. Formati 3- Pasqyra e flukseve monetare për vitin 2022;
4. Formati 4- Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/ fondet neto për vitin 2022;
5. Formati 5- Shënimet shpjeguese për hartimin dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore për vitin 2022;
6. Formati 6- Pasqyra e investimeve dhe burimeve të financimit të tyre për vitin 2022;
7. Formati 7- Pasqyra mbi gjendjen dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata me koston historike dhe me vlerën neto për vitin 2022;
8. Formati 8- Pasqyra e numrit të punonjësve dhe fondi i pagave për vitin 2022.

### **a. Mbi organizimin dhe mbajtjen e kontabilitetit.**

Struktura e llogarive është hartuar mbi bazën e Udhëzimit të MFE me nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar me Udhëzimin e MFE nr.5, datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr.8, datë 09.03.2018.”

Auditimi në drejtim të mbajtjes së kontabilitetit dhe hartimit të pasqyrave financiare u përqendrua në vlerësimin e saktësisë dhe përputhshmërisë ligjore të veprimeve ekonomiko-financiare dhe të dokumentimit të transaksioneve financiare të realizuara gjatë periudhës objekt auditimi, si dhe në lidhje me zbatimin e parimeve të përgjithshme për përgatitjen e llogarive vjetore dhe mbajtjen e kontabilitetit. Dokumentet justifikuese për kryerjen e veprimeve ekonomike, janë plotësuar konform dispozitave ligjore në fuqi, përjashtuar disa mangësi të trajtuara në vijimësi.

Auditimi u krye në lidhje me dy drejtimet e mëposhtme: mbi afatin ligjor të përcaktuar për përgatitjen e pasqyrave financiare dhe në vlerësimin e rregullshmërisë dhe saktësisë së llogarive dhe të pozicioneve të bilancit për çdo vit, si dhe kryerjen dhe dokumentimin e veprimeve në ditarin e përgjithshëm (ku janë regjistruar dhe veprimet e bankës), konform udhëzimeve të Ministrisë së Financave. Për çdo vit të veçantë të periudhës objekt auditimi, në zbatim të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, dhe kërkesave të Udhëzimit të MFE me nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar me Udhëzimin e MFE me nr. 5, datë 21.02.2022, pasqyrat financiare janë përpiluar dhe dërguar në afat për miratim në Degën e Thesarit Tiranë.

Rezultoni se, veprimet kontabël janë azhurnuar periodikisht, janë kontabilizuar në ditarët, ku llogaritë në përgjithësi janë në pozicionin e duhur dhe në përputhje me kërkesat e dispozitave në fuqi. Llogaritë vjetore, si dhe pasqyrat financiare janë të shoqëruara me situacionin e shpenzimeve të programit dhe ato të realizuara nga MTM, situacione këto të rakorduara me degën e Thesarit.

PF është shoqëruar me relacionin shpjegues, sipas udhëzimit të miratuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë (MFE), me situacionin përfundimtar të shpenzimeve si dhe llogaridhënien vjetore. Në bazë të të dhënave kontabël përkatëse janë përpiluar Pasqyrat Financiare vjetore mbi llogaritë e vitit ushtrimor që janë raportuar.

-Për vitin 2022 janë dorëzuar Pasqyrat Financiare pranë Degës së Thesarit Tiranë me shkresën nr. 2049 Prot., datë 24.03.2023 “Për dorëzimin e pasqyrave financiare vjetore të vitit ushtrimor 2022” duke respektuar afatet ligjore.

Sa sipër ka gjetur zbatim paragrafi 117, i Udhëzimit të MFE me nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar, që përcakton se:

*“Njësitë e qeverisjes qendrore janë të detyruara të depozitojnë pasqyrat financiare vjetore individuale të ushtrimit të mbyllur brenda muajit Mars të vitit pasardhës. Depozitimi duhet të bëhet duke dërguar një kopje në degën e thesarit të rrethit përkatës të juridiksionit dhe pas marrjes së konfirmimit nga kjo e fundit, një kopje dërgohet në ministrinë apo institucionin qendror përkatës sipas varësisë, dhe një kopje tjetër në zyrën e statistikave të rrethit”.*

Nga ana tjetër, situacionet progresive vjetore janë rakorduar dhe kundër-firmuar rregullisht nga përfaqësuesi i Degës së Thesarit. Realizimi i buxhetit i është raportuar rregullisht Degës së Thesarit.

**b. Vlerësimi nëse aktivi dhe pasivi janë llogaritur saktë dhe në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore përkatëse, si edhe rakordimi me pasqyrat e tjera financiare.**

**Auditimi i llogarive të performancës financiare**

Nga auditimi i gjendjes së llogarive rezultoi se, evidentimi, kontabilizimi dhe dokumentimi i tyre është kryer konform rregullave. Rakordimi dhe kuadrimi është bërë si për llogaritë sintetike dhe ato analitike.

Totali i ardhurave të funksionimit në Pasqyrën e Performancës është i barabartë me totalin e shpenzimeve vjetore plus rezultatin e ushtrimit (formati nr.2). Konkretisht për vitin 2022 paraqiten si vijon:

i. Të ardhurat (grupi A, pasqyra F2)	= 346,915 mijë lekë
ii. Shpenzimet (grupi B, kolona 74 e F2)	= 351,062 mijë lekë
iii. Rezultati i ushtrimit (llog.85)	= (4,147 mijë lekë)
Totali ii + iii	= 346,915 mijë lekë

Llogaria 85 “Rezultati i veprimtarisë ushtrimore“ në Pasqyrën e Pozicionit Financiar (F1) rakordon me vlerën e kësaj llogarie të shënuar në kolonën nr. 132 të Formatit nr. 2 “Pasqyra e Performancës”.

Llogaria 63 “Ndryshimit të gjendjes së inventarit” në Formatin nr. 1 të Pasqyrave Financiare Vjetore, (diferenca midis tepricës më 31.12.2021 me 31.12.2022, përkatësisht 9,095,579 – 4,948,741) rezulton 4,146,838 lekë, e cila rezulton e barabartë me shumatoren e llogarisë 63 dhe 73 “Ndryshim i gjendjeve të inventarit” në Pasqyrën nr. 2, “Performanca financiare e institucionit”.

Nga analiza e llogarisë 2 “Gjendje Inventari qarkullues” rezulton të jetë regjistruar llogaria 31 “Materiale”.

Në **Aneksin nr. 4/1** “Të ardhurat” bashkëngjitur Raportit Përfundimtar të Auditimit janë pasqyruar të ardhurat e arkëtuara gjatë vitit 2022, në vlerën 346,915,219 lekë, analizuar si më poshtë:

- Në llogarinë 7113 “Te ardhura nga shitja e mallrave e shërbimeve” paraqitet në shumën 453,878 lekë. MTM realizon të ardhura nga lejet dhe tarifet mjedisore. Në akt rakordimin e të ardhurave me thesarin për periudhën 01.01.2022-31.12.2022, të ardhurat paraqiten si vijon:

*në lekë*

Nr.	Llog.	Emërtimi i llogarisë	TR mujore	TR progresive	Pjesa e MTM	Rritje e autorizuar	Derdhur në buxhet	Mbeten per tu trashëguar
1	7113099	Të ardhura nga lejet mjedisore	6,510,910.13	86,915,819.35	0.00	0.00	86,915,819.35	0
2	7780100	Korigjime nga vitet e kaluara	157,800.00	157,800.00	0.00	0.00	157,800.00	0
3	7730200	Derdhur në buxhet teprica e mbylljes së llogarisë	86.33	86.33	0.00	0.00	86.33	0
4	7207010	Sponsorizimi nga OJQ	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0
5	7211100	Grante nga organizata nderkombetare	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0
6	4664100	Derdhur gabim, te viti ne vazhdim	0.00	453,878.00	453,878.00	453,878.00	0.00	0
<b>TOTALI</b>			<b>6,668,796.46</b>	<b>87,527,583.68</b>	<b>453,878.00</b>	<b>453,878.00</b>	<b>87,073,705.68</b>	<b>0</b>

Burimi: MTM/Përpunuar nga grupi i auditimit

Sa më sipër, shuma prej 453,878 lekë përfaqëson shumë të ardhurash të derdhur gabim të vitit në

vazhdim.

▪ Llogaria 720 “Grant korrent i Brendshëm” në shumën 346,461,341 lekë, përbëhet nga llogaria: 7200 “Nga buxheti për NJQP(Qendrore)” në shumën 322,237,353 lekë, 7206 “Financim i pritshëm nga buxheti” në shumën 11,903,441 lekë dhe 7207 “Sponsorizime të brendshme (nga të tretët)” në shumën 12,320,547 lekë.

Në **Aneksin nr. 4/2 “Shpenzimet”** bashkëngjitur Raportit Përfundimtar të Auditimit janë pasqyruar shpenzimet e konstatuara gjatë vitit 2022, në vlerën 351,062,057 lekë, analizuar si më poshtë:

- Llogaria 600 “Paga e shpenzime personeli” në shumën prej 105,963,771 lekë, përfaqëson pagat e personelit të përhershëm.

- Llogaria 601 “Kontribute të Sigurimeve Shoqërore” në shumën prej 37,238,274 lekë, përfaqëson shpenzimet për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, pjesa e paguar nga punëdhënësi.

- Llogaria 602 “Blerje mallra e shërbime” në pasqyrën e performancës financiare paraqitet në shumën prej 183,286,893 lekë, e cila përbëhet nga llogaria 6020 “Materiale dhe shërbime zyre të përgjithshme” në shumën prej 5,288,317 lekë, llogaria 6022 “Shërbime nga të tretët” në shumën prej 17,866,707 lekë, llogaria 6023 “Shpenzime transporti” në shumën prej 1,522,699 lekë, llogaria 6024 “Shpenzime udhëtimi” në shumën prej 16,114,458, llogaria 6025 “Shpenzime për mirëmbajtje” në shumën prej 4,841,904 lekë, llogaria 6027 “Shpenzime për detyrime për kompensime legale” në shumën prej 110,429,404 lekë dhe llogaria 6029 “Shpenzime të tjera Operative” në shumën prej 27,223,404 lekë përfaqëson shpenzime të tjera që nuk janë përfshirë në zërat e sipërpërmendur sipas kriterëve të klasifikimit buxhetor.

-Llogaria 605 “Transferime korente me jashtë” në shumën prej 16,975,049 lekë përfaqëson Transferime Te tjera korrente me jashte shtetit.

- Llogaria 606 “Transferita për buxhetet familjare dhe individët” në shumën prej 3,451,232 lekë përfaqëson shpenzime për pensione dhe shpenzime te tjera familjare.

Llogaria 63 “Ndryshimi i gjendjes së inventarit” nuk është element që ndikon në rezultat, por nëpërmjet operacioneve të transferimit ndikon sipas rastit në shtesë apo pakësim të fondeve bazë të institucioneve. Nga veprimet kontabël të bëra nga institucioni dhe të pasqyruar në pasqyrën e performancës financiare ndryshimi i gjendjes është pasqyruara drejtë në shumën prej 4,146,838 lekë.

### **Pasqyrat Financiare viti 2022**

Paraqitja dhe raportimi i tyre është kryer në përputhje me Udhëzimin nr. 8, datë 03.09.2018, Kapitulli V “Procedurat e paraqitjes dhe raportimit të Pasqyrave Financiare vjetore”.

Nga auditimi i pasqyrave financiare individuale të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit rezultoi:

#### **1. Pasqyra e pozicionit financiar (F1)**

-	Aktivet neto janë të barabarta me Aktivet-Pasivet=	2,682,164 mijë lekë.
-	Aktivet	2,725,012 mijë lekë
-	Pasivet	42,847 mijë lekë
-	Aktivet neto	2,682,164 mijë lekë

### **I. Aktivet Afatshkurtra**

Aktivet afatshkurta më datë 31.12.2022 paraqiten në vlerën **59,138,693 lekë** dhe përbëhen nga shuma e nën rubrikave që përfaqësojnë: mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre, gjendje inventari qarkullues, llogari të arkëtueshme dhe të tjera aktive afatshkurtra, të pasqyruara në **Aneksin nr. 4/3 “Aktivet qarkulluese”** bashkëngjitur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

**Klasa 5 “Mjete monetare dhe ekuivalentet e tyre”,** përbëhet nga:

-Gjendja e llogarisë nr.520 “Disponibilitete në Thesar”, sipas mbylljes së bilancit të vitit 2022 është në shumën 40,261,887 lekë dhe në mbyllje të vitit 2021 në shumën 37,327,982 lekë, të cilat rakordojnë me rubrikën V “Teprica në fillim të vitit ushtrimor” në vlerën 37,327,982 lekë dhe rubrikën VI “Teprica e Likuiditeteve në fund të vitit ushtrimor” në vlerën 40,261,887 lekë. (sipas

formatit F3 “Pasqyra e flukseve monetare”) të pasqyruara në **Aneksin 3.4** “Llogaria 520 “Disponibilitete në Thesar” për vitin ushtrimor 2022” bashkëngjitur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Rakordimi i llogarive me degën e thesarit, llogaria nr.520 “Disponibilitete në Thesar”, llogaria nr.466 “Mjete në ruajtje” dhe llogaritë e të ardhurave.

Llogaria nr.520 “Disponibilitete në Thesar”, në pasqyrat financiare të vitit 2022 paraqitet në vlerën prej 40,261,887 lekë, e cila përfaqëson gjendjen e mjeteve në ruajtje (të evidentuara si të tilla në llogaritë e grupit 466) në shumën prej 28,919,406 lekë, dhe shuma prej 11,342,462 lekë si e ardhur e trashëguar nga MTM, nga të cilat të krijuara në vitin 2022 janë në vlerën 320,014 lekë. Pika 50 e udhëzimit: Tepricat e llogarisë 520 “Disponibilitete në thesar” dhe llogarisë 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje” duhet të vërtetohen me akt rakordimit me thesarin, një kopje e të cilit i bashkëlidhet llogarisë vjetore. Në akt rakordim tepricat duhet të paraqiten të strukturuar sipas natyrës së të ardhurave të trashëguara (të ardhurat e papërdorura, si të çelura ashtu edhe ato të pa çelura, mjetet në ruajtje, sponsorizimet dhe pjesën e grandit që trashëgohet). Në llogaritë vjetore të vitit 2022 ka një akt rakordim me thesarin për “Kreditorët për mjete në ruajtje”, llogari e cila në pozicionin financiar të datës 31.12.2022 reflekton një rritje prej vitit 2021 në vlerën 2,933,905 lekë.

Nga verifikimi i akt-rakordimit vjetor të thesarit për treguesit e realizimit të buxhetit dhe krahasuar këto me veprimet kontabël në llogarinë nr.520 “Disponibilitete në Thesar” dhe me ditarin e bankës rezultojnë të jenë të rakorduara.

- Llogaritë e Klasës 3, sipas Pasqyrës së Pozicionit Financiar të MTM në 31.12.2022 paraqitet në shumën 4,948,741 lekë dhe përbehet nga llogaria kontabël 31 “Materiale” në vlerën 4,948,741 lekë.

- Diferenca me vitin e mëparshëm përfaqëson lëvizjen e inventarit në shumën 4,146,838 lekë e cila kuadron me llogarinë 63 “Ndryshimi gjendjes së inventarit” në shumën 4,146,838 lekë.

Për vitin 2022, është kryer inventarizimi i aktiveve, bazuar në urdhrin e SP me nr. 383 datë 09.12.2022, “Për ngritjen e komisionit të inventarizimit të përgjithshëm të mjeteve kryesore dhe inventarit ekonomik në pronësi të MTM për vitin 2022.”

Gjendja e llogarive të mësipërme është e kuadruar me gjendjen e inventarëve. Për kryerjen e tyre është zbatuar udhëzimi i MF nr. 30, datë 27.12.2012 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

Llogaritë e klasës 3 kanë funksionuar duke u debituar për shtesat në kredi të llog. 63 “Ndryshimi i gjendjeve të inventarit” dhe duke u kredituar për daljet e inventarit në debi të llogarisë 63 “Ndryshimi i gjendjeve të inventarit”.

#### **Llogaritë Klasës 4 “Llogari të arkëtueshme”&“Të tjera aktive afatshkurtra”**

##### **▪ Situa e Detyrimeve të Prapambetura:**

- Llogaria 468 “Debitorë të ndryshëm” në vlerën 2,024,624 lekë e cila përbehet nga detyrime të krijuara para vitit 2010 dhe mbarten në pasqyrat financiare, për të cilët nuk ka asnjë informacion se çfarë masash janë marrë nga ana e Institucionit. Në mënyrë analitike sipas detyrimeve paraqiten si vijon:

- E. shpk - 22,800 lekë;
- Firma “S.”- 1,404,165 lekë;
- Firma “A. N.”- 254,700 lekë;
- E. - 241,920 lekë;
- V. - 17,537 lekë;
- I. F.B. - 60,000 lekë;
- Q. - 23,500 lekë.

Nga auditimi u konstatua se nga ana e Sektorit të Ankesave Administrative dhe Gjyqësore nuk është marrë asnjë masa administrative dhe ligjore për mbledhjen e ketyre detyrimeve.

- Llogaria 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” përfaqëson detyrime të prapambetura ndaj të tretëve, e cila në vitin 2022 paraqitet në shumën zero lekë.

Nga auditimi mbi vendimet e proceseve gjyqësore dhe njohjen e tyre ne kontabilitet rezultoi se, shuma totale e vendimeve gjyqësore, të cilat kanë marrë formë të prerë dhe janë shlyer janë si vijon:

-Vendime të formës së prerë marrë në vitin 2015 në shumën 7,299,162 lekë, në vitin 2016 në shumën 3,718,588 lekë dhe në vitin 2017 në shumën 25,379,916, të cilat janë likuiduar në vitin 2020;

- Vendime të formës së prerë marrë në vitin 2019 në shumën 862,708 lekë, në vitin 2020 në shumën 3,218,548 lekë dhe në vitin 2021 në shumën 1,385,659 lekë, të cilat janë likuiduar në vitin 2021;

- Vendime të formës së prerë marrë në vitin 2017 në shumën 1,290,537 lekë, në vitin 2019 në shumën 16,948,178 lekë, në vitin 2021 në shumën 1,228,512 lekë dhe në vitin 2022 në shumën 3,287,972 lekë të cilat janë likuiduar në vitin 2022;

Këto vendime gjyqësore nuk janë njohur në kontabilitet si detyrime për t’u shlyer.

**1.** Si pasojë, llogaria 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” nuk pasqyron vlerën e saktë në pasqyrat financiare të viteve 2018 - 2021. Në këtë zë nuk janë reflektuar detyrimet sa i takon shpenzimeve të periudhave të ardhshme për vendimet gjyqësore, të cilat kanë marrë formën e prerë përpara mbylljes së pasqyrave financiare të vitit ushtrimor.

**2.** Gjithashtu shpenzimet për vendimet gjyqësore të formës së prerë, nuk janë njohur në kontabilitet sipas parimit të të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara, duke mos u njohur si shpenzime periudhe në momentin e marrjes së formës së prerë të Vendimit të Gjykatës, por janë njohur në momentin e likuidimit, në kundërshtim me nenin 61, të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, i ndryshuar, si dhe Udhëzimit e MFE me nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar, pika 34 dhe 42.

**3.** Duke ju referuar pagesave të kryera nga MTM për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore, rezultoi se nuk është respektuar parimi FIFO, për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura.

-Llogaria 4342 “Operacione me shtetin(Te drejta)” paraqitet në shumën 11,903,441 lekë dhe përfaqëson detyrimet që ka MTM ndaj punonjësve për muajin dhjetor 2022, përkatësisht për pagat, për tatim taksa, për sigurime shoqërore dhe sigurime shëndetësore, të cilat paguhen në janar 2023. Kjo llogari ka si kundërparti llogaritë e pasivit 401,421, 431, 435, 436 dhe 467.

Nga auditimi i regjistrimeve të kryera në sistemin financiar SIFQ, u konstatua se nga ana e MTM, nuk janë njohur detyrimet që kanë lindur ne muajin dhjetor 2022 dhe janë paguar në Janar 2023 për shërbim roje, energji elektrike, ujë etj.

<b>Titulli i Gjetjes:</b>	Mosnjohja e detyrimeve dhe e vendimeve gjyqësore si shpenzime periudhe në momentin e marrjes së formës së prerë të Vendimit të Gjykatës, por në momentin e likuidimit.
<b>Situata:</b>	Nga auditimi mbi vendimet e proceseve gjyqësore dhe njohjen e tyre ne kontabilitet rezultoi se, shuma totale e vendimeve gjyqësore, të cilat kanë marrë formë të prerë dhe janë shlyer si vijon: -Vendime të formës së prerë marrë në vitin 2015 në shumën 7,299,162 lekë, në vitin 2016 në shumën 3,718,588 lekë dhe në vitin 2017 në shumën 25,379,916, të cilat janë likuiduar në vitin 2020; - Vendime të formës së prerë marrë në vitin 2019 në shumën 862,708 lekë, në vitin 2020 në shumën 3,218,548 lekë dhe në vitin 2021 në shumën 1,385,659 lekë, të cilat janë likuiduar në vitin 2021; - Vendime të formës së prerë marrë në vitin 2017 në shumën 1,290,537 lekë, në vitin 2019 në shumën 16,948,178 lekë, në vitin 2021 në shumën 1,228,512 lekë dhe në vitin 2022 në shumën 3,287,972 lekë të cilat janë likuiduar në vitin 2022;

	<p><u>Këto vendime gjyqësore nuk janë njohur në kontabilitet si detyrime për t'u shlyer.</u></p> <p><b>1.</b> Si pasojë, llogaria 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” nuk pasqyron vlerën e saktë në pasqyrat financiare të viteve 2018-2021. Në këtë zë nuk janë reflektuar detyrimet sa i takon shpenzimeve të periudhave të ardhshme për vendimet gjyqësore, të cilat kanë marrë formën e prerë përpara mbylljes së pasqyrave financiare të vitit ushtrimor.</p> <p><b>2.</b> Gjithashtu shpenzimet për vendimet gjyqësore të formës së prerë, nuk janë njohur në kontabilitet sipas parimit të të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara, duke mos u njohur si shpenzime periudhe në momentin e marrjes së formës së prerë të Vendimit të Gjykatës, por janë njohur në momentin e likuidimit, në kundërshtim me nenin 61, të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, i ndryshuar, si dhe Udhëzimit e MFE me nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat në përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, pika 34 dhe 42.</p> <p><b>3.</b> Duke ju referuar pagesave të kryera nga MTM për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore, rezultoi se nuk është respektuar parimi FIFO, për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura.</p> <p>-Llogaria 4342 “Operacione me shtetin(Te drejta)” paraqitet në shumën 11,903,441 lekë dhe përfaqëson detyrimet që ka MTM ndaj punonjësve për muajin dhjetor 2022, përkatësisht për pagat, për tatim taksa, për sigurime shoqërore dhe sigurime shëndetësore, të cilat paguhen në janar 2023. Kjo llogari ka si kundërparti llogaritë e pasivit 401,421, 431, 435, 436 dhe 467. Nga auditimi i regjistrimeve të kryera në sistemin financiar SIFQ, u konstatua se nga ana e MTM, nuk janë njohur detyrimet që kanë lindur ne muajin dhjetor 2022 dhe janë paguar në Janar 2023 për shërbim roje, energji elektrike, ujë etj.</p>
<b>Kriteri:</b>	Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, i ndryshuar, neni 61, Udhëzimi i MFE me nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat në përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, pika 34 dhe 42.
<b>Ndikimi/Efekti:</b>	Mos njohja e detyrimeve në momentin e konstatimit të tyre, po në momentin që likuidohen.
<b>Shkaku:</b>	Mospasqyrimi i drejte i llogarive ne pasqyrën e “Pozicionit financiar”.
<b>Rëndësia:</b>	E mesme
<b>Rekomandimi:</b>	<p>- Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar të marrë masa në vijimësi, që menjëherë pas lindjes së detyrimit të bëjë regjistrimin në kontabilitet të detyrimit të plotë, bazuar në parimin e të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara.</p> <p>- Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar të marrë masa në vijimësi për të rakorduar me Sektorin e Ankesave Administrative dhe Gjyqësore, sa i takon informacionit të plotë të vendimeve të gjykatës të formës së prerë, të cilat duhet të njihen në vlerën e tyre të plotë, si detyrime për t'u shlyer në periudhat e ardhshme dhe për të cilat duhet të provigjionohen shumat përkatëse. Njëkohësisht vlera e tyre duhet njohur edhe si shpenzim periudhe në pasqyrat financiare të institucionit.</p> <p>- Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar në çdo rast të ndjekë dhe të zbatojë me përpikmëri parimin FIFO, gjatë likuidimit të detyrimeve të prapambetura.</p>

	- Nga ana e Sektorit të Ankesave Administrative dhe Gjyqësore, të merren masa për ndjekjen me kujdes të proceseve gjyqësore dhe përcjelljen në kohë të informacionit të plotë dhe të saktë në njësinë përkatëse, përgjegjëse për financë/kontabilitetin, në mënyrë që kjo e fundit të njohë dhe kontabilizojë në kohë vlerat që lidhen me këto shpenzime/detyrime, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi.
--	--

### AKTIVET AFATGJATA JOMATERIALE (AAJM)

Llogaritë e Klasës 20 “Aktivet Afatgjata Jo materiale”, përbëhen nga llog.202 “Studime dhe kërkime”, në vlerën 125,707,341 lekë në fund të vitit 2022 dhe në vitin 2021 në vlerën 105,947,349 lekë, si dhe nga llog.203 “Koncesione, patenta, licenca të ngjashme” në vlerën 441,349,123 lekë në fund të vitit 2022 dhe në vitin 2021 në vlerën 519,234,262 lekë.

Gjithashtu sipas formatit 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” në fund të vitit ushtrimor 2022 llogaria nr.202 “Studime dhe kërkime” paraqitet në vlerën 125,707,341 lekë dhe llogaria nr. 203 “Koncesione, patenta, licenca të ngjashme” në vlerën 441,349,123 lekë.

*në lekë*

Llog	Teprica në fillim			Shtesat gjate vitit		Pakësimet gjate vitit		Teprica ne Fund		
	Kosto Historike	Amortizim Akumuluar	Teprica Neto	Kosto Historike	Amortizim	Kosto Historike	Am	Kosto Historike	Amortizim Akumuluar	Teprica Neto
B			3	4	5	6	7	8	9	10
20	754,062,013	128,880,402	625,181,611	38,503,154	93,777,241	2,851,060	0	789,714,107	222,657,643	567,056,464
201										
202	125,363,760	19,416,411	105,947,349	38,503,154	15,892,102	2,851,060	0	161,015,854	35,308,513	125,707,341
203	628,698,253	109,463,991	519,234,262		77,885,139			628,698,253	187,349,130	441,349,123

Burimi: MTM/Përpunuar nga grupi i auditimit

-Referuar formatit të mësipërm konstatohet se për llogarinë nr.202 “Studime dhe kërkime”, rezulton të ketë shtesa në vlerën 38,503,154 lekë dhe pakësime në vlerën 2,851,060 lekë, ku kosto historike në fund të vitit 2022 paraqitet në vlerën 161,015,854 lekë duke zbritur amortizimin e akumuluar në vlerën 35,308,513 lekë, teprica neto (vlera kontabël neto) paraqitet në shumën prej 125,707,341 lekë.

Gjithashtu konstatohet se për llogarinë nr.203 “Koncesione, patenta, licensa të ngjashme”, nuk rezulton të ketë shtesa dhe pakësime gjatë vitit, ku kosto historike në fund të periudhës paraqitet në vlerën 628,698,254 lekë duke zbritur amortizimin e akumuluar në vlerën 187,349,130 lekë, teprica neto (vlera kontabël neto) paraqitet në shumën prej 441,349,123 lekë.

### AKTIVET AFATGJATA MATERIALE (AAM)

Llogaritë e Klasës 21 “Aktivet Afatgjata Materiale”, AAM sipas të dhënave të pasqyruara për vitin ushtrimor 2022, vlere kontabël neto paraqitet në shumën 1,741,490,088 lekë. Në vitin paraardhës 2021, vlere kontabël neto e AAM-ve paraqitet në shumën 1,742,967,811 lekë, me një pakësim të AAM-ve në shumën (1,477,724) lekë, të pasqyruara në *Aneksin 4/2 “Aktivet afatgjata”* bashkëngjitur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Ndërsa sipas formatit 7/a “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” paraqiten në mbylljen e vitit ushtrimor 2022 në vlerën 1,741,490,088 lekë dhe në fund të vitit ushtrimor 2021 në vlerën 1,742,967,811 lekë. Llogaritë do të analizohen si më poshtë:

- Llogaria nr.210 “Toka, troje, terrene” paraqitet me vlerë 0 lekë.

- Llogaria nr.211 “Pyje, Kullota, Plantacione” paraqitet me vlerë neto 45,939,364 lekë në fund të vitit 2022 dhe në vitin 2021 në vlerën neto 57,424,204 lekë.

Referuar analitikut të llogarisë nr.211, vlere neto prej 45,939,364 lekë përbëhet vetëm nga aktivi “Gjelbërimi Kthesa Kamëz Rinas”.

Nga auditimi i llogarisë më sipër rezulton se për vitin 2022 është llogaritur amortizim në shumën (11,484,841) lekë me normë amortizimi 20% mbi vlerën kontabël neto të vitit 2021.

**Për sa më sipër konstatohet** se norma e amortizimit e përdorur për këtë klasë aktivi është kryer



**te j normës së lejuar prej 5% duke sjellë në këtë mënyrë një zhvlerësim jo real të këtij aktivi.**  
**Veprimet dhe mosveprimet janë në kundërshtim** me UMF nr. 8, datë 9.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme” pika 36 ku citohet se: “ Në lidhje me amortizimin e aktiveve afatgjata, deri në daljen e dispozitave ligjore të veçanta për sektorin publik, amortizimi vjetor i këtyre aktiveve duhet të llogaritet sipas normave të përcaktuara në legjislacioni fiskal përkatës, si më poshtë vijon:

**Për aktivet afatgjata materiale si ndërtesat, konstruksionet, linjat teknologjike e të prodhimit, dhe makineritë e pajisjet me afat të gjatë shërbimi, duhet të zbatohet norma 5%, duke i llogaritur veçmas me vlerën e mbetur;**

*Kompjuterat, pajisjet e ruajtjes së të dhënave, softet e sisteme informacioni të amortizohen mbi bazë grupimi me normën 25%;*

*Për të gjitha aktivet e tjera afatgjata materiale duhet të zbatohet norma vjetore e amortizimit 20% mbi bazë grupimi; dhe*

*Për aktivet afatgjata jo materiale, amortizimi të llogaritet me metodën lineare me normë amortizimi 15%.*

*Baza e llogaritjes vjetore të amortizimit për aktivet afatgjata materiale (mbi të cilat aplikohet përqindja përkatëse e amortizimit vjetor mbi bazë grupimi) duhet të jetë e barabartë me:*

*Vlerën kontabël neto të kategorive përkatëse të aktiveve, të regjistruar në çelje të periudhës ushtrimore;*

*Shtesën e kostos së blerjes dhe kostos së përmirësimit dhe rinovimit të kategorive përkatëse të aktiveve gjatë periudhës ushtrimore; si dhe*

*Zbritjen e vlerës kontabile neto të aktiveve të shitura, të dala jashtë përdorimit apo të humbura për kategorinë përkatëse të aktiveve gjatë periudhës ushtrimore.”*

- Llogaria nr.212 “Ndërtesa dhe Konstruksione”, në fund të vitit 2022 paraqitet në vlerën neto 240,269,947 lekë dhe në fund të vitit ushtrimor 2021 paraqitet në vlerën prej 252,915,734 lekë. Referuar formatit 7/a “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike), në fund të vitit 2022 paraqitet në koston historike prej 331,102,779 lekë e pa ndryshuar nga viti 2021, pra nuk ka patur shtesa ose pakësime. Amortizimi i llogaritur rezulton në vlerën 12,645,787 lekë ose 5% mbi vlerën kontabël neto në çelje të vitit ushtrimor.

Analitiku i llogarisë nr.212 “Ndërtesa dhe Konstruksione” përbëhet nga 6 ndërtesa dhe konstruksione.

Për këto aktive nuk ka një regjistër kontabël ku të specifikohen të dhënat për secilin aktiv në kundërshtim me Udhëzimin nr.30,datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pika 26 ku citohet:“çdo njësi publike duhet të krijojë dhe të përditësojë një regjistër kontabël të të gjitha aktiveve që zotëron apo ka në administrim, përfshi dhe pronat publike nga të cilat siguron të ardhura. Regjistri mbahet në formën e kartelave ose në formë të sintetizuar”, pika 30 ku citohet: “Formati i regjistrit të aktiveve hartohet në vartësi të llojit të tyre afatgjatë apo afatshkurtër si dhe grupit përkatës brenda llojit. Kërkesat minimale që duhet të përmbajë regjistri i aktiveve në vartësi të llojit, përfshijnë: datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datën e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia.

Analitiku i llogarisë nr.212 “Ndërtesa dhe Konstruksione”

vlera historike

Nr.	Përshkrimi	Viti 2021	Shtesa	Pakësime	Viti 2022
1	Murri rrethues Porto Romano	54,518,029			54,518,029
2	Ndërtesa e Portoromanos	5,580,297			5,580,297
3	Magazina shkozet Durres (AKTUALISHT PASKUCI) çmimi	415,000			415,000

Nr.	Përshkrimi	Viti 2021	Shtesa	Pakësime	Viti 2022
	415.000 leke				
4	Godina e DSHP Tirane	81,529,646			81,529,646
5	Rikonstrukcion MTM	5,996,053			5,996,053
6	Ndërtesa e godinës së Ministrisë së Energjetikës çmimi 183.478.753	183,478,753			183,478,753

Burimi: MTM/Përpunuar nga grupi i auditimit

Nga auditimi i analitikut të llogarisë nr.212 “Ndërtesa dhe Konstruksione”, rezulton se nuk paraqiten shtesa ose pakësime gjatë vitit ushtrimor 2022.

- Llogaria nr.213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore”, në fund të vitit 2022 paraqitet në vlerën neto 731,774,005 lekë dhe në fund të vitit ushtrimor 2021 paraqitet në vlerën neto prej 730,966,321 lekë. Referuar formatit 7/a “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike), në fund të vitit 2021 paraqitet në koston historike prej 831,184,038 lekë, me shtesa në vitin 2022 në shumën 37,356,000 lekë, dhe gjendje në fund në shumën 868,540,038 lekë.

Analitiku i llogarisë nr.213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore” përbëhet nga 13 objekte.

Analitiku i llogarisë nr.213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore”

Nr.	Përshkrimi	Viti 2021	vlera historike		Viti 2022
			Shtesa	Pakësime	
1	Rruge sharre	3,957,260			3,957,260
2	Mbyllja rehab. mbet.urbane Vendepoz. ekzis.	80,486,936			80,486,936
3	Mbesht. Financi. Projekti BERZH	50,000,000			50,000,000
4	Forcim kapacitetesh 100 fshatrat	68,417,365			68,417,365
5	Vendosje sinjalistike 100 fshatrat	29,387,852			29,387,852
6	Pastrimi Lumit Ishëm	243,299,282			243,299,282
7	Rruge Kune Vain	144,471,468			144,471,468
8	Krijim i masterplaneve për zhvillimin e turizmit	81,515,800			81,515,800
9	Fondi për zhvillimin e turizmit	29,146,587			29,146,587
10	Fondi për turizmin	3,179,285			3,179,285
11	Studimi mbi Vendepozitime të rehabilituara	1,937,597			1,937,597
12	Sistemi i kamerave	95,384,608			95,384,608
13	Rrjete Stacionet e monitorimit të ajrit , module sistem transmetimi	-	37,356,000		37,356,000
	<b>Shuma</b>	<b>831,184,038</b>	<b>37,356,000</b>		<b>868,540,038</b>

Burimi: MTM/Përpunuar nga grupi i auditimit

Për këto aktive të llogarisë nr. 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore” nuk ka një regjistër kontabël ku të specifikohen të dhënat për secilin aktiv në kundërshtim me Udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pika 26 ku citohet: “Çdo njësi publike duhet të krijojë dhe të përditësojë një regjistër kontabël të të gjitha aktiveve që zotëron apo ka në administrim, përfshi dhe pronat publike nga të cilat siguron të ardhura. Regjistri mbahet në formën e kartelave ose në formë të sintetizuar”, pika 30 ku citohet: “Formati i regjistrit të aktiveve hartohet në vartësi të llojit të tyre afatgjatë apo afatshkurtër si dhe grupit përkatës brenda llojit. Kërkesat minimale që duhet të përmbajë regjistri i aktiveve në vartësi të llojit, përfshijnë: datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datën e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia. Nga ana e Grupit të Auditimit u konstatua se “Sistemi i kamerave” në vlerën 95,384,608 është keqklasifikuar në llogarinë 213 “Rruge, vepra ujore”. Kjo vlerë duhet të klasifikohet në llogarinë 214 “Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune”.

- Llogaria nr.214 “Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune”, paraqitet me vlerë 0 lekë.

- Llogaria nr.215 “Mjete transporti”, në mbyllje të vitit 2022 paraqitet në vlerën neto 11,533,776 lekë dhe në mbyllje të vitit 2021 në vlerën neto 14,417,220 lekë. Ndërsa referuar formatit 7/a “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)”, në fund të vitit 2022 paraqitet në koston historike prej 39,626,829 lekë e pa ndryshuar nga viti 2021, pra nuk ka patur shtesa ose pakësime. Amortizimi i llogaritur rezulton në vlerën 2,883,444 lekë ose 20% mbi vlerën kontabël neto në çelje të vitit ushtrimor.

Analitiku i llogarisë nr.215 “Mjete Transporti” përbëhet nga 10 mjete.

Nr.	Përshkrimi	Viti 2021	Shtesa	Pakësime	Viti 2022
1	Automjet hundaj targa AA529NS	2 871 938			2 871 938
2	AUTOMJET TIP BENZ KR 2150A	500 000			500 000
3	AUTOMJET TIP FORD TR1124 K	812 891			812 891
4	AUTOMJET TIP MITSUBISHI VL9608B	2 618 385			2 618 385
5	Automjet tip Hyundai Tuckon AA 530NS	2 871 938			2 871 938
6	Autovetura hyndaj Tucson targa AA754PN	4 515 907			4 515 907
7	Automjet Hundai TUSCON AA 473 HS	2 871 938			2 871 938
8	Autoveture Tojota Rav 4 me targe AA 991 PK	5 102 269			5 102 269
9	Automjet Tip VOLVOXC90	11 998 800			11 998 800
10	Automjet tip Voiksëagen me targe TR AA 3477B	5 462 763			5 462 763

Burimi: MTM/Përpunuar nga grupi i auditimit

Analitiku i llogarisë nr.215 “Mjete transporti” përbëhet nga 10 mjete me vlerë historike 39,626,829 lekë.

Për këto mjete transporti nuk ka një regjistër kontabël, nuk ka kartela inventariale për secilin mjet, si dhe nuk ka të dhëna për amortizimin e mjeteve dhe shtesa ose pakësime për secilin mjet, si mungojnë të dhëna ku të specifikohen të dhënat për secilin aktiv në kundërshtim me Udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pika 26 ku citohet: “Çdo njësi publike duhet të krijojë dhe të përditësojë një regjistër kontabël të të gjitha aktiveve që zotëron apo ka në administrim, përfshi dhe pronat publike nga të cilat siguron të ardhura. Regjistri mbahet në formën e kartelave ose në formë të sintetizuar”, pika 30 ku citohet: “Formati i regjistrit të aktiveve hartohet në vartësi të llojit të tyre afatgjatë apo afatshkurtër si dhe grupit përkatës brenda llojit. Kërkesat minimale që duhet të përmbajë regjistri i aktiveve në vartësi të llojit, përfshijnë: datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datën e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia.

- Llogaria nr.28 “Caktime të Aktiveve Afatgjata” paraqitet me vlerë neto 678,296,642 lekë në fund të vitit 2022 dhe në vitin 2021 në vlerën neto 647,593,417 lekë. Në këtë llogari janë pasqyruar Investimet për të tretët por që janë likuiduar nga MTM-ja. Analitiku i llogarisë nr.28 “Caktime”, të pasqyruara në *Aneksin 4/6 “Caktime”* bashkëngjitur Raportit Përfundimtar të Auditimit paraqiten të gjitha projektet e investimit për palë të treta të cilat janë në proces. Nga ana e Grupit të Auditimit u konstatua se Sektori i Financës nuk ka informacion për projektet e investimit të zhvilluara përpara vitit 2017, pra se çfarë përfaqëson vlera prej 235,323,285 lekë, duke ndikuar në pasqyrimin jo të drejtë të pasqyrave financiare të institucionit.

Veprime këto në kundërshtim me VKM-në nr. 25, datë 20.01.2011 “Për disa ndryshime të vendimit nr. 248 datë 10.04.1998 për miratimin e planit kontabël publik “ dhe Udhëzimit të MFE nr. 8, datë 09.03.2018 “Për Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme.”

<b>Titulli i Gjetjes:</b>	“Mbi kontabilizimet në llogarinë nr.28 “Caktime” për investime të zhvilluara përpara vitit 2017 në vlerën 235,323,285 lekë gjendje të cilat nuk janë të analizuara”.
<b>Situata:</b>	Nga auditimi i analitikut të llogarisë nr.28 “Caktime” në Pasqyrën e Pozicionit Financiar për vitin ushtrimor 2022, në shumën 678,296,642 lekë (e cila përbëhet kryesisht nga TVSH për projekte), rezulton se një pjesë e konsiderueshme e kësaj llogarie përbëhet nga shuma prej 235,323,285 lekë shumë e cila në analitikun e llogarisë paraqitet si e mbartur përpara vitit 2017. Nga auditimi u konstatua se nga ana e Drejtorisë së Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar nuk ka informacion se cilat janë këto projekte/investime të zhvilluara përpara vitit 2017, si dhe

	<i>nuk kanë emërtim, nuk paraqiten kartela inventariale dhe nuk dihet se çfarë përfaqëson.</i> Mungesa e analizës për këto projekte/investime të mbartura përpara vitit 2017, por të regjistruara në pasqyrat financiare të vitit 2022 në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, ka një ndikim të konsiderueshëm në informacionin kontabël që ofrojnë këto pasqyra në lidhje me pohimet financiare, për rrjedhojë nuk përmbushin kriteret e plotësisë së një aktivi, mos ekzistencën e informacionit kontabël si dhe vërtetësinë e vlerave të aktiveve afatgjata materiale.
<b>Kriteri:</b>	UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar pikat 26, 28, 30, Kreu IV pika 75; Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” Kreu II pika 5 dhe Kreu III pika 30.
<b>Ndikimi/Efekti:</b>	Mungesa e analizës për shumën 235,323,285 lekë me ndikim në informacionin kontabël që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave të llogarisë nr.28 “Caktim”, duke paraqitur risk në sigurinë e arsyeshme dhe besueshmërinë e evidencës kontabël për përdorimin e tyre nga subjektet e interesuara.
<b>Shkaku:</b>	Nga Drejtoria e Buxhetit dhe e Menaxhimit Financiar nuk janë marrë masat e nevojshme për analizimin dhe saktësimin në kontabilitet të këtyre projekteve/investimeve të mbartura, duke mbledhur e evidentuar të dhënat nga gjithë dokumentacioni financiar i trashëguar në vite.
<b>Rëndësia:</b>	E Lartë
<b>Rekomandimi:</b>	Drejtoria e Buxhetit dhe e Menaxhimit Financiar të marrë masa që të kryejë zbrëthimin e dokumentacionit financiar të trashëguar për nxjerrjen e të dhënave për projektet/investimet e mbartura në llogarinë nr.28 “Caktim”, në mënyrë të tillë që të verifikohet, saktësohet dhe të analizohen vlerat e paraqitura në Pasqyrat Financiare dhe në rast pasaktësish të bëhen sistemimet e nevojshme në kontabilitet.

## INVESTIMET

Llogaria 23 “Investimet” paraqitet në vlerën 357,326,354 lekë. Në pasqyrën nr. 6 “Shpenzime për Investime”, paraqiten si vijon:

Nr	Llog	Emërtimi	31.12.2021	Debitim	Kreditim	31.12.2022
<b>1</b>	<b>I.</b>	<b>SHPENZIMET PER INVESTIME</b>	<b>0</b>	<b>357,326,354</b>	<b>0</b>	<b>357,326,354</b>
2	230	Shpenzime për Aktive Afatgjata jo materiale		106,944,900		106,944,900
3	231	Shpenzime për Aktive Afatgjata materiale		250,381,454		250,381,454

Gjendja e llogarisë nr. 230 “Investime për aktive afatgjata jomateriale” në fund të vitit ushtrimor 2022 paraqitet në vlerën prej 106,944,900 lekë. Në këtë llogari paraqiten projektet të cilat janë nga Fondi për Zhvillimin e Turizmit në territorin e Republikës së Shqipërisë, të cilat realizohen brenda vitit buxhetor.

Në *Aneksin 4/7 “Projektet për vitin 2021-2022”* bashkëngjitur Raportit Përfundimtar të Auditimit paraqiten projektet e detajuara.

Nga auditimi i pasqyrës së Investimeve, konstatohet se gjendja në 31.12.2021, paraqitet zero, ndërkohë që nga ana e MTM, me anë të Fondit të Zhvillimit të Turizmit janë realizuar projektet sipas *Aneksin 4/7 “Projektet për vitin 2021-2022”*.

*Aneksin 4/7 “Projektet për vitin 2021-2022”* paraqet në mënyrë analitike investime (projekte) të cilat kanë qenë në proces gjatë vitit ushtrimor 2021, konkretisht janë 8 projekte në shumën 17,372,947 lekë. Nga auditimi konstatohet se këto projekte nuk janë paraqitur në PF e vitit 2021

konkretisht në llogarinë nr.230 “Investime për aktive afatgjata jomateriale”, pasi kjo llogari është paraqitur në vlerën 0 lekë.

Veprime në kundërshtim me Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, pika 18, ku cilësohet se: “Me kapitalizimin e aktiveve bëhet verimi kontabël në debi të llogarive përkatëse të grupit 20 dhe 21 të aktiveve afatgjata në kredi të llogarive përkatëse të grupit 23, llogaritë e investimeve”.

Këto projekte të pa përfunduara në vitin 2021 duhet të pasqyroheshin në llogarinë nr.230 “Investime për aktive afatgjata jomateriale”, dhe në momentin e marrjes në dorëzim të kapitalizohen më pas tek klasa e aktiveve afatgjata materiale në vlerën e plotë kontabël të aktivitetit.

<b>Titulli i Gjetjes:</b>	Mbi klasifikimin e llogarisë nr.230 “Investime në proces” dhe kapitalizimin e Aktiveve Afatgjata Jo-Materiale”, për vitin 2021.
<b>Situata:</b>	Nga auditimi rezulton se gjatë vitit ushtrimor 2021, për 8 projekte në shumën 17,372,947 lekë kanë qenë aktive afatgjata jo materiale në proces ku investimi i tyre ka qenë i pa përfunduar. Këto projekte nuk janë paraqitur në Pasqyrat Financiare të vitit 2021 konkretisht në llogarinë nr.230 “Investime për aktive afatgjata jomateriale”, pasi kjo llogari është paraqitur në vlerën 0 lekë. Këto projekte të pa përfunduara në vitin 2021 duhet të pasqyroheshin në llogarinë nr.230 “Investime për aktive afatgjata jomateriale”, dhe në momentin e marrjes në dorëzim të kapitalizohen më pas tek klasa e aktiveve afatgjata materiale në vlerën e plotë kontabël të aktivitetit.
<b>Kriteri:</b>	Ligjin 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” neni 6; të nenit 10 dhe 11, të ligjit nr. 9228, datë 29.4.2004, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” udhëzimin nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, Kreu 2 “Klasa 2 Aktivitet Afatgjata” Përbërja dhe trajtimi kontabël”.
<b>Ndikimi/Efekti:</b>	Rritje jo të saktë të llogarisë nr.230 “Investime në proces”, dhe nga ana tjetër mungesë të kapitalizimit të vlerave të aktiveve dhe aseteve në llogaritë e AAGJ-më.
<b>Shkaku:</b>	Mos zbatim i akteve ligjore të kontabilitetit dhe parimeve kontabël mbi pjesën e hyrjes së aktivitetit në njësi.
<b>Rëndësia:</b>	E Mesme
<b>Rekomandimi:</b>	Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar të marrë masa për sistemimin në kontabilitet të llogarisë nr.230 “Investime në proces” me mbylljen e bilancit të vitit pasardhës, për vlerën kontabël prej 17,372,947 lekë, të projekteve të cilat janë marrë në dorëzim, duke kryer veprimin kontabël në debi të llogarisë nr.202 “Studime dhe Kërkime” dhe në kredi të llogarisë nr.230 “Investime në proces”.

**Gjendja e llogarisë nr.231 “Investime për aktive afatgjata materiale”** në fund të vitit ushtrimor 2022 paraqitet në vlerën prej 250,381,454 lekë. Në këtë llogari paraqiten investimet në proces për aktivet afatgjata materiale pasqyruar në **Aneksin 4/8 “Investime për aktive afatgjata materiale”** bashkëngjitur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

### **Pasivet Afatshkurtra**

Llogaritë e klasës 4, në pasiv të Pasqyrës së Pozicionit Financiar, janë llogari të pagueshme ato paraqesin detyrimet e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit më 31.12.2022, kundrejt furnitorëve, pagat e punonjësve të muajit dhjetor 2022, detyrimet kundrejt tatimeve, sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të muajit dhjetor 2022, kreditorë për mjete në ruajtje të cilat kryesisht kanë të bëjnë me garancitë e kontratave, kreditorë të ndryshëm etj., të pasqyruara në **Aneksin 3.3 “Pasivet Afatshkurtra”** bashkëngjitur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

- Llogaria 42, “Detyrime ndaj personelit”, sipas pasqyrave financiare të paraqitura pranë MTM, paraqitet në vlerën 9,394,213 lekë dhe përfaqëson vlerën e pagave të muajit dhjetor për t’u paguar në muajin janar të vitit pasardhës, e cila rakordon me vlerën sipas listë pagesave të muajit Dhjetor.
- Llogaria 431 “Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa”, llogaria 435, “Sigurime shoqërore” dhe llogaria 436 “Sigurime shëndetësore” paraqet vlerën e pa paguar për sigurime shoqërore e shëndetësore për pagat e muajit dhjetor 2022 që paguhen në muajin janar 2023 dhe janë përkatësisht në vlerat 808,523 lekë, 1,527,023 lekë dhe 173,682 lekë.
- Llogaria nr.466 “Kreditorë për mjete në ruajtje”, nga pasqyra e pozicionit financiar për vitin 2022 kjo llogari paraqitet në vlerën kontabël prej 28,919,406 lekë, vlerë kjo e cila është e rakorduar me degën e thesarit, dhe përfaqëson vlerën e garancisë së kontratave në masën 5%.

<b>Titulli i gjetjes:</b>	Mbi kontabilizimin e llogarisë nr.466 “Kreditorë për mjete në ruajtje”.
<b>Situata:</b>	Llogaria 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje”, sipas Pasqyrës së Pozicionit Financiar, në fund të vitit 2022 paraqitet në vlerën <b>28,919,425</b> lekë, e cila përfaqëson vlerën e garancisë së kontratave në masën 5%. Nga analiza e kësaj llogarie përbëhet nga 10 objekte nga të cilat për 7 objekte në vlerën prej 20,730,648 lekë, janë fonde që gjenden të ngurtësuar deri në vitin 2014, për të cilat është tejkaluar afati i garancisë dhe nuk është bërë zhbllokimi i tyre sipas kushteve të kontratave respektive. Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar nuk ka ndërmarrë asnjë veprim për të bërë zhbllokimin e këtyre fondeve dhe përdorimin e tyre në buxhetin e vet.
<b>Kriteri:</b>	UMF nr.8, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njëjësive të Qeverisjes së Përgjithshme, Kapitulli II, pikat nr.29, 30, 39 dhe 50; UKM nr.3, datë 15.02.2011 “Për mbikqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, Kapitulli II, pika nr.10.6,
<b>Ndikimi/Efekti:</b>	Mos regjistrimi në kontabilitet dhe deformim i informacionit financiar për sa i përket gjendjes kontabël të paraqitur në Pasqyrat e Pozicionit Financiar për vitin 2022 të llogarisë 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje”.
<b>Shkaku:</b>	Mos njohja dhe mos zbatim i udhëzimit nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”.
<b>Rëndësia:</b>	E Mesme
<b>Rekomandimi:</b>	Nga Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar të merren masa për sistemimin e llogarisë 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje”, duke rakorduar çdo muaj vlerat e llogarisë, si dhe duke njoftuar subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të nevojshëm për të sistemuar dhe pastruar/transferuar shumat e garancive të cilat tashmë u ka kaluar afati i përcaktuar në kontratën e investimit përkatës.

**Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/ fondet neto** të pasqyruara në **Aneksin 4/10** “Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/ fondet neto”, bashkëngjitur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

<b>Titulli i Gjetjes:</b>	Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/ fondet neto.
<b>Situata:</b>	Nga auditimi rezultoi se Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/ fondet neto dhe pasqyrimi i vlerave në pasqyrën e Pozicionit Financiar në rubrikën C ka një mungesë rakordimesh të vlerave në pasqyrë. Aktivet neto nuk rakordojnë me fondet neto, dhe për disa zëra nuk ka informacion sesi Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar ka arritur në rezultatet e mësipërme. Gjithashtu, në pasqyrën e ndryshimeve të aktiveve neto nuk



	janë plotësuar të gjithë zërat që përfaqësojnë ndryshimet e ndodhura në burimet e brendshme. Veprimet e mësipërme në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njëjësive të qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar pika 3.6.
<b>Kriteri:</b>	Udhëzimi I MFE nr. 8, datë 09.03.2018 “Për Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, i ndryshuar paragrafi 2.3
<b>Ndikimi/Efekti:</b>	Mos pasqyrim i saktë i llogarive me efekt material në pasqyrën financiare.
<b>Shkaku:</b>	Keqklasifikim të llogarive.
<b>Rëndësia:</b>	E lartë
<b>Rekomandimi:</b>	Drejtorja e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar të marrë masat për të kryer sistemimet e nevojshme dhe regjistrimet në kontabilitet në bazë të klasifikimit ekonomik kontabël, për një pasqyrim më të drejtë të fondit neto, me qëllim që të parandalohen gabimet apo parregullsitë e mundshme në interpretimin e llogarive të pasqyrave financiare.

**d. Inventarizimi i pronës shtetërore, nxjerrja e rezultateve të inventarizimit dhe sistemimi i diferencave në përputhje me rregullat kontabël**

Auditimi u fokusua në rregullshmërinë e kryerjes së procesit të inventarizimit sipas Udhëzimit nr. 30 të MFE, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”. Nga shqyrtimi dhe vlerësimi i praktikave të dokumentuara të vëna në dispozicion të grupit të auditimit, ka rezultuar sa më poshtë vijon:

Nga auditimi u konstatua se Ministria e Turizmit dhe Mjedisit ka të dhëna mbi gjendjen fizike dhe vlerën kontabël të pronave në përputhje me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, neni 26 ku citohet: “Çdo njësi publike duhet të krijojë dhe të përditësojë një regjistër kontabël të të gjitha aktiveve që zotëron apo ka në administrim, përfshi dhe pronat publike që siguron të ardhur ...” dhe neni 31, citohet “...për objektet e dhëna me qira – sipërfaqja e objektit në m<sup>2</sup>, numri dhe data e kontratës së qirasë, afati i vlefshmërisë së kontratës...”.

Nisur nga rëndësia dhe materialiteti sasior dhe në natyrë të aspekteve të menaxhimit material dhe mundësisë për veprime të pajustificuara, ky aspekt është audituar shtrirë për periudhën 2020-2022. Nga shqyrtimi dhe vlerësimi i praktikave dokumentuara të vëna në dispozicion të grupit të auditimit, ka rezultuar se, për periudhën objekt auditimi, është realizuar procesi i inventarizimit në përputhje me Paragrafin nr. 74, i Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar ku citon ... “Çdo njësi publike duhet të kontrollojë të paktën një herë në vit ekzistencën dhe vlerësimin e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, aktiveve afatshkurtra, të detyrimeve dhe të drejtave, nëpërmjet inventarizimit të këtyre elementeve dhe dokumentacionit mbështetës.”

-Llogaria nr.218 “Inventar ekonomik”, në mbyllje të vitit 2022 paraqitet në vlerën neto 32,797,836 lekë dhe në mbyllje të vitit 2021 në vlerën neto 39,650,915 lekë. Ndërsa referuar formatit 7/a “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)”, në fund të vitit 2021 paraqitet në koston historike prej 64,253,440 lekë dhe në fund të vitit 2022 në vlerën 66,474,190 lekë.

**Pasqyra statistikore nr. 7.b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata me vlerën neto të tyre”, llogaria nr.218**

Llog	Teprica Në fillim			Shtesat gjate vitit		Pakësimet gjate vitit		Teprica ne Fund		
	Kosto Historike	Am. I Akumuluar	Teprica Neto	Kosto Historike	Amortizim	Kosto Historike	Amortizim	Kosto Historike	Amortizim Akumuluar	Teprica Neto
218	64,253,440	24,602,525	39,650,915	6,392,324	8,325,167	4,171,574	129,856	66,474,190	32,797,836	33,676,354

Referuar të dhënave të paraqitura në pasqyrën statistikore nr.7/b, për llogarinë nr.218 “Inventar ekonomik”, rezulton se gjatë vitit ushtrimor 2022 kemi shtesa të vitit në shumën 6,392,324 lekë si dhe amortizim të kësaj llogarie në shumën (8,325,167) lekë.

Nga auditimi konstatohet se kemi pakësim gjatë vitit ushtrimor të kësaj llogarie në shumën **4,171,574 lekë**. Pakësimi i llogarisë në këtë shumë duhet të përfaqësojë materiale të cilat janë transferuar apo të nxjerra jashtë përdorimi nga ana e MTM-së.

Nga krahasimi i regjistrit përmbledhës të aktiveve bashkëlidhur relacioneve, përkatësisht:

Relacionit me nr. 1752 prot., datë 14.02.2022 “Mbi inventarizimin e Përgjithshëm të Mjeteve Kryesore dhe Inventarit ekonomik ne aparatit e MTM për vitin 2021” dhe relacionit me nr.9166/1 prot., datë 16.01.2023 “Mbi inventarizimin e Përgjithshëm të Mjeteve Kryesore dhe Inventarit ekonomik ne aparatit e MTM për vitin 2022”, rezultoi një pakësim me një diferencë në shumën **5,752,654 lekë**, e përshkruar analitikisht në **Aneksin nr. 4/11: “Materialet në dalje për vitin ushtrimor 2022, llogaria nr.218 “Inventar Ekonomik”** bashkëngjitur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

### **Kalimet e kapitalit pa pagesë**

#### **Viti 2021**

Nga auditimi i pasqyrave financiare u konstatua se në MTM janë bërë pakësime në shumën 42,647,810 lekë. MTM ka kryer transferime/pakësime në institucionet e varësisë pasqyruar në **Aneksin nr. 4/12: “Transferime/pakësime AAGJ”** bashkëngjitur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

*Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion në lidhje me kalimet kapitale pa pagesë janë kryer transferimet kapitale si vijon:*

- Me Urdhrin e Ministrit nr. 147, datë 17.06.2021 “*Kalim kapitali pa pagesë të orendive pajisje zyre*”, nga MTM në Agjencinë Kombëtare të Pyjeve në shumën 915,600 lekë.

Nga ana e Grupit të Auditimit u konstatua se kalimi nuk ka të bashkëngjitur kartelën shoqëruese të llogaritjes së vlerës së amortizimit të akumuluar dhe të llogaritur nga MTM deri në momentin e daljes nga pronësia;

- Sa i takon pakësimeve të tjera nga MTM në institucionet e varësisë, **nuk ka dokumentacion vërtetues bashkëlidhur për transferimet kapitale.**

Veprimet e mësipërme janë kryer në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*”, pika 55 ku citohet ... “*Për hyrjet e mallrave që qarkullojnë pa pagesë në njësitë e sektorit publik fletë-hyrja e plotësuar nga magazina duhet të ketë bashkëlidhur dokumentacionin përkatës si: fletëdaljen e nënshkruar nga përfaqësuesit e njësisë shpenzuese që ka bere dalje mallin; Shkresën e Njësisë për transferimin e aktiveve; Autorizimin për tërheqje malli të firmosur nga nëpunësi zbatues dhe Nëpunësi Autorizues.*”

#### **Viti 2022**

Për vitin 2022, sa i takon llogarisë 218 “Inventar ekonomik”, u konstatua se nga ana e MTM-së janë kryer transferimet kapitale si vijon:

- Me Urdhrin e Ministrit nr. 29, datë 24.01.2022 “*Kalim kapitali pa pagesë të pajisjeve TIK*”, nga MTM në Agjencinë Kombëtare të Bregdetit në shumën 663,374 lekë.

*Nga ana e Grupit të Auditimit u konstatua se kalimi nuk ka të bashkëngjitur kartelën shoqëruese të llogaritjes së vlerës së amortizimit të akumuluar dhe të llogaritur nga MTM deri në momentin e daljes nga pronësia;*

-Me Urdhrin e Ministrit nr. 145, datë 14.04.2022 “*Kalim kapitali pa pagesë të 10 copë tabletave Lenovo TB-X306X*”, nga MTM në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit në shumën 340,200 lekë.

*Nga auditimi u konstatua se kalimi nuk ka të bashkëngjitur kartelën shoqëruese të llogaritjes së vlerës së amortizimit të akumuluar dhe të llogaritur nga MTM deri në momentin e daljes nga pronësia. Gjithashtu mungon procesverbali i marrjes në dorëzim.*



<b>Titulli i Gjetjes:</b>	Kalim kapitali pa pagesë i aktiveve gjatë viteve.
<b>Situata:</b>	Nga auditimi i procesit të kalimit të aktiveve, nga një subjekt në tjetrin mbështetur në Urdhrat për “ <i>Kalim kapitali pa pagesë</i> ” u konstatua mungesë dokumentacioni si: kartela e llogaritjes së vlerës së amortizimit të akumuluar dhe të llogaritur nga subjekti deri në momentin e daljes nga pronësia, ku nga MTM është regjistruar në kontabilitet vlera e kostos historike të tyre; Veprime në kundërshtim me Udhëzimit nr. 30 datë 27.12.2011, në kapitullin III të udhëzimit “Regjistri i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyre”. Mungesa e dokumentacioneve shoqëruese le të hapur ciklin e transferimit të kapitalit nga një institucion në tjetrin.
<b>Kriteri:</b>	Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “ <i>Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik</i> ” kapitulli III “Regjistri i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyre”.
<b>Ndikimi/Efekti:</b>	Mos llogaritje e vlerës së mbetur të aktivitetit, çon në regjistrimin e vlerës jo reale të aktivitetit. Mos paraqitja e flete hyrjeve ose fletë daljeve si dhe aktit të konfirmimit, lë të hapur ciklin e transferimit të kapitalit.
<b>Shkaku:</b>	Mos plotësimi i dokumentacionit shoqërues sipas përcaktimeve ligjore.
<b>Rëndësia:</b>	E mesme
<b>Rekomandimi:</b>	Drejtorja e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar të marrë masat, që për çdo procedurë transferimit, e pakësimit ose të shtesës së aktive në kontabilitet nga lëvizjet kapitale pa pagesë brenda apo jashtë sistemit, të administrojë të gjithë dokumentacionin përkatës të kalimit kapital të aktiveve hyrëse ose daljeve, me qëllim mbylljen e ciklit të transferimit si dhe verifikimin e regjistrimit në kontabilitet të tyre.

<b>Titulli i Gjetjes:</b>	Mungesa e një regjistri të plotë të aktiveve, si dhe mos klasifikimi i aktiveve sipas llogarive të përcaktuara në planin kontabël publik.
<b>Situata:</b>	Nga auditimi i zërave të pasqyrës së aktivitetit për vitin 2022 u konstatua se: -MTM ka një regjistër elektronik për aktivet afatgjata, i cili nuk është përditësuar me vlerën aktuale të aktiveve që institucioni ka në pronësi. Mungesa e mbajtjes së regjistrimit të aktiveve, sipas formatit të përcaktuar në Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “ <i>Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik</i> ” kapitulli III, ku në varësi të llojit të aktivitetit duhet të përmbajë datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim për secilin aktiv, vlerën e amortizimit të akumuluar ndër vite me qëllim verifikimin e vlerës së mbetur të aktiveve në dispozicion të institucionit, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes së tyre etj. si një faktor i rëndësishëm për mirëmbajtjen dhe mirë menaxhimin e aktiveve në pronësi. Si rrjedhojë mungesa e regjistrimit ka sjellë që edhe Amortizimi i aktiveve, i cili është përlllogaritur bazuar në Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03.2018 “ <i>Për Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme</i> ”, i ndryshuar pika 36; konstatohet se përlllogaritja e tij është bërë për aktivet në total dhe jo për secilin aktiv më vete, <b>duke sjellë vështirësi në përcaktimin e vlerave reale të aktiveve (për artikull) që institucioni disponon.</b>
<b>Kriteri:</b>	Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në

	njësitë e sektorit publik” kapitulli III. Udhëzimit të MFE nr. 8, datë 09.03.2018 “ <i>Për Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme</i> ”; VKM-në nr. 25 datë 20.01.2011 “ <i>Për disa ndryshime të vendimit nr. 248 datë 10.04.1998 për miratimin e planit kontabël publik .</i> “
<b>Ndikimi/Efekti:</b>	Mos disponimi i një regjistri të plotë të aktiveve, si dhe mos evidentimi i saktë i gjendjes reale të aktiveve që disponon institucioni ndikon në pamundësinë që institucioni të vlerësojë nëse këto të fundit përdoren në mënyrë efektive, efikase dhe ekonomike për të ofruar shërbimet publike, si dhe ndikon në mos Planifikimin efektiv financiar afatmesëm të nevojave të institucionit për zëvendësimin e këtyre aktiveve, që janë në përfundim të ciklit të tyre të funksionimit.
<b>Shkaku:</b>	Trashëguar në vite mënyra e mbajtjes dhe regjistrimit të aktiveve në kontabilitet.
<b>Rëndësia:</b>	E lartë
<b>Rekomandimi:</b>	Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar të marrë masa për krijimin e një regjistri të plotë të aktiveve të njësisë, duke specifikuar në mënyrë analitike secilin aktiv me informacione në lidhje me, datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datën e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia.

### **- Inventarizimi fizik**

Për vitet 2020-2022 janë ngritur komisionet e inventarizimit me urdhër e Sekretarit të Përgjithshëm të MTM, përkatësisht:

Për vitin 2020, Urdhri i Sekretarit të Përgjithshëm të MTM nr. 323 , datë 17.12.2020 “*Për ngritjen e komisionit të inventarizimit të përgjithshëm të mjeteve kryesore dhe inventarit ekonomik në pronësi të MTM për vitin 2020*”;

Për vitin 2021, Urdhri i Sekretarit të Përgjithshëm të MTM nr. 313, datë 21.12.2021 “*Për ngritjen e komisionit të inventarizimit të përgjithshëm të mjeteve kryesore dhe inventarit ekonomik në pronësi të MTM për vitin 2021*”;

Për vitin 2022, Urdhri i Sekretarit të Përgjithshëm të MTM nr.383 datë 09.12.2022 “*Për ngritjen e komisionit të inventarizimit të përgjithshëm të mjeteve kryesore dhe inventarit ekonomik në pronësi të MTM për vitin 2022*”.

Nga auditimi i dosjeve të inventarit për vitet 2020-2022, u konstatua se para fillimit të inventarit, nga komisioni i inventarizimit nuk është mbajtur procesverbal, ku të ishte fiksuar numri rendor nëpërmjet një procesverbali të mbajtur midis përgjegjësit material dhe komisionit të inventarizimit, veprim ky në kundërshtim me pikën 82 të UMF nr. 30/2011, i ndryshuar, ku citohet ... “*Para fillimit të inventarit fiksohet numri rendor i fletë hyrjes dhe fletë daljeve nëpërmjet një proces verbali të mbajtur midis përgjegjësit material dhe komisionit të inventarizimit dhe behet mbyllja dhe dyllosja e magazinës. Hapja dhe mbyllja behet në prani të komisionit dhe përgjegjësit material.*”

Në dosje janë depozituar kartelat/ fletët e inventarit të çdo punonjësi, të nënshkruara rregullisht nga komisioni i inventarizimit dhe persona materialisht përgjegjës.

Nga komisioni i inventarizimit në fund të procesit ka përgatitur raportin mbi inventarizimin për gjendjen e aktiveve në përdorim, si dhe për vlerat materiale, (për kushtet e ruajtjes së tyre, gjendjen fizike), ku së bashku me gjithë dokumentacionin e inventarizimit është dorëzuar tek nëpunësi autorizues për veprime të mëtejshme, veprime në përputhje me paragrafin 85/c të UMF

nr. 30/2011, i ndryshuar. Në relacion komisioni është shprehur se nuk ka diferenca midis gjendjes kontabël dhe asaj fizike.

<b>Titulli i gjetjes:</b>	Mungesa e vlerësimit të inventarëve si dhe ekzistenca e konfliktit të interesit përgjatë kryerjes së inventarizimit.
<b>Situata:</b>	<p>Nga auditimi i procesit të inventarizimit konstatohet se, nga ana e strukturave të MTM-së paraqiten mangësi pasi nuk ka relacione shpjeguese për të cilat të jetë kryer vlerësimi i inventarëve, si edhe për diferenca të materialeve nëse janë propozuar për vlerësim, e më pas nxjerrje jashtë përdorimi, pra nga ana e MTM-së nuk është ngritur një komision i vlerësimit të aktiveve, rrjedhimisht nuk ka patur as komisione për nxjerrjen jashtë përdorimi/asgjësimi të aktiveve.</p> <p>Veprimet e mësipërme janë kryer në kundërshtim me Udhëzimin nr.30 datë 27.12.2011 <i>“Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”</i>, pika 104 <i>“Proces verbali i vlerësimit”</i>.</p> <p>Nga auditimi i procedurës së inventarizimit u konstatua se për procedurat e inventarizimit të ngritur me Urdhrin nr. 323, datë 17.12.2020 <i>“Për ngritjen e komisionit të inventarizimit të përgjithshëm të mjeteve kryesore dhe inventarit ekonomik në pronësi të MTM për vitin 2020”</i>, Urdhrin nr. 313, datë 21.12.2021 <i>“Për ngritjen e komisionit të inventarizimit të përgjithshëm të mjeteve kryesore dhe inventarit ekonomik në pronësi të MTM për vitin 2021”</i>, dhe Urdhrin nr.383 datë 09.12.2022 <i>“Për ngritjen e komisionit të inventarizimit të përgjithshëm të mjeteve kryesore dhe inventarit ekonomik në pronësi të MTM për vitin 2022”</i>, komisioni i inventarizimit përbehet nga tre anëtarë, ndër të cilët në përbërje të tyre ka patur Specialistin e Sektorit të Financës në Drejtorinë e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar, si dhe Përgjegjës të Sektorit të Shërbimeve. Në këtë proces nuk u konstatua firmosja e deklaratave të mungesës së konfliktit të interesit në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 30, datë 27.12.2011 <i>“Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”</i>, i ndryshuar ku citohet... 82. <i>“Anëtarët e komisionit nuk duhet të kenë konflikt interesi”</i>.</p> <p>Gjithashtu veprimi mësipërm i vendosjes së specialistit të financës në komisionin e inventarizimit, bien në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 <i>“Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”</i>, i ndryshuar, Neni 22, ku citohet... 3.b <i>“ndarjen e detyrave në fushën e dhënies së autorizimit në atë formë, në mënyrë që i njëjti punonjës të mos jetë përgjegjës në të njëjtën kohë për propozimin, miratimin, zbatimin, kontabilitetin dhe kontrollin, sipas udhëzimit të Ministrisë të Financave”</i>.</p>
<b>Kriteri:</b>	Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 <i>“Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”</i> , i ndryshuar dhe Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 <i>“Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”</i> , i ndryshuar.
<b>Ndikimi/Efekti:</b>	Mangësi në procesin e inventarizimit
<b>Shkaku:</b>	Ngritja e komisionit të inventarizimit me punonjës në kushtet e konfliktit të interesit.
<b>Rëndësia:</b>	E mesme
<b>Rekomandimi:</b>	-Nga Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar të merren masa për verifikimin e pakësimeve të aktiveve të llogarisë 218 <i>“Inventar Ekonomik”</i> në vlerën prej 5,752,654 lekë të konstatuara nga grupi i auditimit dhe nxjerrjen e përgjegjësive për mos identifikimin dhe

	<p>dokumentimin/argumentimin e tyre nga komisionet e inventarizimit.</p> <p>- Titullari i Institucionit në cilësinë e NA të marrë masa në vijimësi për shmangien e përfshirjes së punonjësve në proceset e punës, të cilat e vendosin atë në konflikt interesi, me qëllim funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm sa më të qëndrueshëm dhe më efektiv.</p>
--	---

## 2.5 Prokurimet e fondeve publike

Grupi i auditimit, për të realizuar qëllimin dhe objektin e auditimit të përputhshmërisë në lidhje me prokurimet e fondeve publike, u fokusua në zbatimin e bazës ligjore dhe nënligjore të:

- Ligjit nr. 162 datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar;
- Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar;
- Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar;
- VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar;
- VKM-së nr. 918 datë 29.12.2014 “Për kryerjen e procedurave të prokurimit publik në mënyrë elektronike”;
- VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar;;
- Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, si dhe çdo akti juridike që është në fuqi në lidhje mbi prokurimet publike të financuara nga Buxheti i Shtetit.

Auditimi i procedurave të prokurimit të kryera nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit. në cilësinë e AK u ushtrua bazuar në aktet ligjore/ nënligjore të prokurimit publik, si dhe në aktet ligjore/ nënligjore që kanë lidhje me objektet e prokurimit.

Në zbatim të kësaj pike, grupi i auditimit shqyrtoi dokumentacionin, si më poshtë:

- Vlerësimin e hartimit të nevojave për mallra, punë dhe shërbime nga subjekti i audituar;
- Regjistri i parashikimeve;
- Regjistri i realizimeve;
- Shtesat dhe ndryshimet e bëra në regjistrat e parashikimeve të prokurimeve;
- Argumentimin dhe përlllogaritjen e vlerës së fondit limit të kontratës, sipas nevojave konkrete për mallra dhe shërbime;
- Realizimin e procedurave të prokurimit, që nga momenti i nxjerrjes së urdhrorit të prokurimit, deri në lidhjen e kontratës;
- Lidhjen dhe zbatimin e kontratave, deri në marrjen në dorëzim të mallrave, punëve dhe shërbimeve.

### ***1.Regjistri i parashikimeve***

- Autoriteti Kontraktor ka krijuar në SPE regjistrin e parashikimeve të prokurimeve publike në përputhje me formën dhe mënyrën, që është parashikuar, në Udhëzimin nr. 1, datë 03.01.2018 *”Për hartimin e parashikimit të regjistrit të parashikimit të procedurave të prokurimit dhe regjistrin të realizimit të procedurave të prokurimit dhe krijimi i tyre në sistemin e prokurimit publik”* dhe Udhëzimin nr. 4, datë 18.06.2021 *”Për hartimin e parashikimit të regjistrit të parashikimit të procedurave të prokurimit dhe regjistrin të realizimit të procedurave të prokurimit dhe krijimi i tyre në sistemin e prokurimit publik”*, të cilat janë dërguar me nr. 298, datë 18.01.2021 dhe nr. 444, datë 26.01.2022,

Regjistri i parashikimit për vitin 2020 është dërguar me shkresën nr. 1477, datë 12.02.2020

Regjistri i parashikimit për vitin 2021 është dërguar me shkresën nr. 289, datë 12.01.2021

Regjistri i parashikimit për vitin 2022 është dërguar me shkresën nr. 766, datë 27.01.2022.

Sa më sipër regjistrat nuk janë përgatitur, sipas afatit të përcaktuar Udhëzimin nr. 4, datë 18.06.2021 pika 3 ku citohet se “Regjistri i parashikimit të procedurave të prokurimit duhet të përgatitet nga AK jo më vonë se 10 (dhjetë) ditë nga miratimi i ligjit për buxhetin për vitin ushtrimor pasardhës”.

- Ligji i buxhetit nr. 88/2019 “Për buxhetin e vitit 2020” është botuar në fletoren zyrtare nr.221 datë 18.12.2019.

- Ligji i buxhetit nr. 137, datë 16.11.2020 “Për buxhetin e vitit 2021” është botuar në fletoren zyrtare nr.221 datë 17.12.2020.

- ligji i buxhetit nr. 115, datë 25.11.2021 “Për buxhetin e vitit 2022” është botuar në fletoren zyrtare nr.197 datë 21.12.2021.

- Shtesat dhe ndryshimet e bëra në regjistrat e parashikimeve të prokurimeve janë botuar, në formë elektronike, në faqen e APP <https://www.app.gov.al>.

Gjatë viteve regjistri i parashikimeve ka pësuar ndryshime përkatësisht si vijon:

**Për vitin 2020:** Me shkresën nr. 3297 prot., datë 12.05.2020; Me shkresën nr, 4979, datë 10.07.2020; Me shkresën nr. 8345, datë 18.12.2020

**Për vitin 2021:**

**Me shkresën nr. 2478 prot., datë 07.04.2021**

Me memon e datës 26.03.2021, Sektori i Prokurimeve i ka dërguar Sekretarit të Përgjithshëm, z. A. K. kërkesën për shtim zëri të ri në Regjistrin e Parashikimeve të Prokurimeve Publike 2021 mbi “Mbikëqyrje punimesh për objektin Mbyllja, rehabilitimi i mbetjeve urbane nga venddepozitimet ekzistuese (Burrel, Kukës, Libohovë, Përmet, Krujë)” dhe Marrëveshje kuadër me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara, me objekt “Blerje kuti dhe dosje për ruajtje të përhershme”.

Sa më sipër kemi një keqplanifikim nga ana institucionit pasi, ky tender, duhet të ishte planifikuar në zërin e investime kapitale, që në momentin e planifikimit në PBA të procedurës me objekt “Mbyllja, rehabilitimi i mbetjeve urbane nga venddepozitimet ekzistuese (Burrel, Kukës, Libohovë, Përmet, Krujë”, referuar Udhëzimin nr. 3, datë 15.2.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” pika 1 ku citohet se ..” Mbikëqyrja e punimeve bëhet për çdo projekt dhe ka për qëllim kontrollin e mbarëvajtjes të të gjithë procesit të zbatimit të punimeve, në përputhje me projektin, kushtet teknike të projektimit, të zbatimit, si dhe destinacionin e objektit, duke patur parasysh dhe anën ekonomike të tij” dhe pika 2 “ ..... Vlera e kërkuar nga subjekti konkurrues për mbikëqyrjen, duhet të përfshihet në tarifën e përcaktuar në përputhje me VKM 354 datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim”,

- Me shkresën nr. 2478 prot., datë 07.04.2021

- Me shkresën nr. 4696 prot., datë 07.07.2021

- Me shkresën nr. 3261 prot., datë 17.11.2021

- Me shkresën nr. 3952 prot., datë 15.12.2021

Me shkresën nr. 4696 prot., datë 07.07.2021; Me shkresën nr. 3261 prot., datë 17.11.2021; Me shkresën nr. 3952, datë 15.12.2021 janë realizuar ndryshimet si më poshtë vijon:

Me shkresën nr. 7881 prot., datë 05.11.2021, Sektori i Shërbimeve të Përgjithshme i ka kërkuar Sekretarit të Përgjithshëm dhënien e dakordësisë për të vijuar me procedurën “Blerje sete servisi për kabinetin”, bazuar në kërkesën e Kabinetit të Ministrit bërë me email-in e datës 14.10.2021.

Me memon e datës 11.11.2021, Sektori i Prokurimeve i ka dërguar Sekretarit të Përgjithshëm, kërkesën për shtim zëri të ri në Regjistrin e Parashikimeve të Prokurimeve Publike 2021 mbi “Blerje sete servisi për kabinetin e MTM-së” në shumën 100,000 lekë pa TVSH; shtim zëri për objektin “Blerje brava dhe fishekë brave për dyert e MTM-së” në shumën 100,000 lekë pa TVSH dhe shtim zëri për objektin “Blerje orendi dhe pajisje për mobilim zyra”, vlera e mini-kontratës 660,000 lekë pa TVSH, e cila është lidhur bazuar në Marrëveshjen Kuadër nr. 07/5 prot., datë 07.04.2021 e zhvilluar nga ABP, te cilat janë bazuar nga kërkesat e kryera nga Sektori i

Shërbimeve të Përgjithshme si vijon:

-Me shkresën nr. 7882 prot., datë 05.11.2021, Sektori i Shërbimeve të Përgjithshme i ka kërkuar Sekretarit të Përgjithshëm për të vijuar me procedurën e prokurimit me objekt “Blerje brava dhe fishekë për dyert e MTM”.

-Me shkresën nr. 7849 prot., datë 05.11.2021, Sektori i Shërbimeve të Përgjithshme i ka kërkuar Sekretarit të Përgjithshëm miratimin për fondin e porealizuar në shumën 671,037 lekë pa TVSH të kontratës me objekt “Blerje orendi dhe pajisje për mobilim zyra”, të realizuar nga ABP, fond i cili duhet realizuar brenda vitit 2021.

Gjithashtu, ka kërkuar ndryshime në Marrëveshjen Kuadër të realizuar nga AKSHI për procedurën me objekt “Blerje pajisje TIK”, respektivisht për secilën mini-kontratë Loti1 “Blerje UPS” me vlerë 145,500 lekë pa TVSH, Loti 5 “Blerje printera” me vlerë 175,670 lekë pa TVSH dhe Loti 6 “Blerje kompjutera” me vlerë 145,500 lekë pa TVSH.

**Sa më sipër nga MTM** janë realizuar rishikime buxhetore pas datës 15 nëntor. veprim në kundërshtim me nenin 48 “Afati për rishpërndarjen e fondeve buxhetore” të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ku citohet: “E drejta e njërive të qeverisjes së përgjithshme për rishpërndarjen e fondeve, të miratuara për vitin buxhetor, ushtrohet deri në datën 15 nëntor të çdo viti buxhetor”. Ndryshimet pas kësaj date sjell riskun për keqmenaxhimin e fondeve të alokuara.

### ***Për vitin 2022:***

Me shkresën nr. 2685 prot., datë 07.03.2022

Me shkresën nr. 3632 prot., datë 25.04.2022

Me shkresën nr. 4588 prot., datë 24.06.2022

Me shkresën nr. 5564 prot., datë 03.07.2022

Me shkresën nr. 6754 prot., datë 14.09.2022

Me shkresën nr. 7038 prot., datë 27.09.2022

- Me shkresën nr. 4291 prot., datë 16.05.2022 dhe në zbatim të Aktit Normativ nr. 3, datë 13.03.2022, Sektori i Prokurimeve i ka dërguar Sekretarit të Përgjithshëm kërkesën për ndryshim si vijon:

1. Pakësimin e zërave “Blerje pajisje dhe orendi” në shumën 833,333 lekë pa Tvsh dhe “Rehabilitimi i mbetjeve urbane nga vend depozitimet ekzistuese (Memaliaj, Tepelenë, Fushë Arrëz), me vlerë 33,333,333 lekë pa tvsh.

2. Referuar shkresës nr. 2410 prot., datë 27.04.2022, ku Drejtori i Përgjithshëm i AKSHI-t ka Autorizuar MTM për lidhjen e kontratave bazuar në marrëveshjen kuadër me nr. 22.04.2022, të ndarë në dy zëra të veçantë si vijon: Loti 5 “Blerje Printera” në vlerën 43,250 lekë pa tvsh dhe Loti 6 “Blerje Kompjutera” në shumën 1,3760,070 lekë pa tvsh.

3. Referuar shkresës nr. 3931 prot., datë 29.04.2022, ku SP i MTM i është drejtuar “S. A.” shpk me një kërkesë për kontrollin dhe diagnostikimin e automjeteve të MTM, bazuar në kontratën me nr. 3931/2 prot., me objekt “Shërbimi i riparimit dhe mirëmbajtjes së automjeteve në MTM”(Marrëveshje Kuadër), kërkohet shtim i zërit “Shërbimi i riparimit dhe mirëmbajtjes së automjeteve në MTM” në vlerën 256,740 lekë pa tvsh.

5. Me shkresën nr. 4919 prot., datë 09.06.2022, Sektori i Prokurimeve i ka dërguar Sekretarit të Përgjithshëm, kërkesën për shtim zëri të ri në Regjistrin e Parashikimeve të Prokurimeve Publike 2022 për shërbim konsulence të ekspertëve për hartimin e një vlerësimi të ndikimit në mjedis për shpalljen e Ekosistemit Natyror Detar-Bregdetar të Gjirit të Porto Palermos-Llaman “Park Natyror”, bazuar në kërkesën nr. 4919 prot., datë 09.06.2022 të Drejtorisë së Programeve të Zhvillimit të Mjedisit. Me shkresën nr. 4919/1 prot., datë 20.06.2022 rritja e vlerës së përllogaritur në 1,000,000 lekë.

Me shkresën nr. 6948 prot., datë 23.09.2022, Sektori i Prokurimeve i ka dërguar Sekretarit të Përgjithshëm, kërkesën për shtim zëri të ri në Regjistrin e Parashikimeve të Prokurimeve Publike 2022 për zërin “Shërbime riparimi dhe rivënie në punë e sistemeve dhe moduleve përbërëse të

monitorimit të ajrit”, bazuar në Aktin Normativ nr.12 datë 29.07.2022.

## **2. Regjistri i realizimeve**

Në lidhje me regjistrin e realizimit të vitit 2020-2021- 2022 u konstatua se në përgjithësi janë paraqitur me formën dhe mënyrën që është parashikuar, kreut II të Udhëzimit nr. 4, datë 18.06.2021 dhe nenit 4 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

### ***Nga auditimi i procedurave të prokurimit u konstatua se:***

- Me urdhrin e Ministrit z. B. K me nr. 01, datë 05.01.2021 “Për delegimin e kompetencave” urdhëron:

1. Delegimin e kompetencave të Titullarit të Autoritetit Kontraktor, z E.Q., me detyrë Drejtor i Përgjithshëm i Drejtorisë Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse, pranë Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, për të gjitha procedurat e prokurimit publik me fonde buxhetore, për Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit.

2. Kompetencat e deleguara te Titullarit te Autoritetit Kontraktor te Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit. do te ushtrohen për periudhën nga hyrja ne fuqi e këtij urdhri deri ne datën 13 Dhjetor 2021.

3. Ngarkohet per zbatimin e këtij urdhri Drejtori i Përgjithshëm i Drejtorisë Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse.

Sa më sipër delegimi i kompetencave është bërë në kundërshtim të Ligjit nr. 10 296, datë 08.07.2010, i ndryshuar me Ligjin nr. 110/2015, datë 15.10.2015 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i unifikuar dhe manualit të MFK-së miratuar me urdhrin nr. 108, datë 17.11.2016 të Ministrit të financave ku përcaktohet tek pikat:

### ***Roli i Nëpunësit Autorizues të Njesisë***

Gjatë zbatimit të detyrave të tij, NA ka të drejtë të delegojë një pjesë të tyre sipas përcaktimeve të Ligjit për MFK. Njëkohësisht Ligji për MFK përcakton edhe detyrat dhe të drejtat të cilat nuk mund të delegohen dhe konkretisht:

- raportimi, sipas shkallës hierarkike, për statusin e sistemeve të kontrollit të brendshëm, për riskun e mashtrimit e të parregullsive dhe të çdo mangësie serioze që pengon realizimin e objektivave, ose për risqe, të cilat nuk janë adresuar nga njësia, si dhe për masat korrektuese të marra dhe të përmbushura nga nivelet e menaxhimit të njësisë që drejtojnë;

- propozimi te NA i njësisë publike të sistemit të rregullave dhe procedurave të brendshme të njësisë, të planeve strategjike dhe të objektivave afatmesëm dhe vjetor, si dhe monitorimin e zbatimit të tyre në njësi.

- mbikëqyrjen dhe menaxhimin efektiv të punonjësve të njësisë dhe ruajtjen e nivelit të tyre profesional për MFK-në;

- ndarjen e përgjegjësisë që lidhen me vendimmarrjen, kontrollin, zbatimin dhe vendosjen e linjave të raportimit, në përputhje me përgjegjësitë e deleguara;

- ***nuk lejohet delegimi i të drejtës për firmë në procesin e angazhimit financiar.***

### **Delegimi i detyrave**

Delegimi i të drejtave dhe detyrave nuk duhet të çënojë të drejtat e menaxherit që delegon, ose ta shkarkojë atë nga përgjegjshmëria për realizimin e detyrave përkatëse, apo për përzgjedhjen e vartësit, të cilit i ka deleguar të drejtat dhe detyrat. Sipas nenit 15 të Ligjit të MFK, delegimi kryhet në përputhje me rregullat e parashikuara në Kodin e Procedurës Administrative.

- Nga kryqëzimi i të dhënave mbi procedurat e prokurimit të iniciuara në vitin 2020,; 2021 dhe 2022 dhe të dhënave mbi kontratat e regjistruara në SIFQ, u konstatua se urdhër-prokurimet nuk janë regjistruar në SIFQ në momentin e daljes së urdhrin, por bëhet pasi ka përfunduar procedura e prokurimit dhe është lidhur kontrata, duke cënuar kontrollin për marrjen e angazhimeve buxhetore pa fonde disponibël dhe rrjedhimisht krijimin e stokut të faturave të prapambetura



veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Udhëzimi i Ministrit të Financave nr. 9, datë 20.03.2018, “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”.

- Në përputhje me Udhëzimin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 9/1 datë 19.01.2018, pjesa III Procedurat për kryerjen e shpenzimeve, pika 15.1 “Faza para angazhimit...” ku është përcaktuar se: “Nëpunësi Zbatues kryen kontrollin dokumentar të përputhshmërisë si dhe të fondeve në SIFQ dhe në përfundim të procesit konfirmon direkt në SIFQ ngurtësimin e fondeve për prokurimin në fjalë, ose paraqet opinionin negativ zyrtarisht pranë Nëpunësit Autorizues. Urdhër prokurimi autorizohet nga struktura përgjegjëse e Thesarit në degë përpara se të fillojë procesi i prokurimit”. Institucionet buxhetore, të cilat operojnë direkt në SIFQ, krijojnë dhe regjistrojnë në sistem çdo urdhër për prokurim shoqëruar me kodin dhe përshkrimin e projektit dhe fondin limit të përcaktuar në planin e miratuar të prokurimeve të institucionit dhe pasi marrin numrin unik të regjistrimit në SIFQ dhe vulën e thesarit, procedojnë me dërgimin në APP.

- Rishikime që prekin investime kapitale dhe shpenzime korrente, mund të konkludojnë për një mungesës së analizave të mirëfillta të nevojave që ka institucioni para planifikimit, mungesë monitorimi i zbatimit të buxhetit dhe veçanërisht të ecurisë së zbatimit të investimeve, bazuar në Udhëzimi i Ministrit të Financave nr. 9, datë 20.03.2018, “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, pika 75 “Numri i rishpërndarjeve të fondeve buxhetore për çdo njësi të qeverisjes qendrore mund të përbëjë një nga treguesit për vlerësimin e performancës gjatë zbatimit të buxhetit”.

<b>Titulli i Gjetjes:</b>	Mangësitë e konstatuara tek regjistrat parashikimit dhe realizimit;
<b>Situata:</b>	<p>Nga auditimi u konstatua se:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- AK ka bërë shtesat dhe ndryshimet në regjistrat e parashikimeve të prokurimeve të cilat janë botuar, në formë elektronike, në faqen e APP <a href="https://www.app.gov.al">https://www.app.gov.al</a>.</li> </ul> <p>Për vitin 2021, me shkresën nr. 2478 prot., datë 07.04.2021, me memon e datës 26.03.2021, Sektori i Prokurimeve i ka dërguar Sekretarit të Përgjithshëm, z. A. K. kërkesën për shtim zëri të ri në Regjistrin e Parashikimeve të Prokurimeve Publike 2021 mbi “Mbikëqyrje punimesh për objektin Mbyllja, rehabilitimi i mbetjeve urbane nga venddepozitimet ekzistuese (Burrel, Kukës, Libohovë, Përmet, Krujë)”, AK, nga Sektori i Prokurimeve ky tender, duhet të ishte planifikuar në zërin e investime kapitale, që në momentin e planifikimit në PBA të procedurës me objekt “Mbyllja, rehabilitimi i mbetjeve urbane nga venddepozitimet ekzistuese (Burrel, Kukës, Libohove, Përmet, Kruje”, referuar Udhëzimin nr. 3, datë 15.2.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” pika 1, ku citohet se ..” Mbikëqyrja e punimeve bëhet për çdo projekt dhe ka për qëllim kontrollin e mbarëvajtjes të të gjithë procesit të zbatimit të punimeve, në përputhje me projektin, kushtet teknike të projektimit, të zbatimit, si dhe destinacionin e objektit, duke patur parasysh dhe anën ekonomike të tij” dhe pika 2 “ ..... Vlera e kërkuar nga subjekti konkurrues për mbikëqyrjen, duhet të përfshihet në tarifën e përcaktuara në përputhje me VKM me nr. 354 datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim”.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Për vitin 2021, Autoriteti Kontraktor ka realizuar rishikime buxhetore pas datës 15 nëntor. veprim në kundërshtim me nenin 48 “Afati për rishpërndarjen e fondeve buxhetore” të Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i</li> </ul>



	<p>ndryshuar, ku citohet: “E drejta e njërive të qeverisjes së përgjithshme për rishpërndarjen e fondeve, të miratuara për vitin buxhetor, ushtrohet deri në datën 15 nëntor të çdo viti buxhetor”. Ndryshimet pas kësaj date sjell riskun për keqmenaxhimin e fondeve të alokuara.</p> <p>- Nga kryqëzimi i të dhënave mbi procedurat e prokurimit të iniciuara në vitin 2020,; 2021 dhe 2022 dhe të dhënave mbi kontratat e regjistruara në SIFQ, u konstatua se urdhër-prokurimet nuk janë regjistruar në SIFQ në momentin e daljes së urdhrit, por bëhet pasi ka përfunduar procedura e prokurimit dhe është lidhur kontrata, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Udhëzimi i Ministrit të Financave nr. 9, datë 20.03.2018, “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”.; Udhëzimin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 9/1 datë 19.01.2018, pjesa III Procedurat për kryerjen e shpenzimeve, pika 15.1 “Faza para angazhimit...”</p> <p>- Rishikime e shpeshta, mbi investimet kapitale dhe shpenzime korrente, mund të konkludojmë për një mungesë të analizave të mirëfillta të nevojave që ka institucioni para planifikimit, mungesë monitorimi i zbatimit të buxhetit dhe veçanërisht të ecurisë së zbatimit të investimeve, bazuar në Udhëzimi i Ministrit të Financave nr. 9, datë 20.03.2018, “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, pika 75 “Numri i rishpërndarjeve të fondeve buxhetore për çdo njësi të qeverisjes qendrore mund të përbëjë një nga treguesit për vlerësimin e performancës gjatë zbatimit të buxhetit”.</p>
<b>Kriteri:</b>	<p>Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;</p> <p>Udhëzimi i Ministrit të Financave nr. 9, datë 20.03.2018, “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”.;</p> <p>Udhëzimi i Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 9/1 datë 19.01.2018, pjesa III Procedurat për kryerjen e shpenzimeve, pika 15.1 “Faza para angazhimit.....”</p> <p>Udhëzimi nr. 3, datë 15.2.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” pika 1 dhe pika 2 ;</p> <p>VKM me nr. 354 datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim”.</p>
<b>Ndikimi/Efekti:</b>	<p>Cenon kontrollin për marrjen e angazhimeve buxhetore pa fonde disponibël dhe rrjedhimisht krijimin e stokut të faturave të prapambetura;</p> <p>Ndryshimet dhe marrje e angazhimeve pas datës 15 nëntor, sjell riskun për keqmenaxhimin e fondeve të alokuara.</p>
<b>Shkaku:</b>	<p>Mungesës së analizave të mirëfillta të nevojave që ka institucioni para planifikimit, mungesë monitorimi i zbatimit të buxhetit dhe veçanërisht të ecurisë së zbatimit të investimeve.</p>
<b>Rëndësia:</b>	<p>E mesme</p>
<b>Rekomandimi:</b>	<p>Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, personat përgjegjës të parashikimit të investimeve kapitale, të marrin masat në vijimësi për planifikimin e tyre bazuar në prioritet e institucionit, me qëllim mirë menaxhimin e fondeve publike, evitimin e krijimit të detyrimeve të prapambetura, e ndryshimit të prioritetëve të projekteve, si dhe cënimin apo favorizimin</p>

e projekteve specifike.
-------------------------

Nga ana e Autoritetit Kontraktor, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit:

**1. Për vitin 2020 janë kryer 31 procedura prokurimi, nga të cilat:**

- Procedurë Prokurimi “*Kërkesë me propozim*”, në total 2 procedurë, me vlerë kontrate 5,701,000 lekë pa tvsh; (blerje e përqendruar), Procedurat e tjera janë blerje e vogël, blerje bileta transporti ajror, si dhe minikontratat nga marrëveshje kuadër me blerje e përqendruar.

**2. Për vitin 2021 janë kryer 32 procedura prokurimi, nga të cilat:**

- Procedurë Prokurimi “*E Hapur*”, në total 1 procedurë, me vlerë kontrate 146,440,165 lekë pa tvsh;

- Procedurë Prokurimi “*Consulting*” në total 1 procedurë, me vlerë kontrate 2,640,000 lekë pa tvsh;

- Procedurë Prokurimi “*Kërkesë me propozim*”, në total 1 procedurë, me vlerë kontrate 2,178,268 lekë. Procedurat e tjera janë blerje e vogël, blerje bileta transporti ajror, si dhe minikontratat nga marrëveshje kuadër me blerje e përqendruar.

**3. Për vitin 2022 janë kryer 35 procedura prokurimi, nga të cilat:**

- Procedurë Prokurimi “*E Hapur*”, në total 1 procedurë, me vlerë kontrate 31,130,000 lekë pa tvsh;

- Procedurë Prokurimi “*Consulting*” në total 2 procedurë, me vlerë kontrate 29,887,000 lekë pa tvsh. Procedurat e tjera janë blerje e vogël, blerje bileta transporti ajror, si dhe minikontratat nga marrëveshje kuadër me blerje e përqendruar.

Nga këto procedura prokurimi, grupi i auditimit ka audituar të gjithë procedurat e prokuruar dhe realizuara nga MTM.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për procedurat e prokurimit të përzgjedhura nga grupi i auditimit për vitet 2020-2022 u konstatuan:

**1. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për procedurën e prokurimit në objekt: “Mbyllja, rehabilitimi i mbetjeve urbane nga venddepozitimet ekzistuese (Burrel, Kukes, Libohovë, Përmet, Krujë)”, konstatohet:**

Të dhëna mbi objektin e prokurimit:

<b>Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Mbyllja, rehabilitimi i mbetjeve urbane nga venddepozitimet ekzistuese (Burrel, Kukes, Libohovë, Përmet, Krujë)”</b>			
<b>1. Lloji i Procedurës së Prokurimit</b> “E hapur” REF-84210-01-18-2021 Urdhri nr. 15, datë 14.01.2021	<b>1.1 Grupi i hartimit kriterëve kualifikuese</b> Urdhri me nr. 15, prot. 333, datë 14.01.2021.	<b>2 Njësia e Prokurimit</b> I.B R. L S.P Sh.K. A. S.	<b>3 Komisioni i Vlerësimit Ofertave</b> Urdhri nr. 17, prot. 332/1, datë 18.01.2021; i ndryshuar me urdhrin nr. 84, prot.332/2, datë 17.03.2021. R. B,F. C., F. Ll., Sh. H. dhe D. Xh.
<b>4. Fondi Limit (pa tvsh)</b> 148,611,584.6 lekë	<b>5. Oferta fituese (pa tvsh)</b> 146 440 165 lekë		<b>6. Diferenca me fondin limit (pa tvsh)</b> 2,171,419.60 lekë
<b>7/1 Data e hapjes së tenderit</b> Data 01.03.2021	<b>8. Burimi Financimit</b> Buxheti i Shtetit		<b>9. Operatorët Ekonomike</b> a) Pjesëmarrës në tender Numër <b>4</b> b) S’kualifikuar 3 OE, c) Kualifikuar 1 OE
<b>7/2 Kohëzgjatja e kontratës,</b> 6 (gjashtë) muaj duke filluar nga fillimi i punimeve.			
<b>10. Ankimime</b> I.” Sha, me datën 23.01.2021.	<b>11. Përgjigje Ankesës AK me:</b> Me shkresën nr. 563/3, datë 27.01.2021.		<b>12. Përgjigje Ankesës nga KPP</b>
<b>b. Zbatimi i Kontratës Prokurimit</b>			
<b>13. Lidhja e kontratës</b> Mes AK dhe OE fitues	<b>Zbatimi i kontratës:</b>		

### **a-Nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit konstatohet:**

Me shkresën nr. 8510, datë 23.12.2020, nga Drejtori z. R.B. Drejtor i Koncesioneve dhe Fizibilitetit të Projekteve të Mjedisit, drejtuar Z. E. Q., Drejtor i Përgjithshëm i Drejtorisë Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse kërkon marrjen e masave për zhvillimin e projektit të zbatimit të procedurës me objekt “*Mbyllja, rehabilitimi i mbetjeve urbane nga venddepozitimet ekzistuese (Burrel, Kukës, Libohovë, Përmet, Krujë)*” bazuar në studimin e marrë në dorëzim nga grupi i punës i ngritur me urdhër të titullarit nr. 284, datë 06.08.2019 të “*Studimi mbyllja, rehabilitimi i mbetjeve urbane nga venddepozitimet ilegale*”.

- Me urdhrin e prokurimit të Z. E.Q., Drejtor i Përgjithshëm i Drejtorisë Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse, nr. 15, prot. 333, datë 14.01.2021, urdhërohet të kryhet prokurimi i fondit prej 148,611,584.6 lekë pa TVSH, me objekt “*Mbyllja, rehabilitimi i mbetjeve urbane nga venddepozitimet ekzistuese (Burrel, Kukës, Libohovë, Përmet, Krujë)*” dhe ngarkohet njësia e prokurimit e përbërë nga I. B, R. L, S. P, Sh. K. dhe A.S.

#### **Konstatim:**

Hapja e procedurës ende pa u çelur buxheti për investime është veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Udhëzimi i Ministrit të Financave nr. 9, datë 20.03.2018, “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”.

Me urdhrin nr. 14, prot., 332 datë 14.01.2021, i ndryshuar me urdhrin nr. 17, prot. 332/1, datë 18.01.2021 ngrihet Komisioni i vlerësimit të ofertave me anëtar, R.B, E. C, F. Ll, Sh. H dhe D. Xh., i ndryshuar me urdhrin nr. 84, prot.332/2, datë 17.03.2021 me anëtar, R. B, F. C, F.Ll, Sh. H dhe D.Xh.

*Nga auditimi i Dokumenteve të Tenderit nëpërmjet dosjes fizike dhe sistemit të prokurimit elektronik (SPE) rezultoi:*

Përlllogaritja e fondit limit është hartuar nga preventivat marrë në dorëzim dhe protokolluar në MTM me nr. 7864, datë 10.09.2019 dhe me nr. 7362, datë 13.09.2019 për fazën e zbatimit të kontratës “*Studimi mbyllja, rehabilitimi i mbetjeve urbane nga venddepozitimet ilegale*”.

#### **Konstatim:**

*Nga NJP është mbajtur procesverbali me nr. 333/1 datë 18.01.2021, për miratimin e dokumenteve standard të tenderit.*

***Nga auditimi u konstatua se asnjë nga kriteret e vendosura dhe të kërkuara nga AK nuk janë të argumentuar teknikisht dhe në përputhje me preventivin,*** veprime në kundërshtim të VKM-së 285 datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” pika 2 e nenit 78 “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit” ku citohet se “*Në çdo rast, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërisht, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre. Ky procesverbal i vihet në dispozicion personit/ave*”

Nga “I.” Sha, me datën 23.01.2021, (prot MTM me nr. 563, datë 25.01.2021), ka bërë ankesë për kriteret e vendosura në dokumentin e tenderit janë në kundërshtim me ligjin 9643 neni 63 pika 11.

#### **Konkretisht në kriteret e veçanta të kualifikimit:**

Pika 2.3.4 Operatori ekonomik, të ketë të punësuar si staf teknik, përveç drejtuesve teknik të kërkuar në pikën 2, “,,,,,” kërkojnë ndryshimin e këtij kriteri ku “*Inxhinier e specializuar në këtë pikë, mund të jenë dhe drejtues teknik të kërkuar në pikën 2.3.2.*

- Kërkesë tjetër, e cila nuk është në përputhje me preventivat e kësaj procedurë është kërkesë për “*Inxhinier materiale*”, pasi nuk ka materiale specifike përveç materialeve inerte dhe betoneve, ku për kontrollin e cilësisë së tyre keni kërkuar që OE të ketë laborator ose kontratë me laborator të akredituar.

- kërkesa për 5 teknike ndërtimi dhe 1 teknik gjeodet është kriter i fryrë.

- Kriteri 6.5 "Operatori ekonomik te dëshmoje qe ka ne dispozicion ne pronësi apo me qera, kontrate furnizimi fabrikën e betonit, inerteve dhe gurit gëlqeror, të cilat nëse janë në pronësi të paraqitet leje mjedisore e vlefshme. Nëse këto fabrika nuk janë ne pronësi te operatorit ekonomik te paraqitet kontrate qiraje ose kontrate/autorizim furnizimi mes palëve, si dhe licenca përkatëse mjedisore e vlefshme (Kodi III.1A për fabrikën e betonit, Kodi III.1.B për fabrikën e betonit, Kodi III.1.B për fabrikën e gurit gëlqero". Kjo kërkesë që fabrika duhet të jetë e pajisur me licencë Kodi III.1A nuk është në përputhje me ligjin nr. 10448, datë 14.07.2011, i ndryshuar, pasi sipas këtij përcaktimi ligjor mjafton të jetë i pajisur Kodi III.1.B.

Kriteri 2.3. 7 "Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me leje mjedisore lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licensimit për grumbullim dhe transportim të mbetjeve që kanë ndikim në mjedis Kodi III.2.B dhe 8 "Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me leje mjedisore lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licensimit për vlerësimin ne mjedis dhe auditimin mjedisor sipas Kodi III.2.A". Kriteret e mësipërme janë diskriminuese, së pari licenca Kodi III.2.A është licenca, e cila është në fazën e projektimit. Licenca Kodi III.2.B ku si kusht është që ta kenë të gjithë OE të cilët marrin pjesë si BOE është diskriminues dhe i pa bazë, pasi në një marrëveshje të gjithë OE kontribuojnë në makineri, staf, eksperiencë dhe asete të tjera për realizimin e projektit. Prandaj kërkojmë rishikimin e këtij kriteri, ku të vendoset të paktën një nga anëtarët e marrëveshjes të plotësojë këtë kriter.

Nga z. E.Q, Drejtor i Përgjithshëm i Drejtorisë Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse me urdhrin nr. 28, prot., 563/1, datë 25.01.2021, urdhëron pezullimin e procedurës dhe ngarkon për shqyrtimin e ankesës dhe dhënien e mendimit znj. I. C.

Me shkresën nr. 563/2, datë 27.01.2021 drejtuar Titullarit të AK pas shqyrtimit të ankesës znj. I. C. është shprehur për pranimin pjesërisht të ankesës pikërisht për pikat:

Pika 2.3.4 kërkesa për "Inxhinier ndërtimi për sigurimin dhe kontrollin e cilësisë sipas ISO 9001:2015 - 1 (një)" është hequr.

Kriteri 6.5 merret në konsideratë heqja e kërkesës licenca përkatëse mjedisore e vlefshme "Kodi III.1A për fabrikën e betonit".

Kriteri 2.3.7 "Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me leje mjedisore lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licensimit për vlerësimin ne mjedis dhe auditimin mjedisor sipas Kodi III.2.A", **hiqet si kriter nga DT.**

Kriterin 2.3. 8 "Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me leje mjedisore lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licensimit për vlerësimin ne mjedis dhe auditimin mjedisor sipas Kodi III.2.A".

Në rastet e bashkimit ekonomik të operatorëve, licencat e mësipërme duhet të plotësohen nga të gjithë anëtarët pjesëmarrës në marrëveshje.

### **Bëhet**

Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me leje mjedisore lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licensimit për grumbullim dhe transportim të mbetjeve që kanë ndikim në mjedis Kodi III.2.B.

Në rastet e bashkimit ekonomik të operatorëve, licenca e mësipërme duhet të plotësohet të paktën nga njëri nga anëtarët në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në marrëveshje.

Me shkresën nr. 563/3, datë 27.01.2021 i është kthyer përgjigje OE "I." sha për shqyrtimin dhe marrjen pjesërisht në konsideratë të ankesës.

Nga NJP është mbajtur procesverbali me nr. 563/4, datë 28.01.2021 i ndryshimit të Dokumenteve të Tenderit sipas pranimit të pjesshëm të ankesës, ku është publikuar Shtojca 1 e ndryshimit të DT në të cilën është bërë dhe ndryshimi i hapjes së ofertave:

**Ishte:** Afati kohor për dorëzimin dhe hapjen e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje.

**Data 18.02.2021, ora 12:00**

**Bëhet:** Afati kohor për dorëzimin dhe hapjen e ofertave ose kërkesa për pjesëmarrje:

**Data: 23.02.2021, ora 12:00.**

Me urdhrin nr. 39, prot., 563/5, datë 28.01.2021 është bërë heqja e pezullimit të procedurës së prokurimit.

Me datën 29.01.2021 nga APP janë dërguar rekomandime në lidhje me dokumentar e tenderit.

Me urdhrin nr. 45, prot., 889, datë 01.02.2021 të Titullarit të AK bëhet pezullimi i procedurës prokurimit deri në shqyrtimin e rekomandimeve të dërguara nga Drejtoria e Koordinimit të APP. NJP pas shqyrtimit të rekomandimeve ka mbajtur procesverbalin me datën 09.02.2021, dhe mbështetur në nenin 42, pika 2 të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, njofton Modifikimin e dokumentacionit standard të procedurës së prokurimit **Shtojcën 12, pika 2 “Kriteret e veçanta për kualifikim”,** si vijon:

**Te njoftimi i kontratës, në seksionin “Shënime të tjera”,**

**Ishte**

Shënime te tjera

**Bëhet**

**Shënime te tjera**

Në zbatim të Ligjit Nr. 87/2019 "Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit", i ndryshuar, si dhe të njoftimit të përbashkët të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe APP, respektivisht me Nr. 25366 Prot dhe Nr. 8480 Prot, datë 30.12.2020, informohen operatorët ekonomikë që për nënshkrimin e kontratës publike, në përfundim të procedurës, duhet të kenë:

- *Kopje të Certifikatës elektronike për Fiskalizimin, për tatimpaguesit që përdorin Platformën Qendrore të Faturave.*

- *Kopje të Certifikatës elektronike për Fiskalizimin dhe Kopje të vlefshme të Kontratës së lidhur me Shoqërinë e Certifikuar për zgjidhjen softwere-ike në përdorim, për tatimpaguesit që lëshojnë faturat nëpërmjet zgjidhjes softwar-ike.*

**Kriteri 2.1.1.** Në ekstraktin e lëshuar nga Q.K.B, objekti i veprimtarisë së operatorit ekonomik duhet të jetë sipas objektit të prokurimit.

Ky kriter hiqet.

**Pika 2.3 “Për kapacitetin teknik”, Pika 1 “Licenca Profesionale e Shoqërisë, për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuar nga autoritetet kompetente Shtetërore, sipas modelit të lëshuar nga MPPT/MTI në kategoritë:**

NP - 1 C Punime gërmimi ne toke ;

NP - 2 B Ndërtime civile dhe industriale...”, **modifikohet si më poshtë:**

**Ishte:**

Licenca Profesionale e Shoqërisë, për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuar nga autoritetet kompetente Shtetërore, sipas modelit të lëshuar nga MPPT/MTI në kategoritë:

NP - 1 C Punime gërmimi ne toke

NP - 2 B Ndërtime civile dhe industriale

NP -12 D Punime te inxhinierisë se mjedisit

NS - 9 B **Punime strukturore speciale**

NS -10 B **Shtresa dhe mbistruktura speciale**

NS - 17 B Ndërtim i impianteve te grumbullimit dhe trajtimit te mbetjeve

NS -18 C Punime topogjeodezike

**Bëhet:**

Licenca Profesionale e Shoqërisë, për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuar nga autoritetet kompetente Shtetërore, sipas modelit të lëshuar nga MPPT/MTI në kategoritë:

NP - 1 C Punime gërmimi ne toke

NP - 2 B Ndërtime civile dhe industriale

NP -12 D Punime te inxhinierisë se mjedisit

NS - 17 B Ndërtim i impianteve te grumbullimit dhe trajtimit te mbetjeve

NS -18 C Punime topogjeodezike

**Pika 2.3 “Për kapacitetin teknik”, Pika 2 “Referuar preventivit, grafikut të punimeve, specifikimeve teknike, si dhe punimeve ndërtimore OE. duhet të ketë të punësuar drejtues teknik punimesh si më poshtë:**

- *Inxhinier Ndërtimi* - 2 (një);

- *Inxhinier Elektrik* - 1 (një);

- *Inxhinier Hidroteknik* - 1 (një)...”, **modifikohet si më poshtë:**

**Ishte:**

Referuar preventivit, grafikut të punimeve, specifikimeve teknike, si dhe punimeve ndërtimore O.E. duhet të ketë të punësuar drejtues teknik punimesh si më poshtë:

- Inxhinier Ndërtimi - 2 (një);
- **Inxhinier Elektrik** - **1 (një);**
- Inxhinier Hidroteknik - 1 (një);
- **Inxhinier Mekanik** - 1 (një);
- Inxhinier Topograf - 1 (një);
- Inxhinier Gjeolog - 1 (një);
- Inxhinier Mjedisi - 1 (një);

Për sa më sipër OE. pjesëmarrës të paraqesë:

- Kontratë individuale pune, diplomën përkatëse për secilin nga drejtuesit.
- 1 (një) nga drejtuesit e **mësipërm duhet të jetë i pajisur me certifikatën për sigurinë dhe shëndetin në punë.** Të paraqitet certifikata e trajnimit/kualifikimit përkatëse e dhënë nga një organizëm i licencuar certifikimi kombëtar dhe/ose ndërkombëtar.
- Inxhinieri i mjedisit, drejtues teknik i shoqërisë, duhet të jetë i specializuar **si ekspert mjedisor në auditimin mjedisor dhe vlerësimin e ndikimit në mjedis.**
- Drejtuesit nuk duhet të jenë të angazhuar në kontrata të tjera gjatë periudhës së realizimit të objektit. Për këtë arsye të paraqitet deklaratë përkatëse nga Administratori/Drejtuesi Ligjor i shoqërisë.

**Bëhet:**

Referuar preventivit, grafikut të punimeve, specifikimeve teknike, si dhe punimeve ndërtimore O.E. duhet të ketë të punësuar drejtues teknik punimesh si më poshtë:

- Inxhinier Ndërtimi - 2 (një);
- Inxhinier Hidroteknik - 1 (një);
- Inxhinier Mekanik - 1 (një);
- Inxhinier Topograf - 1 (një);
- Inxhinier Gjeolog - 1 (një);
- Inxhinier Mjedisi - 1 (një);

Për sa më sipër O.E. pjesëmarrës të paraqesë:

- Kontratë individuale pune, diplomën përkatëse për secilin nga drejtuesit.
- 1 (një) nga drejtuesit e **mësipërm duhet të jetë i pajisur me certifikatën për sigurinë dhe shëndetin në punë.** Të paraqitet certifikata e trajnimit/kualifikimit përkatëse e dhënë nga një organizëm i licencuar certifikimi kombëtar dhe/ose ndërkombëtar.
- Inxhinieri i mjedisit, drejtues teknik i shoqërisë, duhet të jetë i specializuar si ekspert mjedisor në auditimin mjedisor dhe vlerësimin e ndikimit në mjedis.
- Drejtuesit nuk duhet të jenë të angazhuar në kontrata të tjera gjatë periudhës së realizimit të objektit. Për këtë arsye të paraqitet deklaratë përkatëse nga Administratori/Drejtuesi Ligjor i shoqërisë.

**Pika 2.3 “Për kapacitetin teknik”, Pika 4 “Operatori ekonomik, të ketë të punësuar si staf teknik, përveç drejtuesve teknik të kërkuar në pikën 2, punonjësit si më poshtë: - Inxhinier ndërtimi për sigurimin dhe kontrollin e cilësisë sipas ISO 9001:2015...”, **modifikohet si më poshtë:****

**Ishte:**

Operatori ekonomik, të ketë të punësuar si staf teknik, përveç drejtuesve teknik të kërkuar në pikën 2, punonjësit si më poshtë:

- **Përgjegjës për sigurinë dhe shëndetin në punë** -2 (dy)
- **Inxhinier përgjegjës për dëmet në mjedis** -1 (një)
- **Specialist të ndihmës së parë, certifikuar nga Kryqi i Kuq/ekuivalente** -2 (dy)
- Teknik ndërtimi - 5 (pesë)
- Karpentier - 5 (pesë)

- Hidroizolues - 5 (pesë)
- Hekurkthyes - 5 (pesë)
- Elektricist - 5 (pesë)
- Saldator - 5 (pesë)
- Specialist montim tubash HDPE -1 (një)

*Drejtues mjetesh te renda minimalisht:*

- **Manovratorë** - **6 (gjashtë)**
- **Shofer** - 6 (gjashtë)

- Për punonjësit e mësipërm të paraqitet kontratë pune përkatëse si dhe certifikata/diploma profesionale për secilin.

- Për drejtuesit e mjeteve të rënda përveç kontratës së punës të paraqitet dëshmia aftësisë profesionale (për manovrator) dhe certifikatën e aftësimin profesional (për shoferët) si dhe leje drejtimi të kategorisë C për secilin nga drejtuesit e mjeteve.

- Staf i mësipërm minimalisht të figurojë tre muajt e fundit në listepagesat e shoqërisë. Për këtë arsye të paraqiten listepagesat përkatëse të nënshkruara elektronikisht nga sistemi e-Albania si dhe urdhër pagesa përkatëse që konfirmon kryerjen e pagesave përkatëse mujore.

**Bëhet:**

Operatori ekonomik, të ketë të punësuar si staf teknik, përveç drejtuesve teknik të kërkuar në pikën 2, punonjësit si më poshtë:

- Përgjegjës për sigurinë dhe shëndetin në punë -2 (dy)
- Inxhinier përgjegjës për dëmet në mjedis -1 (një)
- Teknik ndërtimi - 5 (pesë)
- Karpentier - 5 (pesë)
- Hidroizolues - 5 (pesë)
- Hekurkthyes - 5 (pesë)
- Elektricist - 5 (pesë)
- Saldator - 5 (pesë)
- Specialist montim tubash HDPE -1 (një)

*Drejtues mjetesh te renda minimalisht:*

- Manovratorë - 6 (gjashtë)
- Shofer - 6 (gjashtë)

- Për punonjësit e mësipërm të paraqitet kontratë pune përkatëse si dhe certifikata/diploma profesionale për secilin.

- Për drejtuesit e mjeteve të rënda përveç kontratës së punës të paraqitet dëshmia aftësisë profesionale (për manovrator) dhe certifikatën e aftësimin profesional (për shoferët) si dhe leje drejtimi të kategorisë C për secilin nga drejtuesit e mjeteve.

- Staf i mësipërm minimalisht të figurojë tre muajt e fundit në liste pagesat e shoqërisë. Për këtë arsye të paraqiten listepagesat përkatëse të nënshkruara elektronikisht nga sistemi e-Albania si dhe urdhër pagesa përkatëse që konfirmon kryerjen e pagesave përkatëse mujore.

- Për punonjësit manovratorë dhe shoferë mund të jenë në listepagesat e subjektit dhe/ose punonjës me kontratë.

AK në zbatim të nenit 42 pika 2/1 të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, si dhe nenit 62 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik, i ndryshuar, të Udhëzimit nr. 11, datë 22.05.2015 “Për procesin e pezullimit, modifikimit të dokumenteve standarde të tenderit dhe shtyrjen e afatit të procedurave të prokurimit në sistemin e prokurimit elektronik”.

**Ishte:** Afati kohor për dorëzimin dhe hapjen e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje.

**Data 23.02.2021, ora 12:00**

**Bëhet:** Afati kohor për dorëzimin dhe hapjen e ofertave ose kërkesa për pjesëmarrje:

**Data: 01.03.2021, ora 12:00.**

Me urdhrin e Titullarit të AK nr. 51, prot., 1073, datë 09.02.2021 urdhërohet heqja e pezullim të

procedurës së prokurimit dhe vijimi me hapat e mëtejshëm.

<b>Titulli i Gjetjes:</b>	Vendosja e kritereve të veçanta të kualifikimit nuk janë të argumentuar .
<b>Situata:</b>	<p>Nga auditimi i Dokumenteve të Tenderit nëpërmjet dosjes fizike dhe sistemit të prokurimit elektronik (SPE), u konstatuan se:</p> <p><b>Në DT është kërkuar nga AK kriteret si vijon:</b></p> <p><b>Pikën 2.</b> Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti kontraktor kërkon:</p> <p>Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:: Formular vlerësimi nga Autoriteti Kontraktor; Kontratë; Situacionin përfundimtar; Aktin e kolaudimit; Fatura tatimore; Kontratë e bashkëpunimit ndërmjet OE, ku të jetë e përfshirë marrëveshja e ndarjes së punimeve mes palëve.</p> <p>- Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm: Kontratë, Situacion përfundimtar, Fatura tatimore, Formular vlerësimi nga Autoriteti Kontraktor Akti i Kolaudimit Certifikatën e marrjes ne dorëzim lëshuar nga autoritetet përkatëse.</p> <p><i>Sa mësipërm këto dokumentacione të kërkuara janë të panevojshme pasi: Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me ente publike mjafton Formular vlerësimi nga Autoriteti Kontraktor; Kontratë dhe në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik Fatura tatimore të shitjes.</i></p> <p>AK në përcaktimin e kritereve duhet të mbajë në konsideratë parashikimet e pikës 6, te nenit 26 te VKM ku përcaktohet se ‘ ‘Autoriteti kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime te lëshuara nga një ent publik, ku te shënohen vlera, kohu dhe natyra e punës së bërë dhe çdo lloj dokumenti tjetër, qe parashikohet ne legjislacionin ne fugi, për te vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve”.</p> <p>- AK ka kërkuar: 5 punonjës si staf teknik me profilin Elektracist, e cila është kërkesë, që nuk ka lidhje me objektin, natyrën e kontratës, pasi në preventiv nuk ka asnjë punim mekanik dhe elektrik.</p> <p>- Në pikën <b>2.3.3</b> kërkohet që “Operatori ekonomik ofertues ..... krahas stafit të mësipërm, duhet të ketë të punësuar një numër mesatar punonjësish prej 150 punëtorësh për periudhën Tetor - Dhjetor 2020. Për këtë arsye të paraqiten listëpagesat përkatëse të nënshkruara elektronikisht nga sistemi e- Albania si dhe urdhër pagesa përkatëse që konfirmon kryerjen e pagesave përkatëse mujore”. <i>Nga NJP, numri i personave prej 150 punonjës, nuk është argumentuar.</i></p> <p>Sa me sipër, Autoritetet kontraktore duhet të kishte hartuar analiza teknike, ku të parashikohej fuqia punëtore dhe mjetet/makineritë që nevojiten për realizimin e secilit zë punimesh, sipas afateve kohore te parashikuara në grafikun e punimeve dhe, mbi bazën e analizave përkatëse të përcaktohet numri minimal i punonjësve të domosdoshëm, për realizimin e punimeve objekt kontrate.</p> <p>- Në kërkesat kualifikuese pika <b>2.3.1</b> konstatohet se janë vendosur pika licence jo në përputhshmëri me volumin dhe natyrën e objektit, në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014, i ndryshuar "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", neni 26.</p> <p>Konstatohen kategorizime më të larta, në krahasim me zërat dhe me volumet e objektit. Kategorizimi i të gjithë zërave me nivelin C (51 – 100</p>



	<p>milion lekë) dhe D (101-200 milion lekë) nuk përputhet me volumin apo vlerën e zërave përkatës, ku këto zëra punimesh bazuar preventivitetit i përkasin kategorizimeve A dhe B.</p> <p>2.3.5. Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij mjekun e shoqërisë. Te paraqitet kontrate pune/shërbimi, diplomë, si dhe licence (urdhër mjeku) referuar VKM-së nr. 108, datë 9.2.2011 “Për aftësitë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë”. ndryshuar me vendimin nr. 632, datë 15.7.2015. Kërkesa është në kundërshtim me përcaktimet e vendimin nr. 632, datë 15.7.2015 pikën 1. Pas pikës 5, të kreut II, shtohet pika 6, me përmbajtje, si më poshtë vijon:</p> <p>“6. Punëdhënësit e grupeve “A” dhe “B”, në zbatim të pikës 2, të kreut II, të këtij vendimi, për çdo 700 punëmarrës, sigurojnë shërbimin mjekësor në ndërmarrje nëpërmjet mjekut të punës. Ndërsa punëdhënësit e grupeve “C” dhe “D”, për çdo 1500 punëmarrës, sigurojnë shërbimin mjekësor në ndërmarrje nëpërmjet mjekut të punës të kontraktuar nga jashtë. Numri maksimal që është kërkuar për OE nga AK është 150 punonjës.</p> <p>Veprimet e mësipërme kanë ngushtuar konkurrencën dhe janë në shkelje të Ligjit të prokurimit publik. Dokumentet e tenderit të hartuara e miratuara nga AK, nuk kanë të argumentuar vendosjen e çdo kriteri për kualifikim, në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 61, pika 2 “hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit” ku citohet se: “Në çdo rast, hartimi i kriterëve për kualifikim dhe specifikimet teknike duhet të <u>argumentohen</u> dhe të <u>dokumentohen</u> në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre”. Janë konstatuar shkelje të <b>nenin 46</b>, pika 3 të LPP, <u>kërkesat për kualifikim duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm dhe në çdo rast të jenë sipas përcaktimeve në rregullat e prokurimit publik dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014, i ndryshuar "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", <b>neni 26</b> "Kontrata për punë publike" pika 5, <u>kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 46 të LPP. <u>Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.</u></u></u></p>
<b>Kriteri:</b>	<p>- Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 46, pika 3.</p> <p>- VKM-në nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 26, 61.</p>
<b>Ndikimi/Efekti:</b>	<p>Kriteret kualifikuese të paargumentuara, duke ndikuar në kufizimin e konkurrencës.</p>
<b>Shkaku:</b>	<p>Kriteret kualifikuese jo në përputhshmëri me parashikimet e Ligjit nr. 9643, datë 20/11/2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar.</p>
<b>Rëndësia:</b>	<p>E mesme</p>
<b>Rekomandimi:</b>	<p>Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Njësia e Prokurimit në procedurat e prokurimit të mallrave /shërbimeve dhe punëve që do zhvillohen në vazhdimësi, të marrë masa që çdo kriter i veçantë duhet të jetë në përputhje me natyrën dhe përmasën e kontratës. Vendosja e çdo kriteri duhet të jetë e argumentuar dhe i dokumentuar.</p>

**b-Në lidhje me vlerësimin e ofertave nga KVO.**

Në procedurën e prokurimit kanë marrë pjesë 4 OE, për të cilët, referuar formularit paraprak të njoftimit të fituesit datë 19.03.2021. KVO-ja ka kryer në SPE vlerësimin dhe klasifikimin përkatës si më poshtë:

Nr	Shoqëria OE/BOE	Oferta Lekë PA TVSH	S'kualifikuar/ Kualifikuar
1	A.-I. G. C.” shpk	134 332 463	S'kualifikuar
2	A. K.” shpk	146 440 165	Kualifikuar/ Fituesi
3	“T.” shpk	147 688 351.40	S'kualifikuar
4	“A.M” shpk	148 338 048	S'kualifikuar

Pas vlerësimit të ofertave, KVO ka mbajtur procesverbalin me datën 19.03.2021, ku referuar procesverbalit dhe njoftimit të fituesit, janë s'kualifikuar Operatorët Ekonomik, për këto arsye: Janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

**1. “A.-I.G.C.”, shpk.**

- Operatori ekonomik nuk ka dorëzuar Urdhër Pagesën e muajit Dhjetor 2020, që vërteton pagesën në bankë.

- OE ka dorëzuar dokumentet për 4 karpentier, por ne listëpagesat e 3 muajve të fundit rezultojnë vetëm 2. Mungojnë 3 karpentier nga 5 të kërkuar nga AK.

- OE ka dorëzuar dokumentet për tre punonjës hekurkthyes nga 5 të kërkuar.

- OE ka dorëzuar dokumentet për 8 elektriciste, por ne listëpagesat e tre muajve të fundit rezultojnë vetëm dy elektrecista të siguruar nga 5 të kërkuar.

- OE ka dorëzuar dokumentet për 3 punonjës saldator, por ne listëpagesat të tre muajve të fundit, rezultojnë vetëm 2 saldatorë nga 5 të kërkuar.

- Në dokumentet e dorëzuar nga OE për makineri dhe pajisje, ka mangësi në dokumentacion, konkretisht mungonte: 1 Eskavator me krahë të gjate, 4 autobot uji, 2 koke tërheqëse, 3 matrapike, 4 pompa thithëse, 1 çekiq pneumatik, 3 kontenier stacioner. Gjithashtu, në asnjë nga Kontratat e Qerese që OE ka dorëzuar për makineri dhe pajisje nuk është përcaktuar emërtesa për objektin e prokurimit në fjalë dhe afati sipas kriterëve të kërkuara nga AK.

- OE ka dorëzuar fatura blerje me korigjime, me emër blerësi dhe NIPT të paqarte.

- OE nuk disponon Kontrate Furnizim me fabrikë për Gurin Gëlqeror dhe Licence përkatëse mjedisore për Kodi III.1B për fabrikën e Gurit Gëlqeror.

- OE nuk ka dorëzuar certifikatën në zbatim të Ligjit nr. 87/2019 "Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit", i ndryshuar, si dhe të njoftimit të përbashkët të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe APP, respektivisht me nr. 25366 Prot dhe nr. 8480 Prot, datë 30.12.2020, informohen operatorët ekonomikë që për nënshkrimin e kontratës publike, në përfundim të procedurës, duhet të kenë:

- Kopje të Certifikatës elektronike për Fiskalizimin, për tatimpaguesit që përdorin Platformën Qendrore të Faturave.

- Kopje të Certifikatës elektronike për Fiskalizimin dhe Kopje të vlefshme të Kontratës së lidhur me Shoqërinë e Certifikuar për zgjidhjen software-ike në përdorim, për tatimpaguesit që lëshojnë faturat nëpërmjet zgjidhjes softwar-ike.

**2. “T.” shpk.**

- Operatori ekonomik ka dorëzuar dokumentet për 2 punonjës Hidroizolues nga 5 të kërkuar.

- OE ka dorëzuar dokumentet për 3 punonjës Hekurkthyes nga 5 të kërkuar.

- OE ka dorëzuar dokumentet për 2 punonjës Saldator nga 5 të kërkuar.

- Në dokumentuat e dorëzuar nga OE mungojnë makineri dhe pajisje si: 1 Fadromë nga 3 të kërkuara, 2 Eskavatorë nga 5 të kërkuar, 2 autobetonjere nga 5 të kërkuar, 4 autobot uji nga 5 të kërkuar, 2 Kompaktor Ngjeshës nga 5 të kërkuar, 2 Matrapikë nga 5 të kërkuar, 1 Sondë shpimi nga 2 të kërkuar.

- OE nuk ka dorëzuar dokumentacion që të dëshmojë që ka ne dispozicion ne pronësi apo me qera, kontrate furnizimi fabrikën e betonit, inerteve dhe gurit gëlqeror , te cilat nëse janë ne pronësi te paraqitet leje mjedisore e vlefshme. Nëse këto fabrika nuk janë ne pronësi te operatorit ekonomik te paraqitet kontrate qiraje ose kontrate/autorizim furnizimi mes palëve, si dhe licenca përkatëse mjedisore e vlefshme (Kodi III.1A për fabrikën e betonit, Kodi III.1.B për fabrikën e betonit, Kodi III.1.B për fabrikën e gurit gëlqero).

- OE nuk ka dorëzuar kontrate noteriale me një laborator testimi te betonit, i cili duhet te jete i akredituar nga organizma kombëtar ose ndërkombëtar sipas standardeve. Detyrimisht te paraqitet kontrata noteriale shërbimi ndërmjet palëve si dhe dokumenti i akreditimit.

### 3. “A.M.” shpk.

Operatori ekonomik ka dorëzuar vetëm dokumentet si: Ekstraktin Historik të QKB për subjektin, Bilancet e tre viteve të kërkuara dhe Vërtetim detyrimi për energjinë elektrike.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 19.03.2021.

“A.-I.G.C.”, shpk është bërë Ankesa nr. 2141 Prot., datë 26.03.2021.

Me urdhrin nr. 94 prot., 2141/1, datë 26.03.2021 është bërë pezullimi i procedurës së prokurimit dhe është ngarkuar Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave për shqyrtimin e ankesës së OE me anëtar R. F, M.H dhe I. C.

KSHA me shkresën nr. 2141/2, datë 02.04.2021 kthen përgjigje OE të mos pranimit të ankesës.

Në lidhje me pikën “ Operatori ekonomik nuk ka dorëzuar Urdhër Pagesën e muajit Dhjetor 2020, që vërteton pagesën në bankë” ku OE pretendon se kjo është bërë ne bazë të vetdeklarimit në shtojcën tete ku kërkohet gj. *Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.*

KSHA nuk e merë në konsideratë pretendimin e |OE me arsyetimin se në shtojcën 12 kapacitet teknike pika 3 të DT kërkohet “3- *Referuar preventivit, grafikut të punimeve, specifikimeve teknike të publikuara në SPE si dhe punimeve ndërtimore në këto objekte, krahas stafit të mësipërm, OE. pjesëmarrës duhet të ketë të punësuar një numër mesatar punonjësish prej 150 punëtorësh për periudhën Tetor - Dhjetor 2020. Për këtë arsye të paraqiten listëpagesat përkatëse të nënshkruara elektronikisht nga sistemi e- Albania si dhe urdhër pagesa përkatëse që konfirmon kryerjen e pagesave përkatëse mujore*”, ku ky kriter nuk është plotësuar nga OE.

Ne lidhje me mangësitë e tjera të konstatuara

“A.-I.G.C.”, shpk arsyeton se është në shkelje në zbatim të nenit 46 pika 1,germa c, të ligjit 9643 .....dhe nenit 5.3 pika 3 të ligjit.

Pretendon se duke qene se dhe oferta është më e ulët dhe me leverdi ekonomike madje buxhetit të shtetit KVO ka bërë vlerësim sipërfaqësor.

KSHA nuk e merë në konsideratë pretendimin e |OE me arsyetimin se nuk plotëson kriteret e përcaktuara në shtojcën 12 kapacitet teknike pika 4 të DT “*Operatori ekonomik, të ketë të punësuar si staf teknik, përveç drejtuesve teknik të kërkuar në pikën 2, punonjësit si më poshtë.....*”; pika 6 “*Ofertuesi duhet të disponojë këto makineri...*” ku nga shqyrtimi i dokumentacionit në SPE kishte mangësi të tyre dhe në asnjë nga kontratat e qerasë nuk ishte përcaktuar emërtesa për projektin e prokurimit.

Pikën 6.5 OE e arsyeton se është në shkelje në zbatim të nenit 46 pika 1,germa c, të ligjit nr. 9643, date 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar dhe nenit 5.3 pika 3 të ligjit.

KSHA arsyeton se nuk është plotësuar kriteri 6.2 i përcaktuar në shtojcën 12 të DT OE ne lidhje me pikën

- Kopje të Certifikatës elektronike për Fiskalizimin, për tatimpaguesit që përdorin Platformën Qendrore të Faturave.

- Kopje të Certifikatës elektronike për Fiskalizimin dhe Kopje të vlefshme të Kontratës së lidhur me Shoqërinë e Certifikuar për zgjidhjen softwere-ike në përdorim, për tatimpaguesit që lëshojnë faturat nëpërmjet zgjidhjes softwar-ike.

Pretendon se në dokumentet e tenderit nuk është përcaktuar në asnjë rast nuk është përcaktuar ndonjë kërkesë në lidhje me dorëzimin e këtyre dokumenteve në fazën kualifikuese, pra siç citon dhe KVO kjo duhet të paraqitet në fazën e përpara lidhjes së kontratës, pra pasi të jetë kryer procesi i kualifikimit dhe procesit të animimit dhe OE te jetë shpallur fitues.

KSHA arsyeton se në zbatim të ligjit 87/2019 ”Për faturën dhe sistemin elektronik dhe njoftimit të përbashkët të DPT dhe APP respektivisht me numër 25366 prot., dhe nr. 8480 prot., datë 30.12.2020 informon OE, që për nënshkrimin e kontratës publike në përfundim duhet të paraqesë.....”

KPP me vendimin nr. 589/1, datë 14.04.2021 prot ne MTM me nr. 2646, datë 16.04.2021 kërkon AK pezullimin e procedurës dhe kalimin në shqyrtim të ankesës së bërë nga OE.

AK të dërgojë të gjithë informacionin e hollësishëm pranë KPP mbi këtë procedurë.

Me shkresën nr. 8646 datë 20.04.2021 i përcillet KPP i gjithë informacionin e kërkuar.

KPP me urdhrin nr. 248/2021 prot më MTM me nr. 3778, datë 03.06.2021 del me vendimin e mos marrjes parasysh të ankesës së OE dhe me vazhdimin e procedurës së prokurimit me hapat e mëtejshëm.

Titullari i AK me Urdhrin nr. 132, prot., 2141/4, datë 04.06.2021 urdhëron heqjen e pezullimit të procedurës së prokurimit.

Nga KVO-ja është mbajtur raporti përmbledhës me nr. 333/3, datë 04.06.2021.

- Me raportin përmbledhës nr. nr. 333/3, datë 04.06.2021, miratohet procedura nga titullari i AK z. E. Q., ku është shpallur fitues OE “A. K.” shpk.

Formulari i njoftimit të fituesit është publikuar me datën 04.06.2021, prot., me nr. 333/4, datë 04.06.2021.

Me shkresën nr. 105, datë 08.06.2021 (prot., 3948, datë 10.06.2021) OE fitues ka depozituar dokumentacionin fizik të tenderit, ku me datë 10.06.2021, nga KVO nga KVO është mbajtur procesverbali i pranimit të dokumentacionit.

Mes AK dhe OE fitues “A.K.” shpk është lidhur kontrata me nr. 333/3, datë 25.06.2021.

Njoftimi i kontratës së nënshkruar është firmosur me shkresën nr. 333/6, datë 28.06.2021 dhe ngarkuar me darën 29.06.2021.

Me shkresën nr. 333/9, datë 05.07.2021 është dërguar në APP raporti i planit të zbatimit të kontratës.

Me urdhrin nr. 170, prot., 330/10, datë 23.08.2021 është ngritur grupi i punës për mbikëqyrjen dhe marrjen në dorëzim të punimeve referuar procedurës së prokurimit ”Mbyllja, rehabilitimi i mbetjeve urbane nga venddepozitimet ekzistuese (Burrel, Kukës, Libohovë, Përmet, Krujë:

<b>Titulli i Gjetjes</b>	Mos verifikimi nga KVO nëse OE plotëson kriterin “kapacitetet teknike dhe profesionale”.
<b>Situata:</b>	Nga auditimi i dokumentacionit të dorëzuar nga OE, rezultoi se ka mospërputhje të dhënash midis Listëpagesës së dorëzuar për plotësimin e kriterëve të DST, të cilat kanë qenë me kode që <b>NUK</b> përkonin me kodet e profesioneve të kërkuara në DST në pikën 4- “Operatori ekonomik, të ketë të punësuar si staf teknik, përveç drejtuesve teknik të kërkuar në pikën 2, punonjësit si më poshtë: <b>Elektricitist 5</b> , sipas listëpagesës janë vetëm 3 të punësuar me këtë profesion me kodin 7411.0 ndërsa: F. M. me kodin 8342.03 (Drejtues Fadrome/Fadronist), dhe K.E. me kodin 9312.06 (Punëtor krahu). <b>Hekurkthyes 5</b> , sipas listëpagesës asnjë nuk është me këtë profesion me kodin 7114.04 ndërsa: K. G. me kodin 9312.06 (Punëtor krahu), B. A. me kodin 7115.02, F. Z. me kodin 712.03 (savatues), P. G. me kodin 9312.06 (Punëtor krahu) dhe S.O. me kodin 7112.05 (murator).

**Karpentier 5** sipas listëpagesës vetëm një është me këtë profesion me kodin 7115.02 ndërsa:  
 B. K. me kodin 9312.06 (Punëtor krahu), G.Sh. me kodin 8332.14 (Shofer kamioni), R. L. me kodin 9312.06 (Punëtor krahu), A. D. me kodin 7112.05 (Murator).

**Hidroizolues 5**, sipas listëpagesës vetëm 2 janë me këtë profesion me kodin 7126.03 ndërsa:  
 D. S. me kodin 9312.06 (Punëtor krahu).H.G. me kodin 7112.05 (Murator) dhe E. I. me kodin 9312.06 (Punëtor krahu).

**Teknik ndërtimi 5** copë listëpagesës vetëm 3 janë me këtë profesion me kodin 3911.15 ndërsa:  
 A. L. me kodin 7124.01 (Punëtor izolimi) ndërsa R. C. me kodin 8332.14 (Shofer kamioni)

**Saldador 5**, sipas listëpagesës vetëm 3 janë me këtë profesion me kodin 7212.09 ndërsa:  
 I.Xh. me kodin 9312.06 (Punëtor krahu) dhe H.V. me kodin 9312.06 (Punëtor krahu).

Sa më sipër OE nuk plotëson kriterin e mësipërm të vendosur nga Njësia e Prokurimit,

Bazuar në praktikën e **Komisionit të Prokurimit Publik vendimi nr. 480/2020 i datës 29.10.2020**, i cili parashikon se: *“KPP gjykon se kriteret e veçanta për kualifikim kanë si synim kryesor që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumentet duhet të refuzohen si të papranueshme.”*, si edhe në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 514, datë 20.09.2017 “Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve (LKP), të rishikuar”, i cili parashikon listën kombëtare të profesioneve, të cilët identifikohen me anë të kodeve në listëpagesë.

Konstatimi i mospërputhjeve midis Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe dokumentacionit të dorëzuar përben kusht s’kualifikimi.

Në Ligjin Nr. 162 datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, neni 76 “**Kriteret detyruese për skualifikim**” pika 3 shkronja ë parashikon: *“Çdo operator ekonomik skualifikohet nga pjesëmarrja në procedurën e prokurimit nëse është në një nga situatat e mëposhtme:*

ë) *operatori ekonomik ka paraqitur deklaratat të rreme në dhënien e informacionit të kërkuar për të vërtetuar mungesën e arsyeve për skualifikim ose për plotësimin e kriterëve të përzgjedhjes, ka fshehur një informacion të tillë ose nuk është në gjendje të dorëzojë dokumentet provuese sipas kërkesave të përcaktuara në dokumentet e tenderit;*

Në këto kushte KVO ka vepruar në kundërshtim me VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 66/3 ku

citon se “*Pas mbylljes së seancës publike, komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit*”. Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumenteve të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për s’kualifikim.

Në DT është kërkuar në piken 1/d në kriteret e përgjithshme të pranimit është kërkuar "Ofertuesi duhet të deklarojë se ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi". Shoqëria “A.K.” shpk ka deklaruar në deklaratën mbi përmbushjen e kriterëve të përgjithshme se ka paguar detyrimet në fjalë sipas legjislacionit në fuqi, ndërkohe rezultoi si vijon:

A. L., teknik ndërtimi ka lidhur kontratën me datën 20.03.2020, ku në nenin 7 pika 7.1 është përcaktuar paga mujore prej 70,000 lekësh. Në listëpagesë ai është deklaruar në vlerën prej 32,500 lekësh për 26 dite pune.

I. Xh, saldator ka lidhur kontratën me datën 15.01.2020, ku në nenin 7 pika 7.1 është përcaktuar paga mujore prej 70,000 lekësh. Në listëpagesë ai është deklaruar në vlerën prej 28,200 lekësh për 15 dite pune.

H.V., saldator ka lidhur kontratën me datën 15.01.2020 ku në nenin 7 pika 7.1 është përcaktuar paga mujore prej 70,000 lekësh. Në listëpagesë ai është deklaruar në vlerën prej 33,750 lekësh për 27 dite pune.

D. S., hidroizolues ka lidhur kontratën me datën 15.01.2020 ku në nenin 7 pika 7.1 është përcaktuar paga mujore prej 70,000 lekësh. Në listëpagesë ai është deklaruar në vlerën prej 36,250 lekësh për 27 dite pune.

E. I., hidroizolues ka lidhur kontratën me datën 15.01.2020 ku në nenin 7 pika 7.1 është përcaktuar paga mujore prej 70,000 lekësh. Në listëpagesë ai është deklaruar në vlerën prej 34,500 lekësh për 27 dite pune.

A.K. nuk ka kontratë pune të bashkëngjitur dhe në dhjetor të 2020 është deklaruar shofer kamioni.

OE: “A.K.” shpk ka vepruar në kundërshtim me piken 2/d të nenit 45 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, ku parashikohet se: "*çdo kandidat ose ofertues përjashtohet nga pjesëmarrja në një procedurë prokurimi, në rastet kur nuk i ka përmbushur detyrimet për derdhjen e kontributeve të sigurimeve shoqërore, në përputhje me legjislacionin shqiptar ose me dispozitat e zbatueshme në shtetin e origjinës*". Në këto kushte, kjo shoqëri ndodhet në kushtet e parashikuara në nenin 13/3 të LPP, pasi ka paraqitur dokumentacion që përmbajnë të dhëna të rreme për qëllime kualifikimi, pasi në deklaratën mbi përmbushjen e kriterëve të përgjithshme ka deklaruar shlyerjen e detyrimeve në fjalë sipas legjislacionit në fuqi.

Sa më sipër në zbatim të nenit 46, pika 1, gërma “b”, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, ku parashikohet shprehimisht: “*Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese. b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës;*

	Ndërsa në nenin 53, pika 3 të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet: “ <i>Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit...</i> ” <b>mosplotësimi i kriterëve për bën shkak për skualifikimin e OE.</b>
<b>Kriteri:</b>	- Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 514, datë 20.09.2017 “Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve (LKP), të rishikuar”, - Ligjin nr. 162 datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, neni 76 “Kriteret detyruese për skualifikim” pika 3 shkronja ë parashikon: - VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 66/3.
<b>Ndikimi/Efekti:</b>	Risku i mos përmbushjes së shërbimit objekt prokurimi nga OE, sipas kriterëve të kërkuar në DST.
<b>Shkaku:</b>	Mos verifikimi nga KVO i dokumenteve të dorëzuara nga OE, në përputhje me DST.
<b>Rëndësia:</b>	I lartë
<b>Rekomandime:</b>	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave të marri masa për eliminimin e praktikave të prokurimit me shkelje ligjore të shpallura fituese në kushtet e mosplotësimi të kriterëve të kërkuara në DST, me qëllim përdorimin me eficence dhe efektivitet e fondeve publike.

Për sa më sipër, ngarkohet me përgjegjësi:

- Znj. I.B; znj. R. L; z. Sh.K ; znj. A. S dhe znj. S. P në cilësinë e anëtarëve të NJP.
- Z. R. B; znj. Sh. H; z. F. Ç; znj. F. Ll dhe znj. D. Xh në cilësinë e anëtarëve të KVO-së.
- Z. E. Q në cilësinë e Drejtor i Përgjithshëm i Drejtorisë Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse.

2. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për procedurën e prokurimit në objekt: ***"Mbikëqyrje punimesh për objektin "Mbyllja, rehabilitimi i mbetjeve urbane nga venddepozitimet ekzistuese (Burrel, Kukës, Libohovë, Përmet, Krujë)"***, konstatohet:

Të dhëna mbi objektin e prokurimit:

<b>Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "Mbikëqyrje punimesh për objektin "Mbyllja, rehabilitimi i mbetjeve urbane nga venddepozitimet ekzistuese (Burrel, Kukës, Libohovë, Përmet, Krujë)".</b>			
<b>1. Lloji i Procedurës së Prokurimit</b> "Kërkesë me propozim" REF-92453-04-07-2021 Urdhri nr. 96, datë 29.03.2021	<b>1.1 Grupi i hartimit kriterëve kualifikuese</b> Urdhri me nr. 96, prot. 2181, datë 29.03.2021.	<b>2 Njësia e Prokurimit</b> R. L S. P A.S	<b>3 Komisioni i Vlerësimit Ofertave</b> Urdhri nr. 97, prot. 2181/1, datë 29.03.2021; R. F Sh. K Sh.H
<b>4. Fondi Limit (pa tvsh)</b> 2,444,185 lekë	<b>5. Oferta fituese (pa tvsh)</b> lekë		<b>6. Diferenca me fondin limit (pa tvsh)</b> 265,917 lekë
<b>7/1 Data e hapjes së tenderit</b> Data 01.03.2021	<b>8. Burimi Financimit</b> Buxheti i Shtetit		<b>9. Operatorët Ekonomike</b> a) Pjesëmarrës në tender Numër 5 b) S'kualifikuar 4 OE, c) Kualifikuar 1OE
<b>7/2 Kohëzgjatja e kontratës</b> 180 ditë/ 6 muaj			
<b>10. Ankimime</b>	<b>11. Përgjigje Ankesës</b> AK me:		<b>12. Përgjigje Ankesës nga KPP</b>
<b>b. Zbatimi i Kontratës Prokurimit</b>			
<b>13. Lidhja e kontratës</b> Mes AK dhe OE fitues	<b>Zbatimi i kontratës:</b> Me urdhër shpenzimin nr. 624, datë 29.12.2021 është likuiduar subjekti "I." shpk në shumën		

“I...” shpk është lidhur kontrata me nr. 2818/8, datë 16.06.2021	prej 205,651 lekë. Me urdhër shpenzimin nr. 625, datë 29.12.2021 është likuiduar subjekti “I.” shpk në shumën prej 944,474 lekë. Me urdhër shpenzimin nr. 359, datë 14.07.2022 është likuiduar subjekti “I.” shpk në shumën prej 731,800 lekë pas dorëzimit të mbikëqyrjes së përfundimit të punimeve.
--	--

### a-Nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit konstatohet:

- Me urdhrin e prokurimit të Z. E. Q , Drejtor i Përgjithshëm i Drejtorisë Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse, nr. 96, prot. 2181, datë 29.03.2021, urdhërohet të kryhet prokurimi i fondit prej 2,444,185 lekë pa TVSH, me objekt **"Mbikëqyrje punimesh për objektin "Mbyllja, rehabilitimi i mbetjeve urbane nga venddepozitimet ekzistuese (Burrel, Kukës, Libohovë, Përmet, Krujë)"** dhe ngarkohet njësia e prokurimit e përbërë nga R., L, S.P dhe A.S.

Me urdhrin nr. 97, prot., 2181/1 datë 29.03.2021, ngrihet Komisioni i vlerësimit të ofertave me anëtar, R. F; Sh.K dhe Sh. H.

*Nga auditimi i Dokumenteve të Tenderit nëpërmjet dosjes fizike dhe sistemit të prokurimit elektronik (SPE) rezultoi:*

#### **Konstatim:**

Nga Titullari i institucionit nuk ka urdhër për ngritjen e komisionit për përlllogaritjen e fondit limit. Përlllogaritja e fondit limit është hartuar nga Njësia e prokurimit në të njëjtën ditë kur është ngritur urdhri i prokurimit, nga R.L., S. P. dhe A.S. bazuar në VKM-në nr. 354, datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikimin e territorit, projektimit, mbikëqyrjes dhe kolaudimit”.

Nga grupi i punës është mbajtur procesverbali me datë 29.03.2021.

*Nga NJP është mbajtur procesverbali me nr. 2181/2 datë 29.03.2021, për miratimin e dokumentare standard të tenderit.*

<b>Titulli i Gjetjes:</b>	Vendosja e kriterëve të veçanta të kualifikimit nuk janë të argumentuar .
<b>Situata:</b>	<p>Nga auditimi i Dokumenteve të Tenderit nëpërmjet dosjes fizike dhe sistemit të prokurimit elektronik (SPE), u konstatuan se:</p> <p><b>Nga AK ka mbivendosje të kriterëve të kërkuara në DT si vijon:</b></p> <p>Në “Kriteret e veçanta të kualifikimit” pika 1 Ofertuesi duhet të dorëzojë: dh) <i>Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.</i></p> <p>Gjithashtu në “Kriteret e veçanta të kualifikimit” <b>në pikën 2.2 “Kapaciteti ekonomik dhe financiar” kërkohet</b> “<i>Një vërtetim që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri. Mosshlyerja e detyrimeve të energjisë elektrike përbën shkak për skualifikimin e operatorit</i>”.</p> <p><b>AK kërkon në pikë 2.3 Për kapacitetin teknik si vijon;</b></p> <p>b. Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e shoqërisë, Drejtues Teknik të kualifikuar si më poshtë..... <i>Stafi i mësipërm duhet të jenë Drejtues Teknik dhe te paraqitet kontrata individuale e punës, CV, Licencë Profesionale.</i></p> <p>Konstatohet se, AK ka vendosur kriterë për kualifikim, te cilat mund te krijojnë problematika apo konfuzion si në plotësimin e vetë kriterit nga operatorët ekonomik ofertues, ashtu edhe gjate procesit te vlerësimit të ofertave.</p> <p>Pra nga AK kërkohet Licencë Profesionale pa specifikuar kategorie, që duhet të jenë.</p>



	<p>c. Dëshmi për fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Ofertuesi duhet të ketë një numër mesatar punonjësish jo më pak se <b>8 (tetë)</b> punonjës të siguruar për tre muajt e fundit, për periudhën Dhjetor 2020, Janar - Shkurt 2021, e vërtetuar kjo me listëpagesat përkatëse të konfirmuara nga Drejtoria e Tatimeve shoqëruar me formularin E-SIG 025.</p> <p>Autoriteti kontraktore kërkojnë numër të pa-argumentuar punonjësish. Ndërkohë, që AK nuk ka hartuar një analizë teknike, ku te parashikohen fuqia punëtore që nevojiten për realizimin e secilit zë punimesh, sipas afateve kohore te parashikuara ne grafikun e punimeve dhe, mbi bazën e analizave përkatëse te përcaktohet numri minimal i punonjësve te domosdoshëm, për realizimin e prokurimit.</p> <p>e. Kualifikimi i Operatorëve Ekonomikë do të bëhet në zbatim të VKM. nr. 354 datë 11.05.2016 "Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në Planifikim Territori, Projektim, mbikëqyrje dhe Kolaudim".</p> <p>AK duhet te përcaktojnë ne mënyre te qartë dhe te saktë kërkesat minimale që duhet të plotësojnë operatorët ekonomike, për të shmangur edhe problemet qe mund te lindin gjatë procesit të vlerësimit. Për këtë qëllim, duhet te përcaktohen jo vetëm kriteret te qarta, por edhe dokumentacioni qe duhet të paraqesë operatori ekonomik për te përmbushur këto kriter, duke shmangur sa me shumë të jetë e mundur përdorimin e kriterëve te përgjithshme, te papërcaktuara.</p> <p><b><i>Sa më sipër kriteret e vendosura dhe të kërkuara nga AK nuk janë të argumentuar teknikisht,</i></b> veprime në kundërshtim të VKM-së 914 datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” pika 2 e nenit 61 “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit” ku citohet se “<i>Në çdo rast, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërish, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre. Ky procesverbal i vihet në dispozicion personit/ave përgjegjës për prokurimin, i cili/të cilët e bën/bëjnë pjesë të dosjes së tenderit.</i>”</p>
<b>Kriteri:</b>	<p>- Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 46, pika 3.</p> <p>- VKM-në nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 26, 61.</p>
<b>Ndikimi/Efekti:</b>	Kriteret kualifikuese të paargumentuara, duke ndikuar në kufizimin e konkurrencës.
<b>Shkaku:</b>	Kriteret kualifikuese jo në përputhshmëri me parashikimet e Ligjit nr. 9643, datë 20/11/2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar.
<b>Rëndësia:</b>	E mesme
<b>Rekomandimi:</b>	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Njësia e Prokurimit në procedurat e prokurimit të mallrave /shërbimeve dhe punëve që do zhvillohen në vazhdimësi, të marrë masa që çdo kriter i veçantë duhet të jetë në përputhje me natyrën dhe përmasën e kontratës, si dhe të hartojë analiza teknike, ku të parashikohet fuqia punëtore dhe mjetet/makineritë që nevojiten për realizimin e secilit zë punimesh,, si dhe dokumentacioni qe duhet të paraqesë operatori ekonomik për te përmbushur këto kriter, duke shmangur sa me shume te jetë e mundur përdorimin e kriterëve te përgjithshme, te papërcaktuara.

**b-Në lidhje me vlerësimin e ofertave nga KVO.**

Në procedurën e prokurimit kanë marrë pjesë 5 OE, për të cilët, referuar formularit paraprak të njoftimit të fituesit datë 19.04.2021,. KVO-ja ka kryer në SPE vlerësimin dhe klasifikimin përkatës si më poshtë:

Nr	Shoqëria OE/BOE	Oferta Lekë PA TVSH	S'kualifikuar/ Kualifikuar
1	"N. S.." shpk	2,175,881	S'kualifikuar
2	"D.E." shpk	2,175,894	S'kualifikuar
3	"I.D. A." shpk	2,176,268	S'kualifikuar
4	"I." shpk	2,178,268	Kualifikuar/ Fituesi
5	"E. C.G." shpk	2 196 880	S'kualifikuar

Pas hapjes së ofertave KVO në zbatim të pikës 5 neni 53 të ligjit nr. 9643, date 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar dhe VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, me shkresën nr. 2887, datë 22.04.2021 drejtuar "I." shpk kërkon sqarim të detajuar në lidhje me ofertën e dorëzuar.

Me shkresën nr. 54/1, date 22.04.2021 prot., në MTM me nr. 2887/1, datë 23.04.2021, OE "I." shpk kthen përgjigje në lidhje me sqarimin e kërkuar për detajimin e ofertës ekonomike, ku ka të bashkëngjitur dhe formularin e detajimit të ofertës.

Me shkresën nr. 137, date 23.04.2021 prot në MTM me nr. 2890, datë 23.04.2021, OE "I.D.A." shpk kthen përgjigje në lidhje me sqarimin e kërkuar për detajimin e ofertës ekonomike, ku ka të bashkëngjitur dhe formularin e detajimit të ofertës.

Pas vlerësimit të ofertave, KVO ka mbajtur procesverbalin nr. 2, me datën 30.04.2021, ku referuar procesverbalit dhe njoftimit të fituesit, janë s'kualifikuar Operatorët Ekonomik, si mëposhtëm:

**"N.S."shpk**, për arsye se duhet të respektojë legjislacionin në fuqi dhe tarifat minimale të shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve referuar VKM-së Nr.354, datë 11.05.2016, duke dorëzuar një ofertë të detajuar ekonomike e cila garanton Autoritetin Kontraktor në përmbushjen e Termave të Referencës. Formulari i ofertës së dorëzuar nga operatori ekonomik (shtojca 1) është në vlerë më të ulët se minimumi i përcaktuar sipas këtij vendimi, për këtë arsye s'kualifikohet.

Operatori ekonomik nuk ka plotësuar të gjitha kriteret **1. Kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit dhe 2. Kriteret e veçanta të kualifikimit, sipas Shtojcës 7, konkretisht: Pika 2.3 Për kapacitetin Teknik, pika e) dhe g).**

Në mbështetje të nenit 34, 46, 53 të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, të nenit 28, 39, 58, 66 dhe neni 67 të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, si dhe dokumentet e tenderit të miratuara, Komisioni vendosi se oferta është e skualifikuar dhe nuk pranohet pasi nuk plotëson të gjitha kërkesat për kualifikim të dokumenteve të tenderit.

**"D." shpk**, i cili nuk ka plotësuar të gjitha kriteret 1. Kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit dhe 2. Kriteret e veçanta të kualifikimit, sipas Shtojcës 7, konkretisht: 2.2 Për kapacitetin ekonomik dhe financiar, pika b) dhe Pika 2.3 Për kapacitetin Teknik, pika d), e) dhe g), konkretisht si mëposhtëm:

- Në dokumentet e dorëzuara nga OE mungon Vërtetimi për realizimin e xhiros mesatare vjetore e tre viteve të fundit nga data e shpalljes së tenderit (2018; 2019; 2020) me vlerë sa 40 % e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet, të lëshuar nga Administrata Tatimore.
- Në dokumentet e dorëzuara nga OE mungon Kopje të Certifikatës elektronike për Fiskalizimin, për tatimpaguesit që përdorin Platformën Qendrore të Faturave. Kopje të Certifikatës elektronike për Fiskalizimin dhe Kopje të vlefshme të Kontratës së lidhur me Shoqërinë e Certifikuar për zgjidhjen software-ike në përdorim, për tatimpaguesit që lëshojnë faturat nëpërmjet zgjidhjes softwar-ike.
- Në mbështetje të VKM-së Nr.354, datë 11.05.2016 "Për Miratimin e Manualit të Tarifave për Shërbime në Planifikim Territori, Projektim, Mbikëqyrje dhe Kolaudim", Operatori ekonomik

duhet të respektojë legjislacionin në fuqi dhe tarifat minimale të shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve, duke dorëzuar një ofertë të detajuar ekonomike e cila garanton Autoritetin Kontraktor në përmbushjen e Termave të Referencës. Formulari i ofertës së dorëzuar nga operatori ekonomik (shtojca 1) është në vlerë më të ulët se minimumi i përcaktuar sipas këtij vendimi, për këtë arsye s'kualifikohet.

**“I. D.A.” shpk**, për arsye se duhet të respektojë legjislacionin në fuqi dhe tarifat minimale të shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve referuar VKM-së Nr..354, datë 11.05.2016, duke dorëzuar një ofertë të detajuar ekonomike, e cila garanton Autoritetin Kontraktor në përmbushjen e Termave të Referencës. Formulari i ofertës së dorëzuar nga operatori ekonomik (shtojca 1) është në vlerë më të ulët se minimumi i përcaktuar sipas këtij vendimi, për këtë arsye skualifikohet, Operatori ekonomik nuk ka plotësuar të gjitha kriteret 1. Kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit dhe 2. Kriteret e veçanta të kualifikimit, sipas Shtojcës 7, konkretisht: Pika 2.3 Për kapacitetin Teknik, pika e) dhe g).

**“E. C. G.” shpk** i cili nuk ka dorëzuar të gjithë dokumentacionin e kërkuar nga Autoriteti Kontraktor për plotësimin e të gjithë 1. Kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit dhe 2. Kriteret e veçanta të kualifikimit, sipas Shtojcës 7, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 1, b), c), ç), d), dh) dhe Pika 2.2 Për kapacitetin ekonomik dhe financiar, pika a), konkretisht si mëposhtëm:

- Në dokumentet e dorëzuara nga OE mungojnë Shtojcat sipas përcaktimeve të bëra në pikën 1 të Krieteve të veçanta të kualifikimit, specifikuat pika b), c), ç), d), dh).
- Në dokumentet e dorëzuara nga OE mungon kopje të certifikuar të bilancit të Vitit 2020, të paraqitur pranë autoriteteve përkatëse tatimore dhe të konfirmuar nga ky autoritet.

Nga AK është kualifikuar ofertuesi i mëposhtëm:

**“I.” shpk.**, i cili plotëson të gjitha kriteret 1. Kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit dhe 2. Kriteret e veçanta të kualifikimit, sipas Shtojcës 7 të DST-ve.

Në përfundim të vlerësimit Komisioni i Vlerësimit të Ofertave (KVO), në bazë të përmbushjes së kërkesave kualifikuese të përgjithshme dhe të veçanta, vendosën të kualifikojnë Operatorin Ekonomik “I.” shpk dhe më pas sistemi i APP-së referuar kriterit të vlerësimit “Çmimi më i ulët” bëri renditjen si më poshtë, ku operatori ekonomik “I.” shpk u rendit në vend të parë me ofertën 2 ,178,268.04 lekë pa TVSH (dy milion e njëqind e shtatëdhjetë e tetë mijë e dyqind e gjashtëdhjetë e tetë pikë zero katër) lekë pa TVSH.

<b>Titulli i Gjetjes</b>	Mos verifikimi nga KVO nëse OE plotëson kriterin “kapacitetet teknike dhe profesionale”.
<b>Situata:</b>	Nga auditimi i dokumentacionit të dorëzuar nga OE, rezultoi se Inxhinier Mjedisi, 1 (një) të punësuar Dh. L., nuk e plotëson kriterin <b>2.3 Për kapacitetin teknik:</b> pika 2 b. <i>Operatori ekonomik ofertues duhet të këtë në stafin e shoqërisë, Drejtues Teknik të kualifikuar si më poshtë: Inxhinier Mjedisi, 1 (një) të punësuar.</i> pasi ai ka titullin Kimist teknolog. Sa më sipër OE i shpallur fitues nuk plotësin të gjitha kriteret e përcaktuara në DT. Në zbatim të nenin 53, pika 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, ku parashikohet: “ <i>Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit...</i> ” <b>mosplotësimi i krieteve përbën shkak për skualifikimin e OE</b> Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë dhe përvojën e duhur, për të zbatuar kontratën

	objekt prokurimi, si edhe janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit, në mënyrë që edhe vlerësimi të bëhet në përputhje me këtë dokumentacion, pasi <b>ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme.</b> - Mes AK dhe OE fitues <b>“I.” shpk</b> është lidhur kontrata me nr. 2818/8, datë 16.06.2021. Nga auditimi i likuidimit të kontratës u konstatua se realizimi i pagesës është bërë në këste në kundërshtim më DT shtojca 16, ku në Neni 9 <i>“Pagesa Paraprake”</i> nuk është përcaktuar asnjë kusht ligjor se pagesa do të bëhet me këste, si dhe në kontratën nr. 2818/8, datë 16.06.2021 në të cilën nuk është përcaktuar dhe specifikuar pagesë paraprake për shërbimin.
<b>Kriteri:</b>	Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 <i>“Për prokurimin publik”</i> , i ndryshuar nenin 53, pika 3; Dokumentar e DST.
<b>Ndikimi/Efekti:</b>	Risku i mos përmbushjes së shërbimit objekt prokurimi nga OE, sipas kriterëve të kërkuar ne DST
<b>Shkaku:</b>	Mos verifikimi nga KVO i dokumenteve të dorëzuara nga OE, në përputhje me DST.
<b>Rëndësia:</b>	I lartë
<b>Rekomandime:</b>	- Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave të marrë masa për eliminimin e praktikave të prokurimit me shkelje ligjore të shpallur fitues në kushtet e mosplotësimit të kriterëve të kërkuara në DST, me qëllim përdorimin me eficence dhe efektivitet e fondeve publike. - Sektori i Financës të marrë masa në vijimësi që pagesat të mos copëzohen në këste, nëse kjo nuk është e parashikuar në kushtet e veçanta të kontratës së lidhur mes AK dhe operatorit ekonomik, me qëllim përdorimin me eficence dhe efektivitet të fondeve buxhetore.

Nga KVO-ja është mbajtur raporti përmbledhës me nr. 2181/6, datë 10.05.2021.

- Me raportin përmbledhës me nr. 2181/6, datë 10.05.2021, miratohet procedura nga titullari i AK z. E. Q, ku është shpallur fitues OE **“I.” shpk**.

Formulari i njoftimit të fituesit është publikuar me datën 10.05.2021, prot., nr. 2181/7, datë 10.05.2021.

OE fitues ka depozituar dokumentacionin fizik të tenderit, ku me 14.05.2021, nga KVO është mbajtur procesverbali i pranimit të dokumentacionit.

Mes AK dhe OE fitues **“I.” shpk** është lidhur kontrata me nr. 2818/8, datë 16.06.2021.

Njoftimi i kontratës së nënshkruar është firmosur me shkresën nr. 2181/9, datë 17.06.2021 dhe ngarkuar me datën 17.06.2021.

**“I.” shpk** ka dërguar shkresat për fillimin e punimeve:

Me datën 19.11.2021 (prot., 8490, datë 22.11.2021) *“Njoftimi për fillimin e punimeve” për “Mbikëqyrje punimesh për objektin “Mbyllja, rehabilitimi i mbetjeve urbane nga venddepozitimet ekzistuese Burrel”*.

Me datën 18.11.2021 (prot., 8485, datë 22.11.2021) *“Njoftimi për fillimin e punimeve” për “Mbikëqyrje punimesh për objektin “Mbyllja, rehabilitimi i mbetjeve urbane nga venddepozitimet ekzistuese Përmet”*.

Me datën 25.11.2021 (prot., 8657, datë 01.12.2021) *“Njoftimi për fillimin e punimeve” për “Mbikëqyrje punimesh për objektin “Mbyllja, rehabilitimi i mbetjeve urbane nga venddepozitimet ekzistuese Libohovë”*.

Me datën 09.12.2021 (prot., 8921, datë 13.12.2021) *“Njoftimi për fillimin e punimeve” për “Mbikëqyrje punimesh për objektin “Mbyllja, rehabilitimi i mbetjeve urbane nga venddepozitimet ekzistuese Krujë”*.

Me datën 10.12.2021 (prot., 8938, datë 14.12.2021) *“Njoftimi për fillimin e punimeve” për “Mbikëqyrje punimesh për objektin “Mbyllja, rehabilitimi i mbetjeve urbane nga venddepozitimet*

*ekzistuese Kukës”.*

Me datën 10.12.2021 (prot., 8938, datë 14.12.2021) “Njoftimi për fillimin e punimeve” për *“Mbikëqyrje punimesh për objektin “Mbyllja, rehabilitimi i mbetjeve urbane nga venddepozitimet ekzistuese Kukës”.*

Me datën 28.12.2021 është dorëzuar raporti mbi ecurinë e punimeve në lidhje me situacionin nr. 1 në vlerën 13,825,524 lekë dhe nr. 2 në vlerën 63,494,883 lekë në total në vlerën 77,320,407 lekë me TVSH.

“I.” shpk me shkresën datë 21.06.2022 (prot., nr. 5198, datë 21.06.2022) njofton përfundimin e punimeve nga subjekti “A... K...” shpk me datën 10.06.2022.

Me urdhër shpenzimin nr. 624, datë 29.12.2021 është likuiduar subjekti “I.” shpk në shumën prej 205,651 lekë.

Me urdhër shpenzimin nr. 625, datë 29.12.2021 është likuiduar subjekti “I.” shpk në shumën prej 944,474 lekë.

Me urdhër shpenzimin nr. 359, datë 14.07.2022 është likuiduar subjekti “I.” shpk në shumën prej 731,800 lekë pas dorëzimit të mbikëqyrjes së përfundimit të punimeve.

#### ***Për sa më sipër, ngarkohet me përgjegjësi:***

- Znj. R. L; znj. A. Sdhe znj. S.P në cilësinë e anëtarëve të NJP.

- Z. Sh. K; znj. Sh. H; dhe Z. Rr,F në cilësinë e anëtarëve të KVO-së.

### **ZBATIMI I KONTRATAVE;**

**5.2** Lidhja dhe zbatimi i kontratave deri në marrjen në dorëzimit të mallrave/punëve dhe shërbimeve.

Për objektin **“Mbyllja, rehabilitimi i mbetjeve urbane nga vend depozitimet ekzistues (Burrel, Kukës, Libohovë, Përmet, Krujë)”**, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

#### *1) Dosja teknike e zbatimit:*

- *Kontrata e zbatimit të punimeve midis Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe OE “A. K” shpk me Nr. 333/5Prot. datë 25.06.2021.*
- *Projekti i Zbatimit (Vizatimet sipas faktit);*
- *Pagesat pjesore deri në situacionin përmbledhës;*
- *Librezat e masave pjesore deri në situacionin përmbledhës;*
- *Kontrata e Mbikëqyrjes së punimeve midis Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe OE “I..” shpk me Nr. 2181/8Prot. datë 16.06.2021.*
- *Korrespondencat mes Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe operatorit ekonomik që kryen mbikëqyrjen OE “I.” shpk.*

#### **Kontrata**

Objekti është kryer sipas kontratës për punë publike me nr. 333/5 prot. datë 25.06.2021 me objekt *“Mbyllja, rehabilitimi mbetjeve urbane nga vend depozitimet ekzistues (Burrel, Kukës, Libohovë, Përmet, Krujë)”*, me vlerë 175,728,198 lekë me TVSH, të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, të përfaqësuar nga z. E.Q i ngarkuar me detyrë, në cilësinë e Titullarit të Autoritetit Kontraktor referuar Urdhrit Nr.1, datë 05.01.2021 *“Për delegimin e kompetencave”* dhe Operatorit Ekonomik *“A.K.”* shpk me përfaqësues z. A.K. dhe Licence për zbatim punimesh NZ..... Afati zbatimit të kontratës është përcaktuar periudha kohore 6 muaj nga data e fillimit të punimeve sipas nenit 2 *“Objekti i kontratës”* dhe Kushtet e Veçanta neni 5 *“Data e fillimit”*.

Mbikëqyrja e punimeve të zbatimit të kontratës është kryer nga OE “I.” shpk sipas kontratës së shërbimit nr. 2181/8 datë 16.06.2021, *“Mbikëqyrje punimesh për objektin Mbyllja, rehabilitimi mbetjeve urbane nga venddepozitimet ekzistues (Burrel, Kukës, Libohovë, Përmet, Krujë)”* me vlerë 2,613,921.65 lekë me TVSH, dhe përfaqësues z. I. D. me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK. 1641/12.

Kolaudimi i punimeve të ndërtimit është kryer nga OE “A.” shpk sipas kontratës Nr. Nr. 5198/4 Prot, datë 13.09.2022, me vlerë 79,077.60 lekë me TVSH. me përfaqësues znj. N. M. me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK.

Marrja në dorëzim e objektit është kryer më datë 24.06.2022 nga grupi i punës i përbërë nga, R.B., Sh. M, Sh.K sipas Urdhër të Autoritetit Kontraktor Nr. 170 Prot. datë 23.08.2021 “Për ngritjen e grupit të punës për mbikëqyrjen dhe marrjen në dorëzim të punimeve referuar procedurës së prokurimit ‘Procedurë e hapur’ punë, me objekt ‘Mbyllja, rehabilitimi i mbetjeve urbane nga vend-depozitimet ekzistues (Burrel, Kukës, Libohovë, Përmet, Krujë)’, në zbatim të kontratës nr. 333/5 prot. datë 25.06.2021”.

#### Hartimi i projektit

Studimi dhe projekti i detajuar për zbatim është hartuar nga shoqëria BOE “D.... P....” shpk “A.C.” shpk dhe “U.” shpk në vitin 2019 ku është parashikuar që jetëgjatësia e këtyre landfilleve të jetë 5 vjet. Hartimi i projekt zbatimit për ndërtimin e vend depozitimit të mbetjeve urbane të qyteteve ka pas si objektiv të përgjithshëm reduktimin e rrezikut mjedisor dhe atij shëndetësor që vjen si rezultat i administrimit të mbetjeve urbane. Llogaritjet për sasinë e mbetjeve dhe jetëgjatësia e tyre janë bërë në bazë të të dhënave të marra nga bashkitë, lidhur me numrin e popullsisë, trendin e rritjes së saj, për 5 vitet e ardhshëm, sipërfaqen e vënë në dispozicion dhe një përshkrim i përbërjes së mbetjeve. Studim projektimi i detajuar është realizuar për 10 (dhjetë) bashki, konkretisht, Kukës, Libohovë, Përmet, Krujë, Burrel ku për to janë realizuar punimet e zbatimit si dhe për bashkitë Vlorë, Tropojë, Kavajë, Roskovec dhe Lushnjë (vend-depozitimi Grabian).

#### Zbatimi i punimeve

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se Lejet Infrastrukturore dhe dorëzimi i sheshit të ndërtimit dhe fillimi i punimeve, sipas njoftimeve përkatëse janë bërë për secilën bashki, konkretisht:

1. Bashkia Përmet, Leje Infrastrukturore Nr. 4 datë 17.11.2021 dhe Akt dorëzimi i sheshit të ndërtimit, pikeimi e fillimi i punimeve në datën 18.11.2021.
2. Bashkia Mat, Leje Infrastrukturore Nr. 240 datë 19.11.2021 dhe Akt dorëzimi i sheshit të ndërtimit, pikeimi e fillimi i punimeve në datën 19.11.2021.
3. Bashkia Kukës, Leje Infrastrukturore Nr. 229 datë 10.12.2021 dhe Akt dorëzimi i sheshit të ndërtimit, pikeimi e fillimi i punimeve në datën 12.10.2021.
4. Bashkia Libohovë, Leje Infrastrukturore Nr. 02 datë 25.11.2021 dhe Akt dorëzimi i sheshit të ndërtimit, pikeimi e fillimi i punimeve në datën 25.11.2021.
5. Bashkia Krujë, Vendim Nr. 250 datë 09.12.2021 për miratimin e deklaratës për kryerje punimesh dhe Akt dorëzimi i sheshit të ndërtimit, pikeimi e fillimi i punimeve në datën 10.12.2021.

Mbikëqyrësi i punimeve me shkresën nr. 67, prot datë 20.05.2022 i është drejtuar AK për ndryshime volumesh (+/-), si dhe preventivi i rishikuar brenda vlerës së kontratës bazë. Ndryshimi i volumeve dhe preventivi i rishikuar është përcjellë i miratuar nga ana e AK me shkresën Nr. 4427/3 Prot. datë 27.05.2022.

Nr.	Emërtimi i objektit	Preventivi i kontratës (Lekë)	Vlera e punimeve që shtohen (Lekë)	Vlera e punimeve që zbriten (Lekë)	Preventivi i ripunuar (Lekë)
1	Mbyllja, rehabilitimi i mbetjeve urbane nga venddepozitimet ekzistues – Libohovë	30,836,230	8,762,663	8,764,226	30,834,667
2	Mbyllja, rehabilitimi i mbetjeve urbane nga venddepozitimet ekzistues - Përmet,	23,250,490	2,887,177	2,888,975	23,248,692
3	Mbyllja, rehabilitimi mbetjeve urbane nga venddepozitimet ekzistues -Burrel.	33,429,095	7,662,805	7,622,820	33,429,080

4	Mbyllja, rehabilitimi i mbetjeve urbane nga venddepozitimet ekzistues -Kukës,	27,921,585	4,281,930	4,282,030	27,921,485
5	Mbyllja, rehabilitimi i mbetjeve urbane nga venddepozitimet ekzistues -Krujë	31,002,765	6,258,202	6,262,592	30,998,375
6	<b>Shuma pa TVSH</b>	<b>146,440,165</b>	<b>29,812,777</b>	<b>29,820,643</b>	<b>146,432,299</b>

<b>Zbatimi i Kontratës së Punimeve “Mbyllja, rehabilitimi i mbetjeve urbane nga venddepozitimet ekzistues (Burrel, Kukës, Libohovë, Përmet, Krujë)”.</b>					
<b>14. Lidhja e kontratës</b> Kontrata nr. 333/5prot. datë 25.06.2021.		<b>15. Vlera e kontratës (me tvsh)</b> 175,728,198 lekë <b>OE “A.K.” SHPK</b>		<b>16. Likuiduar deri dt</b>	
<b>17- Situacioni Përfundimtar</b> a) <b>Kontrata bazë</b> - <b>Vlera me TVSH 175,718,758 lekë</b> - <b>Vlera pa TVSH 146,432,298 lekë</b>		<b>18. Afati i kontratës në</b> Parashikuar 180 ditë. Zbatuar 180 ditë. Fillimi punimeve: 09.12.2021 Përfundimi punimeve: 10.06.2022		<b>19. Zgjatja e kontratës</b> S’ka	
<b>20. Mbikëqyrësi i punimeve</b> “L.” SHPK		Licenca Nr: MK .----	Kontrata nr.2 181/8 datë 16.06.2021		
<b>21. Kolaudatori i punimeve</b> OE “A.” SHPK		Licenca Nr: MK. ----	Kontrata Nr. 5198/4 Prot, datë 13.09.2022		
<b>22.Akt Kolaudimi</b> datë 23.09.2022		<b>23. Akt i marrjes në dorëzim</b> datë 23.09.2022			

Në kontratën me objekt “Mbyllja, rehabilitimi i mbetjeve urbane nga vend depozitimet ekzistues (Burrel, Kukës, Libohovë, Përmet, Krujë)” afati i përfundimit të kontratës është 180 ditë nga data e fillimit të punimeve pasi janë lëshuar lejet infrastrukturore të ndërtimit nga bashkitë përkatëse. Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion konstatohet se lejet infrastrukturore dhe fillimi i punimeve nuk kanë nisur në të njëjtën kohë kështu që dhe afati i përfundimit për çdo bashki do të duhet të ishte i ndryshëm. Për fillimin e punimeve në secilën bashki është mbajtur procesverbali i fillimit të tyre por procesverbali i përfundimit të punimeve është mbajtur vetëm kur kanë përfunduar në Bashkinë që kanë filluar e fundit dhe jo për secilën prej tyre respektive. Pavarësisht se kontrata është një e tërë por punimet në secilën bashki janë të pa varura nga njëra tjetra dhe njoftimi për përfundimin e punimeve duhet të ishte secili më vete sipas fillimit të punimeve dhe afatit të përcaktuar në kontratë. Mos përcaktimi i afateve të përfundimit të punimeve në kontratë, për secilën bashki më vete, ka bërë të mundur shmangien e penaliteteve, për ditë vonesë, për pjesën e kontratës në bashkitë ku punimet kanë filluar më herët.

Nga auditimi i situacionit përfundimtar, projektit dhe preventivit bazë, preventivit të rishikuar, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të dukshme të ndërtimit, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan diferenca në volume apo punime të llogaritura jo në përputhje me projektin e zbaruar (vizatimet sipas faktit), me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit në vlerën **264,170 lekë pa TVSH**.

Diferencat e volumeve të argumentuara si më poshtë:

Në kapitullin e punimeve Punime shtresash, sipas detajeve të projektit është shtuar zëri i punimeve, Shtresë stabilizanti t=20cm mbi shtresën e gjeo-membranës për të bërë mbrojtjen e tubave të sistemit të mbledhjes së shllamit nga shtypja dhe presioni i ngarkesave që do të vijë nga hedhja e mbeturinave në gropën e landfillit. Referuar manualit të çmimeve zëri 3.212/d Shtresë stabilizanti t=20cm ka kosto 792 lekë/m<sup>2</sup> dhe i miratuar nga supervizori me çmimin 780 lekë/m<sup>2</sup>. Pjesë përbërëse e analizës së çmimit janë grejder me vlerë 113 lekë/m<sup>2</sup> dhe rul me vibrim me vlerë 89 lekë/m<sup>2</sup>. Nga auditimi i dokumentacionit si dhe metoda e realizimit të punimeve për vetë kushtet e terrenit ku punimet realizohen, rezulton se makineritë grejder dhe rul me vibrim nuk janë përdorur për vetë faktin se kjo shtresë hidhet për mbrojtjen e tubave nga ngarkesat, kështu që përdorimi i tyre do të dëmtonte ato.

Përhapja dhe ngjeshja e shtresës së stabilizantit është kryer me krahë dhe me tokmak elektrik sipas zërit 3.47/1b Mbushje, rrafshim, ngjeshje me tokmak elektrik çdo 30 cm, tok e zakonshme me vlerë sipas ofertës 185 lekë/m<sup>2</sup>, kështu që kontraktori ka përfituar më tepër diferencën e çmimit për njësi

të makinerive duke e ponderuar me çmimin e ofertuar, grejder dhe rul me vibrim, me çmimin e mësipërm. Sipas analizës së çmimit vlera e makinerive, grejder dhe rul me vibrim, referuar ofertës është 199 lekë/m<sup>2</sup> [780x(113+89)/792] e për rrjedhojë vlera e përfituar më tepër për njësi është 14 lekë/m<sup>2</sup> (199-185) e në vlerë totale 198,170 lekë pa TVSH (14,155 m<sup>2</sup>x14lekë/m<sup>2</sup>), ku vlera 14,155 m<sup>2</sup> është volumi i punimit të zërit Shtresë stabilizanti t=20cm të realizuar në të pesë bashkitë ku janë realizuar punimet.

Në venddepozitimim e mbetjeve në Bashkinë Kukës, nga vizita në terren, në kapitullin Punime drenazhimi dhe mbledhja e ujërave sipërfaqësor, zëri Struktura monolite betoni C 6/10 (blloku) u konstatua se në të dyja anët e hyrjes në një gjatësi prej 30 ml kjo strukturë nuk ishte realizuar sipas vizatimeve sipas faktit. Ankorimi i shtresave të gjeotekstitit dhe gjeomembranës ishte realizuar me betonin e pjesës së sipërme të kanalit të ujërave mbledhëse në skarpatin e jashtëm të gropës. Për sa më sipër kontraktori ka përfituar më tepër volumin e punimeve prej 7.5 m<sup>3</sup> (30 ml x 0.5m x 0.5m) të zërit Struktura monolite betoni C 6/10 (blloku) kjo në vlerën 66,000 lekë pa TVSH (7.5m<sup>3</sup>x8800 lekë/m<sup>3</sup>).

<b>Titulli i gjetjes:</b>	Punime të situacionuara por të pakryera në fakt.																		
<b>Situata:</b>	<p>Në objektin <u>“Mbyllja, rehabilitimi i mbetjeve urbane nga venddepozitimet ekzistues (Burrel, Kukës, Libohovë, Përmet, Krujë)”</u> sipas kontratës të lidhur midis Ministria e Turizmit dhe Mjedisi dhe OE “A. K.” shpk me Nr. 333/5 Prot. datë 25.06.2021 në lidhje me zbatimin e punimeve me vlerë 175,728,198 lekë me TVSH me afat përfundimi të punimeve 6 muaj nga data e fillimit të tyre, deri më 10.06.2022, nga dokumentacioni i vendosur në dispozicion, konkretisht:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>Projekti fillestar;</i></li> <li>• <i>Projekti i Zbatimit pjesor (Vizatimet sipas faktit);</i></li> <li>• <i>Pagesat pjesore deri në situacionin përfundimtar;</i></li> <li>• <i>Librezat e masave pjesore deri në situacionin përfundimtar;</i></li> <li>• <i>Ndryshimet e miratuara nga AK;</i></li> <li>• <i>Korrespondencat midis Ministria e Turizmit dhe Mjedisi dhe OE që kryen supervizionimin “I.” shpk.</i></li> </ul> <p>si dhe nga verifikimi i kryer në terren në prezencë të përfaqësuesve shtetërorë të KLSH dhe mbikëqyrësit (supervizori i punimeve) rezultuan se janë përfshirë në librezat e masave volume pune të pakryera në fakt. Këto diferenca rezultuan në zërat me vlerat përkatëse si më poshtë:</p> <table border="1" data-bbox="483 1339 1421 1543"> <thead> <tr> <th>Nr.</th> <th>Kategoria e Punimeve</th> <th>Emërtimi i Zërit</th> <th>Vlera (lekë pa TVSH)</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>1</td> <td>Punime shtresash</td> <td>Shtresë stabilizanti t=20cm</td> <td>198,170</td> </tr> <tr> <td>2</td> <td>Punime drenazhimi</td> <td>Struktura monolite betoni C 6/10 (blloku)</td> <td>66,000</td> </tr> <tr> <td colspan="3" style="text-align: right;">SHUMA</td> <td><b>264,170</b></td> </tr> </tbody> </table> <p>Konkretisht, argumentimet pasqyrohen të përshkruara në Akt konstatimin Nr. 7.</p>			Nr.	Kategoria e Punimeve	Emërtimi i Zërit	Vlera (lekë pa TVSH)	1	Punime shtresash	Shtresë stabilizanti t=20cm	198,170	2	Punime drenazhimi	Struktura monolite betoni C 6/10 (blloku)	66,000	SHUMA			<b>264,170</b>
Nr.	Kategoria e Punimeve	Emërtimi i Zërit	Vlera (lekë pa TVSH)																
1	Punime shtresash	Shtresë stabilizanti t=20cm	198,170																
2	Punime drenazhimi	Struktura monolite betoni C 6/10 (blloku)	66,000																
SHUMA			<b>264,170</b>																
<b>Kriteri:</b>	<p>Ligji nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7 <u>ku përcaktohet se:</u> “Mbikëqyrësi i punimeve është i detyruar të kontrollojë periodikisht dhe në fazat më kryesore, librin e kantierit dhe është përgjegjës për saktësinë vërtetësinë e dokumenteve dhe cilësinë e punimeve të ndërtimit”</p> <p>-Udhëzimit nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, Kreu II, Pika 8.1 <u>ku përcaktohet se:</u> “Situacionet pjesore hartohen në lloje, zëra, sasi, çmim e vlerë, sipas kontratës dhe ndryshimeve të</p>																		



	<p><i>urdhëruara nga investitori. Zërat, sasi të, çmimet jashtë kontratës dhe përdorimi i fondit rezervë në situacionin përfundimtar justifikohen me dokumentacionin përkatës”.</i></p> <p>- Udhëzimi nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar me Udhëzimin Nr. 1, datë 16.6.2011, Kreu I, pika 3, nënparagrafët 3.2 dhe 3.3.</p> <p>- Kontrata e shërbimit me objekt “Mbikëqyrje të objektit, ‘Mbyllja, rehabilitimi i mbetjeve urbane nga vend-depozitimet ekzistues (Burrel, Kukës, Libohovë, Përmet, Krujë)”, Nr. 2181/8 Prot. datë 16.06.2021.</p>
<b>Ndikimi/Efekti:</b>	Dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit në shumën 264,170 lekë pa TVSH.
<b>Shkaku:</b>	Certifikimi nga ana e mbikëqyrësit volume punimesh të pakryera në fakt nga ana e sipërmarrësit.
<b>Rëndësia:</b>	E lartë.
<b>Rekomandimi:</b>	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit të marri masa, për arkëtimin e shumës 264,170 Lekë pa TVSH, e cila përbën dëm ekonomik në buxhetin e shtetit dhe njësisë vendore, duke ndjekur të gjitha procedurat nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjyqimit nga OE “A. K.” shpk sipas kontratës së lidhur me nr. 333/5Prot. datë 25.06.2021 për realizimin e punimeve civile.

*Për sa më sipër ngarkohet me përgjegjësi përfaqësuesi i mbikëqyrësit OE “I..” shpk z. I.D sipas kontratës së shërbimit Nr. 2181/8Prot. datë 16.06.2021 me objekt: “Mbikëqyrje të objektit, ‘Mbyllja, rehabilitimi i mbetjeve urbane nga vend-depozitimet ekzistues (Burrel, Kukës, Libohovë, Përmet, Krujë)”.*

*Menaxhimi i landfilleve për secilën bashki dhe gjendja e tyre.*

*Bashkia Përmet*

Nga vizita në terren, vend-depozitim i mbetjeve Bashkia Përmet, në prezencë të përgjegjësit të urbanistikës u konstatua se, sasia e plehrave të depozituara ishte e vendosur brenda vendit të përcaktuar dhe e shpërndarë por nuk ishte kryer ngjeshja e tyre. Porta mbahej e mbyllur dhe nga ana e bashkisë përgjatë rrethimit ishin mbjellë pemë që në kohën e mbulimit sipërfaqësor përfundimtar të bëhet i mundur rikuperimi ambiental i zonës. Nga ana e bashkisë nuk ishte kryer mbulimi me dhe i sasisë së hedhur, pasi ato të jenë ngjeshur dhe niveluar, për të shmangur erën e keqe që shpërndahet në zonë nga ky vend-depozitim.

*Bashkia Libohovë*

Nga vizita në terren në prani të Nënkrëtarit të Bashkisë Libohovë u konstatua se gjeomembrana ishte e dëmtuar dhe ishte e zhvendosur nga era së bashku me shtresën e gjeotekstit. Gjithashtu tubat e kullimit të llumit ishin dëmtuar dhe nuk mund të kryenin funksionin për të cilin ishin vendosur. Dëmtimet kanë ardhur si rezultat i keqmenaxhimit të investimit nga ana e përfituesit. Në rrethimin e jashtëm të landfillit gjendeshim grumbuj mbetjesh urbane dhe jo të depozituara në vendim përkatës. Sasia e mbetjeve urbane e hedhur në gropë ishte shumë e vogël e hedhur në skarpatet e gropës dhe në disa raste të djegura. Djegia e mbetjeve brenda gropës dëmton shtresat e gjeotekstit dhe gjeomembranës e për rrjedhojë nuk mund të kryejnë funksionin e tyre në të ardhmen duke lejuar llumin të kontaminoj terrenin përreth. Mbetjet nuk janë shpërndarë në mënyrë të njëtrajtshme, të kryhej diferencimi i tyre nga ato që kanë një kohë shumë të gjatë dekompozimi dhe të mbulohen me një shtresë dhe për shmangie e erës së keqe dhe mos djegien e tyre për shkak biogazit që lëshojnë, pavarësisht së është modest në madhësinë e këtyre landfilleve. Landfilli ishte i rrethuar me rrjetë teli sipas specifikimeve të kontratës dhe me portë metalike por porta qëndronte e hapur gjatë gjithë kohës. Moskontrolli i hyrjes në venddepozitim bën të mundur hedhjen e mbetjeve nga subjekte të pa autorizuar dhe mbetje të rrezikshme që kërkojnë një trajtim të veçantë. Për sa më sipër depozitimi i mbetjeve dhe menaxhimi i landfillit nga Bashkia Libohovë dhe Ministria

e Turizmit dhe Mbetjeve nuk kryhet sipas specifikimeve të përcaktuara në ligjin nr. 10463, datë 22.09.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, i ndryshuar, dhe VKM nr. 452, datë 11.07.2012 “Për lëndfillet e mbetjeve”.

#### Bashkia Krujë

Nga vizita në terren, venddepozitimi i mbetjeve Bashkia Krujë, në prani të mbikëqyrësit të punimeve u konstatua se, hedhja e mbetje nuk kryhej në mënyrë të diferencuar ku në të kishte mbetje që kanë një jetëgjatësi shumë të madhe dekompozimi, goma makinash mbetje plastike si dhe mbetje inerte të cilat nuk janë parashikuar të depozitohen në këtë landfill. etj. Hedhja e mbetje që nga fillimi i depozitimit të tyre është kryer në mënyrë kaotike dhe jo me shtresa. Mbetjet nuk janë shpërndarë në mënyrë të njëtrajtshme dhe nuk janë ngjeshur e mbuluar me dhe çdo një metër lartësi për rrjedhojë në zonë përhapej një erë e keqe duke shkaktuar dëme në shëndetin publik. Porta e hyrjes dhe një pjesë e rrethimit ishte e dëmtuar dhe nuk krijonte një mbyllje të plotë të venddepozitimit. Gjithashtu jashtë rrethimit, në hyrjen e landfillit, kishte grumbuj të mbetjeve të cilat duhet të ishin në vend-depozitim. Mos kontrolli i hyrjes në venddepozitim bën të mundur hedhjen e mbetjeve nga subjekte të pa autorizuar dhe mbetje të rrezikshme që kërkojnë një trajtim të veçantë. Nga vetë mënyra e trajtimit të mbetje të pa ngjeshura dhe të pa mbuluara me dhe konstatohet se, jetëgjatësia e landfillit nuk do të jetë 5 vjet siç është parashikuar në projektim por për një kohë të shkurtër do të kërkojë një vend tjetër depozitimi i mbetjeve, e kështu investimi i kryer për të nuk ja ka arritur objektivit të parashikuar. Për sa më sipër depozitimi i mbetje dhe menaxhimi i landfillit nga Bashkia Krujë dhe Ministria e Turizmit dhe Mbetjeve nuk kryhet sipas specifikimeve të përcaktuara në ligjin nr. 10463, datë 22.09.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, i ndryshuar, dhe VKM nr. 452, datë 11.07.2012 “Për lëndfillet e mbetjeve”.

#### Bashkia Kukës

Nga vizita në terren, vend-depozitimi i mbetjeve Bashkia Kukës, në prani të mbikëqyrësit të punimeve u konstatua se gjeomembrana ishte e dëmtuar në disa vende dhe ishte e zhvendosur nga era. Nga ana e Bashkisë Kukës mbetjet urbane nuk depozitoheshin në të, vetëm në hyrje të saj kishte një sasi të vogël mbetjesh inerte të cilat bllokoni hyrjen e gropës. Dëmtimet kanë ardhur si rezultat i keq menaxhimit të investimit nga ana e përfituesit. Nga ana e Autoritetit kontraktor nuk ka një monitorim të situatës se ku depozitohen mbetjet urbane të kësaj bashkie. Ndërtimi i vend-depozitimit është kryer si rezultat i situatës emergjente të mbetjeve në bashkinë Kukës. Nisur nga fakti se ky vend-depozitim nuk është vendosur në shfrytëzim edhe pse ka kaluar një vit nga përfundimi i punimeve dhe marrjes në dorëzim tregon se, situata e mbetje në Bashkinë Kukës nuk ka qenë emergjente dhe investimi i kryer nuk ka qenë efikas. Për sa më sipër vlera e investimit prej 27,921,485 lekë pa TVSH, të kryer në vend-depozitim në Bashkinë Kukës, nga grupi i auditimit konsiderohet shpenzim pa ekonomikitet, efikasitet dhe efektivitet i fondeve publike deri në këtë fazë të menaxhimit të landfillit.

#### Konkluzion.

- Vend-depozitimi, në Bashkia Kukës nuk është në shfrytëzim pavarësisht se investimi është kryer në kushtet e emergjencës dhe shpenzimi i kryer deri në këtë fazë të auditimit konsiderohet shpenzim pa ekonomikitet, efikasitet dhe efektivitet i fondeve publike deri në këtë fazë të menaxhimit të tij. Në këto kushte vend-depozitimi mund të dëmtohet dhe do të kërkojë fonde shtesë në të ardhmen.
- Nisur nga gjendja faktike e vend-depozitimit të mbetjeve në Bashkinë Krujë konstatohet se mënyra e menaxhimit dhe trajtimi i mbetjeve në të ka sjellë që jetëgjatësia e tij të jetë më e vogël se 5 vjet e parashikuar në studim projektim. Mbyllja e landfillit para afatit të parashikuar do të kërkojë një studim dhe investim të ri për shmangien e ndikimeve të pa favorshme mjedisore dhe sociale.
- Menaxhimi i vend-depozitimeve nga ana e bashkive përfituese shumë i dobët dhe trajtimi i mbetjeve në to jo në përputhje me legjislacionin dhe rregullat në fuqi.

<b>2. Titulli i gjetjes:</b>	Vend-depozitimi i mbetjeve në Bashkinë Kukës i pa vendosur në shfrytëzim.
<b>Situata:</b>	Në kontratën me objekt <u>“Mbyllja, rehabilitimi i mbetjeve urbane nga venddepozitimet ekzistuese (Burrel, Kukës, Libohovë, Përmet, Krujë)”</u> nga verifikimi në venddepozitimin e Bashkisë Kukës mbetjet urbane nuk depozitoheshin në të, vetëm në hyrje të saj kishte një sasi të vogël mbetjesh inerte të cilat bllokonin hyrjen e gropës. Nga ana e Autoritetit kontraktor nuk ka një monitorim të situatës se ku depozitohen mbetjet urbane të kësaj bashkie pasi objekti është në periudhën e garancisë dhe nuk ka kaluar si investim kapital përfituesit. Ndërtimi i vend-depozitimit është kryer si rezultat i situatës emergjente të mbetjeve në bashkinë Kukës. Nisur nga fakti se ky vend-depozitim nuk është vendosur në shfrytëzim edhe pse ka kaluar një vit nga përfundimi i punimeve dhe marrjes në dorëzim tregon se, situata e mbetje në Bashkinë Kukës nuk ka qenë emergjente dhe investimi i kryer nuk ka qenë efikas. Për sa më sipër vlera e investimit prej 27,921,485 lekë pa TVSH, të kryer në vend-depozitimin në Bashkinë Kukës, nga grupi i auditimit konsiderohet shpenzim pa ekonomikitet, efikasitet dhe efektivitet i fondeve publike deri në këtë fazë të menaxhimit të landfillit.
<b>Kriteri:</b>	Ligji nr.10463, datë 22.09.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, i ndryshuar, dhe VKM nr. 452, datë 11.07.2012 “Për landfillet e mbetjeve”.
<b>Ndikimi/Efekti:</b>	Shpenzim pa ekonomikitet, efikasitet dhe efektivitet në vlerën 27,921,485 lekë pa TVSH.
<b>Shkaku:</b>	Mos vendosja në funksion e vend-depozitimit dhe investimi i kryer jo në kushtet e emergjencës siç është parashikuar.
<b>Rëndësia:</b>	E lartë.
<b>Rekomandimi:</b>	Ministria e Turizmit e Mjedisit në bashkëpunim Bashkinë Kukës të marrë masa të menjëhershme për verifikimin se ku depozitohen mbetjet urbane si dhe monitorimin e situatës se si menaxhohet trajtimi i tyre duke shmangur ndotjen e ambientit e ruajtjen e shëndetit publik.
<b>3. Titulli i gjetjes:</b>	Monitorim dhe menaxhim i dobët i venddepozitimeve nga Ministria e Mjedisit dhe Turizmit dhe bashkive përfituese.
<b>Situata:</b>	Në kontratën me objekt <u>“Mbyllja, rehabilitimi i mbetjeve urbane nga venddepozitimet ekzistuese (Burrel, Kukës, Libohovë, Përmet, Krujë)”</u> nga verifikimi në venddepozitime u konstatua se depozitimi i mbetjeve nuk kryhet në mënyrë të diferencuar ku në to kishte mbetje që kanë një jetëgjatësi shumë të madhe dekompozimi, goma makinash mbetje plastike si dhe mbetje inerte të cilat nuk janë parashikuar të depozitohen në këto landfille. etj. Hedhja e mbetje që nga fillimi i depozitimit të tyre është kryer në mënyrë kaotike dhe jo me shtresa. Mbetjet nuk janë shpërndarë në mënyrë të njëtrajtshme dhe nuk janë ngjeshur e mbuluar me dhe çdo një metër lartësi për rrjedhje në zonë përhapet erë e keqe duke shkaktuar dëme në shëndetin publik. Në raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (VNM) kapitulli 5, “Plani i menaxhimit social dhe mjedisor” janë parashikuar një sërë masash zbutëse, monitoruese dhe institucionale që duhen miratuar gjatë fazave të ndërtimit dhe <u>operimit</u> për të eliminuar ose zvogëluar ndikimet e pafavorshme mjedisore dhe sociale që dalin nga rehabilitimi i vend-depozitimit. Një nga masa është marrëveshjet institucionale, për të

	përfshirë përcaktimin e përgjegjësive për zbatimin dhe monitorimin e masave zbutëse siç është përcaktuar. Gjatë periudhës së garancisë së punimeve administrimi i vend-depozitimeve do të kryhej nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, deri në kalimin kapital të tyre, dhe operimi nga bashkitë përkatëse. Referuar VNM për menaxhimin social e mjedisit, MTM duhet lidhte një marrëveshje me institucionet (bashkitë përkatëse), duke përcaktuar përgjegjësitë gjatë fazës së operimit deri në transferimin e plotë të tyre tek përfituesit (bashkitë). Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion nuk gjenden gjurmë që kjo marrëveshje të jetë realizuar.
<b>Kriteri:</b>	Ligji nr. 10463, datë 22.09.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, i ndryshuar; VKM nr. 452, datë 11.07.2012 “Për landfille e mbetjeve” dhe Vlerësimin të Ndikimit në Mjedis (VNM) kapitulli 5, “Plani i menaxhimit social dhe mjedisit”.
<b>Ndikimi/Efekti:</b>	Jetëgjatësia e landfilleve mund të jetë më e vogël se ajo e parashikuar.
<b>Shkaku:</b>	Monitorim dhe menaxhim i dobët nga institucionet përkatëse.
<b>Rëndësia:</b>	E lartë.
<b>Rekomandimi:</b>	Ministria e Turizmit e Mjedisit në bashkëpunim me bashkitë të kryej vlerësimin e landfilleve për mënyrën e depozitimit të mbetjeve dhe përcaktimin e jetëgjatësisë e tyre për marrjen e masave pas mbylljes së tyre. Gjithashtu të kryhen trajnime për rritjen e kapaciteteve menaxhuese dhe mënyrën e trajtimit të mbetjeve në landfille, të bashkive përkatëse dhe atyre ku do të kryhen investime të reja.

<b>4. Titulli i gjetjes:</b>	Dëmtime të shtresave mbrojtëse sistemi i largimit të shllamit dhe rrethimi mbrojtës.
<b>Situata:</b>	Në kontratën me objekt <u>“Mbyllja, rehabilitimi i mbetjeve urbane nga venddepozitimet ekzistuese (Burrel, Kukës, Libohovë, Përmet, Krujë)”</u> nga verifikimi në venddepozitimet u konstatuan dëmtime të shtresave mbrojtëse dhe tubave të largimit të shllamit, konkretisht: Në Bashkinë Libohovë dhe Kukës u konstatua se gjeomembrana ishte e dëmtuar dhe ishte e zhvendosur nga era së bashku me shtresën e gjeotekstilit. Gjithashtu tubat e kullimit të llumit në bashkinë Libohovë ishin dëmtuar dhe nuk mund të kryenin funksionin për të cilin ishin vendosur. Shtresat mbrojtëse dhe sistemi i tubacionit për largimin e shllamit të dëmtuara nuk mund të kryejnë funksionin e tyre duke lejuar llumin të kontaminon terrenin përreth. Në Bashkinë Krujë një pjesë e rrethimit ishte e dëmtuar dhe nuk krijonte një mbyllje të plotë të vend-depozitimit dhe kjo bën të mundur hedhjen e mbetjeve nga subjekte të pa autorizuar dhe mbetje të rrezikshme që kërkojnë një trajtim të veçantë. Dëmtimet kanë ardhur si rezultat i keq menaxhimit të investimit nga ana e përfituesit.
<b>Kriteri:</b>	Ligji nr. 10463, datë 22.09.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, i ndryshuar, dhe VKM nr. 452, datë 11.07.2012 “Për landfille e mbetjeve”.
<b>Ndikimi/Efekti:</b>	Kontaminim i mjedisit si rezultat i dëmtimit të shtresave mbrojtëse.
<b>Shkaku:</b>	Menaxhim i dobët i vend-depozitimeve nga ana e bashkive përfituese.
<b>Rëndësia:</b>	E lartë.
<b>Rekomandimi:</b>	Ministria e Turizmit e Mjedisit në bashkëpunim me sipërmarrësin e punimeve të marrë masa për riparimin e shtresave mbrojtëse të dëmtuara, sistemet e kullimit duke shmangur kontaminimin e mjedisit përreth si

	dhe rrethimet e dëmtuara për parandalimin e hedhjes së mbetjeve jo të lejuara, për minimizimin e kostove na të ardhmen me rritjen e jetëgjatësisë së landfillleve.
--	--

**Ngarkohet me përgjegjësi Autoriteti Kontraktor, për mos ngritjen e grupeve të punës për monitorimin e landfillleve gjatë fazës së operimit në garancinë e punimeve deri në dorëzimin përfundimtar dhe kalimin kapital të investimit tek përfituesit, bashkitë. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me ligjin nr. 10463, datë 22.09.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, i ndryshuar, VKM nr. 452, datë 11.07.2012 “Për landfillet e mbetjeve” dhe VNM si pjesë e kontratës së zbatimit.**

**3. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për procedurën e prokurimit në objekt: “Shërbim riparimi dhe rivënia në punë e sistemeve dhe moduleve përbërëse të stacioneve të monitorimit të ajrit”, konstatohet:**

Të dhëna mbi objektin e prokurimit:

<b>Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Shërbim riparimi dhe rivënia në punë e sistemeve dhe moduleve përbërëse të stacioneve të monitorimit të ajrit”</b>			
<b>1. Lloji i Procedurës së Prokurimit</b> “E hapur” REF-44641-10-06-2022 Urdhri nr. 302, datë 05.10.2022	<b>1.1 Grupi i hartimit kriterëve kualifikuese</b> Urdhri me nr. 291, prot. 7065, datë 28.09.2022. R.B. R.L. I. H.	<b>2 Njësia e Prokurimit</b> R.B. R. L. I. H.	<b>3 Komisioni i Vlerësimit Ofertave</b> Urdhri nr. 303, prot. 7248/1, datë 05.10.2022; G.H. A. S. B. P.
<b>4. Fondi Limit (pa tvsh)</b> 31,458,720 lekë	<b>5. Oferta fituese (pa tvsh)</b> 31,130,000 lekë		<b>6. Diferenca me fondin limit (pa tvsh)</b> 328,720 lekë
<b>7/1 Data e hapjes së tenderit</b> Data 24.10.2022	<b>8. Burimi Financimit</b> Buxheti i Shtetit		<b>9. Operatorët Ekonomike</b> a) Pjesëmarrës në tender Numër 1
<b>7/2 Kohëzgjatja e kontratës 50</b> (pesëdhjetë) ditë duke filluar nga nënshkrimi i kontratës.			
<b>10. Ankimime:</b>	<b>11. Përgjigje Ankesës AK me:</b>		<b>12. Përgjigje Ankesës nga KPP</b>
<b>b. Zbatimi i Kontratës Prokurimit</b>			
<b>13. Lidhja e kontratës</b> Mes AK dhe OE fitues “K.” shpk është lidhur kontrata me nr. 7248/8, datë 07.11.2022.	<b>Zbatimi i kontratës:</b> Me urdhër shpenzimit nr. 687, datë 29.12.2022 është likuiduar OE në shumën 11,764,800 lekë duke i mbajtur 5% garanci punimesh në vlerën prej 619,200 lekë. Me urdhër shpenzimit nr. 688, datë 29.12.2022 është likuiduar OE në shumën 23,723,400 lekë duke i mbajtur 5% garanci punimesh në vlerën prej 1,248,600 lekë.		

**a-Nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit konstatohet:**

Nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit me shkresën nr. 3893/2, datë 20.07.2022 ,(prot., në MTM me nr. 4449/2, datë 21.07.2022) në vijim të shkresës së MTM me nr. 4449/1, datë 29.06.2022 është dërguar Raporti i përpiluar me datën 26.04.2022, në të cilën është përcaktuar gjendjen e pajisjeve të stacionuara në rrethet Durrës, Elbasan, Fier Tiranë, Korçë dhe stacioni i lëvizshëm makinë, pas një ekspertize të gjendjes fizike dhe funksionale, dhe kapaciteteve për çdo pajisje të realizuar nga AKM.

Me shkresën nr. 6943, datë 22.09.2022 ‘Kërkesë për ekspertë të jashtëm’ MTM kërkon nga agjencia vënien në dispozicion të specialisteve në këtë fushë, me qëllim realizimin e procedurës “Shërbim riparimi dhe rivënia në punë e sistemeve dhe moduleve përbërëse të stacioneve të monitorimit të ajrit”.

AKM me shkresën nr. 7409/1, datë 23.09.2022 (prot., në MTM me nr. 6943/1, datë 26.09.2022) vë në dispozicion dy specialistët I.H dhe B.P.

Me urdhrin e Sekretarit të Përgjithshëm Znj. L. B. A. me nr. 291, prot., nr. 7065, datë 28.09.2022 ngrihet komisioni i përllogaritjes së fondit limit dhe hartimin e specifikimeve teknike me anëtar R. Bi, R. L dhe . H.

Me shkresën nr. 7065/1, datë 03.10.2022 nga MTM i është dërguar tre OE, "E." shpk; "K." shpk dhe "I." shpk ftesa për ofertë bazuar në nenit 34 dhe 36 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", ku bashkëlidhur janë vënë dhe specifikimet teknike dhe preventivat e shërbimit që do të prokurohen.

Tre OE kanë dorëzuar ofertat e tyre:

"E." shpk dërguar me shkresën datë 04.10.2021 me vlerën 31,380,160 lekë pa TVSH.

"K." shpk dërguar me shkresën me nr 246, datë 04.10.2021 (prot ne MTMT me nr. 7065/2, datë 04.10.2022) me vlerën 30,930,000 lekë pa TVSH.

"I." shpk dërguar me shkresën datë 04.10.2021 me vlerën 32,066,000 lekë pa TVSH.

Nga komisioni është mbajtur procesverbali me nr. 7247, prot., datë 05.10.2022 mbi përllogaritjen e fondit limit dhe hartimin e specifikimeve teknike.

- Me urdhrin e prokurimit të Sekretarit të Përgjithshëm Znj. L. B.A. me nr. 302, prot., 7048, datë 05.10.2022, urdhërohet të kryhet prokurimi i fondit prej 31,458,720 lekë pa TVSH, me objekt "Shërbim riparimi dhe rivënia në punë e sistemeve dhe moduleve përbërëse të stacioneve të monitorimit të ajrit" dhe ngarkohet njësia e prokurimit e përbërë nga R. B, R.L dhe I.H.

Me urdhrin nr. 303, prot., 7248/1, datë 05.10.2022, ngrihet Komisioni i vlerësimit të ofertave me anëtar, G. H, A. S dhe B. P.

*Nga auditimi i Dokumenteve të Tenderit nëpërmjet dosjes fizike dhe sistemit të prokurimit elektronik (SPE) rezultoi:*

Nga NJP është mbajtur procesverbali me nr. 7248/2 datë 06.10.2022, për miratimin e dokumenteve standard të tenderit dhe procesverbali me nr. 7248/3, datë 06.10.2022 mbi argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim.

Me datën 10.11.2022 nga koordinimi APP janë dërguar rekomandime në lidhje me dokumentet e tenderit.

Me memon nr. 7421, datë 13.10.2021 drejtuar SP nga znj. R.L kërkohet pezullimi i procedurës së prokurimit, me qëllim reflektimin e rekomandimeve të APP.

Me urdhëron nr. 309, prot., 7421/1, datë 13.10.2022 të Titullarit të AK bëhet pezullimi i procedurës prokurimit deri në shqyrtimin e rekomandimeve të dërguara nga Drejtoria e Koordinimit të APP.

NJP pas shqyrtimit të rekomandimeve ka mbajtur procesverbalin me datën 13.10.2022 dhe mbështetur në nenin 75, pika 2 të Ligjit nr. 162/2020, "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, njofton Modifikimin e dokumentacionit standard të procedurës së prokurimit me Shtojcë 1. DST me nr. 7421/2, datë 13.10.2022 dhe konkretisht: kriteret e përcaktuar në Shtojcën 8, pika 2 "Kriteret e veçanta të kualifikimit", pika 2.3.2 " Personeli Kryesor", modifikohet si mëposhtë:

**Ishte:**

**- Inxhinier elektrik/elektronik (ose ekuivalent) - 2 (dy)**

Inxhinierët duhet të jenë të certifikuar/trajnuar për servisin e pajisjeve objekt prokurimi, të vërtetuar nëpërmjet çertifikatës/çertifikatave të trajnimit të lëshuara nga kompani prodhuese të stacioneve të monitorimit apo moduleve përbërës të tyre.

**Bëhet:**

**- Inxhinier elektrik/elektronik (ose ekuivalent) - 2 (dy)**

Inxhinierët duhet të jenë të certifikuar/trajnuar për servisin e pajisjeve objekt prokurimi, të vërtetuar nëpërmjet çertifikatës/çertifikatave të trajnimit të lëshuara nga kompani prodhuese të stacioneve të monitorimit apo moduleve përbërës të tyre *dhe/ose çertifikime ekuivalente të lëshuar nga autoritete të autorizuar/çertifikuara për dhënien e tyre.*

Me urdhrin e Titullarit të AK nr. 310, prot., 7421/3, datë 13.10.2022 urdhërohet heqja e pezullimit

të procedurës së prokurimit dhe vijimi me hapat e mëtejshëm.

### ***b-Në lidhje me vlerësimin e ofertave nga KVO.***

Në procedurën e prokurimit kanë marrë pjesë 1 OE. KVO-ja.

Nr	Shoqëria OE/BOE	Oferta Lekë PA TVSH	S'kualifikuar/ Kualifikuar
1	"K." shpk	31,130,000	Kualifikuar/ Fituesi

Pas vlerësimit të ofertës, KVO ka mbajtur procesverbalin me nr. 2, datë 25.10.2021, ku referuar procesverbalit dhe njoftimit të fituesit është kualifikuar si ofertë e suksesshme OE **"K." shpk**.

Nga KVO-ja është mbajtur raporti përmbledhës me nr. 7248/7, datë 01.11.2022

- Me raportin përmbledhës nr. 7248/7, datë 01.11.2022, miratohet procedura nga titullari i AK, Znj. L. B. A, ku është shpallur fitues OE "K." shpk.

Formulari i njoftimit të fituesit është publikuar me datën 28.10.2022, prot., nr. 7248/5, datë 28.10.2022.

Me shkresën nr. 269, datë 27.10.2022 (prot., 7761, datë 27.10.2022) OE fitues ka depozituar dokumentacionin fizik të tenderit, ku nga KVO është mbajtur procesverbali i pranimit të dokumentacionit.

Mes AK dhe OE fitues "K." shpk është lidhur kontrata me nr. 7248/8, datë 07.11.2022.

Njoftimi i kontratës së nënshkruar është firmosur me shkresën nr. 7248/11, datë 09.11.2022 dhe ngarkuar me darën 10.11.2022.

Me shkresën nr. 7248/10, datë 07.11.2022 është hartuar planit i zbatimit të kontratës.

Me shkresën nr. 8272, datë 10.11.2022 është dërguar në APP raporti i planit të zbatimit të kontratës.

### ***c. Mbi zbatimin e kontratës.***

Me urdhrin nr. 342 prot., 7248/9, datë 07.11.2022, i ndryshuar me urdhrin nr. 369 prot., 3789, datë 24.11.2022 është ngritur grupi i punës për ndjekjen e ecurisë së zbatimit të kontratës dhe marrjen në dorëzim të shërbimit me anëtar K.Ç, I. H dhe B. P.

Nga komision është mbajtur procesverbali me datë 22.12.2022 dërguar në MTM me shkresën nr. 10226/1, datë 23.12.2022 (prot., 9468, datë 23.12.2022) mbi marrjen në dorëzim të *"Shërbim riparimi dhe rivënia në punë e sistemeve dhe moduleve përbërëse të stacioneve të monitorimit të ajrit"*, dorëzuar nga OE me faturën nr. 1972 datë 22.12.2022. Me urdhër shpenzimin nr. 687, datë 29.12.2022 është likuiduar OE në shumën 11,764,800 lekë duke i mbajtur 5% garanci punimesh në vlerën prej 619,200 lekë.

Nga komision është mbajtur procesverbali me datë 27.12.2022 dërguar në MTM me shkresën nr. 10262/1, datë 28.12.2022 (prot., 9534, datë 28.12.2022) mbi marrjen në dorëzim të *"Shërbim riparimi dhe rivënia në punë e sistemeve dhe moduleve përbërëse të stacioneve të monitorimit të ajrit"*, dorëzuar nga OE me faturën nr. 1978, datë 27.12.2022. Me urdhër shpenzimin nr. 688, datë 29.12.2022 është likuiduar OE në shumën 23,723,400 lekë duke i mbajtur 5% garanci punimesh në vlerën prej 1,248,600 lekë.

<b>Titulli i Gjetjes:</b>	Mbi marrjen në dorëzim te mallrave/shërbimeve /punëve.
<b>Situata</b>	Nga auditimi mbi marrjen në dorëzim te mallrave/shërbimeve u konstatua se: Komisioni i marrjes në dorëzim mallrave/shërbimeve ka hartuar procesverbalin e marrjes në dorëzim por plotësimi i tij është thjesht formal, duke ju referuar faturës dhe kontratës pa një përshkrim të hollësishëm të mallrave/shërbimeve të marra në dorëzim. Nga komisioni është mbajtur një procesverbal për të gjitha stacionet e monitorimit, të cilat ndodhen në vende të ndryshme si rrjedhojë procesverbalet nuk janë mbajtur mbi verifikimin fizik në vend të këtyre stacioneve . Nga komisioni i marrjes në dorëzim nuk është argumentuar

	se pajisjet e sjella nga OE m për secilin stacion janë në përputhje me ato të ofertuara, pra nga prodhuesit për të cilin OE ka autorizimin e paraqitur në fazën e tenderimit si dhe nëse mallrat/punët janë brenda specifikimeve teknike të kërkuara në DT dhe në kontratën e lidhur. Marrja në dorëzim e shërbimit është bazuar vetëm në raportin teknike të paraqitur nga OE “K.” shpk, veprim në kundërshtim me UMF nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pika 42 ku citohet se “Titullari i njësisë miraton urdhrin për ngritjen e komisionit për marrjen në dorëzim të aktiveve <i>te furnizuara për sasinë, cilësinë, llojin, plotësinë e tyre dhe te dokumentacionit shoqërues</i> ”.
<b>Kriteri:</b>	UMF nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pika 43.
<b>Ndikimi/Efekti:</b>	Mosverifikimi analitik i mallrave/shërbimeve /punëve të marra në dorëzim,, ndikon në mungesës e sigurisë që cilësia e mallrave është e njëjtë me cilësinë e premtuar në ofertë.
<b>Shkaku:</b>	Mosdokumentimi i procesit të punës nga komisioni i marrjes në dorëzim.
<b>Rëndësia:</b>	E mesme
<b>Rekomandim:</b>	Komisionet e marrjes në dorëzim mallrave/shërbimeve/punëve të ngritura nga Titullari i Institucionit të marrin masa në vijimësi që procesverbalet e mbajtura për marrjen në dorëzim të mallrave/shërbimeve /punëve të jenë të detajuara sipas kërkesave të përcaktuara në DST dhe në kontratën e lidhur mes AK, dhe OE fitues, me qëllim evidentimin e realizimit të kontratës sipas kërkesave dhe cilësisë së kërkuar nga AK.

4. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për procedurën e prokurimit në objekt: **“Rehabilitimi i shesheve dhe zonave kryesore në afërsi të pikave doganore shqiptare”**, konstatohet:

Të dhëna mbi objektin e prokurimit:

<b>Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Rehabilitimi i shesheve dhe zonave kryesore në afërsi të pikave doganore shqiptare”</b>			
<b>1. Lloji i Procedurës së Prokurimit</b> “Shërbim Konsulence” REF-20422-02-23-2022 Urdhri nr. 138, datë 14.06.2021	<b>1.1 Grupi i hartimit kritereve kualifikuese</b> Urdhri me nr. 76, datë 23.02.2022	<b>2 Njësia e Prokurimit</b> S. J R. L E.O	<b>3 Komisioni i Vlerësimit Ofertave</b> Urdhri nr. 79, prot., 2313, datë 23.02.2022; R. M, Y. H K.T
<b>4. Fondi Limit (pa tvsh)</b> 12,535,001 lekë	<b>5. Oferta fituese (pa tvsh)</b> 12,480,000 lekë		<b>6. Diferenca me fondin limit (pa tvsh)</b> 53,001 lekë
<b>7/1 Data e hapjes së tenderit</b> Data 15.03.2022	<b>8. Burimi Financimit</b> Buxheti i Shtetit		<b>9. Operatorët Ekonomike</b> a) Pjesëmarrës në tender Numër <b>12</b> b) S’kualifikuar 11 OE, c) Kualifikuar 1 OE
<b>7/2 Kohëzgjatja e kontratës, 120 dite</b>			
<b>10. Ankimime</b>	<b>11. Përgjigje Ankesës AK me:</b>		<b>12. Përgjigje Ankesës nga KPP</b>
<b>b. Zbatimi i Kontratës Prokurimit</b>			
<b>13. Lidhja e kontratës</b> Është lidhur lidhur kontrata me nr. 2144/10 datë 09.06.2022, mes AK dhe OE fitues “A.” shpk.	<b>Zbatimi i kontratës:</b> Me urdhër shpenzimit nr. 489 datë 10.10.2022 është likuiduar OE për shumën 5,980,400 lekë bazuar në faturën me nr. 171, datë 23.09.2022. Me urdhër shpenzimit nr. 607, datë 07.12.2022 është likuiduar OE për shumën 8,985,600 lekë bazuar në faturën me nr. 242, datë 02.12.2022.		



### **a-Nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit konstatohet:**

Me memon nr. 7980, datë 14.10.2021 përgatitur nga z. E.O, specialist Drejtoria e politikave dhe strategjive të zhvillimit të turizmit, drejtuar Ministrit dhe SP kërkon nevoja për ri-kualifikimin e pikave hyrëse tokësore, detare, ajrore dhe korridoreve lidhëse me territorin e Republikës së Shqipërisë.

#### ***Në memo citon se:***

Në këto pika, përgjatë viteve të fundit, janë bërë investime për përmirësimin e infrastrukturës fizike të pikave të kalimit kufitar (tokësore, detare e ajrore), përmirësimin e procedurave për të zvogëluar ndjeshëm kohën e pritjes në kufi, si edhe janë trajnuar në vazhdimësi kapacitetet njerëzore për të ofruar shërbim me të mire dhe të shpejtë.

Duke i konsideruar pikat e kalimit kufitar si korridore mikpritjeje dhe përcjelljeje, duke synuar transmetimin e do elementi, mesazhi apo vlere që përshkohet nga ngjyra të mikpritjes shqiptare apo të politikave shtetërore në turizëm vlerësojmë nevojën për të ndërmarrë nisma që lidhen me përmirësimin e infrastrukturës fizike apo shërbimeve.

Ne këtë kuadër, propozojmë iniciativa për rikualifikimin e korridoreve hyrëse e dalëse në pikat kufitare tokësore, detare e ajrore, në gjatësi kalimi që mund të shkoj 1-2 km, në varësi të pikës kufitare, duke iu dhënë përparësi korridoreve që të çojnë drejt portave me fluksin me të lartë të kalimeve.

Propozojmë që iniciativa për rikualifikimin e korridoreve të përfshijë disa elementë thelbësorë, të cilët do t'i plotësojnë korridoret me mjetet e munguara për të komunikuar më mirë me kalimtarët, do t'i njësojnë kundrejt njëra-tjetrës, do t'i thjeshtojnë nga pikëpamja vizuale, do t'i bëjnë ato më të sigurta për këmbësoret, çiklistet, apo përdoruesit e makinave dhe do t'i kthejnë nga rruge lidhëse në korridore të përjetimit pozitiv të asaj që po vjen apo të asaj që u vizitua.

Sugjerojmë të ri-projektohet seria e tabelave mikpritëse, informuese e përcjellëse, pas daljes nga pikat e kalimit, në krye dhe përgjakte korridoreve të kalimit, të cilat nëpërmjet tekstit, simboleve dhe imazheve duhet të japin mbi të gjitha mesazhe të kujdesit që shteti dhe shoqëria shqiptare ofrojnë për miqtë, si edhe mesazhe orientimi për t'i ndihmuar ata të ndërtojnë eksperiencat e tyre. Tabelat mikpritëse të të gjitha korridoreve duhet të projektohen për të qene të ngjashme dhe me elementët dallues që i lidhin me vendin specifik ku do të vendosen.

Rruga e kalimit është pjese shume e rëndësishme e korridorit hyrës apo dalës nga kufiri, e cila ka një fasade horizontale dhe fasadat rrethuese vertikale. Sipërfaqja horizontale e rrugës duhet të trajtohet për të bërë edhe një organizim shumë të mirë të kalimit, duke mbajtur parasysh mjetet dhe përdoruesit e ndryshëm, në mënyre që secili të ketë hapësirën e tij të dedikuar. Kjo behet edhe me e rëndësishme për të promovuar gjithashtu përdorimin e biçikletave, mjeteve me impakt minimalisht në natyrë dhe standardet për ndërtimin e korridorit shqiptar të EUROVELO 8.

Ndriçimi i korridoreve hyrëse apo dalëse nga kufiri është element tjetër tepër i rëndësishëm, cili duhet të trajtohet në iniciativën ri-kualifikuese, atje ku ai mungon apo është i papërshtatshëm.

Gjithashtu propozojmë që korridoret të pajisen me element të peizazhit natyror të gjelbëruar, si gjelbërimi i ulet dhe peme të larta për hijezim, unifikim të fasadës së rrugës, krijimin e një ritmi të qete e natyror që qetëson shqisat dhe shkarkon lodhjen e një udhëtimi të gate apo të një kalimi doganor në raste fluksi.

Në përfundim, theksojmë se rikualifikimi i korridoreve hyrëse e dalëse nga pikat kufitare tokësore, detare e ajrore, do të përmirësonte ndjeshëm sigurinë në rruge dhe korridore kalimi, ndriçimin dhe për gjelbërimin e tyre, unifikimin e fasadës së korridoreve, komoditetin e lëvizjes, komunikimin e informacioneve dhe mesazheve gjë u vlejnë udhëtareve dhe ju ofrojnë një përjetim pozitiv rreth mikpritjes së shqiptarëve.

Për të realizuar një vlerësim të përgjithshëm teknik e financiar të kësaj ndërhyrjeje është i nevojshëm, vendosja e një bashkëpunimi me institucionet publike të specializuara si Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit dhe Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore, etj., e me pas për të siguruar finalizimin e procesit, projektit dhe të projektit të zbatimit, angazhimi në një

skadër i ekspertëve të komunikimit grafik, arkitektëve, arkitektëve të peizazhit, inxhinierëve të ndriçimit në bashkëpunim me specialiste të institucioneve publike do të ishte domosdoshëm.

Vlerësimi i përgjithshëm financiar do të mundësonte përfshirjen e fondeve të nevojshme për përgatitjen e projektit dhe zbatimin, në projektin buxhetin për vitin 2021, në Programin "Zhvillimi i Turizmit".

Me memon nr. 7280/1, datë 18.10.2021 përgatitur nga z. M. H, përgjegjës Sektorit të përgatitjes dhe fizibilitetit të projekteve të zhvillimit turistik e politikave dhe strategjive të zhvillimit të turizmit, drejtuar Ministrisë dhe Sekretariatit të përgjithshëm z. A.D. informojnë në lidhje me bashkëpunimin e institucioneve publike të specializuara si Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit dhe Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore, për vlerësimin e përgjithshëm teknik e financiar të kësaj ndërhyrjeje, të cilët kanë hartuar preventivin paraprak të punimeve dhe llogaritjet vlerën e përafërt për hartimin e projektit zbatimit.

Mbi bazën e këtyre dokumentacioneve drejtorja e konceptimit dhe fizibilitetit të projekteve të turizmit ka hartuar "Formularin e propozimit të projektit" për alokimin e fondeve të nevojshme në buxhetin e MTM-së për hartimin e studimit të projektit të zbatimit "Shërbim Konsulencë" me qëllim realizimin e këtij projekti.

***Fishat e planifikimit për PBA 2022-2024 për këtë projekt janë përgatitur në datë 18.10.2021.***

***Sa më sipër ky projekt është planifikuar pa pasur një studim paraprak dhe arsye se pse është futur si prioritet për vitin 2022.***

Me urdhrin nr. 10, prot., 160 datë 13.01.2022, ngrihet Komisioni për hartimin e detyrave të projektimit me anëtar, A. B, D. P dhe M H.

Me memon nr. 160/1, datë 24.01.2022 është dorëzuar "Detyra e projektimit/ Termave të referencës" për realizimin e projektit "Rehabilitimi i shesheve dhe zonave kryesore në afërsi të pikave doganore shqiptare".

- Me urdhrin e prokurimit të znj. L.B.A., Sekretare e Përgjithshme me nr. 76, prot. 2144, datë 23.02.2022, urdhërohet të kryhet prokurimi i fondit prej 12,535,001 lekë pa TVSH, me objekt "Rehabilitimi i shesheve dhe zonave kryesore në afërsi të pikave doganore shqiptare", dhe ngarkohet njësisë e prokurimit e përbërë nga S. J, E. O dhe R. L.

Nga komisioni është mbajtur procesverbalin me datë 24.02.2022 mbi argumentimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim.

#### ***Konstatim:***

Me datën 23.02.2022 është bërë përllogaritja e fondit limit nga komisioni i ngritur me urdhrin nr. 76, prot. 2144, datë 23.02.2022, ku në urdhër është përcaktuar dhe fondi limit i përllogaritur.

Pra, AK nuk ka ngritur komision për përllogaritjen e fondit limit.

Sa më sipër veprime në kundërshtim me pikën 2 të nenit 76 "Mënyrat për përllogaritjen e vlerës së prokurimit" ku citohet se "Autoriteti/enti kontraktor, përpara nxjerrjes së urdhrin të prokurimit, duhet të argumentojë dhe të dokumentojë përllogaritjen e vlerës së kontratës, bazuar në specifikimet teknike të objektit që prokurimet". Në procesverbalin i mbajtur nga komisioni nuk është bërë asnjë argumentim në lidhje me klasifikimet e objektit, si dhe mënyra se si është bërë ndarja e kostos për strukturën e jashtme dhe kostoja për ndërtesën dhe ndarja funksionale e tyre, mbi të cilën është llogaritur dhe një kosto shtese prej 50%.

Në nenin 29 dhe 31 të VKM-në nr. 354, datë 11.05.2016 "Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikimin e territorit, projektimit, mbikëqyrjes dhe kolaudimit" është bërë ndarja sipas grupeve tarifore.

**Nga auditimi i përllogaritjes së fondit limit konstatohet se mungojnë sqarimet në lidhje me vlerën:**

- 172,864,693 lekë për koston e llogaritshme të strukturave në ambientet e jashtme;

- 115,234,429 lekë për koston e llogaritshme të grupeve tarifore për ndërtesat dhe ndarjet funksionale të brendshme, pasi bazuar në zërat e projektimit vlerat e llogaritur nuk përputhen.

Vlera e projektimit është përcaktuar në vlerën e përllogaritur të ndërtimit prej 287,989,279 lekë pa tvsh e përgatitur nga Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit dërguar me e-mail me datën

18.10.2021.

AKPT sqaron se përlllogaritja e vlerës është bazuar në VKM-në nr. 629, datë 15.7.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre” (Ndryshuar me VKM nr. 631, datë 26.10.2018). Vlera e përafërt e hartimit të projekt zbatimit është në vlerën 24,240,000 lekë bazuar në VKM-në nr. 354, datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikimin e territorit, projektimit, mbikëqyrjes dhe kolaudimit”.

Me urdhrin nr. 79, prot., 2313 datë 23.02.2022, ngrihet Komisioni për vlerësimin e ofertave me anëtar, R. M., Y.H. dhe K. T.

Nga NJP është mbajtur procesverbali me nr. 2144/1, datë 24.02.2022, mbi argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim të procedurës.

Me shkresën nr. 2144/2, datë 24.02.2022 është bërë njoftimi i shkurtuar i kontratës.

Me datën 28.02.2022 nga OE nëpërmjet SPE ka ardhur një kërkesë për sqarim në lidhje me kriterin 2.3.2 të shtojcës 11 te DT.

Me memon nr. 2508, datë 01.03.2022 nga NJP është kërkuar pezullimi i procedurës së prokurimit. Me urdhrin e titullarit të AK nr. 87, datë 01.03.2022 është bërë pezullimi i procedurës së prokurimit.

Nga NJP është bërë ndryshimi i **2.3.2 Personeli Kryesor**

**Ishte: Inxhinier Mjedisi – 1 (një)**

Kualifikimet dhe aftësitë;

- Diplomë universitare në Inxhinierinë elektrike.
- License projektimi
- Të ketë përvoja të mëparshme në projektim, të ngjashme me kontratën e propozuar.

**Bëhet : Ekspert Mjedisi – 1 (një)**

Sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 10 440, datë 7.7. 2011 “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedisi”, të ndryshuar.

Kualifikimet dhe aftësitë;

- Certifikatë Ekspert Mjedisi
- Të ketë përvoja të mëparshme në projektim, të ngjashme me kontratën e propozuar.

Me urdhrin e titullarit të AK nr. 88, datë 01.03.2022 është bërë heqja e pezullimit të procedurës së prokurimit.

Koordinatori i APP me datën 01.03.2022 në e-mailin e dërguar i kërkon AK që për pikën **2.3.2**

*Listë e personelit kryesor të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit, shoqëruar me CV-të e tyre dhe licencat profesionale sipas kategorive të përcaktuara më poshtë, kontratat e shërbimit/ bashkëpunimit ose kontratat individuale të punës konkretisht pika.*

- Të ketë përvoja të mëparshme në projektim dhe si drejtues grupi të ngjashme me kontratën e propozuar.

*APP kërkon shmangien e këtij përcaktimi pasi i kriteri për përvojën e mëparshme është përcaktuar në pikën 2.3.2 të kapacitet teknike Në procedurë janë evidentuar dhe kritere të veçanta të cilat konsiderohen në mënyrë direkte ose indirekte, që mund të sjellin kufizime e pjesëmarrjes së OE, ofertues të mundshëm*

**Pika 3. PROJEKTUES KONSTRUKTOR**

a) Objekte civile - industriale – turistike prej murature e skelet beton arme deri në 5 kate.

Pika 3.3 “Operatori Ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij të paktën 8 (tetë) punonjës për muajin Janar 2022.....” nga natyra e objektit të prokurimit është e numër i lartë dhe nëse qëndron AK duhet të mirë argumentojë atë dukë e mbajtur në konsideratë përcaktimet e nenit 77 pika 1 e LPP dhe pikës 2 neni 41 të VKM-së 285 datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

**Konstatim:**

Nga sa më sipër konstatohet se *kriteret e vendosura dhe të kërkuara nga AK nuk janë të*

**argumentuar. NJP është mjaftuar vetëm me citimin e bazës ligjore,** veprime në kundërshtim të VKM-së 285 datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” pika 2 e nenit 78 “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit” ku citohet se “Në çdo rast, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërish, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre. Ky procesverbal i vihet në dispozicion personit/ave”.

**b-Në lidhje me vlerësimin e ofertave nga KVO.**

Me datën 15.03.2021, nga KVO është mbajtur procesverbali nr. 1 i hapjes së fazës së shqyrtimit të kualifikimit të kandidatëve që kanë shprehur interes.

Me datën 25.03.2021, nga KVO është mbajtur procesverbali nr. 2 i hapjes së fazës së shqyrtimit të kualifikimit të kandidatëve që kanë shprehur interes, ku nga 12 OE që kanë marrë pjesë janë skualifikuar:

1. “A.” shpk; Gj.” shpk; “G.” SHPK; “I. C. E” SHPK ; “T” shpk: “N.G.” SHPK; “S.R.” shpk ; “T.” SHPK me arsyetimin:

Në fazën e parë të procedurës, nuk kanë dorëzuar dokumentacionin e kërkuar nga Autoriteti Kontraktor për plotësimin e të gjithë 1. Kriteret e Përgjithshme të Pranimit/Kualifikimit dhe 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, sipas Shtojcës 11, konkretisht pika 2.3 Kapaciteti Teknik, si mëposhtë:

OE nëpërmjet dokumentacionit të dorëzuar, nuk kanë dëshmuar të ketë shërbime të ngjashme të realizuara gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, me vlerë jo më të vogël se 40 % e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se eksperiencat e paraqitura nga operatori ekonomik në sistemin e prokurimit elektronik nuk përmbushin pikën 2.3 Kapaciteti teknik, përvoja të mëparshme të ngjashme me objektin e prokurimit dhe/ose shërbimet e ngjashme me fushat përkatëse të ekspertizës, pjesë e objektit të prokurimit.

- “A. D. Ch.” shpk

Operatori ekonomik është skualifikuar në fazën e parë të procedurës, pasi nuk ka dorëzuar dokumentacionin e kërkuar nga Autoriteti Kontraktor për plotësimin e të gjithë 1. Kriteret e Përgjithshme të Pranimit/Kualifikimit dhe 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, sipas Shtojcës 11, konkretisht si më poshtë:

OE ka dorëzuar vetëm një Licencë Kodi II.8.B, që nuk bën pjesë te kriteret e kërkuara nga AK.

- “I.P.” SHPK.

Operatori ekonomik është skualifikuar në fazën e parë të procedurës, pasi nuk ka dorëzuar dokumentacionin e kërkuar nga Autoriteti Kontraktor për plotësimin e të gjithë 1. Kriteret e Përgjithshme të Pranimit/Kualifikimit dhe 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, sipas Shtojcës 11, konkretisht Sigurimin e ofertës, Pika 2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar, pika 2.3 Kapaciteti Teknik, si më poshtë:

-OE nëpërmjet dokumentacionit të dorëzuar, nuk ka paraqitur formularin e sigurimit të ofertës, sipas Shtojcës 5.

-OE nëpërmjet dokumentacionit të dorëzuar, nuk ka paraqitur Vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2018, 2019, 2020 lëshuar nga Administrata Tatimore.

-OE nëpërmjet dokumentacionit të dorëzuar, nuk ka dëshmuar të ketë shërbime të ngjashme të realizuara gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, me vlerë jo më të vogël se 40 % e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet. Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se eksperiencat e paraqitura nga operatori ekonomik në sistemin e prokurimit elektronik nuk përmbushin pikën 2.3 Kapaciteti teknik, përvoja të mëparshme të ngjashme me objektin e prokurimit dhe/ose shërbimet e ngjashme me fushat përkatëse të ekspertizës, pjesë e objektit të prokurimit.

Operatorët ekonomikë të kualifikuar në përfundim të fazës së parë të procedurës janë “A.” shpk dhe “I.D.” shpk.

Me shkresën nr. 2144/3, datë 05.04.2022 dërguar "I.D. – A." shpk dhe shkresën nr. 2144/4, datë 05.04.2022 dërguar "A. 4" shpk është kërkuar paraqitja e propozimit brenda datës 26.04.2021. Nga KVO është mbajtur procesverbalin nr. 3, datë 26.04.2022 ku është bërë hapja e propozimit teknik në prani të gjithë anëtarëve.

KVO me datën 10.05.2021 ka mbajtur procesverbalin nr. 4, ku është bërë vlerësimi i propozimit teknik të OE.

Me shkresën nr. 2144/5, datë 10.05.2022 është njoftuar OE "I. D.- A." shpk për s'kualifikimin nga procedura për arsye se nga vlerësimi i propozimit teknik të dorëzuar nuk është arritur të marrë pikët minimale dhe nuk i plotëson kërkesat për propozim.

Me shkresën nr. 2144/6, datë 10.05.2022 është njoftuar OE "A." shpk, për të vijuar procedurën si OE i kualifikuar në këtë fazë.

Me shkresën nr. 2144/7, datë 18.05.2022 drejtuar OE "A." shpk fton operatorin për paraqitjen pranë ambienteve të ministrisë për hapjen e ofertës ekonomike me datë 20.05.2022.

Nga KVO është mbajtur procesverbali nr. 5, datë 20.05.2022 në të cilën argumenton hapjen e ofertës ekonomike të dorëzuar nga "A." shpk në vlerën prej 12,480,000 lekë pa tvsh e shoqëruar dhe me sigurimin e ofertës.

KVO me datën 17.09.2021 ka mbajtur procesverbalin nr. 6, ku është bërë vlerësimi pikësor mbi OE duke marrë në konsideratë vlerësimin e propozimit teknik dhe ofertës ekonomike, nga ku rezultoi se "A." shpk është shpallur fitues.

Nr.	Shoqëria	Oferta Leke PA TVSH	Vlerësimi teknik	Vlerësimi ekonomik	Pikëzimi
1	"A." shpk	12,480.000	90.2*0.8	100*0.2	92
2	"I. D. – A." shpk	12,480.000	49*0.8	100*0.2	39.2

### **Konstatim:**

Nga komisioni i vlerësimit është bërë vlerësim pikësor për OE "ID.– A." shpk, i cili nuk ka kaluar fazën e dytë të vlerësimit. Ku është marrë vlera e ofertës ekonomike, kur subjektit nuk i është kërkuar paraqitja e ofertës ekonomike.

Formulari i njoftimit të fituesit është publikuar me datën 27.05.2022, prot., nr. 2144/8 datë 26.05.2022.

Me shkresën nr. 4193, datë 24.05.2022 (prot., 4499, datë 24.05.2022) OE fitues ka depozituar dokumentacionin fizik të tenderit, ku me datë 30.09.2021, nga KVO është mbajtur procesverbali i pranimit të dokumentacionit me datën 24.05.2022.

Me shkresën nr. 2144/8, datë 26.05.2022 është publikuar formulari i njoftimit të fituesit.

Nga KVO-ja është mbajtur raporti përmbledhës me nr. 2144/9, datë 06.06.2022

- Me raportin përmbledhës nr. 2144/9, datë 06.06.2022, miratohet procedura nga titullari i AK znj. L.B. A, ku është shpallur fitues OE "A." shpk.

Mes AK dhe OE fitues "A." shpk është lidhur kontrata me nr. 2144/10 datë 09.06.2022.

Me urdhrin e Titullarit të AK nr. 182, prot., 2144/11 datë 09.06.2022 është ngritur grupi i punës për marrjen në dorëzim të shërbimit e anëtar D.P, E. F dhe Dh. L.

Njoftimi i kontratës së nënshkruar është firmosur me shkresën nr. 2144/12, datë 10.06.2022 dhe ngarkuar me datën 13.06.2022.

Me shkresën nr. 2144/14, datë 13.06.2022 është dërguar në APP raporti i planit të zbatimit të kontratës nr. 2144/13, datë 10.06.2022.

OE "A." shpk me shkresën nr. 4232 datë 15.06.2022 prot në MTM me nr. 21445/15, datë 15.06.2022 kërkon që në zbatim të nenit 6 'Kushtet e veçanta' parashikohet që: "Brenda 15 ditëve nga nënshkrimi i kontratës, Autoriteti Kontraktor duhet t'i sigurojë Kontraktuesit informacionin sipas pikës 6, paragrafi 6.2 i "Termave te Referencës".

Pika 6.2 e Termave te Referencës, parashikon që: Autoriteti Kontraktor nga ana e tij do të sigurojë:

- Kufirin e saktë të ndërhyrjes për secilën pikë doganore, nëse ka ndonjë ndryshim nga kufiri i përcaktuar në Termat e Referencës;
- Dokumentacionin e pronësisë për secilën pikë doganore (nëse është i disponueshëm);
- Rilevimin topografik për zonat në të cilat do të përqendrohet ndërhyrja;
- Komunikimin dhe bashkëpunimin në kohë me Autoritete të tjera lokale dhe qendrore për kërkesat dhe ndjekur hapat e planit të punës;
- Çdo informacion të kërkuar nga Konsulenti, në mënyre që të mundësohet përgatitja e një projekti cilësor;
- Vendimmarrje të shpejtë mbi çdo fazë të projektit;
- Bashkëpunim të vazhdueshëm me Konsulentin për çdo nevojë të zbatimit të projektit.

Bazuar në sa më lartë, për të vijuar me hartimin e projektit: "*Rehabilitimi i shesheve dhe zonave kryesore në afërsi të pikave doganore Shqiptare*", ju drejtojmë disa pyetje/ kërkesa për informacion, përgjigjet e të cilave do të na ndihmonin për të kuptuar më qartë situatën në tete pikat doganore që do të rijetëzohen.

Në mënyre që të kryejmë disa vizita dhe investigime të situatës së secilës pike doganore, ju lutemi na vini në dispozicion një person kontakti i cili do të na asistojë me aksesin në këto objekte si dhe informacione të nevojshme gjatë vizitave nëpër objekte.

Cilat janë kufizimet e sigurisë në pikat doganore dhe distancat apo llojet e ndërhyrjeve që mund të ndërmerren ose jo në afërsi të tyre?

Cilat janë periudhat me flukset më të mëdha të qarkullimit në secilën pikë doganore?

Sa kohë janë të detyruar udhëtarët të qëndrojnë në pritje gjatë këtyre periudhave?

A ka të dhëna mbi numrin e posteve të nevojshëm të parkimit në funksion të shërbimit doganor (institucioni, stafi, etj.), dhe posteve të parkimit në përdorim të qytetareve?

Hapësira ku strehohen qentë e kufirit është e domosdoshme të jete vizualisht e dukshme nga përdoruesit gjatë qarkullimit normal të tyre?

A ka protokolle të caktuara për kalimin në këto pika doganore të personave me rendësi të veçante (VIP), të cilat kërkojnë projektim specifik?

Cilat janë problematikat kryesore që punonjësit e pikave doganore kanë vënë re gjatë punës apo feedback që kanë marrë nga komunikimet me qytetarët?

MTM me shkresën nr. 2144/6, datë 21.06.2022 kthen përgjigje OE

- Porsa i përket periudhave me flukset më të mëdha të qarkullimit në secilën pikë doganore është periudha Qershor- Shtator.

- Vënia në dispozicion i personit të kontaktit si përfaqësues nga MTM.

- Bashkëlidhur është dokumentacioni mbi rivelimin topografik për zonat në të cilën do të përqendrohet ndërhyrja, **dokumentacion i cili nuk është bashkëlidhur dosjes së prokurimit.**

Sa me sipër, për mbarëvajtjen e punës dhe respektimin e afateve, do të luteshim nga ana juaj të na vini në dispozicion materialet e parashikuara në Nenin 6 "Kushtet e veçanta" të Kontratës, paragrafin 6.2 të Termave të Referencës, si dhe informacionet e mësipërme të kërkuara nga ana jone.

Nga DPD është dërguar shkresë me nr. 9728/1 datë 01.07.2022 drejtuar Autoritetit Portual dhe, për bashkëpunimin e tyre për realizimin e kontratës së lidhur mes MTM dhe OE "A." për "*Rehabilitimi i shesheve dhe zonave kryesore në afërsi të pikave doganore shqiptare*",

Me shkresës nr. 11691/1 datë 29.06.2022 drejtuar Degëve Doganore kërkon marrjen e masave që OE "A." të autorizohet dhe të operojë në këto zona.

MTM, me shkresës nr. 5140 datë 17.06.2022 drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë kërkohet aksesin i OE në korridoret hyrëse e dalëse pranë pikave doganore.

Nga subjekti është dërguar me shkresën nr. 4267, datë 08.07.2022 prot., MTM me nr. 5570, datë 08.07.2022 materiali i parashikuar për fazën e parë. Grupi i punës me memon nr. 5570/1 datë 18.07.2022 drejtuar Ministrisë dhe SP informo se nga OE është realizuar faza e parë dhe se vlerësojnë se materiali i dorëzuar është në përputhje me termat e referencës dhe planin e zbatimit

të kontratës.

Me shkresën nr. 4315, datë 18.08.2022 prot., MTM me nr. 6285, datë 18.08.202, nga OE "A." është dërguar materiali i parashikuar për fazën e dytë.

Grupi i punës së marrjes në dorëzim ka mbajtur procesverbalin nr. 6285/1, datë 31.08.2022 si dhe memon me nr. 6285/2, datë 31.08.2022 drejtuar Ministrit dhe SP, ku informo se nga OE është realizuar faza e parë dhe se vlerësojnë se materiali i dorëzuar është në përputhje me termat e referencës dhe planin e zbatimit të kontratës.

Nga subjekti me shkresën nr. 4356, datë 16.09.2022 prot., MTM me nr. 3826, datë 16.09.2022 është dërguar projekt-ideja paraprake.

Grupi i punës së marrjes në dorëzim ka mbajtur procesverbalin datë 19.09.2022 si dhe memon me nr. 6326/1, datë 20.09.2022 drejtuar Ministrit dhe SP, ku informo se nga OE ka realizuar projekt dhe se vlerësojnë se materiali i dorëzuar është në përputhje me termat e referencës dhe planin e zbatimit të kontratës.

Me shkresën nr. 6890, datë 20.09.2022 nga MTM drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Doganës dhe Autoritetit Rrugor Shqiptar kërkohet mendimi në lidhje me Projekt-idenë e propozuar nga OE, dorëzuar me datën 16.09.2022.

Drejtoria e Përgjithshme e Doganës, me shkresën nr. 16766/1, datë 26.09.2022 prot., në MTM me nr. 6890/1, datë 28.09.2022 kthen përgjigje për dakortësinë e projektit të propozuar.

ARRSH me shkresën nr. 9107/1, datë 13.10.2022 prot., në MTM 6890/2 sqaron se për punimet që do të kryhen në akset rrugore kombëtare sqaron se që të merret leje duhet të aplikohet në E-Albania me gjithë dokumentacionin bashkëngjitur.

Ndërsa për vendosjen e pemës së mirëseardhjes kërkojnë që ajo të vendoset brenda zonës doganore pasi ndërtimi përgjatë akseve rrugore kombëtare kërkon zbatimin e detyrimeve ligjore të nenit 23 të ligjit 8378, datë 22.07.1998 "Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar dhe neneve 25, 46, 47; 48 dhe 49 të VKM-së 153, datë 07.04.2000 "Për miratimin e rregullores së zbatimit të Kodit Rrugor në RSH" i ndryshuar, sugjerim i cili është marrë në konsideratë nga OE.

Me shkresën nr. 4418, datë 28.10.2022 prot., MTM me nr. 7832, datë 28.10.2022, nga OE "A." është dërguar projekt zbatimi i detajuar.

Grupi i punës së marrjes në dorëzim ka mbajtur procesverbalin me nr. 7832/3, datë 25.11.2022 të marrjes në dorëzim të dokumentacionit të fazës së IV si dhe memon me nr. 7832/4 datë 25.11.2022 drejtuar Ministrit dhe SP informo dhe kërkon miratimin e fazës së katërt të realizuar nga OE pasi vlerësojnë se materiali i dorëzuar është në përputhje me termat e referencës dhe planin e zbatimit të kontratës.

Me shkresën nr. 4474, datë 02.12.2022 prot., MTM me nr. 9030, datë 02.12.2022, nga OE "A." është dërguar Hartimi i projekt zbatimit.

Me shkresën nr. 9964, datë 20.12.2022 është dërguar APP raporti për monitorimin e kontratës "Rehabilitimi i shesheve dhe zonave kryesore në afërsi të pikave doganore shqiptare".

Me urdhër shpenzimit nr. 489 datë 10.10.2022 është likuiduar OE për shumën 5,980,400 lekë bazuar në faturën me nr. 171, datë 23.09.2022.

Me urdhër shpenzimit nr. 607, datë 07.12.2022 është likuiduar OE për shumën 8,985,600 lekë bazuar në faturën me nr. 242, datë 02.12.2022.

Pagesa pjesore është realizuar sipas përcaktimeve në kushtet e veçanta të kontratës në nenin 9 "kushtet e pagesës", ku citohet se 40% e vlerës paguhet në momentin e aprovimit të projekti idesë dhe 60% e vlerës në momentin e dorëzimit të projektit.

Projekti është bërë hyrje me fletë hyrjen nr. 70. Datë 02.12.2022 të fazës së I dhe fazës së II.

### **Konstatimi:**

Sa me sipër konstatohet se në MTM nuk është depozituar asnjë kërkesë nga Degët Doganore apo nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganës, si dhe nuk rezulton të jetë kryer një studim paraprak nga ana e MTM-së, për nevojat e realizimit e këtij investimi si prioritet i parashikuar në PBA 2022-2024, me ndryshimet e bëra në PBA me datë 18.10.2021. Ky projekt është planifikuar pa patur një

studim paraprak dhe arsye se pse është futur si prioritet për vitin 2022, Veprimet e mësipërme janë kryer në kundërshtim me VKM nr. 185, datë 29.03.2018, “Për menaxhimin e investimeve publike” aneksi 1.

Nga auditimi u konstatua se në procedurën me objekt “Rehabilitimi i shesheve dhe zonave kryesore në afërsi të pikave doganore shqiptare” janë përfshirë:

- Porti i Durrësit, i cili është me koncesion dhe operon në Shqipëri që nga Viti 2013.
- Dega Dogana Kapshtice, për të cilën është bërë “**Projekti për rikonceptimin e hapësirave të Degës Doganore Kapshticë**” në vlerën 4,896,000 leka pa tvsh me kontratën e lidhur me nr. 6940/5, datë 04.07.2018 dhe amendimin e kontratës me nr. 19094, datë 17.08.2018 mes OE “Gj.” shpk dhe AK “Drejtoria e Përgjithshme e Doganës”. Projekt është finalizuar në datën 01.09.2018.
- Me memon nr. 7980, datë 14.10.2021 nuk është parashikuar “Aeroporti i Tiranës”, nga 12 pikat e kalimit të propozuar. Aeroporti është shtuar në Terma reference për projektin e zbatimit me objekt: “Rehabilitim i shesheve dhe zonave kryesore në afërsi të pikave doganore shqiptare”. Gjithashtu “Aeroportit të Rinasit” është nën administrimin e koncesionarit, i cili ka për detyrë për të administruar, operuar dhe mirëmbajtur të gjithë anën ajrore dhe **infrastrukturën** (përveç kontrollit të trafikut ajror).

Sa më sipër përfshirja e tre pikave doganore në procedurën me objekt “Rehabilitimi i shesheve dhe zonave kryesore në afërsi të pikave doganore shqiptare”, sjell efekt financiar negativ në përdorimin e fondeve buxhetore.

<b>Titulli i Gjetjes</b>	Në procedurën e prokurimit: “Rehabilitimi i shesheve dhe zonave kryesore në afërsi të pikave doganore shqiptare” Mos zbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP-së.
<b>Situata:</b>	<p>Nga auditimi u konstatua se:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Me datën 23.02.2022 është bërë përllogaritja e fondit limit nga komisioni i ngritur me urdhrin nr. 76, prot. 2144, datë 23.02.2022, ku në urdhrë është përcaktuar dhe fondi limit i përllogaritur, Pra, AK nuk ka ngritur komision për përllogaritjen e fondit limit, veprime në kundërshtim me pikën 2 të nenit 76 “Mënyrat për përllogaritjen e vlerës së prokurimit” ku citohet se “Autoriteti/enti kontraktor, përpara nxjerrjes së urdhrit të prokurimit, duhet të argumentojë dhe të dokumentojë përllogaritjen e vlerës së kontratës, bazuar në specifikimet teknike të objektit që prokurohet”. Në procesverbalin i mbajtur nga komisioni nuk është bërë asnjë argumentim në lidhje me klasifikimet e objektit, si dhe mënyra se si është bërë ndarja e kostos për strukturën e jashtme dhe kostoja për ndërtesën dhe ndarja funksionale e tyre, mbi të cilën është llogaritur dhe një kosto shtese prej 50%.</li> <li>Në nenin 29 dhe 31 të VKM-në nr. 354, datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikimin e territorit, projektimit, mbikëqyrjes dhe kolaudimit” është bërë ndarja sipas grupeve tarifore.</li> <li>Nga auditimi i përllogaritjes së fondit limit konstatohet se mungojnë sqarimet në lidhje me vlerën: <ul style="list-style-type: none"> <li>- 172,864,693 lekë për koston e llogaritshme të strukturave në ambientet e jashtme;</li> <li>- 115,234,429 lekë për koston e llogaritshme të grupeve tarifore për ndërtesat dhe ndarjet funksionale të brendshme, pasi bazuar në zërat e projektimit vlerat e llogaritur nuk përputhen.</li> <li>- Kriteret e vendosura dhe të kërkuara nga AK nuk janë të argumentuar. NJP është mjaftuar vetëm me citimin e bazës ligjore, veprime në kundërshtim të VKM-së 285 datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” pika 2 e nenit 78 “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit”</li> </ul> </li> </ul>



	<p>ku citohet se “Në çdo rast, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërish, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre. Ky procesverbal i vihet në dispozicion personit/ave”</p> <p>2. Nga komisioni i vlerësimit është bërë vlerësim pikësor për OE “I.” shpk, i cili nuk ka kaluar fazën e dytë të vlerësimit, nga ku nuk ka informacion se ku është marrë vlera e ofertës ekonomike, kur subjektit nuk i është kërkuar paraqitja e ofertës ekonomike.</p>
<b>Kriteri:</b>	<p>- Ligjit nr. 162 datë 23.12.2020 “Për prokurimin Publik”.</p> <p>- VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.</p>
<b>Ndikimi/Efekti:</b>	Mos rritje e efikasitetit dhe efikasitetit në procedurën e prokurimit
<b>Shkaku:</b>	Mos argumentimi i përllogaritjes së fondit limit dhe të kriterëve të kërkuar.
<b>Rëndësia:</b>	I Lartë
<b>Rekomandime:</b>	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit në procedurat e prokurimit të mallrave /shërbimeve dhe punëve që do zhvillohen në vazhdimësi, të marrë masa që çdo proces pune të jetë i argumentuar teknikisht dhe i dokumentuar me dokumentacionin përkatës.

<b>Titulli i Gjetjes</b>	Në procedurën e prokurimit: “Rehabilitimi i shesheve dhe zonave kryesore në afërsi të pikave doganore shqiptare”
<b>Situata:</b>	<p>Nga auditimi u konstatua se:</p> <p>- Nga MTM nuk rezulton të jetë kryer një studim paraprak për nevojat e realizimit të këtij investimi si prioritet i parashikuar në PBA 2022-2024, me ndryshimet e bëra në PBA me datë 18.10.2021. Ky projekt është planifikuar pa patur një studim paraprak dhe arsye se pse është futur si prioritet për vitin 2022, veprimet janë kryer në kundërshtim me VKM nr. 185, datë 29.03.2018, “Për procedurat e menaxhimit të investimeve publike” pika 7.</p> <p>- Në procedurën me objekt “Rehabilitimi i shesheve dhe zonave kryesore në afërsi të pikave doganore shqiptare” janë përfshirë:</p> <p>- Porti i Durrësit, i cili është me koncesion dhe operon në Shqipëri që nga Viti 2013.</p> <p>- Dega Dogana Kapshtice, për të cilën është bërë “Projekti për rikonceptimin e hapësirave të Degës Doganore Kapshticë” në vlerën 4,896,000 leka pa tvsh me kontratën e lidhur me nr. 6940/5, datë 04.07.2018 dhe amendimin e kontratës me nr. 19094, datë 17.08.2018 mes OE “Gj.” shpk dhe AK “Drejtoria e Përgjithshme e Doganës”. Projekt është finalizuar në datën 01.09.2018.</p> <p>- Me memon nr. 7980, datë 14.10.2021 nuk është parashikuar “Aeroporti i Tiranës”, nga 12 pikat e kalimit të propozuar. Aeroporti është shtuar në Termat reference për projektin e zbatimit me objekt: “Rehabilitim i shesheve dhe zonave kryesore në afërsi të pikave doganore shqiptare”.</p> <p>Gjithashtu “Aeroportit të Rinasit” është nën administrimin e koncesionarit, i cili ka për detyrë për të administruar, operuar dhe mirëmbajtur të gjithë anëtarët ajrore dhe infrastrukturën (përveç kontrollit të trafikut ajror).</p> <p>Sa më sipër përfshirja e tre pikave doganore në procedurën me objekt “Rehabilitimi i shesheve dhe zonave kryesore në afërsi të pikave doganore shqiptare”, sjell efekt financiar negativ në përdorimin e fondeve buxhetore.</p>
<b>Kriteri:</b>	VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

	VKM nr. 185, datë 29.03.2018, “Për procedurat e menaxhimit të investimeve publike” pika 7. Ligjit nr. 162 datë 23.12.2020 “Për prokurimin Publik”, i ndryshuar.
<b>Ndikimi/Efekti:</b>	Fondi i përdorur pa efikasitet dhe efektivitet.
<b>Shkaku:</b>	Përfshirja si prioritet nga MTM pa bërë një studim paraprak mbi nevojën e realizimit të procedurës.
<b>Rëndësia:</b>	I Lartë
<b>Rekomandime:</b>	- Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, personat përgjegjës të parashikimit të investimeve, të marrin masat në vijimësi për realizimin e studimeve paraprak në bashkëpunim me autoritet përkatëse pjesë e projekteve, me qëllim mirë menaxhimit të fondeve publike, evitimin e ndryshimit të prioritetëve të projekteve, si dhe cënimin apo favorizimin e projekteve specifike. - Titullari i Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit të marrë masa për ngritjen e një komisioni me specialist të fushës, me qëllim ndarjen dhe përcaktimin e vlerave që i përkasin tre pikave doganore për të cilat MTM nuk duhet ti kishte përfshirë në projekt. - Ministria e Turizmit dhe Mjedisit të informojë menjëherë Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave dhe Autoritetit Rrugor Shqiptar në lidhje me ndryshimet që do të kenë në projekt dhe pas finalizimit të dërgojë pikat doganore për të cilat nuk do të realizohet projekti.

Për sa më sipër, ngarkohet me përgjegjësi:

- Znj. L. B. A. në cilësinë e NA.

- z. E. O, i cili ka kërkuar nevojën për ri-kualifikimin e pikave hyrëse tokësore, detare, ajrore dhe korridoreve lidhëse me territorin e Republikës së Shqipërisë.

- Z. S. J ; z. E. O dhe znj. R.L në cilësinë e anëtarëve të NJP.

**5. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për procedurën e prokurimit në objekt: “Studim mbyllja, rehabilitimi i mbetjeve urbane nga vend depozitimet ilegale”, konstatohet:**

Të dhëna mbi objektin e prokurimit:

<b>Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Studim mbyllja, rehabilitimi i mbetjeve urbane nga vend depozitimet ilegale”</b>			
<b>1. Lloji i Procedurës së Prokurimit</b> “Shërbim Konsulencë” REF-00533-07-08-2021 Urdhri nr. 138, datë 14.06.2021	<b>1.1 Grupi i hartimit kritereve kualifikuese</b> Urdhri me nr. 138, datë 14.06.2021	<b>2 Njësia e Prokurimit</b> I.B R. L V. G	<b>3 Komisioni i Vlerësimit Ofertave</b> Urdhri nr. 139, prot., 4036/1, datë 14.06.2021; R.B, A. S Sh. K
<b>4. Fondi Limit (pa tvsh)</b> 3,300,000 lekë	<b>5. Oferta fituese (pa tvsh)</b> 2,640,000 lekë		<b>6. Diferenca me fondin limit (pa tvsh)</b> 660,000 lekë
<b>7/1 Data e hapjes së tenderit</b> Data 01.03.2021	<b>8. Burimi Financimit</b> Buxheti i Shtetit		<b>9. Operatorët Ekonomike</b> a) Pjesëmarrës në tender Numër <b>4</b> b) S’kualifikuar 3 OE, c) Kualifikuar 1 OE
<b>7/2 Kohëzgjatja e kontratës</b> , 45 (dyzetë e pesë) ditë duke filluar nga nënshkrimi i kontratës.			
<b>10. Ankimime</b>	<b>11. Përgjigje Ankesës</b> AK me:		<b>12. Përgjigje Ankesës</b> nga KPP
<b>b. Zbatimi i Kontratës Prokurimit</b>			
<b>13. Lidhja e kontratës</b> Mes AK dhe OE fitues “N.” shpk është lidhur	<b>Zbatimi i kontratës:</b> - Nga komisioni i ngritur me urdhrin e Titullarit të AK nr. 216, prot., 4036/7, datë 04.10.2021 është mbajtur procesverbali i marrjes në dorëzim të shërbimit të realizuar me datën 18.11.2021.		

### **a-Nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit konstatohet:**

Bashkia Tropull me shkresën nr. 388, datë 18.01.2021, Bashkia Fushë Arrëz me nr. 542, datë 22.01.2021, Bashkia Pukë me shkresën nr. 301, datë 14.01.2021, Bashkia Memaliaj me shkresën nr. 405, datë 18.01.2021, Bashkia Poliçan me shkresën nr. 324, datë 14.01.2021, Bashkia Tepelene me shkresën nr. 274, datë 13.01.2021, Bashkia Bulqizë me shkresën nr. 161, datë 08.01.2021 dhe Bashkia Klos me shkresën nr. 162, datë 08.01.2021 i janë drejtuar Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, ku kërkojnë bashkëpunimin dhe mbështetjen financiare për “Për bandillin e mbetjeve” për vendosjen e standardeve minimale për vend depozitimet ekzistuese me qëllim për të funksionuar për një periudhë tranzitore.

Me urdhrin nr. 29, prot., 578 datë 25.01.2021, ngrihet Komisioni për hartimin e detyrave të projektimit me anëtar, R. B, L. K, dhe Sh. K.

Nga komisioni me datën 14.06.2021 është mbajtur procesverbali i hartimit të projektimit me objekt “*Studim mbyllja, rehabilitimi i mbetjeve urbane nga venddepozitimet ilegale*”.

#### ***Kontaktim:***

*Bashkëngjitur dosjes mungojnë shqyrtimi i planeve pranë Komitetit Ndërmintor për Mbetjet veprime në kundërshtim me Vendimin nr. 846, datë 28.10.2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 452, datë 11.7.2012, të Këshillit të Ministrave, “Për lëndfilllet e mbetjeve”, të ndryshuar ku citohet se:*

2. Pas pikës 25, shtohen pikat 25/1 dhe 25/2, me këtë përmbajtje: “25/1 “Në rast se operatorët e një venddepozitimi ekzistues nuk kanë burimet financiare ose aftësitë teknike për të përgatitur planin e përmirësimit të venddepozitimit me kërkesën e operatorit të venddepozitimit, plani i përmirësimit të venddepozitimit dhe rehabilitimi mund të kryhen nga ministria përgjegjëse për mjedisin. 25/2 “Planet e përmirësimit, të dërguara nga operatorët për miratim, pranë Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, pas datës 31 dhjetor 2018, vlerësohen dhe miratohen nga Agjencia dhe kalojnë për shqyrtim pranë Komitetit Ndërmintor për Mbetjet, në përputhje me parashikimet e këtij vendimi.”

3. Pika 28 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“28. Agjencia Kombëtare e Mjedisit, pasi miraton planin e përmirësimit, e dërgon atë për shqyrtim pranë Komitetit Ndërmintor për Mbetjet, i cili vendos për masat që duhen marrë dhe periudhën e nevojshme të tranzicionit për zbatimin e tyre, periudhë e cila në çdo rast përfundon në datën 31 dhjetor 2024.

Agjencia Kombëtare e Mjedisit, në rastet kur miraton planin e përmirësimit, Përgatit një relacion shpjegues teknik për Sekretariatit Teknik të Komitetit, i cili dërgohet së bashku me planin e përmirësimit. Relacioni shpjegues përmban të dhëna mbi pikëzimin e venddepozitimit, si dhe impaktin mjedisor, ekonomik e social të zonës ku ndodhet lëndfilli. Sekretariati shqyrton të gjithë dokumentacionin e përcjellë nga AKM-ja dhe i përgatit një relacion përmbledhës Komitetit.”.

- Me urdhrin e prokurimit të z. E. Q, Drejtor i Përgjithshëm i Drejtorisë Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse, nr. 138, prot. 4036, datë 14.06.2021, urdhërohet të kryhet prokurimi i fondit prej 3,300,000 lekë pa TVSH, me objekt “*Studim mbyllja, rehabilitimi i mbetjeve urbane nga venddepozitimet ilegale, Dropull, Pukë, Bulqizë, Klos, Fushë Arrëz, Poliçan, Tepelene, Memaliaj*” dhe ngarkohet njësia e prokurimit e përbërë nga I.B, R.L dhe V. G ku është cituar dhe shuma e fondit limit.

Komisioni i përlllogaritjes së fondit limit ka bërë përlllogaritjen e fondit duke marrë oferta nga tre operatorë ekonomik të cilët kanë si objekt të veprimtarisë së tyre të njëjtë/ngjashme me objektin që po prokurohet.

Ne dosje mungon shkresa e dërguar nga MTM drejtuar OE, për paraqitjen e ofertave.

Nga komisioni është mbajtur procesverbali me datën 14.06.2021, ku nga mesatarja e tre ofertave

të paraqitur nga OE ka dalë në vlerën 3,300,000 lekë pa TVSH.

Me urdhrin nr. 139, prot., 4036/1, datë 14.06.2021, ngrihet Komisioni Vlerësimit të Ofertave me anëtar, R. B, A. S dhe Sh. K.

Nga NJP është mbajtur procesverbali me nr. 4036/2, datë 08.07.2021, mbi argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim të procedurës.

<b>Titulli i Gjetjes:</b>	Problematika që nga inicimi i procedurës, si dhe Vendosja e kriterëve të veçanta të kualifikimit nuk janë të argumentuar .
<b>Situata:</b>	<p>Bashkëngjitur dosjes mungojnë shqyrtimi i planeve pranë Komitetit Ndërmintor për Mbetjet, veprime në kundërshtim me Vendimin nr. 846, datë 28.10.2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 452, datë 11.7.2012, të Këshillit të Ministrave, “Për lëndfillet e mbetjeve”, të ndryshuar ku citohet se: 2. Pas pikës 25, shtohen pikat 25/1 dhe 25/2, me këtë përmbajtje: “25/1 “Në rast se operatorët e një venddepozitimi ekzistues nuk kanë burimet financiare ose aftësitë teknike për të përgatitur planin e përmirësimit të venddepozitimit me kërkesën e operatorit të venddepozitimit, plani i përmirësimit të venddepozitimit dhe rehabilitimi mund të kryhen nga ministria përgjegjëse për mjedisin. 25/2 “<i>Planet e përmirësimit, të dërguara nga operatorët për miratim, pranë Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, pas datës 31 dhjetor 2018, vlerësohen dhe miratohen nga Agjencia dhe kalojnë për shqyrtim pranë Komitetit Ndërmintor për Mbetjet, në përputhje me parashikimet e këtij vendimi.</i>”</p> <p>3. Pika 28 ndryshohet, si më poshtë vijon: “28. Agjencia Kombëtare e Mjedisit, pasi miraton planin e përmirësimit, e dërgon atë për shqyrtim pranë Komitetit Ndërmintor për Mbetjet, i cili vendos për masat që duhen marrë dhe periudhën e nevojshme të tranzicionit për zbatimin e tyre, periudhë e cila në çdo rast përfundon në datën 31 dhjetor 2024.</p> <p>Agjencia Kombëtare e Mjedisit, në rastet kur miraton planin e përmirësimit, Përgatit një relacion shpjegues teknik për Sekretariatit Teknik të Komitetit, i cili dërgohet së bashku me planin e përmirësimit. Relacioni shpjegues përmban të dhëna mbi pikëzimin e venddepozitimit, si dhe impaktin mjedisor, ekonomik e social të zonës ku ndodhet lëndfilli. Sekretariati shqyrton të gjithë dokumentacionin e përcjellë nga AKM-ja dhe i përgatit një relacion përmbledhës Komitetit.”.</p> <p>Nga auditimi i Dokumenteve të Tenderit nëpërmjet dosjes fizike dhe sistemit të prokurimit elektronik (SPE), u konstatuan se:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>- Përlllogaritja e fondit është bërë me të njëjtën datë kur është ngritur dhe urdhri i komisionit njësisë së prokurimit.</li></ul> <p><b>Në DT në pikën 2.3 Kapaciteti teknik kërkohet:</b></p> <ul style="list-style-type: none"><li>a. Operatori Ekonomik ofertues duhet të paraqesë Licencë profesionale të vlefshme të shoqërisë për projektim, të lëshuara nga institucionet e autorizuar me ligj.</li><li>3/a - Objekte civile - industriale - turistike prej murature e skelet beton arme deri ne 5 kate.</li><li>3/c-1. Objekte me shkallë të lartë vështirësie Beton arme - metalike – 2, troje dhe shpatë me qëndrueshmëri të ulët.</li><li>6/a- Rrugë lokale, rrugë urbane dytësore dhe rrugë interurbane dytësore.</li><li>8/b- Rivelime inxhinierike kadastrale.</li><li>8/c- Sisteme GIS.</li><li>11/a- Sinjalistikë jondriçuese në rrugë lokale, rrugë urbane dytësore, rrugë</li></ul>

	<p>interurbane dytësore, sheshe e parkime.</p> <p><b><i>Këto Licensa profesionale të kërkuar nuk kanë lidhje me objektin, natyrën e kontratës objekt prokurimi.</i></b></p> <p>Nga AK ka mbivendosje të kritereve të kërkuara në DT si vijon:  Në “Kriteret e përgjithshme të përzgjedhjes/ kualifikimit” në pikën e kërkohe:</p> <p>e) <i>ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohe për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.</i></p> <p>Gjithashtu në “Kriteret e veçanta të kualifikimit” <b>në pikën 2.2 “Kapaciteti ekonomik dhe financiar” kërkohe</b> “<i>Një vërtetim që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri. Mosshlyerje e detyrimeve të energjisë elektrike përbën shkak për s’kualifikimin e operatorit</i>”.</p> <p>Sa më sipër konstatua se kriteret e vendosura dhe të kërkuara nga AK nuk janë të argumentuar. NJP është mjaftuar vetëm me citimin e bazës ligjore. Veprime në kundërshtim me nenin 78 të VKM-së Nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” pika 2 ku citon se “<i>Në çdo rast, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërish, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre. Ky procesverbal i vihet në dispozicion personit/ave përgjegjës për prokurimin, i cili/të cilët e bën/bëjnë pjesë të dosjes së tenderit</i>”.</p>
<b>Kriteri:</b>	<p>- Ligjit nr. 162 datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” neni 36.  -VKM-së Nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” ndryshuar, neni 78.  Vendimin nr. 846, datë 28.10.2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 452, datë 11.7.2012, të Këshillit të Ministrave, “Për lendfillet e mbetjeve”,</p>
<b>Ndikimi/Efekti:</b>	<p>Kriteret kualifikuese të paargumentuara, duke ndikuar në kufizimin e konkurrencës, mosndjekja e hallkave të miratimit sipas përcaktimit të Vendimin nr. 846, datë 28.10.2020 së sjell mundësinë e mos identifikimit të qartë të masat që duhen marrë dhe periudhën e nevojshme të tranzicionit për zbatimin e tyre.</p>
<b>Shkaku:</b>	<p>Kritere kualifikuese jo në përputhshmëri me parashikimet e LPP. Moszbatimi i akteve ligjore dhe nënligjore nga strukturat përgjegjëse.</p>
<b>Rëndësia:</b>	<p>I Lartë</p>
<b>Rekomandimi:</b>	<p>Ministria e Turizmit dhe Mjedisit në procedurat e prokurimit të mallrave /shërbimeve dhe punëve që do zhvillohen në vazhdimësi, të marrë masa që çdo proces pune të jetë i argumentuar teknikisht dhe i dokumentuar me dokumentacionin përkatës.</p>

### ***Në lidhje me vlerësimin e ofertave nga KVO.***

Me datën 19.07.2021, nga KVO është mbajtur procesverbali nr. 1 i hapjes së fazës së shqyrtimit të kualifikimit të kandidatëve që kanë shprehur interes.

Me datën 23.07.2021, nga KVO është mbajtur procesverbali nr. 2 i hapjes së fazës së shqyrtimit të kualifikimit të kandidatëve që kanë shprehur interes, nga 4 OE që kanë marrë pjesë janë skualifikuar

- **“I.”sh.p.k** është s’kualifikuar në fazën e parë të procedurës me arsyetimin se nuk ka dorëzuar të

gjithë dokumentacionin e kërkuar nga Autoriteti Kontraktor për plotësimin e të gjithë 1. Kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit dhe 2. Kriteret e veçanta të kualifikimit, sipas shtojcës 11, konkretisht: për kapacitetin teknik, pika c):

- OE nëpërmjet dokumentacionit të dorëzuar nuk ka dëshmuar që ka në stafin e tij ose të ketë kontratë bashkëpunimi të vlefshme për ekspert dhe inxhinierët e mëposhtëm: - 1 (një) Ekspert mjedisi i pajisur me Licencë për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis.

- OE nëpërmjet dokumentacionit të dorëzuar, nuk ka dëshmuar që disponon Licence nga QKL për ekspertizën në lidhje me ndikimin në mjedis me certifikatën me kod: III.2.A (1+2) për kategorinë "Shërbim ekspertize dhe/ose profesionale lidhur me ndikimin në mjedis" sipas kërkesave të përcaktuara në DST.

Me shkresën nr. 5555, datë 03.08.2021 u është dërguar OE "GJ." shpk, BO "D.C P." shpk dhe "U." shpk dhe N." shpk ftesë për paraqitjen e propozimit, i cili duhet të paraqitet në rrugë elektronike deri me datën 19.08.2021.

Nga KVO është mbajtur procesverbali nr. 3, datë 19.08.2021 për hapjen e propozimeve teknike të OE.

OE "GJ." shpk i kualifikuar në fazën e parë nuk ka shprehur interes për të vijuar në fazën e dytë, ndërsa BO "D.C .P" shpk dhe "U." shpk ka dorëzuar ofertën vetëm me zarf dhe jo në mënyrë elektronike brenda afatit të përcaktuar, për të cilin KVO ka kërkuar një mendim në APP me shkresën nr. 5893, datë 23.08.2021 për mënyrës se si do të veprohet në këtë rast pasi bazuar në vendimin e APP nr. 4377/1, datë 07.07.2021 thuhet që procedura "Shërbim Konsulence" do të zhvillohet në të gjitha fazat në sistemin elektronik.

APP me shkresën nr. 5282/1, datë 30.08.2021 kthen përgjigje MTM (prot.5893/1 datë 01.09.2021) se autoriteti juaj duhet të zbatojë parashikimet e VKM-së nr. 384, datë 30.06.2021 "Për formën e komunikimit në procedurën e prokurimit publik".

Nga KVO është mbajtur procesverbali nr. 3/1, datë 25.08.2021 për hapjen e propozimeve teknike në prani të gjithë anëtarëve, nga ku **BO "D.C P" shpk dhe "U." shpk** është skualifikuar në fazën e dytë të procedurës, me arsyetimin se nuk ka ofertuar elektronikisht nëpërmjet sistemit të prokurimit elektronik në zbatim të Njoftimit Nr. 4377/1 Prot., datë 07.07.2021 mbi Vendimin Nr. 384, datë 30.06.2021 "Për formën e komunikimit në procedurat e prokurimit publik", por vetëm në formë shkresore.

Me shkresën nr. 5851/1, datë 03.09.2021 është njoftuar BO "D.C P." shpk dhe "U." shpk për mosmarrjen në shqyrtim të propozimit dhe kthimin mbrapsht të zarfit të propozimit teknik.

KVO me datën 07.09.2021 ka mbajtur procesverbalin nr. 4, ku është bërë vlerësimi i propozimit teknik të OE në total është vlerësuar me 74 pikë.

Me shkresën nr. 6076, datë 07.09.2021 është njoftuar OE "N." shpk mbi vlerësimin e propozimit teknik të kryer nga KVO.

Me shkresën nr. 6453, datë 15.09.2021 drejtuar "N." shpk fton operatorin për paraqitjen pranë ambienteve të ministrisë për hapjen e ofertës ekonomike me datë 17.09.2021.

Nga KVO është mbajtur procesverbali nr. 5, datë 17.09.2021 në të cilën argumenton hapjen e ofertës ekonomike të dorëzuar nga "N..." shpk në vlerën prej 2,640,000 lekë pa tvsh e shoqëruar dhe me sigurimin e ofertës.

KVO me datën 17.09.2021 ka mbajtur procesverbalin nr. 6, ku është bërë vlerësimi pikësor mbi OE duke marrë në konsideratë vlerësimin e propozimit teknik dhe ofertës ekonomike, nga ku rezultoi se "N." shpk është shpallur fitues.

Nr.	Shoqëria	Oferta Leke PA TVSH	Vlerësimi teknik	Vlerësimi ekonomik	Pikëzimi
2	N" shpk	2,640,000	74*0.8	100*0.2	97.2

Formulari i njoftimit të fituesit është publikuar me datën 22.09.2021, prot., nr. 4036/4, datë 21.09.2021.

Nga KVO-ja është mbajtur raporti përmbledhës me nr. 4036/5, datë 30.09.2021  
 - Me raportin përmbledhës nr. 4036/5, datë 30.09.2021, miratohet procedura nga titullari i AK z. E.Q, ku është shpallur fitues OE “N.” shpk.  
 Me shkresën nr. 343, datë 30.09.2021 (prot., 6952, datë 30.09.2021) OE fitues ka depozituar dokumentacionin fizik të tenderit, ku me datë 30.09.2021, nga KVO është mbajtur procesverbali i pranimit të dokumentacionit.  
 Mes AK dhe OE fitues “N.” shpk është lidhur kontrata me nr. 4036/6, datë 04.10.2021.  
 Njoftimi i kontratës së nënshkruar është firmosur me shkresën nr. 4036/9, datë 05.10.2021 dhe ngarkuar me datën 05.10.2021.  
 Me shkresën nr. 4036/10, datë 06.10.2021 është dërguar në APP raporti i planit të zbatimit të kontratës, për të cilin APP me shkresën nr. 6179/1, datë 13.10.2021 i kërkon plotësimin e formatit sipas standardit të udhëzimit nr. 8, datë 01.09.2021 “Mbi hartimin e planit të zbatimit të kontratës”.  
 Me shkresën nr. 7511, datë 22.10.2021 është ridërguar në APP raporti i planit të zbatimit të kontratës.  
 Me urdhrin e Titullarit të AK nr. 216, prot., 4036/7, datë 04.10.2021 është ngritur grupi i punës për marrjen në dorëzim të shërbimit me anëtar R. B, Sh. H dhe Sh. K.

<b>Titulli i Gjetjes:</b>	Mos verifikimi nga KVO nëse OE ka bërë deklaratimet sipas përcaktimeve të LPP dhe kërkesave në DST.
<b>Situata:</b>	<p>Nga auditimi i dokumentacionit të dorëzuar nga OE “N.” shpk, rezultoi se, sipas strukturës së propozimit ekonomik të dorëzuar pagesa ditore për Drejtuesve Teknik: 1 (një) Inxhinier Ndërtimi; 1 (një) Inxhinier Hidroteknik; 1 (një) Inxhinier Gjeodet; 1 (një) Inxhinier Gjeolog ; 1 (një) Ekspert mjedisi do të jetë në vlerën 10,800 lekë.</p> <p>Ndërkohë në kontratën e lidhur mes OE dhe inxhinierëve të deklaruar dhe bazuar në deklaratimin e bërë në "Listëpagesa e Kontributeve të Sigurimeve Shoqërore, Shëndetësore dhe Tatimit mbi të Ardhurat nga Punësimi" për muajt Mars-Maj 2021, konstatohet se deklarimi është bërë mbi pagën 24,000 në muaj.</p> <p>Sa më sipër OE: ka vepruar në kundërshtim me piken 2/d të nenit 76, të Ligjit nr. 162 datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, ku parashikohet se: "Një operator ekonomik skualifikohet nga pjesëmarrja në një procedurë prokurimi kur operatori ekonomik ka shkelur detyrimet e tij në lidhje me pagesën e taksave ose kontributeve të sigurimeve shoqërore".</p> <p>Ne këto kushte, kjo shoqëri ndodhet në kushtet e parashikuara në nenin 78 pika 1 të LPP, pasi ka paraqitur dokumentacion që përmbajnë të dhëna të rreme për qëllime kualifikimi, pasi në deklaratën mbi përmbushjen e kriterëve të përgjithshme ka deklaruar shlyerjen e detyrimeve në fjalë sipas legjislacionit në fuqi.</p>
<b>Kriteri:</b>	Ligjit nr. 162 datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar me piken 2/d të nenit 76, nenin 78/1. Dokumentar e DST.
<b>Ndikimi/Efekti:</b>	Risku i mos përmbushjes së shërbimit objekt prokurimi nga OE, sipas kriterëve të kërkuar në DST.
<b>Shkaku:</b>	Mos verifikimi nga KVO i dokumenteve të dorëzuara nga OE, në përputhje me DST.
<b>Rëndësia:</b>	I lartë
<b>Rekomandimi:</b>	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave të marri masa për eliminimin e praktikave të prokurimit me shkelje ligjore të shpallur fitues në kushtet e mosplotësimit të kriterëve të kërkuara në DST, me qëllim përdorimin me efience dhe efektivitet e fondeve publike.

***Për sa më sipër, ngarkohet me përgjegjësi:***

- Znj. I.B; Znj. R.L dhe Znj. V. G në cilësinë e anëtarëve të NJP.

- Z. R. B; Z. Sh. K Znj. A. S në cilësinë e anëtarëve të KVO-së.

- Z. E.Q. në cilësinë Drejtor i Përgjithshëm i Drejtorisë Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse.

**Zbatimi i kontratës:**

“N.” shpk me shkresën nr. 423, datë 18.11.2021 prot në MTM me shkresën nr. 8380, datë 18.11.2021 dorëzon projektin për kontratën me objekt “*Studim mbyllja, rehabilitimi i mbetjeve urbane nga venddepozitimet ilegale, Dropull, Pukë, Bulqizë, Klos, Fushë Arrëz, Poliçan, Tepelene, Memaliaj*”.

Nga komisioni i ngritur me urdhrin e Titullarit të AK nr. 216, prot., 4036/7, datë 04.10.2021 është mbajtur procesverballi i marrjes në dorëzim të shërbimit të realizuar me datën 18.11.2021.

Me urdhër shpenzimin nr. 610, datë 29.12.2021 është likuiduar OE në shumën prej 3,168,000 lekë, për faturën nr. 388, datë 02.12.2021.

**2.6 Vlerësimi i funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit.**

Vlerësimi i funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit u realizua bazuar në Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*”, i ndryshuar, Manualin për MFK-në, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 108, datë 17.11.2016, si dhe urdhrat dhe udhëzimet e dala në zbatim të tij. Në kuptimin e ligjit të lartpërmendur, menaxhimi financiar dhe kontrolli përcaktojnë përgjegjshmërinë menaxheriale për planifikimin, zbatimin dhe kontrollin e buxhetit, kontabilitetin dhe raportimin, duke respektuar parimet e transparencës dhe të ligjshmërisë për të arritur objektivat dhe për të shmangur shpërdorimin, keqpërdorimin dhe vjedhjen e pasurisë.

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit ka caktuar znj. L. B. A (Sekretare e Përgjithshme) si Nëpunës Autorizues me anë të shkresës nr. 8894 prot., datë 13.12.2021 dhe z. S. J (Drejtor i Përgjithshëm Ekonomik dhe i Shërbimeve Mbështetëse) 1 Sa më sipër, në përmbushje të kërkesave të pikës të nenit 18/1, nenit 19, të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “*Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin*”, i ndryshuar, “*Nëpunësi autorizues i çdo njësie të qeverisjes së përgjithshme, në bazë të vetëvlerësimit depoziton te titullari i njësisë publike dhe nëpunësi i parë autorizues deklaratën dhe raportin përkatës për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrollit të brendshëm të njësisë publike që mbulon, për vitin e mëparshëm, jo më vonë se fundi i muajit shkurt aktual*”.

MTM, në bazë të nenit 19 të ligjit nr.10296, datë 08.07.2010, i ndryshuar me ligjin nr.110/2015, ka hartuar dhe dërguar pyetësorin vjetor të vetëvlerësimit të sistemit të kontrollit të brendshëm për vitin 2021 dhe vitin 2022 me shkresat nr. 2426 datë 28.02.2022, dhe nr. 1550 datë 28.02.2023 drejtuar strukturës përgjegjëse për Harmonizimin e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.

Me anë të shkresave të cituara, MTM ka dërguar deklaratat për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm dhe raportet për funksionimin e kontrollit të brendshëm në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë. Struktura e raportimit respekton përcaktimet e Udhëzimit nr. 28, datë 15.12.2011 “*Mbi paraqitjen e Deklaratës dhe Raportit Vjetor për cilësinë e Sistemit të Kontrollit të Brendshëm në Njësitë Publike*”.

Referuar përgjigjeve të pyetësorit, më poshtë rendisim punën e kryer nga institucioni i MTM-së, si dhe mangësitë e konstatuara në plotësimin e kërkesave që kërkojnë komponentët e kontrollit të brendshëm në drejtim të funksionimit me përgjegjshmëri, realizimit të objektivave të institucionit dhe përdorimit me efektivitet të fondeve të tij. Aktivitetet e planifikuara për tu ndërmarrë me qëllim zgjidhjen e mangësive të zbuluara gjatë përgatitjes së raporteve vjetore mbi funksionimin e sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit janë si më poshtë:

Nga auditimi u konstatua se MTM ka ngritur Ekipin e Menaxhimit të Programit me shkresat nr.



5398 prot., datë 28.07.2020, nr. 8567 prot., datë 24.12.2020, nr.6062 prot., datë 05.08.2022 dhe nr. 3620 prot., datë 15.04.2022 në zbatim të udhëzimit nr.7, datë 28.02.2018 të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë “Për procedurat standarde të përgatitjes së PBA-së” paragrafi 2.5 pika 1/a në njësitë e qeverisjes qendrore që zbatojnë më shumë se një program buxhetor.

Drejtuues programi si rregull është respektivisht nëpunësi autorizues i njësisë publike. Paragrafi 2.5 pika 2 citon se “Drejtuuesit e programit janë përgjegjës për të garantuar që janë duke u realizuar siç duhet përgjegjësitë e ekipit të menaxhimit të programit, si një komponent kyç i organizimit institucional për përgatitjen e kërkesave buxhetore”.

Sipas Manualit të MFK, në kreun III, “Komponentët e menaxhimit financiar dhe kontrollit”, neni 19 citohet: *Titullarët e njësive të sektorit publik, zbatojnë menaxhimin financiar dhe kontrollin nëpërmjet komponentëve të ndërlidhur me njëri-tjetrin:*

1. *Mjedisi i kontrollit.*
2. *Menaxhimi i riskut.*
3. *Veprimtaritë e kontrollit.*
4. *Informacioni dhe komunikimi.*
5. *Monitorimi.*

## **1. Mjedisi i kontrollit**

Mjedisi i kontrollit është baza e menaxhimit të fondeve buxhetore dhe përbën themelin, ku ngrihen të gjithë komponentët e tjerë të kontrollit të brendshëm. Mjedisi i kontrollit përban: Integritetin personal dhe etikën profesionale të nivelit menaxhues dhe punonjësve të tjerë të njësive publike; politikat menaxheriale dhe stilin e punës; strukturën organizative, garantimin e ndarjes së detyrës, hierarkinë dhe rregulla të qarta, të drejtat, përgjegjësitë dhe linjat e raportimit; Politikat dhe praktikatat e menaxhimit të burimeve njerëzore dhe aftësitë profesionale të punonjësve.

**a. Integriteti personal dhe etika profesionale e nivelit menaxhues dhe punonjësve të tjerë të kësaj njësie publike.**

Në referencë të ligjit nr. 9131, datë 08.09.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike”, si dhe ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, nevojitet që punonjësit të respektojnë normat etike dhe profesionale të bashkëpunimit e të ndihmës së ndërsjellë, mbështetur në krijimin e një Kodi të Brendshëm Etik. Nga auditimi u konstatua se, institucioni ka hartuar dhe zbaton një kod etike, i cili është miratuar me Urdhrin e Ministrit të MTM me nr.412 datë 02.11.2018.

**b. Struktura organizative, garantimi i ndarjes së detyrave, rregullat e qarta, të drejtat, përgjegjësitë dhe linjat e raportimit.**

Deri më 15.11.2022, MTM ka funksionuar në bazë të strukturës së miratuar me Urdhër të Kryeministrit Nr. 165, datë 05.10.2017, “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit”, e cila ka pësuar ndryshime me Urdhrin e Kryeministrit me nr. 127 datë 08.11.2021 “ Për disa ndryshime në Urdhrin nr.165, datë 05.07.2017.”

Aktualisht, MTM funksionon në bazë të strukturës së miratuar me Urdhër të Kryeministrit Nr. 185, datë 15.11.2022, “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit”. Krahas tij janë edhe Urdhrat e Ministrit të MTM, të cilat përcaktojnë organikën e institucioneve në varësi. MTM ushtron veprimtarinë e vet mbi bazën e Rregullores së Organizimit dhe Funksionimit të Brendshëm, miratuar me Urdhrin e Ministrit të MTM me nr. 420, datë 07.11.2018 “Për miratimin e rregullores së brendshme për organizimin dhe funksionimin e MTM-së.” Nga ana e Grupit të Auditimit konstatohet se Rregulloja e Brendshme e MTM nuk ka reflektuar ndryshimet e strukturës organizative, pasi nuk është bërë rishikimi i saj; duke sjellë mangësi në ndarjen e detyrave, përgjegjësi dhe linjën e raportimit të punonjësve. Rregullorja e brendshme e funksionimit duhet të reflektojë të gjithë aspektet e organizimit dhe funksionimit administrativ në institucion. Në rregullore mungojnë përcaktimet e përgjegjësisë për kryerjen e raportimeve për buxhetin.

**c. Stili i të vepruarit dhe filozofia e menaxhimit.**

Nga ana e Grupit të Auditimit është konstatuar se në MTM nuk ka një rregullore të brendshme të përditësuar ku të, ku të jenë evidentuar delegimi i detyrave dhe mënyra e dokumentimit të tyre veprime këto në kundërshtim me ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, neni 15 “Rregulla të përgjithshme për delegimin e detyrave”, si dhe Kapitulli III “Delegimi i detyrave”, të Manualit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin.

*d. Politikat dhe praktikat e menaxhimit të burimeve njerëzore.*

Në MTM, burimet njerëzore menaxhohen nga Drejtoria e Mirëadministrimit të Burimeve Njerëzore, në varësi të së cilës është Sektori i Burimeve Njerëzore dhe Arkiv Protokollit. Nga auditimi u konstatua se për periudhën objekt auditimi janë kryer dhe janë përfshirë në dosje vlerësimet e punonjësve për vitet 2020-2022.

*e. Për ruajtjen dhe zhvillimin e kompetencave profesionale të punonjësve gjatë viteve objekt auditimi, u konstatua se nga ana e Sektorit të Burimeve Njerëzore në MTM nuk janë paraqitur programe specifike për trajnimin e punonjësve të administratës, veprime në kundërshtim me Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, Kap. II, pika 2.5.1 “Mjedisi i kontrollit (ose mjedisi i brendshëm i njësisë)”, paragrafët “Politikat dhe praktikat që lidhen me burimet njerëzore” dhe “Profesionalizmi i stafit”. Punonjësit e institucionit kanë kryer trajnime të ndryshme gjithëpërfshirëse, kryesisht të organizuara nga ASPA, për të cilat ka qenë e pamundur sigurimi i informacionit mbi trajnimet dhe ndjekjen e tyre nga ana e stafit të MTM-së.*

## **2. Menaxhimi i riskut**

Risku dhe menaxhimi i riskut përcaktohet në Nenin 21 të Ligjit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin. Risku zakonisht përcaktohet si pasiguria e rezultatit, qoftë kjo mundësi pozitive apo negative i veprimeve dhe ngjarjeve. Kjo është mundësia që një ngjarje e caktuar, e cila do të ketë ndikim në arritjen e objektivave të njësisë, mund të ndodhë. Risku matet me efektin e tij dhe shkallën e mundësisë së ndodhjes. Menaxhimi i riskut përfshin identifikimin, vlerësimin, kontrollin dhe monitorimin e këtyre ngjarjeve të mundshme apo situatave që mund të kenë një efekt negativ në arritjen e objektivave të njësive dhe është projektuar për të dhënë siguri të arsyeshme se objektivat do të arrihen.

Nga auditimi u konstatua se nuk janë kryer takime me stafin menaxherial mbi çështjet e menaxhimit të riskut, diskutimin e problematikave dhe dokumentimin e veprimtarisë së përditshme të menaxhimit të riskut. MTM nuk ka hartuar strategjinë për menaxhimin e riskut, veprim në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar, pika 2, neni 21 “Menaxhimi i Riskut”, ku citohet:...”*Titullari i njësisë publike miraton një strategji, e cila përditësohet çdo tre vjet ose sa herë që ka ndryshime thelbësore të mjedisit të risku. Nëpunësi autorizues analizon dhe përditëson kontrollet që synojnë minimizimin e riskut, të paktën një herë në vit.*”, si dhe me udhëzimin e MFE nr. 16, datë 20.07.2016, “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike”, pika 3.2.1 ku citohet:...”*Titullari i njësisë publike është përgjegjës për përcaktimin e objektivave dhe strategjisë. Kjo përfshin: Menaxhimin efektiv të riskut*”.3.2.2 “*Nëpunësi autorizues/koordinatori i riskut ka përgjegjësi për: Ngritjen dhe funksionimin e sistemit të MR, përcaktimin e nivelit të oreksit të riskut; Vlerësimin e sistemit të MR (...)*”.

Mbështetur në nenin 18, të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar, me shkresën nr. 1550 prot., datë 28.02.2023, Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar ka dërguar në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik në MFE, Deklaratën për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm; Raportin për funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm të MTM, i cili është përmbledhje e raportit vjetor për menaxhimin financiar dhe kontrollin e Drejtorisë së Auditit të Brendshëm në MTM; Pyetësorin e vetëvlerësimit për komponentët e MFK-së nëpërmjet të cilit synohet ndërjegjësim i mëtejshëm mbi rëndësinë dhe efektivitetin e sistemit të kontrollit të brendshëm; Planin e veprimit; si dhe Regjistrin e riskut për vitin 2022.

**Nga auditimi i regjistrit të riskut për vitin 2022**, i cili përmbledh regjistrat e risqeve dhe planet e veprimit së të gjithë strukturave të MTM-së, u konstatua se nuk janë përgatitur dhe dërguar te NA, regjistri i riskut nga secila drejtori përkatëse, veprim ky në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar pika neni 11, ku citohet... “Menaxherët e tjerë të strukturave të të gjitha niveleve të njësisë publike janë përgjegjës dhe raportojnë dhe i japin llogari eprorit, sipas shkallës hierarkike, për:

2. Identifikimin dhe krijimin e regjistrit të riskut, vlerësimin, kontrollin e risqeve që vënë në rrezik arritjen e objektivave dhe realizimin me sukses të veprimtarive të strukturave që ata drejtojnë”.

Nga ana e Grupit të Auditimit konstatohet se për vitin 2020 dhe 2021, MTM nuk ka ngritur Grupin e Menaxhimit Strategjik. Për vitin 2022, , është ngritur Grupi për Menaxhimin Strategjik (GMS) me shkresën nr. 3619 prot., datë 14.04.2022.

Nga auditimi i funksionimit të sistemeve të kontrollit të brendshëm për vitin 2022, rezultoi se në MTM ka mungesë të ngritjes së GMS për vitin 2021. Gjithashtu, nuk ka takime të dokumentuara të veprimtarisë së GMS-së, i cili duhet të mbledhet të paktën 4 herë në vit, veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar, pika nr. 1, e nenit 27 “Takimet periodike ndërmjet menaxherëve të njësisë publike”, si dhe me Udhëzimin nr. 16 të MFE, datë 20.07.2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinitorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinitorit të riskut në njësitë publike” pika nr. 3, paragrafi 2.2.4 “Roli i GMS në sistemin e MFK”, së, e cila përcakton se: “GMS duhet të mbledhet të paktën katër herë në vit. Vendimet duhet të jenë objektive dhe të merren si grup, (...).Vendimet e GMS duhet të regjistrohen nga sekretari dhe vihen në dispozicion të drejtimit të njësisë publike.” Gjithashtu, GMS nuk ka realizuar përgjegjësinë e rishikimit jo më pak se dy herë në vit të regjistrit të riskut, veprim ky në kundërshtim me Udhëzimin nr. 16, datë 20.07.2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinitorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinitorit të riskut në njësitë publike”, ku përcakton se “GMS është përgjegjës të sigurojë se regjistri i riskut për programe/objektiva specifik rishikohet jo më pak se dy herë në vit”.

### **3. Aktivitetet e kontrollit**

Nga auditimi u konstatua se MTM nuk ka të miratuar një rregullore të përditësuar me ndryshimet ligjore në fuqi, duke përfshirë dhe ndryshimet në organikën e institucionit të MTM-së dhe njësive të varësisë, duke përcaktuar qartë detyrat. Rrjedhimisht, nuk ka miratuar Gjurmën e Auditimit, si një dokument të unifikuar për të gjitha proceset e MTM-së, në kundërshtim me përcaktimet e pikave nr. 2 dhe 3, të nenit 16, “Detyrimi për përgatitjen dhe dokumentimin e gjurmës së auditimit”, të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar, ku citohet... “2. Titullarët e njësive publike miratojnë gjurmët e auditimit për procedura që lidhen me veprimtari kryesore të njësisë dhe sigurojnë që të gjitha operacionet e njësisë publike dokumentohen në atë formë, që u mundëson audituesve të brendshëm, të jashtëm dhe autoriteteve mbikëqyrëse të kuptojnë mjedisin e kontrollit. 3. Gjurma e auditimit arkivohet sipas dispozitave ligjore në fuqi”.

Nga ana e Grupit të Auditimit u konstatua se, MTM nuk disponon një regjistër kontabël të plotë aktiveve, veprim ky në kundërshtim me udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”, Kreu III “Regjistri i aktiveve të njësive të sektorit publik”, paragrafi 26, përcakton se: “Çdo njësi publike duhet të krijojë dhe të përditësojë një regjistër kontabël të të gjitha aktiveve që zotëron apo ka në administrim, përfshi dhe pronat publike nga të cilat siguron të ardhura. Regjistri mbahet në formën e kartelave ose në formë të sintetizuar”.

Gjithashtu, u konstatua se me urdhrin e Ministrisë z. B. K. me nr. 01, datë 05.01.2021 “Për delegimin e kompetencave” ku, urdhëron delegimin e kompetencave të Titullarit të Autoritetit Kontraktor, z. E.Q. me detyrë Drejtor i Përgjithshëm i Drejtorisë Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse, për të gjitha procedurat e prokurimit publik me fonde buxhetore, për MTM, ku kompetencat e deleguara te Titullarit të AK do të ushtrohen për periudhën nga hyrja në fuqi e këtij urdhri deri në datën 13 Dhjetor 2021. Sa më sipër, delegimi i kompetencave është kryer në kundërshtim me

Ligjin nr. 10 296, datë 08.07.2010, i ndryshuar me Ligjin nr. 110/2015, datë 15.10.2015 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i unifikuar dhe manualit të MFK-së miratuar me urdhrin nr. 108, datë 17.11.2016 të MFE ku përcaktohet tek pikat: Roli i Nëpunësit Autorizues të Njesisë Gjatë zbatimit të detyrave të tij, NA ka të drejtë të delegojë një pjesë të tyre sipas përcaktimeve të Ligjit për MFK. Njëkohësisht Ligji për MFK përcakton edhe detyrat dhe të drejtat të cilat nuk mund të delegohen.

#### 4. Informimi dhe komunikimi

Nga auditimi u konstatua se, përgjithësisht komunikimi me titullarin dhe nëpunësit e tjerë është bërë në formën dhe kohën e duhur, për ti ndihmuar ata në përmbushjen e detyrave dhe të përgjegjësi. Titullari është informuar nga drejtuesit me anë të mbledhjeve, nëpërmjet relacioneve dhe raporteve rreth këtyre mbledhjeve. Drejtuesit e programeve kanë raportuar tek nëpunësi autorizues për ecurinë e veprimtarisë, planeve të punës dhe objektivave të vendosur për realizimin e politikave, duke hartuar raporte monitorimi periodike në varësi të punës. Punonjësit brenda institucionit komunikojnë me postë elektronike dhe në mënyrë verbale, ndërsa jashtë institucionit komunikohet kryesisht në formë shkresore zyrtare dhe ka korrespondencë të rregullt me subjektet e tjera, pa përjashtuar komunikimin elektronik dhe atë telefonik. Ministria e Turizmit dhe Mjedisit ka faqen e saj zyrtare në internet dhe nëpërmjet kësaj të fundit të gjithë të interesuarit mund të informohen rreth veprimtarisë së institucionit.

#### 4. Monitorimi

Nga auditimi konstatohet se në vijim të përcaktimit në pikën 23/1 të nenit 4 të ligjit nr. 10 296, datë 08.07.2010 i ndryshuar me Ligjin nr. 110/2015, datë 15.10.2015 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin: “Nëpunës autorizues i nivelit të dytë”, dhe /ose të niveleve të tjera, janë nëpunës të administratës publike në secilën nga njësitë e vartëse, me buxhet më vete të njësisë së qeverisjes së përgjithshme, përgjegjës për përgatitjen, zbatimin, kontrollin e brendshëm financiar, monitorimin, raportimin, kontabilitetin dhe auditimin e brendshëm të buxhetit të tyre, që përgjigjet përpara nëpunësit autorizues...”, për periudhën objekt auditimi janë hartuar raportet e monitorimit 4-8-12 mujore të buxhetit të MTM-së së bashku me institucionet e varësisë të cilat dërgohen në Ministrinë e Financave, por MTM si institucion buxhetor më vete nuk ka hartuar raportet e monitorimit të buxhetit të Aparatit veprime në kundërshtim me pikën 42 kapitulli III të 41.2 kapitulli III, të Udhëzimit nr. 22, datë 17.11.2016, “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në njësitë e Qeverisjes Qendrore”.

Nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit nuk ka asnjë plan monitorimi periodik me objektiva të qarta mbi projektet të finalizuara sa i takon zhvillimit të turizmit. Nuk ka një analize mbi impaktin që kanë patur dhe kanë këto projekte në zhvillimin e turizmit.

<b>Titulli i Gjetjes:</b>	Mos implementimi i një sistemi të përshtatshëm rregullash të menaxhimit financiar dhe kontrollit.
<b>Situata:</b>	Nga auditimi i sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit në MFE, rezultoi se nuk janë implementuar si duhet kërkesat e ligjit 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, për arsye se: Nga auditimi i sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit në MFE, rezultoi se: - Drejtoria e Mirëadministrimit të Burimeve Njerëzore, Aseteve dhe Shërbimeve në MTM nuk ka paraqitur programe specifike për trajnimin e punonjësve të administratës; - Nuk janë kryer takime me stafin menaxherial mbi çështjet e menaxhimit të riskut, diskutimin e problematikave dhe dokumentimin e veprimtarisë së përditshme të menaxhimit të riskut, si dhe MFE nuk ka hartuar strategjinë për menaxhimin e riskut;

	<p>- Nuk janë përgatitur dhe nuk janë dërguar te NA, regjistri i riskut nga drejtoritë përkatëse, të cilët përmblihen në regjistrin e riskut të vitit 2022 të MTM-së;</p> <p>- Nuk ka takime të dokumentuara të veprimtarisë së GMS, i cili duhet të mblihet të paktën 4 herë në vit, GMS nuk ka kryer përgjegjësinë e rishikimit, jo më pak se dy herë në vit të regjistrin të riskut. Veprimet e mësipërme janë kryer në kundërshtim me pikën 2 të nenit 21, me pikën 2 të nenit 11, me pikën 1 të nenit 27, pikave nr. 1, 2 dhe 3 të nenit 16, të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar, si dhe me Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, Kap. II, pika 2.5.1.</p>
<b>Kriteri:</b>	Ligji 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar. Udhëzimi nr. 16, datë 20.07.2016, “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike” të Ministrisë të Financave. Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”.
<b>Ndikimi/Efekti:</b>	Mangësi në implementimin dhe respektimin e detyrimeve që rrjedhin nga zbatimi i ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar si dhe në udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”.
<b>Shkaku:</b>	Moszbatimi i bazës ligjore në fuqi, e cila rregullon proceset e punës në fushën e MFK-së.
<b>Rëndësia:</b>	E lartë
<b>Rekomandimi:</b>	Strukturat përgjegjëse të MTM-së, të marrin masa për plotësimin e mangësive të evidentuara, si dhe implementimin e një sistemi të përshtatshëm rregullash të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, konform përcaktimeve të ligjit të MFK-së dhe akteve të dala në zbatim të tij, për ta bërë atë efektiv dhe në dobi të veprimtarisë institucionale.

## 6.2. Vlerësimi i auditimit të brendshëm

Në zbatim të kësaj pike të auditimit, nga auditimi i kryer në Drejtorinë e Auditimit të Brendshëm (DAB), të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit (MTM), rezultoi se:

### 6.2.1. Planifikimi dhe miratimi i Programit Vjetor dhe Planit Strategjik

Në MTM gjatë periudhës objekt auditimi kanë ndodhur ndryshime organizative, operacionale dhe ligjore, si në aparatin e ministrisë ashtu edhe në institucionet e varësisë. Sa i takon Planit Strategjik dhe Vjetor të përgatitur nga njësia e AB, paraqitet si vijon:

#### Viti 2020

*Plani Strategjik dhe Plani Vjetor, i përgatitur nga njësitë e AB, pas miratimit nga titullari i institucionit, dërgohen jo më vonë se data 15 tetor e çdo viti pranë NjQH/AB.*

Plani strategjik 2020-2022 dhe plani vjetor 2020 janë miratuar nga Ministri i MTM me shkresën nr. 8299/1 prot., datë 30.12.2019.

Me anë të shkresës nr. 8299/1 prot., datë 30.12.2019, MTM, ka dërguar Planin Vjetor dhe Strategjik në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik, në Ministrinë së Financave dhe Ekonomisë.

-Plani Strategjik për periudhën 2020 – 2022, përbëhet nga :

- Vlerësimi i nivelit të riskut për subjektet për vitin 2020 – 2022;
- Plani Strategjik i subjekteve të synuara për tu audituar 2020 – 2022;

- Plani i Angazhimeve të NJAB për vitin 2020;
- Planifikimi vjetor i nevojave për trajnim të NJAB për vitin 2020;
- Planifikimi vjetor i buxhetit dhe shpërndarja e burimeve të NJAB për vitin 2020.

Bazuar në Planin Strategjik 2020 – 2022 janë parashikuar gjithsej 19 angazhime auditimi në subjektet e varësisë dhe Aparatin e MTM. Në planin vjetor 2020, DAB ka parashikuar gjithsej 7 angazhime auditimi, nga të cilat 5 auditime të kombinuara, 1 auditim financiar dhe 1 auditim performancës, si vijon:

- Auditimi i performancës me temë “Sistemi i implementimit të rregullave dhe standardeve në fushën e licencimit dhe monitorimit të mjedisit, turizmit etj” është programuar në subjektin Drejtoria e Përgjithshme e Rregullatore dhe Përputhshmërisë në Turizëm dhe Mjedis, në Aparatin e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit.
- Auditimi financiar në Drejtorinë e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar, në Aparatin e MTM-së;
- Auditimet e kombinuara janë programuar të kryhen në Aparatin e MTM-së dhe institucionet e varësisë

Sa më sipër, nga ana e MTM janë planifikuar dhe realizuar auditimet si vijon:

Nr.	Auditime të planifikuara dhe realizuara
1	Ministria e Mjedisit(detyrimet e prapambetura)
2	Agjencia Kombëtare e Mjedisit
3	Agjencia Kombëtare e Mjedisit Berat
4	Agjencia Kombëtare e Mjedisit Fier
5	Agjencia Kombëtare e Mjedisit Lezhë
6	Agjencia Kombëtare e Mjedisit Tiranë
7	Projekte mjedisore
8	Projekte mjedisore

Burimi: MTM

Nga 8 auditime të planifikuara janë realizuar 8 prej tyre.

### **Viti 2021**

*Plani Strategjik dhe Plani Vjetor, i përgatitur nga njësitë e AB, pas miratimit nga titullari i institucionit, dërgohen jo më vonë se data 15 tetor e çdo viti pranë NjQH/AB.*

Plani strategjik 2021-2023 dhe plani vjetor 2021 janë miratuar nga Ministri i MTM me shkresën nr. 6499/1 prot., datë 09.12.2020.

Me anë të shkresës nr. 6499/2 prot., datë 09.12.2020, MTM, ka dërguar Planin Vjetor dhe Strategjik në Drejtorisë së Përgjithshme të Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik, në Ministrinë së Financave dhe Ekonomisë.

-Plani Strategjik për periudhën 2021 – 2023, përbëhet nga :

- Vlerësimi i nivelit të riskut për subjektet për vitin 2021-2023
- Plani Strategjik i subjekteve të synuara për tu audituar 2021-2023
- Plani i Angazhimeve të NJAB për vitin 2021.
- Planifikimi vjetor i nevojave për trajnim të NJAB për vitin 2021.
- Planifikimi vjetor i buxhetit dhe shpërndarja e burimeve të NJAB për vitin 2021

Bazuar në Planin Strategjik 2021-2023 janë parashikuar gjithsej 15 angazhime auditimi në subjektet e varësisë dhe Aparatin e MTM. Në planin vjetor 2021, DAB ka parashikuar gjithsej 8 angazhime auditimi, nga të cilat 6 auditime të kombinuara, 1 auditim financiar dhe 1 auditim performancës, si vijon:

- Auditimi i performancës me temë “Vlerësim i performancës së strukturave, në hartimin dhe implementimin e strategjive të fushës së mbrojtjes të mjedisit” është programuar në subjektin

Drejtoria e Përgjithshme e Politikave dhe Zhvillimit të Mjedisit, në Aparatin e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit.

- Auditimet e kombinuara janë programuar të kryhen në Aparatin e MTM dhe institucionet e varësisë

Sa më sipër, nga ana e MTM janë planifikuar dhe realizuar auditimet si vijon:

Nr.	Auditime të planifikuara dhe realizuara
1	Aparati i MTM
2	Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura
3	Agjencia Kombëtare Z.M, Qarku Shkodër, Lezhë
4	Agjencia Kombëtare Z.M, Qarku Kukës
5	Agjencia Kombëtare Z.M, Qarku Korçë, Berat
6	Agjencia Kombëtare Z.M, Qarku Dibër
7	Agjencia Rajonale e Mjedisit Lezhë
8	Agjencia Rajonale e Mjedisit Tiranë

Burimi: MTM

Nga DAB, për vitin 2021 janë planifikuar 8 auditime, të cilat janë realizuar 100%.

### Viti 2022

Plani Strategjik dhe Plani Vjetor, i përgatitur nga njësitë e AB, pas miratimit nga titullari i institucionit, dërgohen jo më vonë se data 15 tetor e çdo viti pranë NjQH/AB.

Plani strategjik 2022-2024 dhe plani vjetor 2022 janë miratuar nga Ministri i MTM me shkresën nr. 6193/2 prot., datë 09.12.2021.

Me anë të shkresës nr. 6193/2 prot., datë 09.12.2020, MTM, ka dërguar Planin Vjetor dhe Strategjik në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik, në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.

-Plani Strategjik për periudhën 2022 – 2024, përbëhet nga :

- Vlerësimi i nivelit të riskut për subjektet për vitin 2022 – 2024;
- Plani Strategjik i subjekteve të synuara për tu audituar 2022 – 2024;
- Plani i Angazhimeve të NJAB për vitin 2022;
- Planifikimi vjetor i nevojave për trajnim të NJAB për vitin 2022;
- Planifikimi vjetor i buxhetit dhe shpërndarja e burimeve të NJAB për vitin 2022.

Bazuar në Planin Strategjik 2022 – 2024 janë parashikuar gjithsej 30 angazhime auditimi në Aparatin dhe subjektet e varësisë të MTM-së. Në Planin Vjetor 2022, DAB ka parashikuar gjithsej 10 angazhime auditimi, nga të cilat 10 auditime të kombinuara.

Sa më sipër, nga ana e MTM janë planifikuar dhe realizuar auditimet si vijon:

Nr.	Auditime të planifikuara dhe realizuara
1	Agjencia Rajonale Mjedisit Berat
2	Agjencia Rajonale Mjedisit Fier
3	Agjencia Kombëtare e Mjedisit
4	Drejtoria e Buxhetit & Menaxhimit Financiar në MTM
5	Drejtoria Konceptimi & Fizibilitetit të Projekteve
6	Drejtoria e Integritit dhe Asistencës ( struktura IPA)
7	Zbatim Rekomandime
8	Agjencia Kombëtare e Bregdetit
9	Agjencia Kombëtare e Turizmit
10	Agjencia Kombëtare e Pyjeve

Burimi: MTM

Nga DAB për vitin 2022 janë planifikuar 10 auditime, të cilat janë realizuar 100%.

Nga ana e grupit të auditimit u konstatua se Plani Strategjik dhe Plani Vjetor janë dërguar me vonesë për të tre vitet, veprim në kundërshtim me Manualin e Auditimit të Brendshëm, pika 3.3 ku citohet ...“Plani Strategjik dhe Plani Vjetor, i përgatitur nga njësitë e AB, pas miratimit nga titullari i institucionit, dërgohen jo më vonë se data 15 tetor e çdo viti pranë NjQH/AB.

### **6.2.2. Kapacitetet audituese të Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm**

Struktura e Auditimit të Brendshëm në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit është e organizuar në rang Drejtorie dhe përmban në organikën e saj 5 auditues (1 përgjegjës sektori dhe 4 specialist), sipas Urdhrit të Kryeministrit me nr.185, datë 15.11.2022, “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit”, me ndryshimet përkatëse.

Nga auditimi u konstatua se, gjatë vitit 2021, DAB ka funksionuar me strukturë të paplotësuar, duke pasur 2 vende vakante në pozicionin e specialistit.

Punonjësit e DAB kanë arsim bazë: 3 prej tyre profil ekonomik, dhe të gjithë punonjësit janë të pajisur me certifikatën “Auditues i Brendshëm në sektorin publik” dhe kanë përvojë pune, mbi 5 vite si auditues të brendshëm. Pra, punësimi i tyre është bërë në përputhje me nenin 11, të ligjit nr. 114, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion grupit të auditimit, u konstatua se, punonjësit e DAB i kanë kryer trajnimet e vijueshme të detyrueshme, 40 orë në vit dhe kanë marrë pjesë në të gjitha trajnimet që ka organizuar Njësia Qendrore e Auditit të Brendshëm (NJQAB).

Njësia e auditimit funksionon në mënyrë të pavaruar dhe raporton drejtpërdrejtë tek titullari i njësisë publike, Ministri i Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, ndërsa varësia organizative është nga Sekretari i Përgjithshëm.

#### Karta e Auditimit.

Në vlerësim me përputhshmërinë e zbatimit të nenit 14, “Përgjegjësitë e drejtuesit të njësisë së auditimit të brendshëm”, të ligjit nr. 114, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, nga auditimi u konstatua se drejtori i DAB ka hartuar “Kartën e Auditimit” dhe është miratuar me urdhrin nr. 1072/1, datë 10.02.2017, të Ministrit të MTM-së.

#### **Zbatimi i procedurave në dokumentimin e punës, evadimi, ruajtja dhe arkivimi i tyre.**

Grupi i auditimit shqyrtoi për vlerësim, 4 dosje me zgjedhje të rastësishme të angazhimeve të kryera nga DAB për periudhën objekt auditimi. Dosje të subjekteve:

- Agjencia Kombëtare e Mjedisit;
- Aparati i Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit;
- Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura;
- Agjencia Rajonale e Mjedisit Fier, Vlorë dhe Gjirokastrë.

Nga auditimi u konstatua se për çdo angazhim, grupet e punës kanë krijuar një dosje të veçantë, kanë grumbulluar informacionet e nevojshme për përgatitjen e Raporteve të Auditimit. Audituesit i kanë analizuar informacionet e grumbulluara nëpërmjet metodave dhe teknikave të përdorura të auditimit, që janë gjykuar më të përshtatshme dhe të besueshme për subjektin. Në dosjet e auditimit u gjenden të administruara e të firmosura, të gjitha dokumentet sipas modelit të Fomatit Standard nr. 1, në Kapitullin VI, të Manualit të Auditimit të Brendshëm, i ndryshuar, janë kryer vlerësimet e riskut për mjedisin e përgjithshëm të kontrollit, janë organizuar takimet fillestare me subjektet, janë bërë ndarjet e detyrave për çdo auditues, si dhe pyetësorët e dhënë nga grupet e auditimeve, të cilat lënë gjurmë dhe dëshmojnë mbi proceset e ndjekura për zbatimin e programit të auditimit të miratuar. Gjithashtu, u konstatua se janë respektuar afatet për dërgimin e projektraportit dhe raportit përfundimtar të auditimit, në përputhje me kërkesat e Manualit për Auditin e Brendshëm, i ndryshuar; si dhe në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 114/2015, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”. Grupet e auditimit pas angazhimeve në terren, në zbatim të pikës 4.1.12. Hapi 11: “Raportet e auditimit dhe plotësimi i plan veprimit nga njësia e audituar”, Kapitulli IV, i Manualit të Auditimit të Brendshëm, i ndryshuar; kanë përcjellë në subjektet e audituara, së bashku me raportin përfundimtar edhe plan veprimin e sugjeruar për realizimin e rekomandimeve. Në zbatim të standardeve të Kapitullit VII “Sigurimi i cilësisë së punës të auditimit të brendshëm”, 4.1.10. Hapi 9: “Rishikimi i punës së Auditimit” në Manualin e Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik, i ndryshuar; i cili citon: Sigurimi i cilësisë ka rëndësi të veçantë, pasi nëpërmjet rishikimit duhet të sigurohet nëse puna e AB është kryer në përputhje me Standarde.



Në vlerësim të përputhshmërisë me këtë standard, nga auditimi u konstatua se dokumenti “Rishikimi i Cilësisë së Punës” për dosjet e përzgjedhura, ishte në përputhshmëri të plotë. Në përfundim të çdo angazhimi auditues, drejtori i DAB ka përcjellë tek Titullari i Institucionit, Memo të nënshkruar (përmbledhje e shkurtër e raportit përfundimtar). Në zbatim të kërkesave të parashikuara në “Normat tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë”, ligji nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat”, një kopje e dokumenteve të dosjeve të auditimeve (shkresa dhe/ose dokumente që lidhen me të), duhet të protokollohen e të dorëzohen në arkivën e Institucionit. Në vlerësim me përputhshmërinë e zbatimit të këtij ligji, nga auditimi u konstatua se dosjet e angazhimeve për vitin 2021, janë protokolluar e arkivuar.

<b>Titulli i Gjetjes:</b>	Mosplotësimi i strukturës dhe mosfeksionimi i Komitetit të Auditimit të Brendshëm
<b>Situata:</b>	<p>- Struktura e Auditimit të Brendshëm në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit është e organizuar në rang Drejtorie dhe përmban në organikën e saj 5 auditues (1 përgjegjës sektori dhe 4 specialist), sipas Urdhrit të Kryeministrit me nr.185, datë 15.11.2022, “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit”, me ndryshimet përkatëse.</p> <p>Nga auditimi u konstatua se, gjatë vitit 2021, DAB ka funksionuar me strukturë të paplotësuar, duke pasur 2 vende vakante në pozicionin e specialistit.</p> <p>-Nga ana e Grupit të Auditimit u konstatua se nuk është ngritur Komiteti i Auditimit të Brendshëm nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, veprim në kundërshtim me Ligjin nr.114, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” i ndryshuar, neni 12 germa b “Titullarët e njësisve publike janë përgjegjës për: b) krijimin e Komitetit të Auditimit të Brendshëm në njësitë publike përkatëse sipas kriterëve të miratuara me vendim të Këshillit të Ministrave, sipas shkronjës “b” të nenit 23 të këtij ligji “.</p>
<b>Kriteri:</b>	<p>Ligji nr.114, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” i ndryshuar, neni 12 germa b.</p> <p>VKM nr.160 datë 02.03.2016 “Për mënyrën e funksionimit, kompetencat dhe përbërjen e komitetit të auditimit të brendshëm në njësitë publike”.</p>
<b>Ndikimi/Efekti:</b>	Mungesa e garancisë së arsyeshme për mënyrën e funksionimit të njësisë publike dhe monitorimit të çështjeve që lidhen me funksionimin e kontrollit të brendshëm.
<b>Shkaku:</b>	Mos përmbushja e detyrimit ligjor në kuadër të përgjegjshmërisë menaxheriale, për miratimin e Komitetit të Auditimit të Brendshëm.
<b>Rëndësia:</b>	I mesëm
<b>Rekomandimi:</b>	<p>-Ministria e Turizmit dhe Mjedisit të marrë të gjitha masat e nevojshme me qëllim plotësimin e strukturës të Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm me personel me qëllim mbarëvajtjen e punës së kësaj drejtorie dhe të gjithë institucionit për shkak të rolit të rëndësishëm që kjo drejtori ka në evidentimin e problematikave të menaxhimit.</p> <p>- Ministria e Turizmit dhe Mjedisit të marrë masa të menjëhershme për krijimin e Komitetit të Auditimit të Brendshëm, i cili ofron këshilla e rekomandime objektive Titullarit të njësisë publike në lidhje me funksionimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm, me qëllim arritjen e objektivave si dhe të mbështesë njësinë e auditimit të brendshëm në përmbushjen e përgjegjësisë të saj.</p>

## 2.7 Probleme të ndryshme që mund të dalim gjatë auditimit.

### MBI PROJEKTET PËR ZHVILLIMIT TË TURIZMIT:

#### Viti 2020

Në zbatim të ligjit nr. 93/2015 “Për Turizmin” i ndryshuar, neni 31 dhe VKM-së nr. 281, datë 13.04.2016 “Për përcaktimin e kriterëve të afateve të kërkesë propozimeve për mbështetjen financiare të projekteve në fushën e turizmit”.

Me urdhrin e Ministrit nr. 236, datë 19.09.2020 (prot 6052) është miratuar formulari i aplikimit dhe procedurave për përfitim e mbështetjes financiare lidhur me projektet në fushën e turizmit.

Në pikën 3 të urdhrin është përcaktuar se “Publikimi i procedurës për përfitime të mbështetjes financiare në lidhje me projektet e turizmit, në faqet zyrtare të ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, në media dhe në Buletinin e njoftimeve Zyrtare”.

Për zbatimin e urdhrin është ngarkuar Drejtoria e Programeve të Zhvillimit të Turizmit, sektori i Standardeve në Turizëm dhe Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar.

Në aneksin nr. 2 janë përcaktuar procedurat për përfitim e mbështetjes financiare ku kriteret e pjesëmarrjes janë sipas VKM-së 281, datë 13.04.2016 “Për përcaktimin e kriterëve e të afateve të kërkesë/propozimeve për mbështetjen financiare të projekteve në fushën e turizmit” pika 6.

Në vendimin nr. 325, datë 31.5.2018 “Për përcaktimin e anëtarëve të komisionit të përzgjedhjes së projekteve në turizëm” citon:

1. Përcaktimin e anëtarëve të Komisionit të Përzgjedhjes së Projekteve në Turizëm, përfaqësues të ministrisë përgjegjëse për turizmin, si më poshtë vijon:

- Sekretari i Përgjithshëm, kryetar;
- Drejtori i Përgjithshëm i Politikave dhe Zhvillimit të Turizmit, anëtar;
- Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë Kombëtare të Turizmit, anëtar;
- Drejtori i Politikave dhe Strategjive të Zhvillimit të Turizmit, anëtar;
- Drejtori i Konceptimit dhe Fizibilitetit të Projekteve të Turizmit, anëtar

2. Përcaktimin e anëtarëve të Komisionit të Përzgjedhjes së Projekteve në Turizëm, përfaqësues të shoqatave në sektorin e turizmit, si më poshtë vijon:

- Shoqata Shqiptare e Turizmit (ATA);
- Shoqata “A. I.T. A.”

Komisioni i përzgjedhjes së projekteve përbëhet nga 3 anëtar nga:

Z. A.K, Sekretar i Përgjithshëm në MTM;

Znj. K.F, Drejtor i Agjencisë Kombëtare të Turizmit;

Znj. A. B. Drejtor i Drejtorisë së Politikave dhe Strategjive të Zhvillimit të Turizmit.

#### **Konstatimi:**

Ngritja e komisionit është kryer në kundërshtim me Vendimin nr. 325, datë 31.5.2018 “Për përcaktimin e anëtarëve të komisionit të përzgjedhjes së projekteve në turizëm” pasi në përbërjen e grupit duhet të jenë 7 anëtarë, ku dy nga anëtarët të jenë sipas përcaktimeve të 2 të vendimit.

*Ministria e Turizmit dhe Mjedisit shpall thirrjen për përfitim e mbështetjes financiare të projekteve në fushën e turizmit nga data 14/09/2020 deri me datën 14/10/2020.*

**Qëllimi kryesor** i kësaj thirrjeje ishte forcimi i konkurrencës dhe qëndrueshmërisë në sektorin e turizmit në Shqipëri, nisur edhe nga situata në të cilën ndodhej industria e turizmit për shkak të gjendjes së epidemisë të shkaktuar nga infeksioni COVID 19, ku ishte i nevojshëm fokusi në promovimin e destinacioneve turistike e të vlerave të trashëgimisë kulturore dhe natyrore vendase, si dhe duke diversifikuar me modele inovative produktet turistike, duke zhvilluar modele te reja të funksionimit të aktiviteteve detare dhe menaxhimit të vijës bregdetare.

**Duke patur parasysh këto objektiva kryesore, për thirrjen e vitit 2020 thirrja ishte e ndarë në dy tematika:**

1. *Promovimin e destinacioneve turistike e të vlerave të veçanta të produkteve dhe atraksioneve turistike.*

Nën këtë tematikë, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit do të bashkë financonte projekte që do të synojnë:

- Zgjerimin e aktiviteteve dhe ofertave turistike, duke synuar forcimin apo krijimin e produkteve të reja turistike, që shkojnë për zhvillimin e vendit dhe përfitimet e mundshme për popullsinë lokale të rajoneve të ndryshme.
- Përfshirjen gjithnjë e më shumë në sektorin e turizmit të komuniteteve lokale, studentëve në promovimin përmes produktit turistik sipas karakteristikave të destinacioneve turistike.
- Promovimin e produkteve turistike shqiptare.

2. *Krijimi/zhvillimi/përmirësimi/i produkteve turistike specifike në përputhje me kërkesën gjithnjë në rritje për paketa inovative, që ofrojnë përvoja të pazakonta me surpriza dhe ide stimuluese, përveç shërbimeve bazë standarde. Nën këtë tematikë Ministria e Turizmit dhe Mjedisit do të bashkë financonte projekte që do të synonin:*

- Zhvillimin e produktit turistik në mënyrë inovative drejt produkteve të interesit të veçanta Në këtë përfshihet hartimi i modeleve studimore e zhvillimore të aktiviteteve detare si pjesë e Turizmit blu, si dhe ngritjen e modeleve të menaxhimit të hapësirës së stacioneve të plazhit.

- Zhvillimin e produktit turistik gjatë gjithë vitit në lidhje me veprimtari të ndryshme turistike me tematikë gastronominë, zonat rurale, etnografinë, trashëgiminë kulturore dhe natyrore etj.

Me urdhrin nr. 281, datë 10.11.2020 është ngritur Grupi i monitorimit të Kontratave me anëtar: R. B., Drejtor i Drejtorisë së Konceptimit dhe Fizibilitetit të Projekteve të Mjedisit; B. T., Kryetare e Degës Territoriale të Shërbimit të Mjedisit; J.E, Specialiste në Sektorin e Financës.

Me urdhër të Ministrit Z. B. K me nr. 228, datë 03.07.2019 është bërë delegimi i kompetencave për nënshkrimin e kontratave për mbështetjen financiare në fushën e turizmit z. A. K, Sekretar i Përgjithshëm.

Nga Komisioni i vlerësimit të projekteve, në datën 26.10.2020 është mbajtur procesverbali i vlerësimit ku citohet se:

Të gjithë anëtarëve iu vu në dispozicion dosja me të gjithë dokumentacionin e projekteve dhe dokumentet ligjor të thirrjes.

Fillimisht për procedurë z. K., mbështetur në Urdhrin nr. 156, datë 16.05.2019 "Për mënyrën e funksionimit të Komisionit të Përzgjedhjes së Projekteve", verifikoi prezencën në mbështetje të pikës 7 të Urdhrit, ku kërkoi deklarimin e konfliktit të interesit nga anëtarët pasi të njihen me aplikimet dhe pasi u konstatua, që janë të pranishëm 4 anëtarë, deklaroi mbledhjen e hapur.

Në vijim të punës, z. K. theksoi se, sipas dosjeve të dorëzuara në protokoll, të cilat u vunë në dispozicion nga sekretaria teknike, rezultoi së jenë paraqitur 14 aplikime.

Anëtarët u shprehën se bazuar në kriteret që parashikon VKM nr. 281/2016 dhe urdhri i Ministrit nr. 155, datë 16.05.2019 duhet të skualifikohen fillimisht projektet që kanë mundësi dhe pasaktësi në dokumentacionin administrativ, ato që tejkalojnë afatin 31.12.2020 ose fillojnë para afatit të caktuar në thirrje dhe ato që kalojnë shumën e asaj që duhet të kërkojnë, sipas përcaktimeve në VKM.

Pas kësaj citohet në procesverbal, se të gjithë anëtarët filluan shqyrtimin e dokumentacionit bazuar në vlerën e fondit në dispozicion, kohëzgjatjes që duhet të kenë këto projekte, dokumentacionit që duhej dorëzuar, ku pas këtij shqyrtimi komisioni vendosi mos kalimin në fazën tjetër të vlerësimit të kërkesë propozimeve, projektet e mëposhtme:

"Arkeologjia Nënujore" me arsytimin: Mungesë dokumentacioni dhe gjithashtu e paqarte dhe vlera që kërkohet pasi buxheti i paraqitur është i paplotë e nuk është përcaktuar vlera që i kërkohet MTM. Gjithashtu vlerat e buxhetit nuk rakordojnë me vlerat që paraqiten tek të dhënat e projektit tek formulari aplikimit. Subjekti aplikues është Individ, pasi nuk rezulton asnjë e dhënë për regjistrimin e tij si Person Fizik.

"Vargje mbi gurë shekujsh" me arsytimin: Mungesë dokumentacioni dhe e paqartë vlera që kërkohet pasi buxheti tek tabela e buxhetit total llogaritur gabim. Subjekti aplikues është Individ,

pasi nuk rezulton asnjë e dhënë për regjistrimin e tij si Person Fizik.

"#TravelFunSafe #Albanian Youth" me arsyetimin: Mungesë dokumentacioni dhe gjithashtu vlera e paraqitur ne buxhet rezulton ndryshe nga ajo e përcaktuar tek fondet e kërkuar tek të dhënat e projektit ne formularin e aplikimit. Përsa i përket kohëzgjatjes projekti fillon një dite para datës se përcaktuar ne thirrje.

"Transformimi dixhital dhe puna inteligjente ne batimin e mjeteve te efijencës se energjisë" me arsyetimin: Mungese dokumentacioni. Sipas buxhetit kërkohet 100% financim nga MTM, pra kalon 50% e vlerës se projektit qe financohet sipas kësaj thirrje. Gjithashtu nuk përcaktohet ne buxhet sa është vlera që kërkohet nga MTM.

Në lidhje me projektin "*\*Modele për zhvillimin e aktiviteteve te turizmit detar; Planifikimi dhe projektimi i aktiviteteve ne zonat bregdetare*", subjekti aplikues për shkak të pamundësisë për t'i aksesuar në kohë këto dokumente nga institucionet lëshuese te tyre për shkak te situatës se krijuar nga epidemia e shkaktuar nga COVID- 19, nuk i kishte paraqitur ne dosjen e aplikimit, dhe me shpresën nr. 7014. Prot, datë 22.10.2020, kishte kërkuar ti bashkëngjiteshin aplikimit. Komisioni i Përzgjedhjes se Projekteve duke marre parasysh edhe situatën e krijuar si pasojë e epidemisë te shkaktuar nga COVID- 19 dhe masave te marra për parandalimin e saj, vendosi te marre ne konsiderate dokumentacionin e sjelle prej subjektit aplikues.

Pas diskutimeve në lidhje me projektet, te cilat nuk përmbushnin kriteret dhe kishin mungese dokumentacioni, nga komisioni u vendos kalimi ne fazën tjetër, pas shqyrtimin te dokumentacionit, i cili paraqitet i plotë, për shqyrtim edhe te qëllimit, objektivave te tyre, projektet e mëposhtme:

1. "Birdwatching-Kundrimi i zogive si produkt i ri turistik"
2. "ALBANIA, THE BEAUTIFUL, Territore dhe Njerëz"
3. "Shqiptarët e mrekullueshëm UT"
4. "Promovimi i zonave te mbrojtura"
5. "Reklamimi i kalave dhe njohja e audiencës me historinë e tyre"
6. "Kultura, Mjeshtëria dhe Turizmi një Partneritet"
7. "Evidentimi dhe promovimi i shtigjeve të hiking në Shqipëri"
8. "Tirana 100"
9. "Krijimi i një databaze për hotelerinë në Shqipëri"
10. "Modele për zhvillimin e aktiviteteve te turizmit detar; Planifikimi de projektimi i aktiviteteve ne zonat bregdetare".

Me datën 30.10.2020 është mbajtur procesverbali i mbledhjes së komisionit të vlerësimit të projekteve ku citohet se: Theksi në këtë mbledhje ishte që gjatë shqyrtimit të personit fizik/juridik të mbahet në konsideratë veprimtaria e deritanishme përvoja e suksesshme me partner e donator të tjerë, kontributi në fushën ku vepron, kapaciteti në termat e burimeve njerëzore dhe ekspertizës teknike për të zbatuar/menaxhuar projektin dhe objektivat e projektit të propozuar përputhen me objektivat e thirrjes dhe politikave dhe strategjisë së MTM.

Pas diskutimit komisioni ka vendosur se nga 10 projekte të kaluar nga faza e parë e përzgjedhjes, kualifikuan 9 prej tyre.

Konstatim:

**Në fazën e dytë është hequr projektin "Birdwatching-Kundrimi i zogjve si produkt i ri turistik" për të cilën nuk është dhënë asnjë sqarim nga komisioni për arsyet e skualifikimit.**

- Nga auditimi i projekteve të kaluar e realizuara në vitin 2020 u konstatua se është paguar "Promovimi i shtegut te biçikletave Theth-Valbonë" në vlerën prej 4,495,000 lekë me përfitues "Sh. D." për të cilën nuk ka kaluar fazat e aplikimit dhe të përzgjedhjes.

Pagesa është bërë nga Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura duke bërë një transferim fondi nga aparati i ministrisë tek AKZM, me arsyetimin se projekti është marrë në dorëzim nga Staf i zonave të Mbrojtura.

Sa më sipër projekti nuk ka kaluar fazat e aplikimit dhe përzgjedhjes, si dhe të miratimit të projektit nga Ministri. Veprime në kundërshtim me ligjin nr. 93/2015 "Për Turizmin" i ndryshuar, neni 31

Nga auditimi i realizimit të projekteve u konstatua se:

- Në projektin “Tirana 100” është lidhur kontrata me nr. 7477, datë 11.11.2020.

Nga komisioni i monitorimit është mbajtur raporti me datën 28.12.2020, ku citohet se:

Subjekti fitues “T.” ka realizuar aplikacioni Web [www.Tirana.com](http://www.Tirana.com), **për të cilën nuk ka asnjë gjurmë.**

Pasi, sipas përcaktimeve të nenit 8 “Kalimi i të drejtave pasurore të autorit” të kontratës së lidhur me nr. 7477, datë 11.11.2020 citohet se; Përfituesi në cilësinë e autorit të veprës i kalon Financuesit në formën ekskluzive të drejtat pasurore të veprës. Përfituesi nuk ka të drejtë që për një periudhë kohore 3 vjeçare ta përdorë vetë veprën dhe as t’ia kalojë të njëjtin tagër një pale të tretë.

- *Videot dokumentare të realizuara nga përfituesi janë të dokumentuara nga grupi në magazinë.*

Njëqind e njëzet Fotografitë në Muzeun Histori Kombëtar të cilat janë bërë për ekspozitën e organizuar, të cilat *tregojnë evoluimin e Tiranës në 100 vite.*

Me urdhër shpenzimin nr. 454, datë 10.12.2020 është bërë pagesa 30% sipas kontratës së lidhur dhe 70% është bërë me urdhër shpenzimin nr. 692, datë 28.12.2020.

Sa më sipër jemi në kushtet e shkeljes së kushteve të kontratës të nenit 5 “Financimi dhe modalitetet e pagesës” pika 1. Vlera e financimit sipas kësaj kontrate do të paguhet nga ana e “Financuesit” 30% në datën e fillimit të projektin.

Fatura e sjellë nga subjekti për fillim projekti ka qenë me nr. 1505, datë 12.11.2020 në vlerën 959,163 lekë.

- **Projekti “Promovimi i zonave të mbrojtura”** është lidhur kontrata me nr. 7481, datë 11.11.2020 me subjektin D. P.

Nga projekti janë bërë video për 12 zona të mbrojtura dhe është bërë promovimi në faqet sociale facebook dhe Instagram “Protected Areas Albania”.

Nga komisioni i monitorimit është mbajtur raporti me datën 28.12.2020.

Me urdhër shpenzimin nr. 468, datë 10.12.2020 është bërë pagesa 30% sipas kontratës së lidhur dhe 70% është bërë me urdhër shpenzimin nr. 697, datë 28.12.2020.

Sa më sipër jemi në kushtet e shkeljes së kushteve të kontratës të nenit 5 “Financimi dhe modalitetet e pagesës” pika 1. Vlera e financimit sipas kësaj kontrate do të paguhet nga ana e “Financuesit” 30% në datën e fillimit të projektin.

Fatura e sjellë nga subjekti për fillim projekti ka qenë me nr. 432, datë 16.11.2020 në vlerën 959,163 lekë.

- **Projekti “Kultura, Mjeshtëria dhe Turizmi një Partneritet Vital”** është lidhur kontrata me nr. 7475, datë 11.11.2020 me subjektin O. C.

Nga projekti janë bërë 5 video të realizuara me prodhime autentike të zejtarëve, të cilat janë hedhur në rrjetin social Facebook.

Nga komisioni i monitorimit është mbajtur raporti me datën 28.12.2020.

Përfituesi ka pasur si detyrë që të krijojë një databazë, **për të cilën nuk ka gjurmë.**

Realizimi i 50,000 broshurave, nuk është i dokumentuar një model i prodhimit të tyre bashkëngjitur dosjes se monitorimit.

Realizimi i një webside <https://crafts.al>, **për të cilën nuk ka gjurmë.**

Me urdhër shpenzimin nr. 463, datë 10.12.2020 është bërë pagesa 30% sipas kontratës së lidhur dhe 70% është bërë me urdhër shpenzimin nr. 695, datë 28.12.2020.

Sa më sipër jemi në kushtet e shkeljes së kushteve të kontratës të nenit 5 “Financimi dhe modalitetet e pagesës” pika 1. Vlera e financimit sipas kësaj kontrate do të paguhet nga ana e “Financuesit” 30% në datën e fillimit të projektin.

Fatura e sjellë nga subjekti për fillim projekti ka qenë me nr. 413, datë 16.11.2020 në vlerën 1,249,000 lekë.

**- Projekti “Reklamimi i kalave dhe njohja e audiencës me historinë e tyre”** është lidhur kontrata me nr. 7474, datë 11.11.2020 me subjektin F.S.

Nga projekti janë bërë 6 video të realizuara në 6 kala të cilat janë hedhur në rrjetin social Facebook dhe Instagram “Albanian Castel”.

Raporti është mbajtur me datën 28.12.2020.

Me urdhër shpenzimin nr. 469, datë 10.12.2020 është bërë pagesa 30% sipas kontratës së lidhur dhe 70% është bërë me urdhër shpenzimin nr. 698, datë 28.12.2020.

Sa më sipër jemi në kushtet e shkëljes së kushteve të kontratës të nenit 5 “Financimi dhe modalitetet e pagesës” pika 1. Vlera e financimit sipas kësaj kontrate do të paguhet nga ana e “Financuesit” 30% në datën e fillimit të projektin.

Fatura e sjellë nga subjekti për fillim projekti ka qenë me nr. 49, datë 13.11.2020 në vlerën 976,500 lekë.

**- Projekti “Krijimi i një databaze për hotelerinë në Shqipëri”** është lidhur kontrata me nr.7478, datë 11.11.2020 me subjektin W.

Nga projekti duhet të krijohet një portal me emrin “Turizmi i Shqipërisë” i cili është një data bazë që përmban “site- map” me të dhënat për hotelerinë në Shqipëri, me administrator qendror MTM dhe 61 bashkitë me profilin e tyre përkatës, ku secila ka të drejtë të listojë të gjitha strukturat akomoduese nëpërmjet një paneli personal.

Raporti është mbajtur me datën 28.12.2020.

Nga kërkimet në web për portalin [www.turizmishqiptar.al](http://www.turizmishqiptar.al) nuk gjendet.

Me urdhër shpenzimin nr. 465, datë 11.12.2020 është bërë pagesa 30% sipas kontratës së lidhur dhe 70% është bërë me urdhër shpenzimin nr. 691, datë 28.12.2020.

Sa më sipër jemi në kushtet e shkëljes së kushteve të kontratës të nenit 5 “Financimi dhe modalitetet e pagesës” pika 1. Vlera e financimit sipas kësaj kontrate do të paguhet nga ana e “Financuesit” 30% në datën e fillimit të projektin.

Fatura e sjellë nga subjekti për fillim projekti ka qenë me nr. 67, datë 16.11.2020 në vlerën 1,170,000 lekë.

## **Viti 2021**

### **Thirrja e I**

Me urdhrin e Ministrit nr. 145 datë 16.06.2021 (prot., me nr. 4153) është miratuar formulari i aplikimit dhe procedurave për përfitim të mbështetjes financiare lidhur me projektet në fushën e Turizmit sipas përcaktimeve të ligjit nr. 93/2015 “Për Turizmin” i ndryshuar, neni 31 dhe VKM-së nr. 281, datë 13.04.2016 “Për përcaktimin e kriterëve të afateve të kërkesë propozimeve për mbështetjen financiare të projekteve në fushën e turizmit” dhe VKM-së 281, datë 13.04.2016 “Për përcaktimin e kriterëve të afateve të kërkesë/propozimeve për mbështetjen financiare të projekteve në fushën e turizmit” .

Në pikën 3 të urdhrin është përcaktuar se “Publikimi i procedurës për përfitime të mbështetjes financiare në lidhje me projektet e turizmit, në faqet zyrtare të ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, në media dhe në Buletinin e njoftimeve Zyrtare”.

Me shkresën nr. 4175, datë 16.06.2021 është bërë kërkesë Qendrës së Botimeve Zyrtare për publikimin e thirrjes dhe procedurës për përfitime nga projektet e turizmit me datën 21.06.2021.

Për zbatimin e urdhrin është ngarkuar drejtoria e programeve të zhvillimit të Turizmit, sektori i Standardeve në Turizëm dhe Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar.

Në aneksin nr. 2 janë përcaktuar procedurat për përfitim të mbështetjes financiare ku kriteret e pjesëmarrjes janë sipas VKM-së 281, datë 13.04.2016 pika 6.

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit ka shpall thirrjen për përfitim të mbështetjes financiare të projekteve në fushën e turizmit nga data 21.06.2021 deri me datën 21.07.2021.

**Qëllimi kryesor i kësaj thirrjeje** ishte forcimi i konkurrencës dhe qëndrueshmërisë në sektorin e turizmit në Shqipëri, nisur edhe nga situata në të cilën ndodhej industria e turizmit për shkak të

gjendjes së epidemisë të shkaktuar nga infeksioni COVID 19, ku ishte e nevojshme nevojitet fokusim ne promovimin e destinacioneve turistike e te vlerave te trashëgimisë kulturore dhe natyrore vendase, si dhe duke diversifikuar me modele inovative produktet turistike, duke zhvilluar modele te reja të funksionimit te aktiviteteteve detare dhe menaxhimit te vijës bregdetare. *Duke pasur parasysh këto objektivi kryesore, për thirrjen e vitit 2021 thirrja ishte e ndarë në dy tematika:*

1. Promovimin e destinacioneve turistike e të vlerave të veçanta të produkteve dhe atraksioneve turistike.

Nën këtë tematike Ministria e Turizmit dhe Mjedisit do te bashkëfinancoje projekte që do të synojnë:

- Zgjerimin e aktiviteteteve dhe ofertave turistike, duke synuar forcimin apo krijimin e produkteve të reja turistike, që shkojnë për zhvillimin e vendit dhe përfitimet e mundshme për popullsinë lokale te rajoneve te ndryshme.
- Përfshirjen gjithnjë e më shumë në sektorin e turizmit të komuniteteve lokale, studentëve në promovimin përmes produktit turistik sipas karakteristikave te destinacioneve turistike.
- Promovimin e produkteve turistike shqiptare.

2. Krijimi/zhvillimi/përmirësimi/i produkteve turistike specifike në përputhje me kërkesën gjithnjë në rritje për paketa inovative, që ofrojnë përvoja të pazakonta me surpriza dhe ide stimuluese, përveç shërbimeve bazë standarde. Nën këtë tematike Ministria e Turizmit dhe Mjedisit do te bashkë financoje projekte që do të synojnë:

- Zhvillimin e produktit turistik në mënyrë inovative drejt produkteve të interesit të veçanta Në këtë përfshihet hartimi i modeleve studimore e zhvillimore të aktiviteteteve detare si pjesë e Turizmit blu, si dhe ngritjen e modeleve te menaxhimit te hapësirës se stacioneve te plazhit.
- Zhvillimin e produktit turistik gjatë gjithë vitit në lidhje me veprimtari të ndryshme turistike me tematikë gastronominë, zonat rurale, etnografinë, trashëgiminë kulturore dhe natyrore etj.

3. Përgatitja e studimeve apo modeleve të produkteve turistike:

Përgatitjen e studimeve apo modeleve të produkteve turistike , të cilat kanë në fokus mënyra/format apo masat që duhet të ndërmerren për rimëkëmbjen e turizmit pas gjendjes së epidemisë të shkaktuar nga infeksioni Covid 19.

Komisioni i përzgjedhjes së projekteve me anëtar përbëhej nga 4 anëtar nga:

Z. A.K, Sekretar i Përgjithshëm në MTM;

Znj. A. B Drejtor i Drejtorisë së Politikave dhe Strategjive të Zhvillimit të Turizmit.

Znj. M. N, Drejtor i Shoqatës Shqiptare e Turizmit;

Znj K. H, përfaqësuese e Shoqatës " A. I.T. A."

### **Konstatimi:**

Ngritja e komisionit është kryer në kundërshtim me vendimin nr. 325, datë 31.5.2018 “Për përcaktimin e anëtarëve të komisionit të përzgjedhjes së projekteve në turizëm” pasi në përbërjen e grupi duhet të jenë 7 anëtar, ku dy nga anëtarët të jenë sipas përcaktimeve të 2 të vendimit.

Me datën 26.07.2021 është bërë mbledhja e parë e Komisionit të Përzgjedhjes së Projekteve në prani të dy anëtarëve të komisionit, të cilët nuk vazhduan procesin e shqyrtimit për mungesë të anëtarëve të tjerë të komisionit.

Me datën 02.08.2021 është bërë mbledhja e dytë e Komisionit të Përzgjedhjes së Projekteve në prani të tre anëtarëve të komisionit, të cilët nuk vazhduan procesin e shqyrtimit për mungesë të anëtarëve të tjerë të komisionit.

Me datën 03.08.2021 është bërë mbledhja e Komisionit të Përzgjedhjes së Projekteve ku është mbajtur procesverbal në të cilën sqarohet:

Të gjithë anëtarëve iu vu ne dispozicion nga sekretaria teknike dosja me të gjithë dokumentacionin e projekteve të dorëzuar në protokoll. nga ku rezultonte 14 aplikime te paraqitura.

Anëtarët në procesverbalin e mbajtur janë shprehur se bazuar në kriteret që parashikon VKM nr. 281/2016 dhe urdhri i Ministrit nr. 155, datë 16.05.2019, duhet të s kualifikoheshin fillimisht



projektet qe kane mungese dhe pasaktësi ne dokumentacionin administrativ, ato që tejkalojnë afatin 31.12.2021 ose që fillojnë para afatit te caktuar ne thirrje dhe ato qe kalojnë shumen e asaj qe duhet te kërkohet, sipas përcaktimeve ne VKM. Pas shqyrtimit komisioni vendosi mos kalimin ne fazën tjetër të vlerësimit, projektet e mëposhtme:

- *\*Kompleks Turistik. Gjelbërim ne zonën ranore*" me arsyetimin: Mungese dokumentacioni dhe gjithashtu vlera që kërkohet te financohet nga MTM është me shume se 50%. Gjithashtu ne buxhet nuk janë parashikuar shpenzimet për auditimin e projektit.

- *"The Development of Soft Skills"* me arsyetimin: Mungese dokumentacioni dhe gjithashtu vlera që kërkohet të financohet nga MTM është pak më shume se 50%.

- *Albania to Discover - Traveling throught Natural Beauty and Traditional Valiues*" me arsyetimin: Mungese dokumentacioni dhe sa i takon kohëzgjatjes së projektit, i cili fillon para datës se përcaktuar ne thirrje.

- *Përfundimi i projektit ECO Turizëm, Rekreativ dhe Sportiv, Zipline Albania*" me arsyetimin: Mungese dokumentacioni. Sipas vërtetimit të paraqitur nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve rezulton qe subjekti nuk ka përmbushur detyrimet për derdhjen e kontributeve te sigurimeve shoqërore e shëndetësore.

- *"Made in Peza"* me arsyetimin: Mungesë dokumentacioni dhe gjithashtu në buxhet nuk janë parashikuar shpenzimet për auditimin e projektit.

- *\*Drejt zbulimit të vlerave turistike në Bashkinë Berat, Skrapar dhe Përmet'* me arsyetimin: Mungese dokumentacioni dhe sa i takon kohëzgjatjes, projekti fillon para datës se përcaktuar në thirrje. Gjithashtu ne buxhet nuk janë parashikuar shpenzimet për auditimin e projektit.

- *"Promovimi i Turizmit ne zonën e Shkodrës"* me arsyetimin: Mungesë dokumentacioni. Sipas buxhetit kërkohet 100% financim nga MTM, pra kalon 50% e vlerës se projektit që financohet sipas kësaj thirrje.

- *"Shijoni Veriun e Shqipërisë"* me arsyetimin: Mungese dokumentacioni. Gjithashtu, përse i përket kohëzgjatjes projekti fillon dhe mbaron brenda ditës, gjë e cila krijon paqartësi për kohën e realizimit te aktiviteteve te projektit te cilat kërkohet kohën e tyre për tu realizuar.

Pas shqyrtimit të fazës së parë kaluan në fazat projektet si vijojnë:

1. "Itenerari i Udhëtimeve";
2. "Eco-Blue #ON";
3. "Check in Festival";
4. "Në zbulim të kulinarisë shqiptare";
5. Identiteti vizual i katër qyteteve në Shqipëri;
6. Strategji e thelluar e integruar dhe e vetëqëndrueshëm por Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, për ta kthyer Shqipërinë në një destinacion të njohur dhe për të rritur numrin e vizitorëve Kinezë në periudhën 2021-2023.

Me datën 11.08.2021 është mbajtur procesverbali i mbledhjes së komisionit të vlerësimit të projekteve ku citohet se:

Pas diskutimit komisioni ka vendosur se nga 6 projekte të kaluar nga faza e parë e përzgjedhjes, kualifikuan 2 prej tyre.

- "Eco-Blue #ON"

- Strategji e thelluar e integruar dhe e vetëqëndrueshme për Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, për ta kthyer Shqipërinë në një destinacion të njohur dhe për të rritur numrin e vizitorëve Kinezë në periudhën 2021-2023.

Komisioni vë theksin se projektet që nuk u përzgjedhën është vënë re përsëritja e aktivitetit, veçanërisht për zonat/produktet turistike tashmë të promovuar, duke mos sjellë diversifikimin me modele inovatore për produktet turistike.

***Sa më sipër, nga ana e komisionit nuk ka një argumentim se kush janë aktivitetet që përsëriten dhe që janë promovuar më parë.***

Projektet janë miratuar me urdhrin e Ministrisë me nr. 169, datë 23.08.2021.



## **Thirrja e II**

Me urdhrin e Ministrit nr. 219, datë 07.10.2021 (prot me nr. 7128) është miratuar formulari i aplikimit dhe procedurave për përfitim të mbështetjes financiare lidhur me projektet në fushën e Turizmit.

Në pikën 3 të urdhrin është përcaktuar se “*Publikimi i procedurës për përfitime të mbështetjes financiare në lidhje me projektet e turizmit, në faqet zyrtare të ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, në media dhe në Buletinin e njoftimeve Zyrtare*”.

Për zbatimin e urdhrin është ngarkuar drejtoria e programeve të zhvillimit të Turizmit, sektori I Standardeve në Turizëm dhe Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit financiar.

Me shkresën nr. 7125/1, datë 07.10.2021 është bërë kërkesë Qendrës së Botimeve Zyrtare për publikimin e thirrjes dhe procedurës për përfitime nga projektet e turizmit me datën 04.10.2021.

Në aneksin nr. 2 janë përcaktuar procedurat për përfitim të mbështetjes financiare ku kriteret e pjesëmarrjes janë sipas VKM-së 281, datë 13.04.2016 pika 6.

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit shpall thirrjen për përfitim të mbështetjes financiare të projekteve në fushën e turizmit nga data 07.10.2021 deri me datën 06.11.2021.

**Qëllimi kryesor** i kësaj thirrjeje ishte forcimi i konkurrencës dhe qëndrueshmërisë në sektorin e turizmit në Shqipëri, nisur edhe nga situata në të cilën ndodhej industria e turizmit për shkak të gjendjes së epidemisë të shkaktuar nga infeksioni COVID 19, nevojitet fokusim në promovimin e destinacioneve turistike e të vlerave të trashëgimisë kulturore dhe natyrore vendase, si dhe duke diversifikuar me modele inovative produktet turistike, duke zhvilluar modele të reja të funksionimit të aktiviteteve detare dhe menaxhimit të vijës bregdetare.

Duke pasur parasysh këto objektivi kryesore, për thirrjen e vitit 2021 thirrja ishte e ndarë në dy tematika, ***të cilat ishin identike me ato të thirrjes së parë.***

Komisioni i përzgjedhjes së projekteve përbëhej nga 5 anëtar nga

Znj. A. D., Sekretar i Përgjithshëm në MTM;

Znj. M. N., Drejtor i Shoqatës Shqiptare e Turizmit;

Znj. A.B. Drejtor i Drejtorisë së Politikave dhe Strategjive të Zhvillimit të Turizmit;

Znj O.C., Drejtor i Drejtorisë së Konceptimit dhe Fizibilitetit të Projekteve të Turizmit;

Znj. K. F., Drejtor i Agjencisë Kombëtare të Turizmit.

MTM me shkresën nr. 7677 datë 29.10.2021 “Kërkesë për caktimin e anëtarit” drejtuar - Shoqata Shqiptare e Turizmit (ATA) dhe me shkresën nr. 7678, datë 29.10.2021 drejtuar Shoqata “A. I.T. A., nga ku kërkesës iu përgjigj vetëm Shoqata Shqiptare e Turizmit (ATA) me anëtar znj. M. N. Me datën 17.09.2021 është bërë mbledhja e parë e Komisionit të Përzgjedhjes së Projekteve në prani të të gjithë anëtarëve.

Nga 52 projekte që kanë aplikuar janë përzgjedhur vetëm 7 prej tyre. Sa i takon projekteve që nuk janë përzgjedhur, komisioni është shprehur me arsyetimin mungesë dokumentacioni dhe të tjera. Me shkresën nr. 8074/2, datë 12.11.2021 është bërë propozimi për miratim ministrit të MTM.

1. Tradita që kthehet në markë;
2. Projekti "Krijimi i Identitetit korporativ & Brand Book për 4 bashki";
3. Në zbulim të kulinarisë shqiptare;
4. Rritja e promovimit dhe përmirësimi i shërbimeve turistike në Bashkinë Përmet;
5. Promovim i kalave dhe njohja me historinë e tyre;
6. Shije dhe eksperiencë nga Jugu i Shqipërisë;
7. Nxitja e angazhimit rinor në promovimin e turizmit.

Projektet janë miratuar me urdhrin e Ministrit me nr. 255, datë 15.11.2021.

Me urdhrin e Ministrit znj. M. K me nr. 252, datë 12.11.2021 është bërë delegimi i kompetencave për nënshkrimin e kontratave për mbështetjen financiare në fushën e turizmit z. A. D, Sekretar i Përgjithshëm.

Me urdhrin nr. 936, datë 07.11.2021 është ngritur Grupi i monitorimit të Kontratave me anëtar; O. C Drejtor i Drejtorisë së Konceptimit dhe Fizibilitetit të Projekteve të Mjedisit; J.T, specialist në Drejtorinë se Konceptimit dhe Fizibilitetit të Projekteve të Mjedisit; B. Rr, specialist në Drejtorinë

se Konceptimit dhe Fizibilitetit të Projekteve të Mjedisit; J. E, Specialiste në Sektorin e Financës dhe B. T, Kryetare e Degës Territoriale të shërbimit të Turizmit.

**Konstatim:**

*Në thirrjen e parë komisioni kishte skualifikuar projekte ku sipas gjykimit të tyre projekti ishte në përsëritje të aktivitetit. Nga ana tjetër, ndër projektet e përzgjedhura konstatohet se përzgjedhja “Promovim i kalave dhe njohja me historinë e tyre” fituar nga “F. S”, projekt i cili është fituar dhe në vitin 2020, ku ndryshimi nga projekti i parë është vetëm destinacioni i kalave të përzgjedhura.*

*Sa më sipër konstatohet një gjykim me dy standarde të përzgjedhjes së projekteve nga Komisioni.*

Nga auditimi i projekteve të realizuara në vitin 2021 u konstatua pagesa e projekteve si vijon:

- **Projekti “Reklamimi i kalave dhe njohja e audiencës me historinë e tyre”** është lidhur kontrata nr. 8131/9, datë 16.11.2021 me subjektin F.S.

Nga projekti janë bërë video bërë 6 video të realizuara në 6 kala të cilat janë hedhur në rrjetin social Facebook dhe Instagram “Albanian Castel”.

Nga komisioni i monitorimit është mbajtur raporti me datën 28.12.2021.

Me urdhër shpenzimin nr. 540, datë 06.12.2021 është bërë pagesa 30% sipas kontratës së lidhur dhe 70% është bërë me urdhër shpenzimin nr. 615, datë 28.12.2021.

Sa më sipër jemi në kushtet e shkëljes së kushteve të kontratës të nenit 5 “Financimi dhe modalitetet e pagesës” pika 1. Vlera e financimit sipas kësaj kontrate do të paguhet nga ana e “Financuesit” 30% në datën e fillimit të projektin.

Fatura e sjellë nga subjekti për fillim projekti ka qenë me nr. 3/2021, datë 01.11.2021 në vlerën 829,600 lekë.

- **Projekti “Tradita që kthehet në markë”** është lidhur kontrata nr. 8131/1, datë 16.11.2021 me subjektin D.

Nga projekti janë bërë video bërë tre video promovuese për qytetin Shkodër, Korçë dhe Gjirokastër. Këto produkte janë dorëzuar në MTM në 15 kopje dixhitale nga 3 kopje për secilin qytet. Këto video janë publikuar në YouTube D... dhe në YouTube në profilin e gazetares R.Xh.

Nga komisioni i monitorimit është mbajtur raporti me datën 28.12.2021.

Me urdhër shpenzimin nr. 536, datë 06.12.2021 është bërë pagesa 30% sipas kontratës së lidhur dhe 70% është bërë me urdhër shpenzimin nr. 611, datë 28.12.2021.

Sa më sipër, jemi në kushtet e shkëljes së kushteve të kontratës të nenit 5 “Financimi dhe modalitetet e pagesës” pika 1. Vlera e financimit sipas kësaj kontrate do të paguhet nga ana e “Financuesit” 30% në datën e fillimit të projektin.

Fatura e sjellë nga subjekti për fillim projekti ka qenë me nr. 3/2021, datë 12.11.2021 në vlerën 900,000 lekë.

- **Projekti “Eco-Blue on”** është lidhur kontrata me nr. 5916/2, datë 24.08.2021.

Raporti është mbajtur me datën 28.12.2020, ku citohet aktivitete e projektit si dhe produktet e projektit të cilat janë; Realizimi i kopjes fizike dhe digjitale të strategjisë “Eco blu”, e cila është dorëzuar në kopje fizike dhe elektronike me CD.

**Konstatim**

Nga auditimi u konstatua se, nga ana e MTM-së nuk është marrë asnjë masë për realizimin, ndjekjen e problematikave, si dhe sugjerimeve të dala nga realizimi i projektit me qëllim përmirësimin e turizmit, arsyeja për të cilën financohen dhe këto projekte.

- Për projektin **“Krijimi i Identitetit korporativ & Brand Book për 4 bashki”** është lidhur kontrata me nr. 8131/1, datë 16.11.2021.

Nga komisioni i monitorimit është hartuar memo me nr. 9162/2, datë 28.12.2021 drejtuar Ministrit dhe SP ku citohet: *Me datën 14.12.2021 pranë MTM janë paraqitur përfaqësues të subjektit “A. K.” ku kërkuan takim me grupim e monitorimit. Gjatë takimit përfituesi shprehet se nuk është realizuar projekti në bashkitë Lezhë, Durrës, Sarandë dhe Gjirokastër siç ishte parashikuar në*

kontratën e lidhur mes AK dhe subjektit. Grupi i monitorimit me datën 15.12.2021 ka konstatuar se subjekti/PF nuk ka paraqitur “Kërkesë për pagesë” dhe as dokumentacion shoqërues në lidhje me zbatimin e kontratës.

Sa më sipër në zbatim të nenit 6 pika 2 të kontratës me nr. 8131/1, datë 16.11.2021, përfituesi në rast të mosrealizimit të aktivitetit të parashikuar në kontratë, detyrohet ti kthejë financuesit fondet e parapaguara dhe të shpenzuara në masën 30% të vlerës së financuar nga MTM.

Nga grupi i monitorimit është hartuar memo me nr. 9262/2, datë 28.12.2021 drejtuar SP Znj. L. A. “Mbi dorëzimin e produkteve dhe materialeve të projekteve fituese për thirrjen e vitit 2021 nga fondi për zhvillimin e turizmit” kërkon dorëzimin e materialeve fizike dhe në CD të dorëzohen pranë Drejtorisë së Mirëadministrimit të Burimeve Njerëzore, Aseteve dhe Shërbimeve për 7 projektet e thirrjes së dytë.

***Për projektet fituese të thirrjes së dytë nuk ka informacion nëse janë depozituar këto materiale.***

## **Viti 2022**

### **Thirrja e I**

Me shkresën nr. 362 prot., date 20.01.2022 Drejtoria e Konceptimit dhe Fizibilitetit të Projekteve të Turizmit ka dërguar memon mbi thirrjen për mbështetje financiare të projekteve në fushën e turizmit për vitin 2022, drejtuar Ministrit të MTM-së, ku ka propozuar për shpalljen e Thirrjes për mbështetje financiare të projekteve në fushën e turizmit sipas prioriteteve.

Prioritetet e Thirrjes për mbështetje financiare të Projekteve në Turizëm, janë:

1. Promovimi i destinacioneve, zhvillimi i produkteve turistike dhe brandimi i territorit;
2. Digjitalizimi dhe inovacioni

Me Urdhrin e Ministrit i MTM-së nr. 25 datë 20.01.2022 “Për mënyrën e funksionimit të komisionit të përzgjedhjes së projekteve”, është përcaktuar objekti i komisionit si dhe mënyra sesi ky komision do funksionojë për përzgjedhjen e projekteve.

Me Urdhrin e Ministrit të MTM-së nr. 26 datë 20.01.2022 “Për miratimin e formularit të aplikimit dhe procedurave për përfitimin e mbështetjes financiare lidhur me projektet në fushën e turizmit”, janë miratuar Formularët e Aplikimit, procedurat për përfitimin e mbështetjes financiare, si dhe publikimi i kësaj procedure në faqen zyrtare të MTM-së.

Me anë të shkresës nr. 362/3 prot., datë 21.01.2022, Sekretari i Përgjithshëm në MTM, znj. L. B. A, i ka kërkuar Qendrës së Botimeve Zyrtare publikimin e thirrjes dhe procedurës për përfitimin e mbështetjes financiare në Buletinin e Njoftimeve Zyrtare me datë 24.01.2022.

Me Urdhrin nr. 58 datë 07.02.2022 “Për delegimin e kompetencave për nënshkrimin e kontratave për mbështetjen financiare të projekteve në fushën e turizmit”, Ministri i MTM-së i ka deleguar kompetencat për nënshkrimin e kontratave me subjektet fituese të Thirrjes për vitin 2022, Sekretarit të Përgjithshëm znj. L. B. A.

Me anë të shkresës nr. 1516/1 prot., datë 15.02.2022, Sekretari i Përgjithshëm në MTM, znj. L. B. A, i ka kërkuar Qendrës së Botimeve Zyrtare publikimin e Urdhrit të Ministrit të MTM-së nr. 58, datë 07.02.2022 “Për delegimin e kompetencave për nënshkrimin e kontratave për mbështetjen financiare të projekteve në fushën e turizmit”.

Bazuar në VKM nr. 325, datë 31.05.2018 “Për përcaktimin e anëtarëve të Komisionit të Përzgjedhjes së Projekteve në Turizëm”, ku përcakton anëtarët e Komisionit të Përzgjedhjes së Projekteve në Turizëm, Sekretari i Përgjithshëm në MTM, znj. L. B. A, ka dërguar shkresat si vijon:

-Me shkresën nr. 1888 prot., datë 17.02.2022, i ka kërkuar Kryetarit të “Sh. Sh. të T.” caktimin e një përfaqësuesi.

-Me shkresë nr. 1889 prot., datë 17.02.2022, i ka kërkuar Kryetarit të Shoqatës “A. I. T. A.” caktimin e një përfaqësuesi.

Komisioni i përzgjedhjes së projekteve përbëhej nga 4 anëtar nga

Znj. L. B. A, Sekretar i Përgjithshëm në MTM;  
Znj. A. B. Drejtor i Drejtorisë së Politikave dhe Strategjive të Zhvillimit të Turizmit;  
Znj O. C., Drejtor i Drejtorisë së Konceptimit dhe Fizibilitetit të Projekteve të Turizmit;  
Znj. K. F., Drejtor i Agjencisë Kombëtare të Turizmit.

*Nga ana e Komisionit të Përzgjedhjes së Projekteve në Turizëm(KPPT) janë kryer mbledhjet si vijon:*

Me shkresën nr. 2493 prot., datë 28.02.2022 është mbajtur procesverbali i mbledhjes së parë të KPPT. Komisioni ka marrë në shqyrtim vetëm dosjet të cilat janë dorëzuar deri me datën 23.02.2022 dhe të cilat kanë dorëzuar dosjen fizike pranë protokollit.

Nga 191 aplikantë janë marrë në shqyrtim vetëm 27 aplikime, ku u shqyrtua dokumentacioni i dhe për 20 aplikantë nga ana e Komisionit u vlerësua se nuk mund të kalonin fazën e vlerësimit;

Me shkresën nr. 2585 prot., datë 04.03.2022 është mbajtur procesverbali i mbledhjes së dytë të KPPT-së, ku u shqyrtua dokumentacioni i 28 aplikantëve, dhe për 23 aplikantë nga ana e KPPT-së u vlerësua se nuk mund të kalonin fazën e vlerësimit ;

Me shkresën nr. 2585/1 prot., datë 09.03.2022 është mbajtur procesverbali i mbledhjes së tretë të KPPT-së, ku u shqyrtua dokumentacioni i 39 aplikantëve, dhe për 29 aplikantë nga ana e KPPT-së u vlerësua se nuk mund të kalonin fazën e vlerësimit ;

Me shkresën nr. 2787 prot., datë 11.03.2022 është mbajtur procesverbali i mbledhjes së katërt të KPPT-së, ku u shqyrtua dokumentacioni i 30 aplikantëve, dhe për 19 aplikantë nga ana e KPPT-së u vlerësua se nuk mund të kalonin fazën e vlerësimit ;

Me shkresën nr. 2797 prot., datë 16.03.2022 është mbajtur procesverbali i mbledhjes së pestë, nga ana e KPPT-së u vlerësua e nevojshme shtyrja e afatit për përzgjedhjen e projekteve për shkak të numrit të lartë të aplikimeve dhe faktit që ka patur ende aplikime të pashqyrtuara.

Me anë të shkresës me nr. 2897/1 prot., datë 16.03.2022, KPPT ka kërkuar shtyrjen e afatit me 10 ditë, e cila është miratuar me anë të Urdhrit të Ministrit të MTM-së me nr. 105 datë 23.03.2022;

Me anë të shkresës me nr. 2897 prot., datë 16.03.2022, është mbajtur procesverbali i mbledhjes së gjashtë të KPPT-së, ku u shqyrtua dokumentacioni i 30 aplikantëve, dhe për 28 aplikantë nga ana e KPPT-së u vlerësua se nuk mund të kalonin fazën e vlerësimit ;

Me shkresën nr. 3042 prot., datë 25.03.2022 është mbajtur procesverbali i mbledhjes së gjashtë të KPPT-së, ku u shqyrtua dokumentacioni i 37 aplikantëve, dhe për 33 aplikantë nga ana e KPPT-së u vlerësua se nuk mund të kalonin fazën e vlerësimit ;

Nga ana e KPPT-së aplikantët janë skualifikuar për shkak se kanë mungesë dhe pasaktësi në dokumentacion, si dhe vlera e kërkuar e financimit është më e madhe se 50%, në kundërshtim me VKM nr. 281, datë 13.04.2016 “Për përcaktimin e kriterëve e të afateve të kërkesë propozimeve për mbështetjen financiare të projekteve në fushën e turizmit.”

Me shkresën nr. 3145 prot., datë 30.03.2022 është mbajtur procesverbali i mbledhjes së shtatë të KPPT-së, ku anëtarët vijuan punën për vlerësimin e përmbajtjes të të gjitha aplikimeve dokumentacioni i të cilave u paraqit i plotë. Në përfundim, referuar fondit buxhetor në dispozicion, KPPT vendosi të përzgjedhë 39 projekte, të cilat u paraqitën për miratim tek Ministri i MTM-së me anë të shkresës nr. 3145/1 prot., datë 30.03.2022.

Sa më sipër u konstatua se në procesverbal dhe në përmbledhësen tabelarë bashkëngjitur procesverbalit nuk është argumentuar dhe sqaruar projekt për projekt se çfarë dokumentesh mungojnë dhe për projektet fituese nuk janë cituar dokumentacioni i dorëzuar nga përfituesi.

Me anë të shkresës nr. 3145/2 datë 30.03.2022, KPPT i ka dërguar Ministrit të MTM-së Informacionin në lidhje me mbledhjet e KPPT-së si dhe dërgimin për miratim të projekteve të përzgjedhura.

Me Urdhrit të Ministrit të MTM-së nr. 122, datë 04.04.2022 u miratuan 39 projekte.

### Monitorimi

Me Urdhrit të Ministrit të MTM-së nr. 129, datë 05.04.2022 “ *Për ngritjen e grupeve të monitorimit të kontratave për mbështetjen financiare të projekteve në fushën e turizmit*”, u ngritën tre grupe

pune, të cilët do të monitorojnë procesin e realizimit të projekteve, miratimin e realizimit të aktiviteteve të projekteve, përgatitjen e raportit të realizimit të aktiviteteve të projekteve dhe përcjelljen për miratim tek Ministri si Autoritet Financues.

Me shkresën nr. 4112 prot., datë 10.05.2022 drejtuar Degës së Thesarit Tiranë, Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Sekretari i Përgjithshëm i MTM-së ka dërguar informacion në lidhje 39 projektet turistike me të cilat janë lidhur kontratat dhe përfitojnë mbështetje financiare nga buxheti i shtetit në vlerën totale prej 74,746,500 lekë.

## **Thirrja e II**

Me shkresën nr. 7316 prot., date 07.10.2022, Drejtoria e Politikave dhe Strategjive të Zhvillimit të Turizmit ka dërguar memon mbi thirrjen e dytë për mbështetje financiare të projekteve në fushën e turizmit për vitin 2022, drejtuar Ministrin të MTM-së, ku ka propozuar shpalljen e Thirrjes për mbështetje financiare të projekteve në fushën e turizmit sipas prioriteteve.

Me anë të Urdhrit të Ministrin të MTM-së nr. 305 datë 07.10.2022 “ Për disa shtesa në Urdhrin e Ministrin nr. 25 datë 20.01.2022 “Për mënyrën e funksionimit të komisionit të përzgjedhjes së projekteve”, janë bërë disa ndryshime dhe shtesa.

Me Urdhrin e Ministrin të MTM-së nr. 306 datë 07.20.2022 “Për miratimin e formularit të aplikimit dhe procedurave për përfitimin e mbështetjes financiare lidhur me projektet në fushën e turizmit”, janë miratuar Formularët e Aplikimit , procedurat për përfitimin e mbështetjes financiare, si dhe publikimi i kësaj procedure në faqen zyrtare të MTM-së.

Me anë të shkresës nr. 7316/3 prot., datë 07.10.2022, Sekretari i Përgjithshëm në MTM, znj. L. B. A, i ka kërkuar Qendrës së Botimeve Zyrtare publikimin e thirrjes dhe procedurës për përfitimin e mbështetjes financiare në Buletinin e Njoftimeve Zyrtare me datë 07.10.2022.

Bazuar në VKM nr. 325, datë 31.05.2018 “Për përcaktimin e anëtarëve të Komisionit të Përzgjedhjes së Projekteve në Turizëm”, ku përcakton anëtarët e Komisionit të Përzgjedhjes së Projekteve në Turizëm, Sekretari i Përgjithshëm në MTM, znj. L. B. A, ka dërguar shkresat si vijon:

-Me shkresën nr. 7632 prot., datë 24.10.2022, i ka kërkuar Kryetarit të “Sh.Sh të T.” dhe Kyetarit të Shoqatës “A. I. T. A.” caktimin në secilën shoqatë të një përfaqësuesi.

*Nga ana e Komisionit të Përzgjedhjes së Projekteve në Turizëm(KPPT) janë kryer mbledhjet si vijon:*

Me shkresën nr. 8393 prot., datë 14.11.2022 është mbajtur procesverbali i mbledhjes së parë të KPPT, ku u përzgjedhën 10 projekte, të cilat iu dërguan për miratim Ministrin të MTM-së me shkresën nr. 8393/1 prot., datë 14.11.2022.

***Sa më sipër konstatohet mungesë informacioni se sa aplikime kanë qenë dhe si është bërë përzgjedhja e përfituesve.***

Me Urdhrin nr. 355 datë 15.11.2022 “Për miratimin e projekteve në turizëm që përfitojnë mbështetje financiare nga buxheti i shtetit”, Ministri i MTM-së ka urdhëruar miratimin e 10 projekteve:

### Monitorimi

Me Urdhrin e Ministrin të MTM-së nr. 358, datë 16.11.2022 “ Për ngritjen e grupeve të monitorimit të kontratave për mbështetjen financiare të projekteve në fushën e turizmit”, u ngritën një grup pune, i cili do të monitoroj procesin e realizimit të projekteve, miratimin e realizimit të aktiviteteve të projekteve, përgatitjen e raportit të realizimit të aktiviteteve të projekteve dhe përcjelljen për miratim tek Ministri si Autoritet Financues.

Me shkresën nr. 4112 prot., datë 10.05.2022 drejtuar Degës së Thesarit Tiranë, Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Sekretari i Përgjithshëm i MTM-së ka dërguar informacion në lidhje 39 projektet turistike me të cilat janë lidhur kontratat dhe përfitojnë mbështetje financiare nga buxheti i shtetit në vlerën totale prej 74,746,500 lekë.

### **Konstatim:**

1. Nga auditimi u konstatua se KKPT ka shpallur fitues projektin "Krijimi i Identitetit korporativ & Brand Book për 4 bashki" me përfitues A. K PF, projekt i cili është shpallur fitues në vitin 2021, ku MTM ka lidhur kontratën me nr. 8131/1, datë 16.11.2021, e cila nuk është realizuar nga përfituesi brenda afateve të përcaktuara. ***Në vitin 2022, Komisioni i Përzgjedhjes së Projekteve e ka rizgjedhur sërish një projekt, i cili është paraqitur një herë dhe është shpallur fitues, ku përfituesi nuk e ka realizuar brenda përcaktimeve të kushteve të kontratës.***

2. Komisioni përzgjedhjes ka shpallur fitues në këtë thirrje dhe ***Projektin "Check in fest Albania"*** me subjektin P., ku **A. K** është ortak i kësaj kompanie.

Po ashtu është shpallur fitues Projekti "VISIT, love and care for Albania Gadgets" me G. B, i cili është ortak i kompanisë P.

3. Nga auditimi u konstatua se është shpallur fitues projekti "Aplikacioni Explore Albania " me përfitues Ç. shpk dhe Projekti "Te ecim përmes Bukurive të natyrës, kulturës dhe trashëgimisë" me përfitues Sh.N. A. Sa më sipër konstatohet se të dy përfituesit janë pjesë e "Ç. M. G."

### **Konstatim:**

Projektet e shpallura fituese si vijojnë:

- *Grupi i monitorimit të kontratës:*

- Me memon nr. 3334/1, datë 08.11.2022 drejtuar Ministrit sqarojnë se: projekti "Za Fest Edicioni i VI" V. S., me të cilin është lidhur kontrata me nr. 3334, datë 06.04.2022, nuk ka realizuar sipas përcaktimeve të nenit 5 të kontratës, brenda muajit Gusht 2022, ku nga subjekti nuk është bërë kërkesë as për 30% dhe as për 70%.

- Me memon nr. 3324/1, datë 24.10.2022 drejtuar Ministrit sqarojnë se: projekti "Who Would Have Thought? Albania"- C. C. A. shpk, me të cilin është lidhur kontrata me nr. 3324, datë 05.04.2022, me datën 23.05.2022 ka shprehur pamundësinë e realizimit të projektit dhe shtyrjen e tij për vitin tjetër. Sipas përcaktimeve të nenit 5 të kontratës, subjekti duhet të realizonte projektin dhe të gjithë aktivitetet e përcaktuara në projekt brenda muajit shtator.

- Projekti "*Fuqizimi i imazhi të Visit Gjirokastra përmes rrjetëzimit publik-privat, përmirësimit të shërbimeve, produkteve turistike dhe marketingut aktiv*" – Shoqata "V. Gj.", me të cilin është lidhur kontrata me nr. 3345, datë 06.04.2022, nuk ka realizuar projektin sipas përcaktimeve të nenit 5 të kontratës. Subjekti është paguar për vlerën 30 % të kontratës sipas përcaktimeve të nenit 5 pika 1. Në kushtet që projekti nuk është realizuar MTM me shkresën nr. 3345/1, datë 06.12.2022 ka kërkuar kthimin mbrapsht të kësaj shumë prej 300,885 lekë, vlerë e cila është arkëtuar me datën 27.12.2022.

- Projekti "Bed & Bike Librazhd (Krevat & Biçikleta)" - Shoqata "Dh.", me të cilin është lidhur kontrata me nr. 3330, datë 06.04.2022, nuk ka realizuar projektin sipas përcaktimeve të nenit 5 të kontratës. Subjekti është paguar për vlerën 30 % të kontratës sipas përcaktimeve të nenit 5 pika 1. Në kushtet që projekti nuk është realizuar MTM me shkresën nr. 5963/1, datë 22.08.2022, bazuar në shkresën e dërguar nga subjekti me nr. 5936, datë 28.07.2022, ku përcjell shkresën për anulimin e kontratës, ka kërkuar kthimin mbrapsht të vlerës 720,000 lekë, vlerë e cila është arkëtuar me datën 09.09.2022.

- ***Projekti "Albania Coast from the Air"*** është lidhur kontrata nr. 3338, datë 06.04.2022 me subjektin G. C. shpk. Nga projekti janë realizuar fotot panoramike nga ajri të të gjithë bregdetit; Janë përgatitur tekstet të cilat do të shoqërojnë fotot e realizuara;

Janë realizuar dizajni grafik dhe printimi i albumit;

Realizuar evente ku është bërë prezantimi i albumit.

Dokumentacioni fizik i albumit është bërë hyrje në MTM me fletë hyrjen nr. 72, datë 02.12.2022.

Nga komisioni i monitorimit është mbajtur raporti me datën 23.12.2022.

### **Konstatimi:**

Dokumentacioni është bërë hyrje më përpara se "Komisioni i monitorimit të marrë në dorëzim projektin dhe të dalë me raportin për realizimin e projektit" veprime në kundërshtim me Udhëzimin

nr. 30 të MFE, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” paragrafi 37. Me urdhër shpenzimin nr. 237, datë 31.05.2022 është bërë pagesa 30% sipas kontratës së lidhur dhe 70% është bërë me urdhër shpenzimin nr. 669, datë 28.12.2021 në total 3,676,445 lekë.

- **Projekti “Gjirokastra in your pocket-Shkodra in your pocket”** është lidhur kontrata nr. 3328, datë 06.04.2022 me subjektin L. I. shpk.

Nga projekti janë realizuar :

Hulumtim, identifikim dhe hartëzimi ne terren i atraksioneve dhe ofertës turistike ne qarqet Gjirokastër dhe Shkodër. Nga ekipi kërkimor është realizuar kërkimi ne terren, ku janë mbledhur informacione faktike në lidhje me atraksione, hotele, bare, restorante dhe janë përpiluar skeda informative, te cilat me pas janë seleksionuar nga ekipi i hartëzimit bazuar në sugjerimet e ekspertit ndërkombëtar, se çfarë mund te përfshihej ne fletëpalosjet.

Ndërkohë me ekipin e hartezimit kane punuar dhe fotografët, te cilët kanë bere foto te atraksioneve, restoranteve, hoteleve te përzgjedhura.

Janë përgatitur fletëpalosjet ne formatin "In your pocket" për Gjirokastrën (përfshire Dropull dhe Libohove), Pukën (përfshire Fushe Arrëz, Vau i Dejës, Ligeni i Komanit), Malësia e Madhe (përfshirë Tamarë, Lëpushe, Vermosh, Boge, Razem dhe Rec), Shkodër (përfshirë Theth, Velipoje he Ligeni i Shkodrës), Lugina e lumit Vjose (përfshirë Tepelene, Përmet, Këlcyrë, Memaliaj).

Publikimi në format të printuar dhe digital i te gjithë materialit te përmbledhur në formatin "In your Pocket Guides".

Janë printuar fletëpalosje, ku 10 kopje për secilën nga fletëpalosjet janë dorëzuar me dokumentacionin e projektit. Gjithashtu materiali i përmbledhur për destinacionet e Qarkut Gjirokastër (Gjirokastër, Libohove, Dropull, Memaliaj, Parmet, Këlcyrë, Tepelene) dhe Shkodër (Shkodër, Malësi e Madhe, Vau i Dejës, Pukë, Fushe Arrëz) është publikuar në platformën "In your Pocket" ne linkun <https://www.inyourpocket.com/albania>.

Shpërndarja dhe promovimi i këtyre materialeve nëpër bashkitë përkatëse sipas numrit te paracaktuar të kopjeve për secilën bashki.

Promovimi është realizuar nëpërmjet një aktiviteti në secilin prej qarqeve.

Nga komisioni i monitorimit është mbajtur raporti me datën 21.10.2022.

Me urdhër shpenzimin nr. 242, datë 31.05.2022 është bërë pagesa 30% sipas kontratës së lidhur dhe 70% është bërë me urdhër shpenzimin nr. 524, datë 28.12.2021 në total 3,392,000 lekë.

- **Projekti “Harta Digjitale e Shqipërisë qytetet UNESCO Faza e pare”** është lidhur kontrata nr. 3329, datë 06.04.2022 me subjektin B.& R. A.

Nga projekti janë realizuar;

Prodhime filmike dhe fotografike;

Ndërtimi i platformës virtuale interaktive VR për qytetin e Gjirokastrës;

Ndërtimi i platformës virtuale interaktive VR për qytetin e Berat, ku përmes tyre është realizimi i tureve virtuale.

Nga komisioni i monitorimit është mbajtur raporti me datën 30.11.2022.

Me urdhër shpenzimin nr. 295, datë 20.06.2022 është bërë pagesa 30% sipas kontratës së lidhur dhe 70% është bërë me urdhër shpenzimin nr. 603, datë 07.12.2021, në total 9,284,678 lekë.

- **Projekti “Check in fest Albania”** është lidhur kontrata nr. 8452, datë 16.11.2022 me subjektin P.

Nga projekti janë realizuar: “Check in street party” datë 19.11.2022; “Check in treasure hunt” datë 19.11.2022; “Check in Live concert” datë 19.11.2022;

“Check in Talk” dhe “Check in DJ set” datë 24.11.2022; të cila janë aktivitete të zhvilluara në Tiranë. Nga komisioni i monitorimit është mbajtur raporti me datën 21.12.2022.

Me urdhër shpenzimin nr. 615, datë 09.12.2022 është bërë pagesa 30% sipas kontratës së lidhur dhe 70% është bërë me urdhër shpenzimin nr. 603, datë 07.12.2021, në total 8,441,500 lekë.

- **Projekti “Shqipëria ne sytë e mi”** është lidhur kontrata nr. 8459, datë 16.11.2022 me subjektin P.

Nga projekti janë realizuar: 6 video promovues të rajoneve të Shqipërisë: Shkodër, Tiranë, Gjirokastër, Korçë dhe Vlorë, ku projekti ka konsistuar në xhirimin e planeve të zonave të përcaktuara në Shqipëri dhe në punën kërkimore ku janë përfshirë tre specialist në fushën e turizmit të cilët kanë bashkërenduar zonat mbi të cilën janë realizuar videot;

Nga komisioni i monitorimit është mbajtur raporti me datën 21.12.2022.

Me urdhër shpenzimin nr. 612, datë 09.12.2022 është bërë pagesa 30% sipas kontratës së lidhur dhe 70% është bërë me urdhër shpenzimin nr. 649, datë 23.12.2021, në total 8,441,500 lekë. ***Nuk ka asnjë sqarim se si janë promovuar këto video ku janë hedhur dhe për çfarë kanë shërbyer***

- **Projekti “Elbasani Turistik”** është lidhur kontrata nr. 8453, datë 16.11.2022 me subjektin Z.

Nga projekti janë realizuar: Dy videoe promovues të qytetit të Elbasanit; Inaugurimi i pistës së parashutizmit Fumar, si dhe ofrimi i informacioneve të hollësishme rreth pasurisë kulturore dhe natyrore të zonës.

*Panairi tradicional*; Aktivitete me të rinjtë; Sofra Elbasançe; prezantimi i dy videove promovuese të qytetit të Elbasanit; inaugurimi i pistës së parashutizmit fumar; masterclass Dj Academy Albania.

Nga komisioni i monitorimit është mbajtur raporti me datën 21.12.2022.

Me urdhër shpenzimin nr. 611, datë 09.12.2022 është bërë pagesa 30% sipas kontratës së lidhur dhe 70% është bërë me urdhër shpenzimin nr. 654, datë 27.12.2021, në total 10,500,000 lekë.

- **Projekti “Analize dhe vlerësim për ecurinë e sektorit turizmit dhe krijimi i një platforme të integruar”** është lidhur kontrata nr. 8451, datë 16.11.2022 me subjektin I. shpk.

Nga projekti është realizuar zhvillimi i një data baze të dhënash mbi performancën e industrisë së turizmit, në formën e një “dashboard” për të qenë sa më uniform dhe i aksesueshëm për politikëbërësit dhe grupet e interesit.

Projekti ka zhvilluar aktivitete si metodologjia e anketës në strukturat akomoduese, pyetësorë, data bazë e të dhënave të anketave në strukturën akomoduese në SPSS dhe excel;

Lista me operatorët turistik; Analiza të sektorit të turizmit; të dhëna social ekonomike; indikatorë të turizmit nga INSTAT dhe WTTC; rezultatet e anketës me strukturën akomoduese; protokollin për përdorimin e databazës, dashboard dhe përditësimi i të dhënave; Webapp Dashboard;

Nga komisioni i monitorimit është mbajtur raporti me datën 21.12.2022.

Me urdhër shpenzimin nr. 611, datë 09.12.2022 është bërë pagesa 30% sipas kontratës së lidhur dhe 70% është bërë me urdhër shpenzimin nr. 654, datë 27.12.2021, në total 10,500,000 lekë.

- **Projekti “Aplikacioni Explore Albania”** është lidhur kontrata nr. 8458, datë 16.11.2022 me subjektin Ç. shpk.

Nga projekti është sqarohet se është realizuar aplikacioni për Smartphone me informacione të detajuara të destinacioneve turistik, prezantime dhe përshkrime të destinacioneve.

Pra nga subjekti thuhet se është bërë nderimi dhe pasqyrimi i aplikacionit.

Nga komisioni i monitorimit është mbajtur raporti me datën 21.12.2022.

Me urdhër shpenzimin nr. 609, datë 09.12.2022 është bërë pagesa 30% sipas kontratës së lidhur dhe 70% është bërë me urdhër shpenzimin nr. 652, datë 23.12.2021, në total 1,700,000 lekë. ***Nga grupi i auditimit u konstatua se një aplikacion i tillë është krijuar me të njëjtin emër që 2014 nga ish- kompania A.***

#### **Konstatimet:**

- Në vitet 2020 dhe 2021 Qëllimi kryesor i thirrjeve dhe tematikat e thurjeve kanë qenë të njëjta, të përgjithshme dhe pa një fokus të përcaktuar të nevojave që ka turizmi.

Nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit nuk ka zhvilluar proces studimi dhe planifikimi, sipas prioritetëve që ministria duhet të ketë çdo vit, duke mos përcaktuar qartë, zonave me përparësi zhvillimin e turizmit dhe burimet turistike për të cilat do të zhvillohen këto projekte dhe të cilat



më pas të do të shndërrohen në produkte turistike.

Veprimi i mësipërme sjellin riskun e krijimit të një procesi të pa adresuar të procesit dhe përsëritje të projekteve për fusha të njëjta të cilat kanë ndodhur gjatë tre viteve.

- Komisionet e përzgjedhjes së aplikantëve në të tre vitet 2020-2021-2022 kanë në përbërje 4-5 anëtar veprime në kundërshtim me ligjin nr. 93/2015 “Për Turizmin” pika 6.”Miratimi i projekteve turistike bëhet nga ministri përgjegjës për turizmin, me propozim të Komisionit të Përzgjedhjes së Projekteve, të përbërë nga 7 anëtarë: a) 5 nëpunës të nivelit të lartë dhe të mesëm drejtues të strukturave përgjegjëse në ministri; b) 2 përfaqësues nga shoqatat e sektorit të turizmit” dhe Vendimin nr. 325, datë 31.5.2018 “Për përcaktimin e anëtarëve të komisionit të përzgjedhjes së projekteve në turizëm”.

- Për vitin 2022, nga auditimi i procesit të vlerësimit të aplikimeve konstatohet se, Komisionit i Përzgjedhjes së Projekteve janë mbledhur me pjesëmarrjen e anëtarëve dhe kanë përpiluar procesverbale, ku japin listën e përfituesve dhe për të skualifikuarit shprehen se ka mungesë dokumentacioni ose kërkesa për financim kalon 50% të vlerës së projekti. Në procesverbal mungon një relacion shpjegues në lidhje me skualifikimet, vlera e financimit që është kërkuar nga aplikuese dokumentacioni i cili nuk është dorëzuar etj, por Komisioni është mjaftuar vetëm me një renditje në formë tabelore të projekteve që kanë aplikuar nga thirrja, ku dhe në tabelë nuk është argumentuar dhe sqaruar projekt për projekt se çfarë dokumentesh mungojnë dhe për projektet fituese nuk janë cituar dokumentacioni i dorëzuar nga përfituesi.

- Komisionit i Përzgjedhjes së Projekteve në procesverbalet e mbajtura ndër vite nuk jep argumente në lidhje me projektet e përzgjedhura dhe të kualifikuara si fitues nëse kanë impakt në planin e zhvillimit turizmit, si dhe nëse ato projekte përputhen me prioritetet e përcaktuara, ku për vitin 2022 MTM ka përcaktuar dy prioritete dhe disa shembuj të tipologjisë së aktiviteteve që synojnë arritjen e këtyre prioritetëve.

Sa më sipër veprime në kundërshtim me ligjin nr. 93/2015 “Për Turizmin” neni 32 “Kompetencat e Komisionit të Përzgjedhjes së Projekteve” ku citohet se: Kompetencat e Komisionit të Përzgjedhjes së Projekteve.

a) klasifikon dhe përzgjedh projektet në fushën e turizmit, duke vlerësuar ndikimin social ekonomik të tyre;

b) propozon miratimin e projekteve, në përputhje me nenin 30 të këtij ligji.

- Nga auditimi u konstatua se mungonte vendosja e logos së financuesit, përgjithësisht për pjesën e projekteve të cilat ishin në media vizive të shkruar apo elektronike të realizuara, veprime në kundërshtim **me nenin 6 pika 3** të kontratave të lidhura mes përfituesit dhe Financuesit MTM.

- Nga auditimi u konstatua se për të gjitha procedurat e projekteve të fituara për vjetet 2020; 2021 dhe 2022, të cilat janë marrë në dorëzim sipas kushteve të kontratës së lidhur midis përfituesit dhe financuesit konstatohet se: *Mungojnë fletë hyrjet e marrjes në dorëzim të projekteve të cilat kanë të bëjnë me krijimin e faqeve web, platforma, databaza të krijuara ose programe të tjera.*

- Nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit nuk ka asnjë plan monitorimi periodik me objektiva të qarta mbi këto projekte të finalizuar, e cila ka çuar në mungesën e një analize mbi impaktin që kanë pasur dhe kanë këto projekte në zhvillimin e turizmit.

<b>Titulli i Gjetjes:</b>	Mangësitë e konstatuara mbi projektet për zhvillimit të turizmit:
<b>Situata:</b>	Nga auditimi i projekteve për zhvillimit të turizmit rezultoi se: - Në vitin 2020 dhe vitin 2021 “ <i>Qëllimi kryesor i thirrjeve dhe tematikat e thurjeve</i> ” kanë qenë të njëjta, të përgjithshme dhe pa një fokus të përcaktuar të nevojave që ka turizmi. - Ministria e Turizmit dhe Mjedisit nuk ka zhvilluar proces studimi dhe planifikimi, sipas prioritetëve që ministria duhet të ketë çdo vit, duke mos përcaktuar qartë, zonave me përparësi zhvillimin e turizmit dhe burimet turistike për të cilat do të zhvillohen këto projekte dhe të cilat më pas të do të shndërrohen në produkte turistike.

Veprime të cilat sjellin riskun e krijimit të një procesi të pa adresuar të procesit dhe përsëritje të projekteve për fusha të njëjta të cilat kanë ndodhur gjatë tre viteve.

- Komisionet e përzgjedhjes së aplikantëve në të tre vitet 2020-2021-2022 kanë në përbërje 3-4 anëtar veprime në kundërshtim me ligjin nr. 93/2015 “Për Turizmin” pika 6.”Miratimi i projekteve turistike bëhet nga ministri përgjegjës për turizmin, me propozim të Komisionit të Përzgjedhjes së Projekteve, të përbërë nga 7 anëtarë: a) 5 nëpunës të nivelit të lartë dhe të mesëm drejtues të strukturave përgjegjëse në ministri; b) 2 përfaqësues nga shoqatat e sektorit të turizmit” dhe Vendimin nr. 325, datë 31.5.2018 “Për përcaktimin e anëtarëve të komisionit të përzgjedhjes së projekteve në turizëm”.
- Për vitin 2022, nga auditimi i procesit të vlerësimit të aplikimeve konstatohet se, Komisionit i Përzgjedhjes së Projekteve janë mbledhur me pjesëmarrjen e anëtarëve dhe kanë përpiluar procesverbale, ku japin listën e përfituesve dhe për të skualifikuarit shprehen se ka mungesë dokumentacioni ose kërkesa për financim kalon 50% të vlerës së projekti. Në procesverbal mungon një relacion shpjegues në lidhje me skualifikimet, vlera e financimit që është kërkuar nga aplikuese dokumentacioni i cili nuk është dorëzuar etj, Komisioni është mjaftuar vetëm me një renditje në formë tabelore të projekteve që kanë aplikuar nga thirrja, ku dhe në tabelë nuk është argumentuar dhe sqaruar projekt për projekt se çfarë dokumentesh mungojnë dhe për projektet fituese nuk janë cituar dokumentacioni i dorëzuar nga përfituesi.
- Komisionit i Përzgjedhjes së Projekteve në procesverbalet e mbajtura ndër vite nuk jep argumente në lidhje me projektet e përzgjedhura dhe të kualifikuara si fitues nëse kanë impakt në planin e zhvillimit turizmit, si dhe nëse ato projekte përputhen me prioritet e përcaktuara, ku për vitin 2022 MTM ka përcaktuar dy prioritete dhe disa shembuj të tipologjisë së aktiviteteve që synojnë arritjen e këtyre prioriteteve. Sa më sipër veprime në kundërshtim me ligjin nr. 93/2015 “Për Turizmin” neni 32 “Kompetencat e Komisionit të Përzgjedhjes së Projekteve” ku citohet se: Kompetencat e Komisionit të Përzgjedhjes së Projekteve a) klasifikon dhe përzgjedh projektet në fushën e turizmit, duke vlerësuar ndikimin social ekonomik të tyre; b) propozon miratimin e projekteve, në përputhje me nenin 30 të këtij ligji.
- Për vitin 2021 nga Komisioni i përzgjedhjes së projekteve në thirrjen e parë në procesverbalet e mbajtura nga ky komision ka skualifikuar projekte, ku sipas gjykimit të tyre projekti ishte në përsëritje të aktivitetit, por pa dhënë asnjë argumentim se kush janë aktivitete që përsëriten dhe që janë promovuar më parë. Në thirrjen e dytë për vitin 2021, komisioni ka përzgjedhur si projekt “Promovim i kalave dhe njohja me historinë e tyre”, projekt i cili është fituar nga “F. S” dhe në vitin 2020, ku ndryshimi nga projekti i parë është vetëm destinacioni i kalave të përzgjedhura. Sa më sipër konstatohet një gjykim me dy standarde të përzgjedhjes së projekteve nga Komisioni.
- Për vitin 2021, rezultoi se KKPT ka shpallur fitues projektin:
  - "Krijimi i Identitetit korporativ & Brand Book për 4 bashki" me përfitues A. K. PF, projekt i cili është shpallur fitues në vitin 2021, ku

	<p>MTM ka lidhur kontratën me nr. 8131/1, datë 16.11.2021, e cila nuk është realizuar nga përfituesi brenda afateve të përcaktuara. <b>Në vitin 2022</b>, Komisioni i Përzgjedhjes së Projekteve e ka rizgjedhur sërish një projekt, i cili është paraqitur një herë dhe është shpallur fitues, ku përfituesi nuk e ka realizuar projektin brenda përcaktimeve të kushteve të kontratës.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- <b>Projektin “Check in fest Albania”</b> me subjektin P., ku <b>A. K.</b> është ortak i kësaj kompanie.</li> <li>- "Visit, love and care for Albania Gadgets" me G.B., i cili është ortak i kompanisë P.</li> <li>- "Aplikacioni Explore Albania " me përfitues Ç. shpk dhe Projekti "Te ecim përmes Bukurive të natyrës, kulturës dhe trashëgimisë" me përfitues Sh. N. A. Sa më sipër konstatohet se të dy përfituesit janë pjesë e “Ç. M. G.”, veprime në kundërshtim me VKM-në 281, datë 13.04.2016 “Për përcaktimin e kriterëve të afateve të kërkesë/propozimeve për mbështetjen financiare të projekteve në fushën e turizmit” pika 13.</li> <li>- Nga auditimi u konstatua se mungonte vendosja e logos së financuesit, përgjithësisht për pjesën e projekteve të cilat ishin në media vizive të shkruar apo elektronike të realizuara, veprime në kundërshtim <b>me nenin 6 pika 3</b> të kontratave të lidhura mes përfituesit dhe Financuesit MTM.</li> <li>- Nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit nuk ka asnjë plan monitorimi periodik me objektiva të qarta mbi këto projekte të finalizuar, e cila ka çuar në mungesën e një analize mbi impaktin që kanë pasur dhe kanë këto projekte në zhvillimin e turizmit.</li> </ul>
<b>Kriteri:</b>	<p>Ligjin nr. 93/2015 “Për Turizmin” neni 32 “Kompetencat e Komisionit të Përzgjedhjes së Projekteve”.</p> <p>Vendimi nr. 325, datë 31.5.2018 “Për përcaktimin e anëtarëve të komisionit të përzgjedhjes së projekteve në turizëm”.</p> <p>VKM-së 281, datë 13.04.2016 “Për përcaktimin e kriterëve të afateve të kërkesë/propozimeve për mbështetjen financiare të projekteve në fushën e turizmit” pika 13.</p>
<b>Ndikimi/Efekti:</b>	<p>Veprime të cilat sjellin riskun e krijimit të një procesi të pa adresuar të procesit dhe përsëritje të projekteve për fusha të njëjta të cilat kanë ndodhur gjatë tre viteve. Mungesa e monitorimit, e cila ndikon në mos identifikimin e impaktin që kanë pasur dhe kanë projektet në zhvillimin e turizmit.</p>
<b>Shkaku:</b>	<p>Mungesë e mirëargumentimit të prioritetëve të MTM çdo vit.</p> <p>Mungesë argumentimi të përzgjedhjes së projekteve nga Komisioni.</p> <p>Mos identifikimi i projekteve të cilat kanë fituar dhe nuk kanë zbatuar kushtet e kontratës.</p>
<b>Rëndësia:</b>	E lartë
<b>Rekomandimi:</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Ministria e Turizmit dhe Mjedisit të marrë masa për hartimin e prioritetëve sa më të qarta mbi zonat me përparësi në zhvillimin e turizmit dhe burimet turistike për të cilat do të zhvillohen këto projekte, me qëllim përdorimin e fondeve publike në këto programe, me eficiencë dhe efektivitet si dhe me impakt në fushën e turizmit.</li> <li>- Komisioni i përzgjedhjes së projekteve, në MTM të marrë masa që në procesverbalet e mbajtur për përzgjedhjen e aplikantëve të argumentojë</li> </ul>

	<p>mënyrën e përzgjedhjes së projekteve duke pasur në fokus impaktin që kanë në planin e zhvillimit turizmit.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Komisioni i përzgjedhjes së projekteve, në MTM gjatë vlerësimit të projekteve brenda një viti të marrë masa për kualifikimin e projekteve, në të cilin ortaku dhe/ose administratori nuk rezulton të jetë pjesë e projekteve të tjera në këtë pozicion.</li> <li>- Drejtoria e Përgjithshme e Politikave dhe Zhvillimit të Turizmit të marrë masë për hartimin e regjistrave të projekteve fituese, duke evidentuar rastet e atyre projekteve të cilat kanë lidhur kontratën dhe nuk kanë përmbushur kushte e saj, me qëllim heqjen e të drejtës së aplikimit sërish më këto projekte në periudhën pasardhëse.</li> <li>- Nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit të merren masa për hartimin e një plani monitorimi periodik, të projektet në fushën e Turizmit, me qëllim vlerësimin e përdorimit të fondeve publike në këto programe, me eficiencë dhe efektivitet si dhe me impakk në fushën e turizmit.</li> </ul>
--	--

***Për sa më sipër, ngarkohet me përgjegjësi:***

- Znj. L. B. A., në cilësinë e anëtares së Komisionit të Përzgjedhjes së Projekteve, si dhe në cilësinë e Nëpunësit Autorizues për mungesën e monitorimit periodik mbi këto projekte.
- Znj. A. B; znj O. C dhe znj. K.F, në cilësinë e anëtares së Komisionit të Përzgjedhjes së Projekteve.

## **IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET**

### **A. MASA ORGANIZATIVE**

**1. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se nga 65 investimet që janë referuar që prej planifikimit buxhetor afatmesëm dhe deri në realizimin e tyre për vitin 2022, 24 prej tyre ose 37% në shumën 78,974,000 lekë nuk janë planifikuar në PBA 2022-2024, nga të cilat 2 investime janë planifikuar dhe miratuar në buxhetin fillestar të vitit 2022. Ndër këto investime të paplanifikuara në PBA 2022-2024, pjesën kryesore ose e zë projekti i investimit “Pajisje dhe pjesë këmbimi për 7 stacionet e monitorimit të ajrit” në vlerën 37,480 mijë lekë. Veprimet në kundërshtim me Ligjin nr. 9936 datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, VKM 185, datë 29.03.2018 “Për procedurat e menaxhimit të investimeve publike”, pika 7 dhe Udhëzimin e MFE nr. 7, datë 28.02.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm” Pika 8. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 1, faqet nr. 19-36 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**1.1. Rekomandimi:** Titullari i Institucionit në bashkëpunim me Grupin e Menaxhimit Strategjik, të marrin masat e nevojshme, që në periudhat në vijim të eliminohen praktikata e çeljes së projekteve të reja pa kaluar në procedurat e ciklit të menaxhimit të investimeve publike, me qëllim respektimin e disiplinës buxhetore, si dhe të respektohen projektet e investimeve të parashikuara në PBA.

**Në vijimësi**

**2. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se, aparati i MTM-së, si njësi shpenzuese, nuk ka hartuar raporte monitorimi çdo katër muaj për të ndjekur realizimin e produkteve të buxhetit të saj, për të garantuar përmirësimin e procesit të planifikimit dhe menaxhimit të buxhetit, ndjekjen dhe arritjen e qëllimit dhe objektivave të synuara, sipas deklaratës së politikës së programit, si dhe krahasimin e treguesve të planifikuar të performancës me treguesit faktik. Nga MTM monitorimi është kryer për të gjithë programet e MTM-së pa hartuar raporte 4 mujore monitorimi sipas përcaktimeve në Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në

Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, neni 65 dhe Udhëzimin e MFE nr. 22, datë 17.11.2016 “Për procedurat standarde të monitorimit të Buxhetit në NJQQ”. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 1, faqet nr. 19-36 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**2.1. Rekomandimi :** NA dhe NZ në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit të marrin masat, për hartimin e raporteve të monitorimit të buxhetit çdo katër muaj për aparatën e MTM-së si njësi shpenzuese, për produktet e buxhetit të administruara nga ana e saj, me qëllim përmirësimin e procesit të planifikimit dhe monitorimit të buxhetit, si dhe publikimin e tyre në faqen zyrtare të ministrisë.

**Në vijimësi**

**3. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i buxhetit për periudhën 01.01.2020 deri në 31.12.2022 u konstatua se:

Fondet e akorduara për rindërtimin në shumën 200,000 mijë lekë, për Agjencinë Kombëtare të Bregdetit për vitin 2020 fillimisht nuk kanë qenë të evidentuar në një produkt të veçantë me objektiv të lidhur me rindërtimin, por i inkorporuar në kodin e produktit 92603AB “Monitorime të kryera gjatë vijës bregdetare” të Agjencisë Kombëtare të Bregdetit, si dhe nuk u konstatua raportim për këtë produkt në numër përfituesish (personash të akomoduar); duke cënuar konceptin e produktit dhe programit në kundërshtim me Ligjin nr. 9936 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor”, i ndryshuar, pikat 27, 31 dhe 32 “Program buxhetor”.

Në raportet e monitorimit për vitin 2020 mungonte raportimi për këtë produkt si në relacionin shpjegues dhe në Aneksin nr. 3 "*Raporti përmbledhës i realizimit të treguesve të performancës/produkteve të programit*", veprime në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 22, datë, 17.11.2016 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit për njësitë e qeverisjes qendrore”, Pjesa I, Pika 4, “*Monitorimi është një proces vlerësimi performance i cili realizohet nëpërmjet krahasimit të treguesve faktikë të performancës me ato të planifikuar*” dhe Pika 5 “*Monitorimi i produkteve bëhet në sasi dhe në vlerë*” dhe Udhëzimin nr. 7, datë 28.02.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së PBA” Pjesa 2.5.

- Për vitin 2020 bazuar në VKM nr. 378, datë 8.5.2020 “Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2020, miratuar për Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, për mbulimin e shpenzimeve të akomodimit të personave që riatdhesohen”, në vlerën 95,200 mijë lekë, për të cilat përgjatë vitit 2020 janë përdorur 70,444 mijë lekë, rezultoi se nga MTM nuk është çelur një kod i ri për riatdhesimin, si dhe nuk disponohet informacion mbi numrin e personave të akomoduar, duke bërë që raportimi i këtij shpenzimi të humbasë gjurmën e auditimit dhe transparencën në raportim. Veprime në kundërshtim me Udhëzimin plotësues të MFE nr. 2, datë 20.01.2020 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2020”, pika 9, për detajimin e fondeve buxhetore sipas klasifikimit buxhetor me kod produkti.

- Për vitin 2021, në buxhetin e miratuar, në programin “Zhvillimi i turizmit”, në artikullin 602 (shpenzime operative), për Agjencinë Kombëtare të Turizmit, i është shtuar fondi prej 100,000,000 (njëqind milionë) lekësh, për përballimin e shpenzimeve për mbështetjen e turizmit shqiptar për promovimin në tregjet ndërkombëtare post COVID-19 dhe prezantimin e Shqipërisë si një destinacion mikpritës COVID-free. Efekti financiar, prej 100,000,000 (njëqind milionë) lekësh, është përballuar nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit për vitin 2021. Ky produkt nuk ka qenë i planifikuar në PBA 2021-2023 në programin “Zhvillimi i turizmit” dhe në monitorimin vjetor 2021 nuk është raportuar në lidhje me sasinë dhe koston për njësi. Veprimet e mësipërme janë kryer në kundërshtim me Ligjin nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor”, i ndryshuar, pikat 27, 31 dhe 32; Udhëzimin e MFE nr. 7, datë 28.02.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së PBA” pjesa 2.5, pika 2; Udhëzimin e MFE nr. 22, datë 17.11.2016 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit për njësitë e qeverisjes qendrore”, pika 49. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 1, faqet nr. 19-36 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**3.1. Rekomandimi:** Ministria e Turizmit dhe Mjedisit të marrë masa për përmirësimin e procesit të planifikimit dhe raportimit, për efekt të hartimit dhe monitorimit të planit buxhetor sa më të

detajuar dhe transparente, duke përfshirë të gjitha njësitë përgjegjëse për buxhetin e programeve të administruara nga institucioni.

## Në vijimësi

**4. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i përmbajtjes/detyrave funksionale të përcaktuara në Rregulloren e brendshme dhe strukturave organike të miratuara me Urdhrat e Kryeministrit nr. 165/2017, nr. 127/2021 dhe nr. 185/2022 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së MTM” konstatohet se nuk ka përshkrim të punës specifik për Drejtoritë e Përgjithshme, Drejtoritë dhe Sektorët sipas emërimit të tyre në strukturën e miratuar, por vetëm një përshkrim të përgjithshëm për të gjitha drejtoritë dhe sektorët duke mos bërë pasqyrimin e detyrave dhe përgjegjësiive sipas të gjitha pozicioneve të punës të miratuar në strukturë. Veprimi i mësipërm bie në kundërshtim me nenin 7, të Ligjit nr. 9000, datë 30.01.2003, pika 4, Ligjit nr. 90/2012 neni 29, pika 2 dhe VKM-së nr. 142, datë 12.03.2014, i ndryshuar, pika 13 dhe pika 16. Në rregulloren e brendshme nuk janë përfshirë përshkrimet e punës të hartuara nga Drejtoria e Burimeve njerëzore. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqet nr. 36-47 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**4.1.Rekomandimi:** Ministria e Turizmit dhe Mjedisit të marrë masat për të përditësuar rregulloren e brendshme të ministrisë me qëllim përcaktimin e detyrave dhe përgjegjësiive për të gjithë pozicionet e punës sipas strukturës organike në fuqi.

## Menjëherë

**5. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i strukturës së MTM-së për periudhën 01.01.2020-31.12.2022 u konstatua se ka patur ndryshime në Strukturën e Ministrisë, ku në procedurën e ristrukturimit janë konstatuar parregullsitë dhe vonesat si vijon:

- MTM ka dërguar kërkesën për krijimin e Komisionit të Ristrukturimit në Departamentin e Administratës Publike (DAP), 5 (pesë) ditë me vonesë nga miratimi i strukturës;
- Njoftimi i punonjësve të aparatit të MTM është dërguar një ditë pas kërkesës për krijimin e komisionit të ristrukturimit drejtuar DAP;
- Vendimi i komisionit i është propozuar DAP me shkresën nr. 1074/1, datë 13.02.2023 është dërguar me një afat kohor prej 81 (tetëdhjetë e një) ditësh dhe jo 15 (pesëmbëdhjetë) ditë.
- Në vendimin e propozimit u konstatua praktika jo e plotë me të cilën Komisioni i Ristrukturimit ka marrë vendimin e propozimit për transferim të përhershëm të 70 (shtatëdhjetë) punonjësve.
- Referuar Vendimit të Komisionit të Ristrukturimit me nr. 8600/2, datë 20.12.2022, për 11 nga 70 pozicione ose 16% të tyre nuk është ruajtur e njëjta kategori, duke dalë jashtë kompetencave të Komisionit të Ristrukturimit i cili ka për detyrë vlerësimin e transferimit të pozicioneve të ndryshuara në një kategori të njëjtë me pozicionin e mëparshëm të punës;
- Nga pozicionet e punës me kategori të ndryshme u konstatua se 5 (pesë) prej tyre janë ndryshuar në kategori më të lartë dhe 6 (gjashtë) prej tyre në kategori më të ulët;
- Prej miratimit të strukturës së re deri më dakordësinë e punonjësve në lidhje me pozicionet e reja të punës, konstatohet se procesit të ristrukturimit i është dashur një periudhë kohore prej 100 (njëqind) ditësh dhe jo 30 (tridhjetë) ditë;
- Në Urdhrin e Kryeministrit nr. 185, datë 15.11.2022 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së MTM” citohet se efektet financiare të strukturës së re do të nisnin më datë 01.01.2023, ndërkohë që sipas Urdhrit të Ministrit të MTM me nr. 70, datë 24.02.2023 “Për zbatimin e Urdhrit të Kryeministrit nr. 185, datë 15.11.2022” struktura e re e MTM hyn në fuqi në datën 01.03.2023, Shtyrja e afatit të procesit të ristrukturimit sipas MTM është bazuar nga një Vendim i Komisionit të Ristrukturimit me nr. 8600/2, datë 20.12.2022 “Vendim për zgjatjen e afatit të procedurës administrative të ristrukturimit” ku Komisioni i Ristrukturimit për punonjësit të cilëve u është shkurtuar vendi i punës i është dashur më shumë kohë për sistemimin e tyre në institucionet e varësisë të cilat janë gjithashtu në proces ristrukturimi.
- Nga auditimi i dosjes të procesit të ristrukturimit në aparatit të MTM, nuk u konstatua një raport

përpara ndryshimit të strukturës.

Veprimet e mësipërme janë kryer në kundërshtim me Ligjin nr. 44/2015 “Kodi i procedurave administrative i republikës së Shqipërisë”, meni 53, pika 1, neni 92, Ligjin nr. 152/2003 “Për Nëpunësin Civil” i ndryshuar, neni 50, pika 7; dhe Udhëzimin e DAP me nr. 1, datë 01.03.2016 “Për krijimin, funksionimin dhe kompetencat e komisionit të ristrukturimit për shkak të mbylljes apo ristrukturimit të institucionit” i ndryshuar, pika 16 dhe pika 17. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqet nr. 36-47 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**5.1.Rekomandimi:** Ministria e Turizmit dhe Mjedisit të marrë masat për të respektuar afatet kohore për të gjitha procedurat në rastet e ndryshimeve në strukturë të cilat shoqërohen me mbylljen apo ristrukturimin e institucionit, gjithashtu këto procedura të shoqërohen me praktikat respektive.

**Në vijimësi**

**6. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi mbi njohjen e detyrimeve në kontabilitet dhe vendimet e proceseve gjyqësore u konstatua se:

**6.1** Nga regjistrimet e kryera në sistemin financiar SIFQ, MTM nuk ka njohur në kontabilitet detyrimet që kanë lindur në muajin dhjetor 2022 dhe janë paguar në Janar 2023 për shërbim roje, energji elektrike, ujë etj, në shumën 749,745 lekë;

**6.2.** Nga auditimi mbi vendimet e proceseve gjyqësore dhe njohjen e tyre në kontabilitet rezultoi se, shuma totale e vendimeve gjyqësore, të cilat kanë marrë formë të prerë dhe janë shlyer janë si vijon:

-Vendime të formës së prerë marrë në vitin 2015 në shumën 7,299,162 lekë, në vitin 2016 në shumën 3,718,588 lekë dhe në vitin 2017 në shumën 25,379,916, të cilat janë likuiduar në vitin 2020;

- Vendime të formës së prerë marrë në vitin 2019 në shumën 862,708 lekë, në vitin 2020 në shumën 3,218,548 lekë dhe në vitin 2021 në shumën 1,385,659 lekë, të cilat janë likuiduar në vitin 2021;

- Vendime të formës së prerë marrë në vitin 2017 në shumën 1,290,537 lekë, në vitin 2019 në shumën 16,948,178 lekë, në vitin 2021 në shumën 1,228,512 lekë dhe në vitin 2022 në shumën 3,287,972 lekë të cilat janë likuiduar në vitin 2022;

Këto vendime gjyqësore nuk janë njohur në kontabilitet si detyrime për t’u shlyer.

- Si pasojë, llogaria 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” nuk pasqyron vlerën e saktë në pasqyrat financiare të viteve 2020 - 2022. Në këtë zë nuk janë reflektuar detyrimet sa i takon shpenzimeve të periudhave të ardhshme për vendimet gjyqësore, të cilat kanë marrë formën e prerë përpara mbylljes së pasqyrave financiare të vitit ushtrimor.

- Gjithashtu, shpenzimet për vendimet gjyqësore të formës së prerë, nuk janë njohur në kontabilitet sipas parimit të të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara, duke mos u njohur si shpenzime periudhe në momentin e marrjes së formës së prerë të Vendimit të Gjykatës, por janë njohur në momentin e likuidimit, në kundërshtim me nenin 61, të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, i ndryshuar, si dhe Udhëzimit të MFE me nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar, pika 34 dhe 42.

- Duke ju referuar pagesave të kryera nga MTM për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore, rezultoi se nuk është respektuar parimi FIFO, për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura.

Veprimet e mësipërme janë kryer në kundërshtim me nenin 61, të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, i ndryshuar, si dhe Udhëzimit të MFE me nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat në përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar, paragrafi 34 dhe 42. Sa më sipër, shuma e vendimeve gjyqësore duhet të ishte reflektuar në mbyllje të pasqyrave financiare të vitit ushtrimor në llogarinë 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqet nr. 58-76 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**Rekomandim 6.1:** Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar të marrë masa në vijimësi, që menjëherë pas lindjes së detyrimit të bëjë regjistrimin në kontabilitet të detyrimit të plotë, bazuar në parimin e të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara.

**Në vijimësi**

**Rekomandim 6.2:** Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar të marrë masa në vijimësi për të rakorduar me Sektorin e Ankesave Administrative dhe Gjyqësore, sa i takon informacionit të plotë të vendimeve të gjykatës të formës së prerë, të cilat duhet të njihen në vlerën e tyre të plotë, si detyrime për tu shlyer në periudhat e ardhshme dhe për të cilat duhet të provigjionohen shumat përkatëse. Njëkohësisht vlera e tyre duhet njohur edhe si shpenzim periudhe në pasqyrat financiare të institucionit.

**Në vijimësi**

**Rekomandim 6.3:** Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar në çdo rast të ndjekë dhe të zbatojë me përpikmëri parimin FIFO, gjatë likuidimit të detyrimeve të prapambetura.

**Në vijimësi**

**Rekomandim 6.4:** Nga ana e Sektorit të Ankesave Administrative dhe Gjyqësore, të merren masa për ndjekjen me kujdes të proceseve gjyqësore dhe përcjelljen në kohë të informacionit të plotë dhe të saktë në njësinë përkatëse, përgjegjëse për financë/kontabilitetin, në mënyrë që kjo e fundit të njohë dhe kontabilizojë në kohë vlerat që lidhen me këto shpenzime/detyrime, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi.

**Në vijimësi**

**7. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i analizave të llogarisë nr.28 “Caktime të Aktiveve Afatgjata” shuma prej 235,323,285 lekë është mbartur përpara vitit 2017. Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar nuk ka informacion se cilat janë këto projekte/investime të zhvilluara përpara vitit 2017, si dhe nuk kanë emërtim, nuk paraqiten kartela inventari dhe nuk dihet se çfarë përfaqësojnë. Veprimet në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, pikat 26, 28, 30, Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar pika 5 dhe pika 30. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqet nr. 58-76 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**Rekomandimi 7.1:** Drejtoria e Buxhetit dhe e Menaxhimit Financiar, të marrë masa që të kryejë analizimin dokumentacionit financiar të trashëguar për nxjerrjen e të dhënave për projektet/investimet e mbartura në llogarinë nr.28 “Caktime të Aktiveve Afatgjata”, në mënyrë të tillë që të verifikohet, saktësohet dhe të analizohen vlerat e paraqitura në Pasqyrat Financiare dhe në rast pasaktësish të bëhen sistemimet e nevojshme në kontabilitet.

**Menjëherë**

**8. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i analizave të llogarisë 230 “Investime në proces” gjatë vitit ushtrimor 2021, për 8 projekte në shumën 17,372,947 lekë kanë qenë aktive afatgjata jo materiale në proces ku investimi i tyre ka qenë i pa përfunduar dhe nuk janë kontabilizuar në llogarinë 230. Këto projekte nuk janë paraqitur në Pasqyrat Financiare të vitit 2021 konkretisht në llogarinë nr.230 “Investime për aktive afatgjata jomateriale”, pasi kjo llogari është paraqitur në vlerën 0 lekë. Këto projekte të pa përfunduara në vitin 2021 duhet të pasqyroheshin në llogarinë nr.230 “Investime për aktive afatgjata jomateriale”, dhe në momentin e marrjes në dorëzim të kapitalizohen më pas tek klasa e aktiveve afatgjata materiale në vlerën e plotë kontabël të aktivitetit. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar pikat 26, 28, 30 dhe pika 75 dhe Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar, pika 5 dhe pika



30. (Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqet nr. 58-76 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**8.1.Rekomandimi:** Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar të marrë masa për sistemimin në kontabilitet të llogarisë nr.230 “Investime në proces” me mbylljen e bilancit të vitit pasardhës, për vlerën kontabël prej 17,372,947 lekë, të projekteve të cilat janë marrë në dorëzim, duke kryer veprimin kontabël në debi të llogarisë nr.202 “Studime dhe Kërkime” dhe në kredi të llogarisë nr.230 “Investime në proces”.

**Në vijimësi**

**9.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zërave të pasqyrës së Pozicionit Financiar u konstatua se në llogarinë 466 “Kreditorë për mjete nën ruajtje” e cila përbëhet nga 10 subjekte nga të cilat për 7 subjekte në vlerën prej 20,730,648 lekë, janë fonde që gjenden të ngurtësuar që nga viti 2014, për të cilat është tejkaluar afati i garancisë dhe nuk është bërë zhblllokimi i tyre sipas kushteve të kontratave respektive. Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar nuk ka ndërmarrë asnjë veprim për të bërë zhblllokimin e këtyre fondeve dhe përdorimin e tyre në buxhetin e vet. Veprimet e mësipërme janë kryer në kundërshtim me UMF nr.8, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësisve të Qeverisjes së Përgjithshme”, pikat nr.29, 30, 39 dhe 50; UKM nr.3, datë 15.02.2011 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, pika 10.6. (Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqet nr. 50-72 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**9.1.Rekomandimi:** Nga Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar të merren masa për sistemimin e llogarisë 466 “Kreditorë për mjete nën ruajtje”, duke rakorduar çdo muaj vlerat e llogarisë, si dhe duke njoftuar subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të nevojshëm për të sistemuar dhe pastruar/transferuar shumat e garancive të cilat tashmë u ka kaluar afati i përcaktuar në kontratën e investimit përkatës.

**Në vijimësi**

**10.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi rezultoi se Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/ fondet neto dhe pasqyrimi i vlerave në pasqyrën e Pozicionit Financiar në rubrikën C ka një mungesë rakordimesh të vlerave në pasqyrë. Aktivet neto nuk rakordojnë me fondet neto, dhe për disa zëra nuk ka informacion sesi Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar ka arritur në rezultatet e mësipërme. Gjithashtu, në pasqyrën e ndryshimeve të aktiveve neto nuk janë plotësuar të gjithë zërat që përfaqësojnë ndryshimet e ndodhura në burimet e brendshme.

Veprimet e mësipërme në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësisve të qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar pika 3.6. (Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqet nr. 58-76 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**10.1 Rekomandimi:** Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar të marrë masat për të kryer sistemimet e nevojshme dhe regjistrimet në kontabilitet në bazë të klasifikimit ekonomik kontabël, për një pasqyrim më të drejtë të fondit neto, me qëllim që të parandalohen gabimet apo parregullsitë e mundshme në interpretimin e llogarive të pasqyrave financiare.

**Në vijimësi**

**11. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i procesit të inventarizimit të pasurisë konstatohet se:

**11.1.** Nga ana e strukturave të MTM-së paraqiten mangësi pasi nuk ka relacione shpjeguese nga kryerja e vlerësimit të inventarëve, si edhe për diferenca të materialeve nëse janë propozuar për vlerësim, e më pas nxjerrje jashtë përdorimi. Pra nga ana e MTM-së nuk është ngritur një komision i vlerësimit të aktiveve, rrjedhimisht nuk ka patur as komisione për nxjerrjen jashtë përdorimi/asgjësimi të aktiveve. Veprimet në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr.30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pika 104 “Proces verbali i

vlerësimet”; Nga auditimi i llogarisë 218 “Inventar Ekonomik” nëpërmjet analitikëve përkatës kanë rezultuar diferenca për aktivet në vlerën 5,752,654 lekë (kryesisht kompjutera, karrige, mobilim etj.), për të cilat nga Drejtoria e Financës dhe Buxhetit nuk janë qartësuar dhe analizuar në mënyrë shteruese.

**11.2.** Për procedurat e inventarizimit të zhvilluara ndjekur sipas Urdhrit nr. 323, datë 17.12.2020, Urdhrit nr. 313, datë 21.12.2021 dhe Urdhrit nr.383 datë 09.12.2022 “Për ngritjen e komisionit të inventarizimit të përgjithshëm të mjeteve kryesore dhe inventarit ekonomik në pronësi të MTM”, për secilin vit, komisioni i inventarizimit përbehet nga tre anëtarë, ndër të cilët në përbërje ka Specialistin e Sektorit të Financës në Drejtorinë e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar, si dhe Përgjegjësën e Sektorit të Shërbimeve, të cilët kanë në ngarkim aktivet dhe janë përgjegjës për kontabilitetin e MTM-së. Në këtë proces nuk u konstatua firmosja e deklaratave të mungesës së konfliktit të interesit.

Veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, i ndryshuar me ligjin 110/2015, datë 15.10.2015 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” neni 22 dhe Udhëzimin e MFE nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pika 82. (Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqet nr. 58-76 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**11.1.Rekomandimi:** Nga Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar të merren masa për verifikimin e pakësimeve të aktiveve të llogarisë 218 “Inventar Ekonomik” në vlerën prej 5,752,654 lekë të konstatuara nga grupi i auditimit dhe nxjerrjen e përgjegjësi për mos identifikimin dhe dokumentimin/argumentimin e tyre nga komisionet e inventarizimit.

**Në vijimësi**

**11.2.Rekomandimi:** Titullari i Institucionit në cilësinë e NA të marrë masa në vijimësi për shmangien e përfshirjes së punonjësve në proceset e punës, të cilat e vendosin atë në konflikt interesi, me qëllim funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm sa më të qëndrueshëm dhe më efektiv.

**Në vijimësi**

**12. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i procesit të kalimit të transferimit kapital të aktiveve, mbështetur në Urdhrat përkatës të titullarit për kalim papagesë, u konstatua mungesë dokumentacioni shoqërues si: kartela e vlerës së amortizimit të akumuluar dhe llogaritja nga subjekti deri në momentin e daljes nga pronësia, ku nga MTM-ja është regjistruar në kontabilitet vlera e kostos historike të tyre.

Veprime në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, kapitullin III, “Regjistri i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyre”. Mungesa e dokumentacioneve shoqëruese nuk finalizon procesin dhe procedurën e transferimit të kapitalit të aktiveve afatgjata nga një institucion në tjetrin. (Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqet nr. 58-76 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**12.1.Rekomandimi:** Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar të marrë masat, që për çdo procedurë transferimi, e pakësimit ose të shtesës së aktive në kontabilitet nga lëvizjet kapitale pa pagesë brenda apo jashtë sistemit, të administrojë të gjithë dokumentacionin përkatës të kalimit kapital të aktiveve hyrëse ose dalëse, me qëllim mbylljen e ciklit të transferimit si dhe verifikimin e regjistrimit në kontabilitet të tyre.

**Në vijimësi**

**13. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zërave të pasqyrës së Pozicionit Financiar për vitin 2022 u konstatua se në MTM është mbajtur një regjistër elektronik për aktivet afatgjata, i cili nuk është përditësuar me vlerën aktuale të aktiveve që institucioni ka në pronësi dhe nuk është i plotë, sipas përcaktimeve të Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” kapitulli III, ku në varësi të llojit të aktivitetit duhet të përmbajë datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim për secilin aktiv, vlerën e amortizimit të akumuluar ndër vite me qëllim

verifikimin e vlerës së mbetur të aktiveve në dispozicion të institucionit, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes së tyre etj., veprime me ndikim në paraqitjen jo të drejtë të fondeve neto të institucionit. (Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqet nr. 58-76 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**13.1.Rekomandimi:** Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar të marrë masa për krijimin e një regjistri të plotë të aktiveve të njësisë, duke specifikuar në mënyrë analitike secilin aktiv me informacione në lidhje me, datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datën e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëposhme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia.

**Në vijimësi**

**14. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i dokumentacionit të shpenzimeve të kryera për blerjen e biletave të transportit ajror ndërkombëtar në procedurat me sistem dinamik blerje. rezultoi se; Në të gjithë urdhër-shpenzimet e blerjes së biletave të transportit ajror ndërkombëtar të testuara për t'u audituar nga ana e grupit të auditimit, si dhe në disa urdhër-pagesa të shërbimeve-dieta jashtë vendit të punonjësve, të likuiduara nëpërmjet arkës, u konstatua *mungesa e ftesës së vendit pritës dhe draft agjenda e punimeve*. Me anë të këtij dokumentacioni, vërtetohet qëllimi dhe objekti i shërbimit si dhe pjesa e shpenzimeve që do të mbulojë organizatori dhe pjesa që do të mbulojë buxheti i shtetit, veprim në kundërshtim me legjislacionin në fuqi. (Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqet nr. 36-47 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**14.1.Rekomandimi:** Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar të marrë masa në vijimësi, që në të gjitha dokumentacionet e pagesave, të cilat kanë të bëjnë me praktikën për udhëtime dieta për jashtë vendi, t'i bashkëngjitet ftesa e vendit pritës dhe draft agjenda e punimeve, me qëllim krijimin e gjurmës së auditimit të përdorimit të fondeve buxhetore.

**Në vijimësi**

**15. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i dokumentacionit të shpenzimeve të kryera për procedurat e prokurimit blerje me vlera të vogla rezultoi se:

- Për procedurën: *“Shërbim konsulence për hartimin e Termave të Referencës për vlerësimin e basenit ujëmbledhës dhe ekosistemit lumor të lumit Vjosa me qëllim shpalljen “Park Kombëtar Lugina e Vjosës” dhe hartimin e Projekt-planit të nënzonimit të territorit të zonës së mbrojtur”* dhe *“Shërbim konsulence për hartimin e Termave të Referencës për planin e menaxhimit dhe projektin e zbatimit për Parkun Natyror Liqeni i Ulzës dhe zona përreth tij”* në vlerën 725,000 lekë pa TVSh realizuar në vitin 2022 u konstatua se: OE ka dorëzuar kontratën e lidhur me datën 14.04.2022 me arkitektin, ku po me personin në fjalë është lidhur dhe kontrata me datën 11.04.2022, arkitekt për realizimin e procedurës *“Shërbim konsulence për hartimin e Termave të Referencës për vlerësimin e basenit ujëmbledhës dhe ekosistemit lumor të lumit Vjosa me qëllim shpalljen “Park Kombëtar Lugina e Vjosës” dhe hartimin e Projekt-planit të nënzonimit të territorit të zonës së mbrojtur”*.

Sa më sipër kemi mbivendosje të kohës së realizimit të kontratave nga i njëjti individ, i kontraktuar nga OE për shërbimin e konsulencës, me të cilin ka lidhur dy kontrata shërbimi për të njëjtën periudhë.

- Për procedurën: *Kolaudim punimesh për objektin “Mbyllja, rehabilitimi i mbetjeve urbane nga venddepozitimet ekzistuese (Burrel, Kukës, Libohovë, Përmet, Krujë)”*, në vlerën 65,898 lekë pa TVSh realizuar në vitin 2022, në dosje mungon procesverbali i mbajtur nga komisioni për vlerësimin e ofertave, se sa OE kanë marrë pjesë, sa prej tyre janë skualifikuar dhe arsyet e skualifikimit.

- Për procedurën: *“Blerje goma”* në vlerën 335,440 lekë pa TVSh mungon dokumentacioni

shoqërues për kërkesat e kërkuara në ftesën për ofertë me nr. 1910, datë 24.02.2020.

- Për procedurën: “*Shërbime e riparime të grilave të jashtme të dritareve MTM*” në vlerën 785,000 lekë pa TVSh dhe “*Rikonstrukcion i bodrumeve*” në vlerën 740,000 lekë pa TVSh e realizuar në vitin 2020 mungon procesverbali i përllogaritjes së fondit limit nga komisioni. Mungon procesverbali i argumentimit të specifikimeve teknike të kërkuar në ftesën për ofertë, si dhe dokumentacioni shoqërues për kërkesat e kërkuara në ftesën për ofertë.

Sa më sipër veprime në kundërshtim me pikën 16 të Udhëzimit të APP-së nr. 3, datë 08.01.2018, ku citohet se, “*Dokumentacioni i kërkuar nga autoriteti kontraktor në përmbushje të kërkesave të përcaktuara në Ftesën për Ofertë, duhet të dorëzohet nga operatori ekonomik i shpallur fitues, në Zyrën e Protokollit të autoritetit kontraktor*”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqet nr. 36-47 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**15.1. Rekomandimi:** Nga Sektori i Prokurimeve, pranë Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit të marrë masa në vijimësi për dokumentimin e çdo procesi pune dhe administrimin e të gjithë dokumentacionit të kërkuar sipas ftesës për ofertë, me qëllim sigurimin e dobishmërisë së përdorimit të fondeve publike.

**Në vijimësi**

**16. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i dokumentacionit mbi marrjen në dorëzim të mallrave/shërbimeve /punëve të kryera për vitet 2020, 2021 dhe 2022 rezultoi se:

Komisioni i marrjes në dorëzim të mallrave/shërbimeve/punëve në çdo rast ka hartuar procesverbalin e marrjes në dorëzim por plotësimi i tij është thjesht formal, duke ju referuar faturës dhe kontratës, pa një përshkrim të hollësishëm të mallrave/shërbimeve dhe punëve të marra. Gjithashtu konstatohet se komisioni i marrjes në dorëzim të mallrave nuk ka në përbërjen e saj specialist të fushës, bazuar në mallrat/shërbimet/punët që do të merren në dorëzim, veprim në kundërshtim me UMF nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pika 43, ku përcaktohet se “*Komisioni përbëhet nga specialistë të fushës sipas llojit të aktiveve dhe, në rast nevojë, edhe nga ekspertë të jashtëm. Në komision bëjnë pjesë jo më pak se tre veta, duke përfshirë edhe punonjësin me përgjegjësi materiale*”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqet nr. 36-47 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**16.1. Rekomandimi:** Komisionet e marrjes në dorëzim mallrave/shërbimeve/punëve të ngritura nga Titullari i Institucionit të marrin masa në vijimësi që procesverbalet e mbajtura për marrjen në dorëzim të mallrave/shërbimeve /punëve të jenë të detajuara sipas kërkesave të përcaktuara në ftesën për ofertë dhe në kontratën e lidhur mes AK dhe OE fitues, me qëllim evidentimin e realizimit të mallrave/shërbimeve/punëve sipas kërkesave dhe cilësisë së kërkuar nga AK.

**Në vijimësi**

**16.2. Rekomandimi:** Titullari i Institucionit të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit të marrë masa, që në urdhrin për ngritjen e komisionit të marrjes në dorëzim të mallrave/shërbimeve/punëve, në përbërje të tij, të paktën një nga anëtar të jetë specialistë i fushës bazuar në objektin e procedurës së prokurimit, me qëllim sigurimin e cilësisë së mallrave sipas specifikimeve.

**Në vijimësi**

**17. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i regjistrave të parashikimit dhe realizimit të procedurave të prokurimit të hartuara nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit u konstatua se,

- Për vitin 2021, në Regjistrin e Parashikimeve të Prokurimeve Publike është bërë shtim zëri i ri për procedurën me objekt “*Mbikëqyrje punimesh për objektin Mbyllja, rehabilitimi i mbetjeve urbane nga venddepozitimet ekzistuese (Burrel, Kukës, Libohovë, Përmet, Krujë)*” në vlerën 2,178,268 lekë, e cila duhet të ishte planifikuar në zërin e investime kapitale, që në momentin e planifikimit në PBA të procedurës me objekt “*Mbyllja, rehabilitimi i mbetjeve urbane nga venddepozitimet ekzistuese (Burrel, Kukës, Libohovë, Përmet, Krujë)*”, referuar Udhëzimin nr. 3,

datë 15.2.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” pika 1 dhe pika 2.

- Për vitin 2021, Autoriteti Kontraktor ka realizuar rishikime buxhetore pas datës 15 nëntor, veprim në kundërshtim me nenin 48 “Afati për rishpërndarjen e fondeve buxhetore”, të Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

- Nga kryqëzimi i të dhënave mbi procedurat e prokurimit të iniciuara në vitin 2020; 2021 dhe 2022 dhe të dhënave mbi kontratat e regjistruara në SIFQ, u konstatua se urdhër-prokurimet nuk janë regjistruar në SIFQ në momentin e daljes së urdhrit, por pasi ka përfunduar procedura e prokurimit dhe është lidhur kontrata, veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

- Referuar rishikimeve të shpeshta, mbi investimet kapitale dhe shpenzime korrente, mund të konkludojmë për një mungesë të analizave të mirëfillta të nevojave që ka institucioni para planifikimit, mungesë monitorimi në zbatimin e buxhetit dhe veçanërisht të ecurisë së zbatimit të investimeve, bazuar në Udhëzimin e Ministrisë të Financave nr. 9, datë 20.03.2018, “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, pika 75. (Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqet nr. 76-128 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**17.1. Rekomandimi:** Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, personat për hartimin e parashikimeve të investimeve kapitale, të marrin masat në vijimësi për planifikimin e tyre bazuar në prioritet e institucionit, me qëllim mirë menaxhimin e fondeve publike, evitimin e krijimit të detyrimeve të prapambetura, e ndryshimit të prioriteteve të projekteve, si dhe cënimin apo favorizimin e projekteve specifike.

**Në vijimësi**

**18. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt: “Rehabilitimi i shesheve dhe zonave kryesore në afërsi të pikave doganore shqiptare” në vlerën 12,480,000 lekë pa TVSh realizuar në vitin 2022 u konstatua se:

- Nga MTM nuk rezulton të jetë kryer një studim paraprak për nevojat e realizimit të këtij investimi si prioritet i parashikuar në PBA 2022-2024, me ndryshimet e bëra në PBA me datë 18.10.2021. Ky projekt është planifikuar pa patur një studim paraprak dhe arsyetim se pse është përfshirë si prioritet për vitin 2022, veprime në kundërshtim me VKM nr.185, datë 29.03.2018, “Për procedurat e menaxhimit të investimeve publike” pika 7.

- Në këtë procedurë janë përfshirë:

a) Porti i Durrësit, i cili është dhënë me koncesion dhe operon në Shqipëri që nga Viti 2013.

b) Dega Dogana Kapshtice, për të cilën është bërë “**Projekti për rikonceptimin e hapësirave të Degës Doganore Kapshticë**” në vlerën 4,896,000 leka pa TVSh me kontratën e lidhur mes OE “Gj.” shpk dhe AK “Drejtoria e Përgjithshme e Doganës” me nr. 6940/5, datë 04.07.2018 dhe amendimin e kontratës me nr. 19094, datë 17.08.2018. Projekti është finalizuar në datën 01.09.2018.

c) “Aeroporti i Rinasit” ku me memon nr. 7980, datë 14.10.2021 nuk ka qenë i parashikuar, nga 12 pikat e kalimit të propozuar. Aeroporti është shtuar në “Terma reference” për projektin e zbatimit me objekt: “Rehabilitim i shesheve dhe zonave kryesore në afërsi të pikave doganore shqiptare”. Gjithashtu “Aeroportit të Rinasit” është nën administrimin e koncesionarit, i cili ka për detyrë për të administruar, operuar dhe mirëmbajtur të gjithë anën ajrore dhe **infrastrukturën** (përveç kontrollit të trafikut ajror). Sa më sipër përfshirja e tre pikave doganore në procedurën me objekt “Rehabilitimi i shesheve dhe zonave kryesore në afërsi të pikave doganore shqiptare”, sjell efekt financiar negativ në përdorimin e fondeve buxhetore. (Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqet nr. 76-128 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**18.1. Rekomandimi:** Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, personat përgjegjës të parashikimit të investimeve, të marrin masat në vijimësi për realizimin e studimeve paraprak në bashkëpunim me autoritetet përkatëse pjesë e projekteve, me qëllim mirë menaxhimin e fondeve publike, evitimin e ndryshimit të prioriteteve të projekteve, si dhe cënimin apo favorizimin e projekteve specifike.

**18.2. Rekomandimi:** Titullari I Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit të marrë masa për ngritjen e një komisioni me specialist të fushës, me qëllim ndarjen dhe përcaktimin e vlerave që i përkasin tre pikave doganore për të cilat MTM nuk duhet ti kishte përfshirë në projekt.

Menjëherë

**18.3. Rekomandimi:** Ministria e Turizmit dhe Mjedisit të informojë menjëherë Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave dhe Autoritetit Rrugor Shqiptar në lidhje me ndryshimet që do të kenë në projekt dhe pas finalizimit të dërgojë pikat doganore për të cilat nuk do të realizohet projekti.

Menjëherë

**19. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt: *“Rehabilitimi i shesheve dhe zonave kryesore në afërsi të pikave doganore shqiptare”* në vlerën 12,480,000 lekë pa TVSh realizuar në vitin 2022 u konstatua se:

- Me datën 23.02.2022 është bërë përlllogaritja e fondit limit nga komisioni i ngritur me urdhrin nr. 76, prot. 2144, datë 23.02.2022, ku në urdhër është përcaktuar dhe fondi limit i përlllogaritur, Pra, AK nuk ka ngritur komision për përlllogaritjen e fondit limit, veprime në kundërshtim me VKM-në nr. 285 datë 19.5.2021 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”* neni 76, pika 2.

- Në procesverbalin e mbajtur nga komisioni nuk është bërë asnjë argumentim në lidhje me klasifikimet e objektit, si dhe mënyrën si është bërë ndarja e kostos për strukturën e jashtme dhe kostoja për ndërtesën dhe ndarja funksionale e tyre, mbi të cilën është llogaritur dhe një kosto shtese prej 50%. Në nenin 29 dhe 31, të VKM-së nr. 354, datë 11.05.2016 *“Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikimin e territorit, projektimit, mbikëqyrjes dhe kolaudimit”* është bërë ndarja sipas grupeve tarifore, ku në procesverbalin e mbajtur nga komisioni mungojnë sqarimet në lidhje me vlerën:

- 172,864,693 lekë për koston e llogaritshme të strukturave në ambientet e jashtme;

- 115,234,429 lekë për koston e llogaritshme të grupeve tarifore për ndërtesat dhe ndarjet funksionale të brendshme, *pasi bazuar në zërat e projektimit vlerat e llogaritur nuk përputhen.*

- Kriteret e vendosura dhe të kërkuara nga AK nuk janë të argumentuar. NJP është mjaftuar vetëm me citimin e bazës ligjore, veprime në kundërshtim të VKM-së me nr. 285, datë 19.5.2021 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”* neni 78, pika 2. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqet nr. 76-128 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**19.1. Rekomandimi:** Ministria e Turizmit dhe Mjedisit Njësia e Prokurimit në procedurat e prokurimit të mallrave /shërbimeve dhe punëve që do zhvillohen në vijimësi, të marrë masa që çdo proces pune të jetë i argumentuar teknikisht dhe i dokumentuar me dokumentacionin përkatës.

Në vijimësi

**20. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt: *“Mbyllja, rehabilitimi i mbetjeve urbane nga venddepozitimet ekzistuese (Burrel, Kukës, Libohovë, Përmet, Krujë”* në vlerën 146,440, 165 lekë realizuar në vitin 2021 u konstatuan se:

Autoriteti Kontraktor në DST në *“kriteret e veçanta të kualifikimit”* ka kërkuar:

- Për të provuar përvojën e mëparshme, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm: Formular vlerësimi nga Autoriteti Kontraktor; Kontratë; Situacionin përfundimtar; Aktin e kolaudimit; Fatura tatimore; Kontratë e bashkëpunimit ndërmjet OE, ku të jetë e përfshirë marrëveshja e ndarjes së punimeve mes palëve etj

- Pesë punonjës si staf teknik me profilin Elektracist, e cila është kërkesë, që nuk ka lidhje me objektin, natyrën e kontratës, pasi në preventiv nuk ka asnjë punim mekanik dhe elektrik.

- Në pikën 2.3.3 që *“Operatori ekonomik ofertues ..... krahas stafit të mësipërm, duhet të ketë të punësuar një numër mesatar punonjësish prej 150 punëtorësh për periudhën Tetor - Dhjetor 2020. Për këtë arsye të paraqiten listëpagesat përkatëse të nënshkruara elektronikisht nga sistemi E-*

Albania, si dhe urdhër pagesa përkatëse që konfirmon kryerjen e pagesave përkatëse mujore”. Nga NJP, numri i personave i kërkuar prej 150 punonjës, nuk është argumentuar.

- Në kërkesat kualifikuese pika 2.3.1 konstatohet se janë vendosur pika licence jo në përputhshmëri me volumin dhe natyrën e objektit, në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014, i ndryshuar "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", neni 26. Konstatohen kategorizime më të larta, në krahasim me zërat dhe me volumet e objektit. Kategorizimi i të gjithë zërave me nivelin C (51 – 100 milion lekë) dhe D (101-200 milion lekë) nuk përputhet me volumin apo vlerën e zërave përkatës, ku këto zëra punimesh bazuar preventivit i përkasin kategorizimeve A dhe B.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, neni 46, pika 3, VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar neni 61, pika 2 dhe neni 26, pika 5.

- Në pikën 2.3.5 që "Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij mjekun e shoqërisë, kërkesa në kundërshtim me përcaktimet e VKM-së nr. 632, datë 15.7.2015, pika 1.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqet nr. 76-128 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**20.1. Rekomandimi:** Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Njësia e Prokurimit në procedurat e prokurimit të mallrave /shërbimeve dhe punëve që do zhvillohen në vijimësi, të marrë masa që çdo kriter i veçantë të jetë në përputhje me natyrën dhe përmasën e kontratës, si dhe të hartojë analiza teknike, ku të parashikohet fuqia punëtore dhe mjetet/makineritë që nevojiten për realizimin e secilit zë punimesh, sipas afateve kohore të parashikuara në grafikun e punimeve dhe, mbi bazën e analizave përkatëse të përcaktohet numri minimal i punonjësve të domosdoshëm, për realizimin e punimeve objekt kontrate.

**Në vijimësi**

**21. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt: "Mbyllja, rehabilitimi i mbetjeve urbane nga venddepozitimet ekzistuese (Burrel, Kukës, Libohovë, Përmet, Krujë" për vitin 2021 në vlerën 146,440, 165 lekë u konstatuan se:

Dokumentacioni i dorëzuar nga OE, për plotësimin e pikës 4 "Operatori ekonomik, të ketë të punësuar si staf teknik, përveç drejtuesve teknik të kërkuar në pikën 2, punonjësit si më poshtë..." nuk përputhet me kriteret e kërkuar në DT në lidhje me profesionet e stafit.

Mosrakordimi midis "Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit" dhe dokumentacionit të dorëzuar përben kusht skualifikimi sipas përcaktimeve të Ligjit nr. 162 datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", neni 76 "Kriteret detyruese për skualifikim" pika 3, shkronja "ë". Në këto kushte, KVO ka vepruar në kundërshtim me VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", neni 66/3.

- Në pikën 1/d në kriteret e përgjithshme të pranimit është kërkuar "Ofertuesi duhet të deklarojë se ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi". Shoqëria "A. K." shpk ka paraqitur në deklaratën mbi përmbushjen e kriterëve të përgjithshme, ku deklaroi se ka paguar detyrimet në fjalë sipas legjislacionit në fuqi, ndërkohe rezultoi se në disa nga kontratat e lidhura me stafin kanë mospërputhje të pagës mujore të përcaktuar në nenin 7 pika 7.1 të saj me atë deklaruar në listëpagesë. Veprime në kundërshtim me pikën 2/d të nenit 45 të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar. Sa më sipër mosplotësimi i kriterëve përben shkak për s'kualifikimin e OE në zbatim të nenit 46, pika 1, gërma "b" në nenin 53, pika 3, të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar. (Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqet nr. 72-130 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**21.1. Rekomandimi:** Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Komisionet e Vlerësimit të Ofertave të marrin masa për eliminimin e praktikave të prokurimit me shkelje ligjore, dhe të shpallura fituese në kushtet e mosplotësimit të kriterëve të kërkuara në DST, me qëllim përdorimin me efieciencë dhe efektivitet të fondeve publike.

**Në vijimësi**

**22. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt: *"Mbikëqyrje punimesh për objektin "Mbyllja, rehabilitimi i mbetjeve urbane nga venddepozitimet ekzistuese (Burrel, Kukës, Libohovë, Përmet, Krujë)" në vlerën 2,44,185 lekë realizuar në vitin 2021 u konstatua se:*

• Kriteret e kërkuara nga AK në DT ka mbivendosje si vijon:

Në "Kriteret e përgjithshme të përzgjedhjes/ kualifikimit" në pikën 1, germa "dh" dhe në "Kriteret e veçanta të kualifikimit" në pikën 2.2 "Kapaciteti ekonomik dhe financiar" kërkohet

*"Një vërtetim që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri".*

• Kriteret e kërkuara nga AK në DT në pikë 2.3 "Për kapacitetin teknike" germa:

b. *"Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e shoqërisë, Drejtues Teknik të kualifikuar si më poshtë..... Stafin i mësipërm duhet të jenë Drejtues Teknik dhe të paraqitet kontrata individuale e punës, CV, Licencë Profesionale"* konstatohet se, AK ka vendosur kriteret për kualifikim, të cilat mund të krijojnë problematika apo konfuzion si në plotësimin e vetë kriterit nga operatorët ekonomik ofertues, ashtu edhe gjatë procesit të vlerësimit të ofertave. Nga AK kërkohet Licencë Profesionale pa specifikuar kategorinë.

c. Dëshmi për fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, duke mos argumentuar numrin e punonjësve të kërkuar.

e. Kualifikimi i Operatorëve Ekonomikë do të bëhet në zbatim të VKM-së nr. 354, datë 11.05.2016 "Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në Planifikim Territori, Projektim, mbikëqyrje dhe Kolaudim", ku nga AK nuk është përcaktuar në mënyrë të qartë dhe të saktë kërkesat minimale që duhet të plotësojnë operatorët ekonomike, për të shmangur edhe problemet, që mund të lindin gjatë procesit të vlerësimit.

Sa më sipër, kriteret e vendosura dhe të kërkuara nga AK nuk janë të argumentuar teknikisht, veprime në kundërshtim të VKM-së nr. 914, datë 19.5.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", neni 61, pika 2. (Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqet nr. 76-128 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**22.1. Rekomandimi:** Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Njësia e Prokurimit të marrë masat që, në procedurat e prokurimit të mallrave /shërbimeve dhe punëve që do zhvillohen në vazhdimësi, çdo kriter i veçantë të jetë në përputhje me natyrën dhe përmasën e kontratës, si dhe të hartojë analiza teknike, ku të parashikohet fuqia punëtore dhe mjetet/makineritë që nevojiten për realizimin e secilit zë punimesh, si dhe dokumentacioni që duhet të paraqesë operatori ekonomik për të përmbushur këto kriteret, duke shmangur sa më shumë të jetë e mundur përdorimin e kriterëve të përgjithshme, të papërcaktuara.

**Në vijimësi**

**23. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt: *"Mbikëqyrje punimesh për objektin "Mbyllja, rehabilitimi i mbetjeve urbane nga venddepozitimet ekzistuese (Burrel, Kukës, Libohovë, Përmet, Krujë)", në vlerën 2,44,185 lekë realizuar në vitin 2021, u konstatua se:*

Nga AK në DT në pikën 2.3 "Për kapacitetin teknik" është kërkuar në pikën 2, germa "b" që *"Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e shoqërisë, Drejtues Teknik të kualifikuar si më poshtë: Inxhinier Mjedis, 1 (një) të punësuar"*. Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik i shpaluar fitues rezultoi se, personi i punësuar si Inxhinier Mjedis, nuk e plotëson kriterin e kërkuar pasi ai ka titullin Kimist teknolog.

Në zbatim të nenin 53, pika 3 të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, ku parashikohet: *"Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e*



*përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit...” mosplotësimi i kriterëve përbën shkak për skualifikimin e OE.*

- Mes AK dhe OE fitues “I.” shpk është lidhur kontrata me nr. 2818/8, datë 16.06.2021. Nga auditimi i likuidimit të kontratës u konstatua se realizimi i pagesës është bërë në këste në kundërshtim më DT shtojca 16, ku në Neni 9 “*Pagesa Paraprake*” nuk është përcaktuar asnjë kusht ligjor se pagesa do të bëhet me këste, si dhe në kontratën nr. 2818/8, datë 16.06.2021 në të cilën nuk është përcaktuar dhe specifikuar pagesë paraprake për shërbimin. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqet nr. 76-128 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**23.1. Rekomandimi:** Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Komisionet e Vlerësimit të Ofertave të marrin masa për eliminimin e praktikave të prokurimit me shkelje ligjore, dhe të shpallura fitues në kushtet e mosplotësimi të kriterëve të kërkuara në DST, me qëllim përdorimin me eficence dhe efektivitet e fondeve publike.

**Në vijimësi**

**23.2. Rekomandimi:** Sektori i Financës të marrë masa në vijimësi që pagesat të mos copëzohen në këste, nëse kjo nuk është e parashikuar në kushtet e veçanta të kontratës së lidhur mes AK dhe operatorit ekonomik, me qëllim përdorimin me eficence dhe efektivitet të fondeve buxhetore.

**Në vijimësi**

**24. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt: “*Studim mbyllja, rehabilitimi i mbetjeve urbane nga venddepozitimet ilegale*” në vlerën 2,640,000 lekë pa TVSh realizuar në vitin 2021 u konstatua se:

- Bashkëngjitur dosjes mungon miratimi i planit të përmirësimit nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit dhe shqyrtimi i tyre pranë Komitetit Ndërmintor për Mbetjet, veprime në kundërshtim me VKM-në nr. 846, datë 28.10.2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 452, datë 11.7.2012, të Këshillit të Ministrave, “Për lëndfillet e mbetjeve”, i ndryshuar, pika 2 dhe pika 3. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqet nr. 76-128 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**24.1. Rekomandimi:** Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, të marrë masa në vijimësi që përpara fillimit të procesit për përmirësimin e venddepozitimeve të vlerësojë dhe të miratojë planin nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit, duke i kaluar për shqyrtim pranë Komitetit Ndërmintor për Mbetjet, në përputhje me parashikimet ligjore.

**Në vijimësi**

**25. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt: “*Studim mbyllja, rehabilitimi i mbetjeve urbane nga venddepozitimet ilegale*” në vlerën 2,640,000 lekë pa TVSh realizuar në vitin 2021 u konstatua se:

- Nga AK në pikën 2.3 “Kapaciteti teknik” kërkohen “*Licenca profesionale*” të cilat nuk kanë lidhje me objektin, natyrën e kontratës objekt prokurimi.

Kriteret e vendosura dhe të kërkuara nga AK nuk janë të argumentuara. NJP është mjaftuar vetëm me citimin e bazës ligjore.

Nga AK ka mbivendosje të kriterëve të kërkuara në DT si vijon:

Në “Kriteret e përgjithshme të përzgjedhjes/ kualifikimit” në pikën 1, germa “e” dhe në “Kriteret e veçanta të kualifikimit” në pikën 2.2 “Kapaciteti ekonomik dhe financiar” kërkohet

“*Një vërtetim që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri*”.

Sa më sipër, veprime në kundërshtim me VKM-në nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 78, pika 2. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqet nr. 76-128 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**25.1. Rekomandimi:** Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Njësia e Prokurimit në procedurat e prokurimit të mallrave /shërbimeve dhe punëve që do zhvillohen në vazhdimësi, të marrë masa që

çdo proces pune të jetë i argumentuar teknikisht dhe i dokumentuar me dokumentacionin përkatës.  
**Në vijimësi**

**26. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt: “*Shërbim riparimi dhe rivënia në punë e sistemeve dhe moduleve përbërëse të stacioneve të monitorimit të ajrit*”, në vlerën 31,130,000 lekë pa TVSh, realizuar në vitin 2022 u konstatua se:

Komisioni i marrjes në dorëzim mallrave/shërbimeve ka hartuar procesverbalin e marrjes në dorëzim të mallrave/shërbimeve, por plotësimi i tij është thjesht formal, duke ju referuar faturës dhe kontratës pa një përshkrim të hollësishëm të zërave/analizave të mallrave/shërbimeve të marra në dorëzim.

Nga komisioni është mbajtur një procesverbal për të gjitha stacionet e monitorimit, të cilat ndodhen në vende të ndryshme, si rrjedhojë procesverbalet nuk janë mbajtur mbi verifikimin fizik në vend të këtyre stacioneve .

Nga Komisioni i marrjes në dorëzim nuk ka argumentuar, nëse pajisjet e sjella nga OE për secilin stacion janë në përputhje me ato të ofertuara, pra nga prodhuesit për të cilin OE ka autorizimin e paraqitur në fazën e tenderimit, si dhe nëse mallrat/punët janë brenda specifikimeve teknike të kërkuara në DT dhe në kontratën e lidhur. Marrja në dorëzim e shërbimit është bazuar vetëm në raportin teknike të paraqitur nga OE “K.” shpk, veprim në kundërshtim me UMF nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar pika 42, ku citohet se “Titullari i njësisë miraton urdhrin për ngritjen e komisionit për marrjen në dorëzim të aktiveve *te furnizuara për sasinë, cilësinë, llojin, plotësinë e tyre dhe te dokumentacionit shoqërues*”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqet nr. 76-128 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**26.1. Rekomandimi:** Komisionet e marrjes në dorëzim mallrave/shërbimeve/punëve të ngritura nga titullari i institucionit të marrin masa në vijimësi që procesverbalet e mbajtura për marrjen në dorëzim të mallrave/shërbimeve /punëve të jenë të detajuara sipas kërkesave të përcaktuara në DT dhe në kontratën e lidhur mes AK dhe OE fitues, me qëllim evidentimin e realizimit të kontratës sipas kërkesave dhe cilësisë së kërkuar nga AK.

**Në vijimësi**

**27. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i dokumentacionit për procedurat e prokurimit, rezultoi se këto procedura në të gjitha rastet nuk ishin të inventarizuara e për pasojë të arkivuara, në kundërshtim me Ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat”, si dhe nenit 21 “Norma tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë”.

Referuar Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar dhe Manualit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, Veprimtaria e Kontrollit, si një prej pesë komponentëve të MFK, përmban detyrimin e hartimit të procedurave për dokumentimin, arkivimin dhe ruajtjen e informacionit, të cilat duhet të vendosen për të mbështetur kryerjen e operacioneve dhe kontrollimin e proceseve në njësinë publike. (Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqet nr. 76-128 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**27.1 Rekomandimi:** Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Sektori i Prokurimeve të marrë masa për inventarizimin dhe arkivimin e të gjithë procedurave, duke dokumentuar të gjithë procesin në rend kronologjik, në zbatim të normave tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë.

**Në vijimësi**

**28. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit në MTM, rezultoi se:

- Drejtoria e Mirëadministrimit të Burimeve Njerëzore, Aseteve dhe Shërbimeve në MTM nuk ka paraqitur programe specifike për trajnimin e punonjësve të administratës;
- Nuk janë kryer takime me stafin menaxhial mbi çështjet e menaxhimit të riskut, diskutimin e

problematikave dhe dokumentimin e veprimtarisë së përditshme të menaxhimit të riskut, si dhe MTM nuk ka hartuar strategjinë për menaxhimin e riskut;

- Nuk janë përgatitur dhe nuk janë dërguar te NA, regjistri i riskut nga drejtoritë përkatëse, të cilët përmbledhen në regjistrin e riskut të vitit 2022 të MTM-së;

- Nuk ka takime të dokumentuara të veprimtarisë së GMS, i cili duhet të mbledhet të paktën 4 herë në vit, GMS nuk ka kryer përgjegjësinë e rishikimit, jo më pak se dy herë në vit të regjistrit të riskut. Veprimet e mësipërme janë kryer në kundërshtim me pikën 2 të nenit 21, me pikën 2 të nenit 11, me pikën 1 të nenit 27, pikave nr. 1, 2 dhe 3 të nenit 16, të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, si dhe me Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, Kap. II, pika 2.5.1. (Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqet nr. 76-128 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**28.1. Rekomandimi:** Strukturat përgjegjëse të MTM-së, të marrin masa për plotësimin e mangësive të evidentuara, si dhe implementimin e një sistemi të përshtatshëm rregullash të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, konform përcaktimeve të ligjit të MFK-së dhe aktet në zbatim të tij, për ta bërë atë efektiv dhe në dobi të veprimtarisë institucionale.

**Në vijimësi**

**29. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i veprimtarisë së auditimit të brendshëm në MTM rezultoi se:

**29.1.** Struktura e Auditimit të Brendshëm në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit është e organizuar në rang Drejtorie dhe përmban në organikën e saj 5 auditues (1 drejtor dhe 4 specialist), sipas Urdhrit të Kryeministrit me nr.185, datë 15.11.2022, “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit”, me ndryshimet përkatëse ku rezultoi se gjatë vitit 2021, DAB ka funksionuar me strukturë të paplotësuar, duke pasur 2 vende vakante në pozicionin e specialistit.

**29.2.** Nga ana e Grupit të Auditimit u konstatua se nuk është ngritur Komiteti i Auditimit të Brendshëm nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, veprim në kundërshtim me Ligjin nr.114, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” i ndryshuar, neni 12 germa b “Titullarët e njësive publike janë përgjegjës për: b) krijimin e Komitetit të Auditimit të Brendshëm në njësitë publike përkatëse sipas kriterëve të miratuara me vendim të Këshillit të Ministrave, sipas shkronjës “b” neni 23. (Më hollësisht trajtuar në pikën 6, faqet nr. 128-138 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**29.1. Rekomandimi:** Ministria e Turizmit dhe Mjedisit të marrë të gjitha masat e nevojshme me qëllim plotësimin e strukturës të Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm me personel me qëllim mbarëvajtjen e punës së kësaj drejtorie dhe të gjithë institucionit për shkak të rolit të rëndësishëm që kjo drejtori ka në evidentimin e problematikave të menaxhimit.

**Menjëherë**

**29.2. Rekomandimi:** Ministria e Turizmit dhe Mjedisit të marrë masa të menjëhershme për krijimin e Komitetit të Auditimit të Brendshëm, i cili ofron këshilla e rekomandime objektive Titullarit të njësisë publike në lidhje me funksionimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm, me qëllim arritjen e objektivave si dhe të mbështesë njësinë e auditimit të brendshëm në përmbushjen e përgjegjësiave të saj.

**Menjëherë**

**30. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i projekteve për zhvillimin e turizmit të realizuara në vitin 2020 në vlerën 34,427 mijë lekë, në vitin 2021 në vlerën 17,373 mijë dhe në vitin 2022 në vlerën 109,583 mijë lekë rezultoi se:

- Për vitin 2020 dhe vitin 2021 “Qëllimi kryesor i thirrjeve dhe tematikat e thirrjeve” kanë qenë të njëjta, të përgjithshme dhe pa një fokus të përcaktuar të nevojave që ka turizmi.

- Ministria e Turizmit dhe Mjedisit nuk ka zhvilluar proces studimi dhe planifikimi, sipas

prioriteteve që ministria duhet të ketë çdo vit, duke mos përcaktuar qartë, zonat me përparësi zhvillimit e turizmit dhe burimet turistike, për të cilat do të zhvillohen këto projekte dhe të cilat më pas të do të shndërrohen në produkte turistike.

- Komisionet e përzgjedhjes së aplikantëve në të tre vitet 2020; 2021 dhe 2022 kanë në përbërje 3-4 anëtar, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 93/2015 “Për Turizmin” pika 6, dhe VKM-ja nr. 325, datë 31.5.2018 “Për përcaktimin e anëtarëve të komisionit të përzgjedhjes së projekteve në turizëm”.

- Komisioni i Përzgjedhjes së Projekteve në procesverbalet e mbajtura ndër vite nuk jep argumente në lidhje me projektet e përzgjedhura dhe të kualifikuara si fitues nëse ato kanë impakt në planin e zhvillimit turizmit, si dhe nëse ato projekte përputhen me prioritet e përcaktuara, veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 93/2015 “Për Turizmin” neni 32 “Kompetencat e Komisionit të Përzgjedhjes së Projekteve”.

- Për vitin 2022, nga auditimi i procesit të vlerësimit të aplikimeve konstatohet se, Komisioni i Përzgjedhjes së Projekteve në procesverbalin e mbajtur, për thirrjen e parë dhe të dytë, mungon një relacion shpjegues në lidhje me skualifikimet, vlera e financimit që është kërkuar nga aplikuesit, dokumentacioni i cili nuk është dorëzuar etj., Komisioni është mjaftuar vetëm me një renditje në formë tabelore të projekteve që kanë aplikuar nga thirrja, ku dhe në tabelë nuk është argumentuar dhe sqaruar projekt për projekt, se çfarë dokumentesh mungojnë dhe për projektet fituese nuk është cituar dokumentacioni i dorëzuar nga përfituesi.

- Për vitin 2022, rezultoi se Komisioni i Përzgjedhjes së Projekteve (KKPT) ka shpallur fitues:

a) Në dy raste, projekte të cilat janë përzgjedhur si fituese në vitin paraardhës dhe nga përfituesi nuk është realizuar projekti brenda afateve dhe përcaktimeve të kushteve të kontratës.

b) Projekte, ku subjektet konkurruese janë pjesë e të njëjtës grup kompanish, veprime në kundërshtim me VKM-në 281, datë 13.04.2016 “Për përcaktimin e kritereve e të afateve të kërkesë/propozimeve për mbështetjen financiare të projekteve në fushën e turizmit” pika 13,

c) Në katër raste, projekte, në të cilin subjektet konkurruese kanë të njëjtin ortak dhe/ose administrator.

- Nga auditimi u konstatua se mungonte vendosja e logos se financuesit, përgjithësisht për pjesën e projekteve, të cilat ishin në media vizive të shkruar apo elektronike të realizuara, veprime në kundërshtim me nenin 6, pika 3, të kontratave të lidhura mes përfituesit dhe Financuesit MTM.

- Nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit nuk ka asnjë plan monitorimi periodik me objektiva të qarta mbi këto projekte të finalizuar, e cila ka çuar në mungesën e një analize mbi impaktin që kanë pasur dhe kanë këto projekte në zhvillimin e turizmit. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 7, faqet nr. 138-178 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**30.1. Rekomandimi:** Ministria e Turizmit dhe Mjedisit të marrë masa për hartimin e prioriteteve sa më të qarta mbi zonat me përparësi në zhvillimin e turizmit dhe burimet turistike për të cilat do të zhvillohen këto projekte, me qëllim përdorimin e fondeve publike në këto programe, me eficiencë dhe efektivitet si dhe me impakt në fushën e turizmit.

**Në vijimësi**

**30.2. Rekomandimi:** Komisioni i përzgjedhjes së projekteve në MTM, të marrë masa që në procesverbalet e mbajtur mbi përzgjedhjen e aplikantëve të argumentojë mënyrën e përzgjedhjes së projekteve duke patur në fokus impaktin që kanë në planin e zhvillimit turizmit.

**Në vijimësi**

**30.3. Rekomandimi:** Komisioni i përzgjedhjes së projekteve në MTM, gjatë vlerësimit të projekteve brenda një viti të marrë masa për kualifikimin e projekteve duke shmangur rastet e përzgjedhjes, ku ortaku dhe/ose administratori rezulton të jetë pjesë e projekteve të tjera në këtë pozicion.

**Në vijimësi**

**30.4. Rekomandimi:** Drejtoria e Përgjithshme e Politikave dhe Zhvillimit të Turizmit të marrë

masa për hartimin e një regjistri me projektet fituese, ku të evidentohen të gjitha rastet, ku është lidhur kontrata dhe nuk janë përmbushur kushtet e saj, me qëllim heqjen e të drejtës së aplikimit sërish me të njëjtin projekt në periudhat pasardhëse.

**Në vijimësi**

**30.5. Rekomandimi:** Nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit të merren masa për hartimin e një plani monitorimi periodik të projektet në fushën e Turizmit, me qëllim vlerësimin e përdorimit të fondeve publike në këto programe, me eficiencë dhe efektivitet si dhe me impakt në fushën e turizmit.

**Në vijimësi**

**31. Gjetja nga auditimi:** Në kontratën me objekt “*Mbyllja, rehabilitimi i mbetjeve urbane nga venddepozitimet ekzistuese (Burrel, Kukës, Libohovë, Përmet, Krujë)*” nga verifikimi në venddepozitime u konstatua se, depozitimi i mbetjeve nuk kryhet në mënyrë të diferencuar ku në to kishte mbetje që kanë një jetëgjatësi shumë të madhe dekompozimi, goma makinash mbetje plastike si dhe mbetje inerte, të cilat nuk janë parashikuar të depozitohen në këto landfille. etj. Hedhja e mbetjeve që nga fillimi i depozitimit të tyre është kryer në mënyrë kaotike dhe jo me shtresa. Mbetjet nuk janë shpërndarë në mënyrë të njëtrajtshme dhe nuk janë ngjeshur e mbuluar me shtresa dheu çdo një metër lartësi, për rrjedhojë në zonë përhapet ndotje mjedisore (aromë jo e këndshme), duke shkaktuar dëme në shëndetin publik.

Në raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (VNM) kapitulli 5 “*Plani i menaxhimit social dhe mjedisor*” janë parashikuar një sërë masash zbutëse, monitoruese dhe institucionale që duhen miratuar gjatë fazave të ndërtimit dhe operimit për të eliminuar ose zvogëluar ndikimet e pafavorshme mjedisore dhe sociale që dalin nga rehabilitimi i venddepozitimit. Një nga masa është marrëveshjet institucionale, për të përfshirë përcaktimin e përgjegjësive për zbatimin dhe monitorimin e masave zbutëse siç është përcaktuar. Gjatë periudhës së garancisë së punimeve administrimi i venddepozitimeve do të kryhej nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, deri në kalimin kapital të tyre, dhe operimi nga bashkitë përkatëse. Referuar VNM për menaxhimin social e mjedisor, MTM duhet lidhte një marrëveshje me institucionet (bashkitë përkatëse), duke përcaktuar përgjegjësitë gjatë fazës së operimit deri në transferimin e plotë të tyre tek përfituesit (bashkitë). Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion nuk gjenden gjurmë që kjo marrëveshje të jetë realizuar. Mungesa e menaxhimit dhe monitorimit të landfilleve është në kundërshtim me Ligjin nr.10463, datë 22.09.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, i ndryshuar; VKM-në nr.452, datë 11.07.2012 “Për lëndfillet e mbetjeve” dhe Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (VNM) kapitulli 5 “*Plani i menaxhimit social dhe mjedisor*”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqet nr. 101-109 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**31.1 Rekomandimi:** Ministria e Turizmit e Mjedisit në bashkëpunim me bashkitë të realizojë vlerësimin e landfilleve për mënyrën e depozitimit të mbetjeve dhe përcaktimin e jetëgjatësisë së tyre, për marrjen e masave pas mbylljes së tyre. Gjithashtu të kryhen trajnime për rritjen e kapaciteteve menaxhuese dhe mënyrën e trajtimit të integruar të mbetjeve në landfille, të bashkive përkatëse dhe atyre ku do të kryhen investime të reja.

**Menjëherë**

**32. Gjetja nga auditimi:** Në kontratën me objekt “*Mbyllja, rehabilitimi i mbetjeve urbane nga venddepozitimet ekzistuese (Burrel, Kukës, Libohovë, Përmet, Krujë)*” nga verifikimi në venddepozitimet u konstatuan dëmtime të shtresave mbrojtëse dhe tubave të largimit të shllamit, konkretisht: Në Bashkinë Libohovë dhe Kukës u konstatua se gjeomembrana ishte e dëmtuar dhe ishte e zhvendosur nga era së bashku me shtresën e gjeotekstitit. Gjithashtu tubat e kullimit të llumit në bashkinë Libohovë ishin dëmtuar dhe nuk mund të kryenin funksionin për të cilin ishin vendosur. Shtresat mbrojtëse dhe sistemi i tubacionit për largimin e shllamit të dëmtuara nuk mund të kryejnë funksionin e tyre duke lejuar llumin të kontaminonj terrenin përreth. Në Bashkinë Krujë

një pjesë e rrethimit ishte e dëmtuar dhe nuk krijonte një mbyllje të plotë të vend-depozitimit dhe kjo bën të mundur hedhjen e mbetjeve nga subjekte të pa autorizuar dhe mbetje të rrezikshme që kërkojnë një trajtim të veçantë. Dëmtimet kanë ardhur si rezultat i keq menaxhimit të investimit nga ana e përfituesit. Mungesa e menaxhimit dhe monitorimit të landfilleve është në kundërshtim me ligjin nr.10463, datë 22.09.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, i ndryshuar; VKM nr.452, datë 11.07.2012 “Për lëndfillet e mbetjeve”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqet nr. 101-109 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**32.1 Rekomandimi:** Ministria e Turizmit e Mjedisit në bashkëpunim me sipërmarrësin e punimeve të marrë masa për riparimin e shtresave mbrojtëse të dëmtuara, sistemet e kullimit duke shmangur kontaminimin e mjedisit përreth si dhe rrethimet e dëmtuara për parandalimin e hedhjes së mbetjeve jo të lejuara, për minimizimin e kostove në të ardhmen me rritjen e jetëgjatësisë së landfilleve.

Menjëherë

## B.1 MASA SHPËRBLIM DËMI

**1. Gjetje nga Auditimi:** Nga auditimi i zbatimit të kontratës së lidhur midis Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit dhe OE “A.K.” shpk me nr.333/5Prot. datë 25.06.2021 me objekt “Mbyllja, rehabilitimi i mbetjeve urbane nga vend-depozitimet ekzistues (Burrel, Kukës, Libohovë, Përmet, Krujë)” me vlerë 175,728,198 lekë me TVSH me afat përfundimi të punimeve 6 muaj, sipas dokumentacionit të dosjes teknike dhe verifikimit në terren të kryera nga ana e përfaqësuesve shtetërorë të KLSH në prezencë të përfaqësuesit të mbikëqyrësit (supervizori i punimeve) rezultuan se; Në librezat e masave dhe në situacionet përfundimtar, janë përfshirë volume punimesh të pakryera në fakt, për 2 (dy) zëra punimesh në shumën 264,170 lekë pa TVSH e cila përbën dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit. Sa më sipër është vepruar në kundërshtim me; Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7, Udhëzimi nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, Kreu II, Pika 8.1, Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar me Udhëzimin Nr. 1, datë 16.6.2011, Kreu I, pika 3, nënparagrafi 3.2 dhe 3.3; - Kontrata e shërbimit me objekt “Mbikëqyrje të objektit, ‘Mbyllja, rehabilitimi i mbetjeve urbane nga vend-depozitimet ekzistues (Burrel, Kukës, Libohovë, Përmet, Krujë)”, Nr. 2181/8 Prot. datë 16.06.2021. (Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqet nr. 101-109 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**1.1 Rekomandimi:** Ministria e Turizmit dhe Mjedisit të marri masa, për arkëtimin e shumës 264,170 Lekë pa TVSH, e cila përbën dëm ekonomik në buxhetin e shtetit dhe njësisë vendore, duke ndjekur të gjitha procedurat nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit nga OE “A. K.” shpk sipas kontratës së lidhur me Nr.333/5Prot. datë 25.06.2021 për realizimin e punimeve civile.

Menjëherë

## B.2 MASA PËR ELIMIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.

**1. Gjetje nga Auditimi:** Në kontratën me objekt “Mbyllja, rehabilitimi i mbetjeve urbane nga venddepozitimet ekzistuese (Burrel, Kukës, Libohovë, Përmet, Krujë)” nga verifikimi në vend-depozitimin e Bashkisë Kukës mbetjet urbane nuk depozitoheshin në të, vetëm në hyrje të saj

kishte një sasi të vogël mbetjesh inerte të cilat bllokoni hyrjen e landfillit. Nga ana e Autoritetit kontraktor nuk ka një monitorim të situatës se ku depozitohen mbetjet urbane të kësaj bashkie pasi objekti është në periudhën e garancisë dhe nuk ka kaluar si investim kapital përfituesit. Ndërtimi i vend-depozitimit është kryer si rezultat i situatës emergjente të mbetjeve në bashkinë Kukës. Nisur nga fakti se ky vend-depozitim nuk është vendosur në shfrytëzim edhe pse ka kaluar një vit nga përfundimi i punimeve dhe marrjes në dorëzim gjë që tregon se, situata e mbetjeve në Bashkinë Kukës nuk ka qenë emergjente dhe investimi i kryer nuk ka qenë efikas. Për sa më sipër vlera e investimit prej 27,921,485 lekë pa TVSH, të kryer në vend-depozitimin në Bashkinë Kukës, nga grupi i auditimit konsiderohet shpenzim pa ekonomikitet, efikasitet dhe efektivitet i fondeve publike deri në këtë fazë të menaxhimit të landfillit. Sa më sipër është vepruar në kundërshtim me ligjin nr.10463, datë 22.09.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, i ndryshuar dhe VKM nr.452, datë 11.07.2012 “Për landfillet e mbetjeve” dhe ligjit nr. 9336, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqet nr. 101-109 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**1.1 Rekomandimi:** Ministria e Turizmit e Mjedisit në bashkëpunim Bashkinë Kukës të marrë masa të menjëhershme për verifikimin se ku depozitohen mbetjet urbane si dhe monitorimin e situatës se si menaxhohet trajtimi i tyre, duke shmangur ndotjen e ambientit e ruajtjen e shëndetit publik.

**Menjëherë**

**2. Gjetje nga Auditimi:** Nga auditimi i Vendimeve gjyqësore, të cilat kanë marrë formë të prerë është konstatuar se, për vitin 2022 është paguar shuma prej 8,145,706 lekë, për ekzekutimin dhe pagesën e 9 vendimeve gjyqësore me detyrimin për “Pagesë page deri në kthim në punë” për ish punonjës të larguar padrejtësisht nga puna, për të cilët vijon pagesa dhe nuk janë marrë parasysh gjatë procesit të ristrukturimit, për faktin se struktura e aparatit të MTM është shkurtuar me 7 punonjës në vitin 2022. Veprime në kundërshtim me Urdhrin nr. 5151, datë 28.10.2015 “Për zbatimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë nga institucionet e administratës shtetërore, të përfshira në fushën e zbatimit të ligjit për shërbimin civil”, me Ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, me Ligjin nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqet nr. 36-47 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**2.1 Rekomandimi:** Nga Strukturat përgjegjëse të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, të merren masa në bashkëpunim me DAP, për rikthimin në punë të të gjithë punonjësve që kanë fituar këtë të drejtë sipas përcaktimeve të vendimeve gjyqësore të formës së prerë.

**Në vijimësi**

## V. ANEKSE

*Aneksi nr 1: Hartimi dhe zbatimi i buxhetit të shtetit, nga faqja 19 deri 36 të Raportit.*

*Aneksi nr. 1/1: “Buxheti fillestar dhe Realizimi i shpenzimeve kapitale për vitin 2020 sipas programeve”,*

Emri i institucionit	Emërtimi i projektit	Çelja e buxhetit 2020	Buxhet përfundimtar	Realizimi
	<b>Ministria e Turizmit dhe Mjedisit</b>			
	<b>Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi</b>	2,000,000	2,171,000	<b>2,151,997</b>
Aparati i Min.Mjedisit	Orendi dhe paisje	1,093,000	1,093,000	1,075,920
Aparati i Min.Mjedisit	Rikonstruksion I bodrumeve te Ministrise	907,000	888,000	888,000
Aparati i Min.Mjedisit	Mbikqyrja dhe Kolaudim		190,000	188,077

	<b>Programe për mbrojtjen e Mjedisit</b>	183,088,000	101,252,508	<b>89,097,476</b>
Aparati i Min.Mjedisit	Mbyllja, rehabilitimi i mbetjeve urbane nga venddepozitimeve ekzistuese	109,921,000	-	
Aparati i Min.Mjedisit	Sistemi elektronik i monitorimit te pyjeve	10,400,000	8,640,000	7,272,445
Aparati i Min.Mjedisit	Pasaporta digjitale mjedisore	8,960,000	-	
Aparati i Min.Mjedisit	Bioenergja- Projekti UNIDO	1,000,000	-	
Aparati i Min.Mjedisit	Parku biosferik i Prespes	3,057,000	11,839,650	11,839,650
Aparati i Min.Mjedisit	Parku biosferik i Prespes	8,943,000	-	
Aparati i Min.Mjedisit	Mekanizmat financiarë - PNUD	3,000,000	1,910,000	
Aparati i Min.Mjedisit	SËAN -Platforma per riperdorimin e mbetjeve	500,000	500,000	500,000
Aparati i Min.Mjedisit	Plastic buster	1,000,000	1,000,000	1,000,000
Aparati i Min.Mjedisit	TUNE - UP	1,000,000	2,915,000	2,915,000
Aparati i Min.Mjedisit	RE-SOURCE	2,000,000	4,600,000	4,600,000
Agjencia Kombetare e Zonave te Mbrojtura	PHAROS4MPAs-Zhvillimi blu dhe ruajtja e burimeve detare ne mesdhe	443,000	443,000	443,000
Aparati i Min.Mjedisit	ALL TOUR	1,000,000	8,878,542	8,878,542
Aparati i Min.Mjedisit	Pershtatja me ndryshimet Klimaterike ne fushen e menaxhimit nderkufitar te riskut te permbetjeve ne Ballkanin perendimor-GIZ	4,000,000	1,014,932	1,014,932
Aparati i Min.Mjedisit	Kune Vain- Projekti GEF	1,000,000	1,000,000	868,028
Aparati i Min.Mjedisit	Parku biosferik i Prespes	10,000,000	11,669,000	11,668,885
Aparati i Min.Mjedisit	Projekti tre liqenet CSBL III - Projekti GIZ	2,000,000	716,200	
Aparati i Min.Mjedisit	Projekti Aquanex - Ruajtja dhe sigurimi I trupave ujor	500,000	150,000	110,924
Aparati i Min.Mjedisit	Trupe nderkufitare e ngritur per menaxhimin e qendrueshem te biodiversitetit, habitateve dhe ekosistemeve ne 3 zona detare dhe bregdetare (Blue Land- Sherbimi i ekosistemeve) -AKZM tvsh	800,000	-	-
Aparati i Min.Mjedisit	Mbetjet- ne kuader te ndryshimeve klimatike-GIZ	3,000,000	7,700,000	7,695,807
Aparati i Min.Mjedisit	SËAN -Platforma per riperdorimin e mbetjeve	200,000	505,300	59,810
Aparati i Min.Mjedisit	Plastic buster	500,000	200,000	50,702
Aparati i Min.Mjedisit	Sistem I ngritur per menaxhimin e mbetjeve detare. (Menaxhimi i Integruar i Mbetjeve dhe Parandalimi i Mbetjeve Detare ne Ballkanin Perendimor - GIZ)	3,360,000	3,360,000	2,647,481
Aparati i Min.Mjedisit	Permiresimi I menaxhimit te kimikateve (Menaxhimi i Kimikateve- SIDA)	510,000	423,420	423,419
Aparati i Min.Mjedisit	TUNE - UP	500,000	200,000	-
Aparati i Min.Mjedisit	Raporte performace te hartuara (Projekti SANE - SIDA)	4,000,000	4,000,000	4,000,000
Agjencia Kombetare e Zonave te Mbrojtura	PHAROS4MPAs-Zhvillimi blu dhe ruajtja e burimeve detare ne mesdhe	554,000	150,067	150,067
Agjencia Kombetare e Zonave te Mbrojtura	Projekti LASPEH	640,000	484,600	484,514
Aparati i Min.Mjedisit	ALL TOUR	300,000	225,000	104,645
Aparati i Min.Mjedisit	IPA-2013, Natyra 2000		15,147,214	15,147,214
Agjencia Kombetare e Mjedisit	Pasaporta digjitale mjedisore		8,960,000	
Aparati i Min.Mjedisit	Trupe nderkufitare e ngritur per menaxhimin e qendrueshem te biodiversitetit, habitateve dhe ekosistemeve ne 3 zona detare dhe bregdetare (Blue Land- Sherbimi i ekosistemeve) -AKZM kosto lokale		2,059,333	2,059,333
Aparati i Min.Mjedisit	RE-SOURCE		-	-
Aparati i Min.Mjedisit	IPA 2013, Mbetje		1,861,250	1,861,201
Agjencia Kombetare e Zonave te Mbrojtura	Projekti LASPEH		700,000	700,000
	<b>Zhvillimi i Turizmit</b>	<b>265,500,000</b>	<b>254,293,492</b>	<b>251,104,696</b>
Agjencia Kombetare e Zonave te Mbrojtura	Vendosja e bovave ankoruese	25,000,000	23,684,492	23,684,492
Aparati i Min.Mjedisit	Fondi per zhvillimin e turizmit	34,495,000	30,000,000	29,932,210
Agjencia Kombetare e Zonave te Mbrojtura	Kontrolli hyres ne Zona te mbrojtura	8,000,000	6,504,000	6,504,000
Aparati i Min.Mjedisit	Permiresim infrastrukture ne zonen e mbrojtur Kune - Vain Lezhe	53,079,000	53,079,000	52,813,924
Aparati i Min.Mjedisit	Masterplane per zonat me perparesi zhvillimin e turizmit	57,061,000	57,061,000	57,061,000
Agjencia Kombetare e Zonave te Mbrojtura	Sistemimi I zones se Peligrinazhit ne malin e Tomorrit	36,860,000	36,860,000	36,860,000
Agjencia Kombetare e Bregdetit	Qëndrueshmëria e peizazheve ujore nëpërmjet ripërdorimit të mbetjeve të ngurta detare (ËELCOME)	2,000,000	2,000,000	2,000,000
Agjencia Kombetare e Bregdetit	Praktikat bregdetare per qeverisjen e kalter (BLUE COAST)	1,500,000	1,500,000	1,500,000
Agjencia Kombetare e Bregdetit	Skema dhe Aplikacioni Mobile për ruajtjen dhe promovimin e përbashkët gastronomisë tradicionale(CBTB)	1,300,000	1,300,000	1,300,000



Aparati i Min.Mjedisit	Zhvillimi i Turizmit Detar dhe Promovimi i Porteve Rajonale REGLPORTS	2,000,000	3,350,000	3,350,000
Agjencia Kombetare e Bregdetit	Zhvillimi i Turizmit Detar dhe Promovimi i Porteve Rajonale REGLPORTS 1	2,000,000	2,500,000	2,500,000
Agjencia Kombetare e Turizmit	Teknologjite e reja ne sherbim te zhvillimit te rrugeve tematike nderrajonale. THEMA	900,000	-	-
Agjencia Kombetare e Turizmit	Grumbullimi i SME-ve inovative te turizmit nderkufitar INNOTOURCLUST	1,800,000	-	-
Agjencia Kombetare e Turizmit	TREC Shqiperi udheto ne menyren tende: Menaxhimi multi aktor I integruar I turizmit rural dhe kulturor ne qarqet e Gjirokastres dhe Beratit.	1,850,000	-	-
Aparati i Min.Mjedisit	Due Mari	12,709,000	25,627,000	25,627,000
Agjencia Kombetare e Bregdetit	Qëndrueshmëria e peizazheve ujore nëpërmjet ripërdorimit të mbetjeve të ngurta detare (ÉELCOME)	1,000,000	300,000	66,871
Agjencia Kombetare e Bregdetit	Praktikat bregdetare per qeverisjen e kalter (BLUE COAST)	1,000,000	1,000,000	397,344
Agjencia Kombetare e Bregdetit	Skema dhe Aplikacioni Mobile për ruajtjen dhe promovimin e përbashkët gastronomisë tradicionale(CBTB)	1,000,000	350,000	62,150
Aparati i Min.Mjedisit	Zhvillimi i Turizmit Detar dhe Promovimi i Porteve Rajonale REGLPORTS	1,500,000	155,000	-
Agjencia Kombetare e Bregdetit	Zhvillimi i Turizmit Detar dhe Promovimi i Porteve Rajonale REGLPORTS 1	1,500,000	500,000	59,484
Agjencia Kombetare e Turizmit	Teknologjite e reja ne sherbim te zhvillimit te rrugeve tematike nderrajonale. THEMA	400,000	-	-
Agjencia Kombetare e Turizmit	Grumbullimi i SME-ve inovative te turizmit nderkufitar INNOTOURCLUST	500,000	-	-
Agjencia Kombetare e Turizmit	TREC Shqiperi udheto ne menyren tende: Menaxhimi multi aktor I integruar I turizmit rural dhe kulturor ne qarqet e Gjirokastres dhe Beratit.	1,100,000	-	-
Aparati i Min.Mjedisit	Due Mari	16,946,000	4,028,000	2,891,221
Agjencia Kombetare e Zonave te Mbrojtura	Fondi per zhvillimin e turizmit		4,495,000	4,495,000
	<b>Administrimi i Pyjeve</b>	89,812,000	87,962,000	<b>69,943,453</b>
Aparati i Min.Mjedisit	Projekti I Sherbimeve Mjedisore	89,812,000	85,533,000	67,514,453
Agjencia Kombetare e Zonave te Mbrojtura	TVSH per Zhdoganim Mjet Lundrimi		150,000	150,000
Agjencia Kombetare e Zonave te Mbrojtura	Destimed Plus		2,279,000	2,279,000

Burimi: MTM, përpunuar nga Grupi i auditimit

### Aneksi nr. 1/2: “Kërkesat shtesë në PBA 2021-2023”.

Gr	Shpenzime	2021				ns000 leke
		Piani i vitit 2020	viti 2021 plani	viti 2021 kerkesa shtese investime	viti 2021 kerkesa shtese 602	
	Kapitale te					
26	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	2,085				
	Orendi dhe pajisje	1,093	2,000			
	Pajisje TIK	992	4,000			
	vendimet gjyqesore				210,000	
26	Programi per Mbrojtjen e Mjedisit	400,871				
	Mbyllja, rehabilitimi i mbetjeve urbane nga venddepozitimeve ekzistuese	109,921	27,300	300,000		
	Studim 10 vend depozitime			4,000		
	Pasaporta dixhitale mjedisore	8,960	2,000			
	Blerje dhe instalim i 6 stacioneve te monitorimit			75,000		
	Sistem Online per regjistrimin dhe aplikimin e Lejeve Mjedisore ne forme te defaultuar			124,000		
	Sistem Online per Monitorimin Parametrave Mjedisore			124,000		
26	Programi Administrimi i Pyjeve	281,990				
	Hartimi i metodikes per rishikimin e planeve te menaxhimit dhe zbatimi i saj ne 5 zona pilot		36,900	100,000		
	Masterplane per Zonat e mbrojtura			50,000		
	Hartimi i studimeve te vizibilitetit per mbetet si detyrim i dokumentit te politikave dhe strategjia kombetare per menaxhimin e integruar te mbetjeve 2-3 zona pilot			90,000		
26	Zhvillimi i Turizmit	214,495				
	Vendosja e bovave ankoruese	25,000		25,000		
	Fondi per zhvillimin e turizmit (Artikulli 230)	34,495	34,000			
	Kontrolli hyres ne Zona te mbrojtura	8,000				
	Perrmesim infrastrukture ne zonen e mbrojtur Kune - Vain Lezhe	53,079				
	Masterplane per zonat me perparesi zhvillimin e turizmit	57,061	55,845			
	Sistemimi i zones se Peligrinazhi ne malin e Tomorrit	36,860	26,000			
	Menaxhimi i qendrueshem i zones Ipatok-FusheKuce, me theks zhvillim turizmi			36,000		
	Sistemi i statistikave lokale te turizmit			50,000		
	Sinjalistika e aktiviteve te turizmit detar			50,000		
	Vendosja e sinjalistikave dhe pasirimi i plazheve AKB			100,000		
	Show Room mbi turizmin Shqiptar			40,000		
	Promovim turizmi dhe organizimi i panisireve			90,000		
	Krijimi i shtigjeve turistike sipas standardeve ne ZM (20km)			30,000		
	Krijimi i infrastruktures turistike ne ZM ( 2 zona)			50,000		
	Sistemi Online I Turizmit Detar			124,000		
	Sistemi Online I Statistikave te Turisteve dhe Klasifikimit te Hoteleve			124,000		
26	Total		191,045	1,496,000	300,000	

Burimi: MTM

**Aneksi nr. 1/3: “Kërkesat e MTM në lidhje me shpenzimet kapitale për vitin 2022”**

Qr		viti 2022 kërkesa shtese investime	viti 2022 kërkesa shtese 602	viti 2023 kërkesa shtese investime	viti 2024 kërkesa shtese investime
26	<b>Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi</b>				
	<i>Arbrazh, Beccreshti</i>		100,000		
26	<b>Programi për mbrojtjen e mjedisit</b>				
	Rehabilitimi i mbetjeve urbane nga vendqendimet e krijesues	300,000			
	Pjesë kembimi për 7 stacionet e monitorimit të ajrit	10,000			
	Blerje dhe instalimi i 2 stacioneve portatili të ajrit	66,046			
	Programi e pajisje komplekse	10,450			
26	<b>Programi Administrimi i Pjeseve</b>				
	Rishikimi Përmes të Menaxhimit për 2 ZM-AKZM	100,000			
	Masterplane për Zonat e mbrojtura - AKZM	50,000			
	Inventarizimi i Faunës së Egër të Qjetisë	100,000			
	Ndërtimi i Qendrës së Vizitorëve në PK të Alpeve (Valbonë)	25,000			
	Hartimi i metodologjisë për inventarizimin e 40 Rrezeve të fardës së egër	12,000			
	Inventarizimi i 40 Rrezeve të faunës së egër në nivel kombëtar	500,000			
	Ndërtimi e qendrës së rehabilitimit të kafshëve të egër në gjendje kapitviteti	400,000			
	Ngritja e qendrës studimore për ojetn (Durrës ose Vlorë)	1,000,000			
26	<b>Zhvillimi i Turizmit</b>				
	Vendosje e boveve ankurorese	25,000			
	Fushata Post-Covid Gjermanishtifilose (10 %)-AKT		75,000		
	Sistemi Online i Turizmit Detar	150,000			
	Sistemi Online i Statistikave të Turizmit	150,000			
	Fushata Post-Covid Gjermanishtifilose (2022-2023)-AKT		730,000		
	Inovacioni Teknologjik (update infopoint) - AKT	25,000			
	Pranohetimi i Turizmit Branding - AKT		5,000		
	Infopoint Digital (update) - AKT	10,000			
	Hapje Zyrate të Turizmit pranë perfaqesive diplomatike - AKT	12,300			
	Tabela Informative pranë Aeroportit - AKT	5,000			
	Blerje Pajisje Elektronike - AKT	1,200			
	Blerje Pajisje TIK-AKB	3,000			
	Krijimi i shërbimeve turistike (20 km) -AKZM	30,000			
	Krijimi i Infrastruktura Turistike (2 Zona) - AKZM	50,000			
	Plan Menaxhimi i Ligatirave Patok-Fushkucje - AKZM	36,000			
	Studim mbi krijimin e shërbimeve malore për biçikleta - AKT	3,000			
	Pasidimi për sezonin turistik për 11 bashkitë e bregdetit	121,358			
26	<b>TOTALI</b>	<b>3,197,364</b>	<b>916,000</b>		

**Aneksi nr. 1/5: “Investimet e paplanifikuara dhe realizuara për vitin 2022”**

Në lekë

F. H	Njësi	Përshkrimi	PBA 2022	Buxheti fillestar 2022	Buxhet perfundimtar	Realizimi 2022
		<b>Investime 230+231</b>	<b>1,091,940,000</b>	<b>1,070,740,000</b>	<b>979,240,000</b>	<b>905,673,353</b>
		<b>Planifikim menaxhim, Administrim</b>	<b>6,000,000</b>	<b>3,000,000</b>	<b>1,800,000</b>	<b>1,703,508</b>
		Orendi dhe pajisje	2,000,000	1,000,000	-	-
		Pajisje TIK	4,000,000	2,000,000	1,800,000	1,703,508
		<b>Programi për mbrojtjen e mjedisit</b>	<b>467,700,000</b>	<b>510,000,000</b>	<b>534,055,000</b>	<b>486,383,480</b>
		Vendepozitime të rehabilituara	50,000,000	50,000,000	50,000,000	49,830,934
		18BF602, Pajisje dhe pjesë kembimi për 7 stacionet e monitorimit të ajrit		-	37,480,000	37,356,000
		Rehabilitimi i mbetjeve urbane (Memaliaj, Tepelenë, Fushë Arrëz)	29,085,000	40,000,000		
		Fire prep- Kosto lokale	1,000,000	9,200,000	5,700,000	5,700,000
		Plastic buster masa pilote të zbatuara- Kosto lokale	800,000	800,000	800,000	800,000
		TUNE UP kosto lokale	1,000,000	1,500,000	1,500,000	1,500,000
		Plastic buster masa pilote të zbatuara, TVSH	200,000	200,000	630,000	627,058
		Sistem i ngritur për parandalimin e mbetjeve detare TVSH	1,000,000	1,230,000	1,230,000	1,055,050
		Raporte performace të hartuara TVSH	800,000	800,000	800,000	591,413
		Përmirësimi i menaxhimit të kimikateve (Menaxhimi i Kimikateve - SIDA) TVSH	500,000			
		M260379, TVSH Mbetjet- Përshtatja me ndryshimet klimatike, GIZ	1,000,000	-	26,000,000	22,664,832
		TVSH Përshtatja me ndryshimet klimatike në fushën e menaxhimit ndërkufitar të riskut të përmbytjeve në Ballkanin përrëndimor, GIZ	615,000	615,000	615,000	615,000
		IPA Ekonomia Qarkulluese Kosto lokale	1,000,000	1,000,000	-	-
		MPA Engage (IPA Intreg Med) Kosto Lokale	1,000,000	2,500,000	6,000,000	6,000,000
	AKM	18BR907, Hartim projekti Rikonstruksioni godes AKM		-	2,160,000	2,160,000
	AKM	M260069, Blerje Pajisje per matjen e qeseve plastike		-	1,140,000	1,106,568
		IPA Ekonomia Qarkulluese TVSH	2,000,000	12,155,000	-	-
		Përshtatja me ndryshimet klimatike në fushën e menaxhimit ndërkufitar të riskut të përmbytjeve në Ballkanin përrëndimor, GIZ		24,600,000	39,000,000	38,066,720
F.Huaj		Rezervati ndërkufitar I Prespës		50,000,000	50,000,000	42,458,375
F.Huaj		Mbetjet në kuadër të ndryshimeve klimatike GIZ		186,403,000	186,403,000	182,352,760
F.Huaj		Plastic buster (masa pilotë zbatuara)		3,000,000	4,000,000	3,218,320
F.Huaj		Sistem i ngritur për menaxhimin e mbetjeve detare		12,300,000	21,000,000	19,881,650
F.Huaj		TUNE UP		2,000,000	2,000,000	1,790,340
F.Huaj		Raporte performace të hartuara (Projekti SANE SIDA)		10,000,000	7,000,000	4,988,845
F.Huaj		Ekonomia qarkulluese IPA 3		31,000,000	-	-
F.Huaj		Fire Prep		3,000,000	3,000,000	1,739,005
F.Huaj		MPA Engage (IPA Intreg Med)		4,000,000	2,000,000	980,390
F.Huaj		ËBC-RRI-NET (Horizont 2020)		2,000,000	3,500,000	2,054,115
F.Huaj		Përmirësimi i menaxhimit të kimikateve (Menaxhimi i Kimikateve - SIDA)		25,607,000	24,494,000	11,039,490
F.Huaj		Projekti i Mekanizmit financiar -PNUD		25,090,000	50,000,000	41,851,060
F.Huaj		Menaxhimi i kimikateve dhe mbetjeve farmaceutike në Shqipëri (Str. Sound Chem)		11,000,000	1,000,000	970,540
F.Huaj		18BG401, Platforma elektronike per menaxhimin e qendrushem te burimeve ujore ne zonen nderkufitare Greqi-Shqiperi.		-	500,000	248,000
F.Huaj		18BG601, Trupe nderkufitare e ngritur per menaxhimin e qendrushem te biodiversitetit, habitateve dhe ekosistemeve ne 3 zona detare dhe bregdetare		-	600,000	415,800

F.Huaj		18CH601, Projekti Sigurimi i Sherbimeve per menaxhimin e burimeve natyrore- RE-SOURCE			-	2,000,000	1,826,350
		GM26058, Kune Vain Grant			-	2,500,000	2,489,165
		GM26074, SANEX Kapitulli 27 - SIDA (programi per zhvillimin e mjedisit)				1,000,000	-
F.Huaj	AKM	18CI001, Permiresimi i efikasitetit te mbrojtjes se ligatinave			-	3,000	5,700
		<b>Zhvillimi I turizmit</b>	<b>499,740,000</b>	<b>479,240,000</b>	<b>408,285,000</b>	<b>382,681,965</b>	
		Fondi per zhvillimin e turizmit	100,000,000	75,760,000	115,910,300	109,583,654	
	Bashki a Berat	Fondi per zhvillimin e turizmit			-	384,000	384,000
		Mbeshetje financiare e projektit BERZH	175,000,000	178,740,000	178,000,000	178,000,000	
		18CH001, Zhvillimi i Turizmit Detar dhe Promovimi i Porteve Rajonale REGLPORTS			-	8,107,000	8,107,000
	AKB	18CH002, Zhvillimi i Turizmit Detar dhe Promovimi i Porteve Rajonale REGLPORTS I			-	2,000,000	1,985,838
	AKZM	Pemirsimi I infrastrukturës dhe kthimi I Parkut Natyror "Syri I Kaltër" në destinacion eko-turistik	50,000,000	50,000,000	49,643,700	49,288,019	
		Due Mari- Kosto Lokale	18,500,000	18,500,000	-	-	
		Due Mari- TVSH	9,000,000	9,000,000	6,000,000	5,149,872	
	AKT	Strategjia e biodiversitetit dhe Turizmit për të mbrojtur gjitharët e detit/ Bio Tours	-	-	2,000,000	-	
	AKT	Strategjia e biodiversitetit dhe Turizmit për të mbrojtur gjitharët e detit/ Bio Tours- TVSH	1,000,000	1,000,000	1,000,000	106,042	
		Strategjia e biodiversitetit dhe Turizmit për të mbrojtur gjitharët e detit/ Bio Tours- Kosto lokale	2,000,000	2,000,000	-	-	
		Sinjalistika përgjatë bregdetit (Plazhet) AKB	20,000,000	20,000,000	-	-	
		Hartim projekti (Rehabilitim io shesheve dhe rrugëve kryesore në afërsi të pikave doganore shqiptare)	24,240,000	24,240,000	16,240,000	14,976,000	
F.Huaj	AKT	Strategjia e Biodiversitetit dhe Turizmit per te mbrojturgjitet e detit/ BioTourS		10,000,000	3,000,000	430,710	
F.Huaj	AKB	Qëndrueshmëria e peizazheve ujore nëpërmjet ripërdorimit të mbetjeve të ngurta detare (ËELCOME)		-	2,000	1,000	
F.Huaj	AKB	Praktikat bregdetare per qeverisjen e kalter (BLUE COAST)		-	2,000	1,000	
F.Huaj	AKB	Skema dhe Aplikacioni Mobile për ruajtjen dhe promovimin e përbashkët gastronomisë tradicionale(CBTB)		-	2,000	1,000	
F.Huaj		Zhvillimi i Turizmit Detar dhe Promovimi i Porteve Rajonale REGLPORTS		-	980,000	874,680	
F.Huaj	AKB	Zhvillimi i Turizmit Detar dhe Promovimi i Porteve Rajonale REGLPORTS		-	2,000	1,000	
F.Huaj	AKT	Teknologjite e reja ne sherbim te zhvillimit te rrugëve tematike nderrajonale. THEMA		-	4,000	3,000	
F.Huaj	AKT	Grumbullimi i SME-ve inovative te turizmit nderkufitar INNOUTOURCLUST		-	4,000	3,000	
F.Huaj	AKT	TREC Shqiperi udheto ne menyren tende: Menaxhimi multi aktor I integruar I turizmit rural dhe kulturor ne qarqet e Gjyrokastres dhe Beratit.		-	4,000	2,980	
F.Huaj		Due Mari	100,000,000	90,000,000	25,000,000	13,783,170	
		<b>Administrimi I Pyjeve</b>	<b>118,500,000</b>	<b>78,500,000</b>	<b>35,100,000</b>	<b>34,904,400</b>	
		Ndërtimi I një qendre multifunkionale për zonën e re të mbrojtur të Lumit Vjosa	50,000,000	30,000,000	-		
		Ngritja e infrastrukturës turistike me theks tek ajo ujore-Eko Park Ulza	68,500,000	48,500,000	21,000,000	20,888,400	
	AKZM	18BE612. Hartimi I Planit te Integruar te Menaxhimit " Parku Kombetar Mali I Dajtit"			-	14,100,000	14,016,000

Burimi: MTM, përpunuar nga grupi i auditimit

Investimet që nuk kanë ndjekur ciklin standart buxhetor janë përmbledhur në tabelën e mëposhtme:

**Aneksi nr. 1/6: "Investimet e paplanifikuara dhe realizuara për vitin 2022"**

Nr	F. H	Njësia	Përshkrimi	PBA	Buxheti fillestar	Buxhet perfundimtar	Realizimi
1			18BF602, Pajisje dhe pjesë kembimi për 7 stacionet e monitorimit të ajrit		-	37,480,000	37,356,000
2		AKM	18BR907, Hartim projekti Rikonstruksioni godines AKM		-	2,160,000	2,160,000
3		AKM	M260069, Blerje Pajisje per matjen e qeseve plastike		-	1,140,000	1,106,568
4	F. Huaj		Menaxhimi i kimikateve dhe mbetjeve farmaceutike në Shqipëri (Str. Sound Chem)	-	11,000,000	1,000,000	970,540
5	F. Huaj		18BG401, Platforma elektronike per menaxhimin e qendrueshem te burimeve ujore ne zonen nderkufitare Greqi-Shqiperi.		-	500,000	248,000
6	F. Huaj		18BG601, Trupe nderkufitare e ngritur per menaxhimin e qendrueshem te biodiversitetit, habitateve dhe ekosistemeve ne 3 zona detare dhe bregdetare		-	600,000	415,800
7	F. Huaj		18CH601, Projekti Sigurimi i Sherbimeve per menaxhimin e burimeve natyrore- RE-SOURCE		-	2,000,000	1,826,350
8			GM26058, Kune Vain Grant		-	2,500,000	2,489,165

9			GM26074, SANEX Kapitulli 27 - SIDA (programi per zhvillimin e mjedisit)			1,000,000	-
10	F. Huaj	AKM	18CI001, Permiresimi i efikasitetit te mbrojtjes se ligatinave	-		3,000	5,700
11		Bashkia Berat (0202)	Fondi per zhvillimin e turizmit	-		384,000	384,000
12			18CH001, Zhvillimi i Turizmit Detar dhe Promovimi i Porteve Rajonale REGLPORTS Kosto lokale	-		8,107,000	8,107,000
13		AKB	18CH002, Zhvillimi i Turizmit Detar dhe Promovimi i Porteve Rajonale REGLPORTS 1 Kosto lokale	-		2,000,000	1,985,838
14		AKT	Strategjia e biodiversitetit dhe Turizmit per te mbrojtur gjitharët e detit/ Bio Tours	-		2,000,000	-
15	F. Huaj	AKT	Strategjia e Biodiversitetit dhe Turizmit per te mbrojturgjitarët e detit/ BioTourS		10,000,000	3,000,000	430,710
16	F. Huaj	AKB	Qëndrueshmëria e peizazheve ujore nëpërmjet ripërdorimit të mbetjeve të ngurta detare (ÉELCOMÉ)	-		2,000	1,000
17	F. Huaj	AKB	Praktikat bregdetare per qeverisjen e kalter (BLUE COAST)	-		2,000	1,000
18	F. Huaj	AKB	Skema dhe Aplikacioni Mobile per ruajtjen dhe promovimin e përbashkët gastronomisë tradicionale(CBTB)	-		2,000	1,000
19	F. Huaj		Zhvillimi i Turizmit Detar dhe Promovimi i Porteve Rajonale REGLPORTS	-		980,000	874,680
20	F. Huaj	AKB	Zhvillimi i Turizmit Detar dhe Promovimi i Porteve Rajonale REGLPORTS	-		2,000	1,000
21	F. Huaj	AKT	Teknologjite e reja ne sherbim te zhvillimit te rrugeve tematike nderrajonale. THEMA	-		4,000	3,000
22	F. Huaj	AKT	Grumbullimi i SME-ve inovative te turizmit nderkufitar INNOTOURCLUST	-		4,000	3,000
23	F. Huaj	AKT	TREC Shqiperi udheto ne menyren tende: Menaxhimi multi aktor I integruar I turizmit rural dhe kulturor ne qarqet e Gjirokastres dhe Beratit	-		4,000	2,980
24		AKZM	18BE612. Hartimi I Planit te Integruar te Menaxhimit " Parku Kombetar Mali I Dajtit"	-	-	14,100,000	14,016,000
<b>Total</b>				-	-	<b>21,000,000</b>	<b>78,974,000</b>
							<b>72,389,331</b>

**Aneksi nr 2: Zbatimi i dispozitave ligjore për marrëdhëniet e punës, nga faqja 36 deri 47 të Raportit.**

**Aneksi nr. 2/1: “Përmbledhja e strukturave të miratuara për periudhën nën auditim”**

Nr.	Pozicioni	Urdhri i Kryeministrit nr. 165/ 2017		Urdhri i Kryeministrit nr. 127/ 2021		Nr. V.2022	Emërtimi i ri i ndryshuar v. 2022	Urdhri i Kryeministrit nr. 185/ 2022	
		Numri	Kategoria	Numri	Kategoria			Numri	Kategoria
1	Ministër	1		1				1	
1.1	Kabineti	7		7				7	
	Drejtor kabineti	1	IIA					1	IIA
	Keshilltarë	4	IIB					4	IIB
	Sekretar	2						2	
2	Zëvendësministër	2		3				2	
	Sekretar	2		2				1	
3	Sekretar i Përgjithshëm	1	IB	1				1	IB
	Sekretar	1		1				1	
4	Drejtoria e përgjithshme e politikave dhe zhvillimit të turizmit	30		30		4	Drejtoria e përgjithshme për zhvillimin e turizmit	21	
	Drejtor i përgjithshëm	1	IIA					1	
4.1	Drejtoria e politikave dhe strategjive të zhvillimit të turizmit	5						5	
	Drejtor	1	IIB					1	
	Specialist	4	IIIB					4	
4.2	Drejtoria e programeve të zhvillimit të turizmit	17		17			Drejtoria e zhvillimit të programeve të turizmit	7	
	Drejtor	1	IIB					1	
4.2.1	Spektori i programeve të zhvillimit të turizmit 3S (SEA, SAND, SUN)	2					Spektori i programeve dhe destinacioneve të turizmit gjithëvjeter	3	
	-						Përgjegjës sektori	1	IIIA
	Specialist	2	IIIB				Specialist	2	IIIB
4.2.2	Spektori i programeve të zhvillimit të turizmit 3C (CONFERENCE, CULTURAL, CLIMATECTERIC)	2					Spektori i promovimit të turizmit kulturor dhe gastronomisë	3	
	-						Përgjegjës sektori	1	IIIA
	Specialist	2	IIB				Specialist	2	IIIB

4.2.3	Degët territoriale të shërbimit të turizmit	12					-	-
	Kryetar i degës territoriale të shërbimit turistik	12	IIIB				-	-
4.3	Drejtoria e konceptimit dhe fizibilitetit të projekteve të turizmit	7					Drejtoria e projekteve zhvillimore të turizmit	8
	Drejtor	1	IIB					1
4.3.1	Spektori i përgatitjes dhe fizibilitetit të projekteve të zhvillimit turistik	3					Spektori i projekteve strategjike	4
	Përgjegjës sektori	1	IIIA				Përgjegjës sektori	1
	Specialist	1	IIIB				Specialist	2
	Specialist	1	IVA				Specialist	1
4.3.2	Spektori i përgatitjes dhe fizibilitetit të projekteve për marketimin e turizmit	3					Spektori i standartizimit në turizëm	3
	Përgjegjës sektori	1	IIIA					1
	Specialist	1	IIIB					1
	Specialist	1	IVA					1
5	Drejtoria e përgjithshme e politikave dhe zhvillimit të mjedisit	25		24			Drejtoria e përgjithshme për zhvillimin e mjedisit	21
	Drejtor i përgjithshëm	1	IIA					1
5.1	Drejtoria e përgjithshme e politikave dhe strategjive të mjedisit	5					Drejtoria e ekonomisë qarkulluese	8
	Drejtor	1	IIB					1
	-	-				5.1.1	Spektori i programimit të cilësisë dhe pastërtisë së mjedisit	4
	-	-					Përgjegjës sektori	1
	-	-					Specialist	3
	-	-				5.1.2	Spektori 3R dhe edukimit mjedisor	3
	-	-					Përgjegjës sektori	1
	Specialist	4	IIIB				Specialist	1
	-	-					Specialist	1
5.2	Drejtoria e programeve të zhvillimit të mjedisit	9		8		5.2	Drejtoria e natyrës dhe pyjeve	7
	Drejtor	1	IIB				Drejtor	1
5.2.1	Spektori i programit të cilësisë dhe pastërtisë së mjedisit	2					-	-
	Specialist	2	IIIB				-	-
5.2.2	Spektori i programit të mbrojtjes mjedisore dhe biodiversitetit	3		2		5.2.1	Spektori i biodiversitetit	3
	Përgjegjës sektori	1		0			Përgjegjës sektori	1
	Specialist	2					Specialist	2
5.2.3	Spektori i pyjeve dhe kullotave	3				5.2.2	Spektori i pyjeve dhe kullotave	3
	Përgjegjës sektori	1	IIIA				Përgjegjës sektori	1
	Specialist	2	IIIB				Specialist	2
5.3	Drejtoria e konceptimit dhe fizibilitetit të projekteve të mjedisit	10				5.3	Drejtoria e ndryshimeve klimaterike	5
	Drejtor	1					Drejtor	1
5.3.1	Spektori i përgatitjes dhe fizibilitetit të projekteve për pastrimin e mjedisit dhe trajtimin e mbetjeve	3					Specialist	4
	Përgjegjës sektori	1	IIIA				-	-
	Specialist	1	IIIB				-	-
	Specialist	1	IVA				-	-
5.3.2	Spektori i përgatitjes dhe fizibilitetit të projekteve për mbrojtjen e mjedisit, natyrës dhe biodiversitetit	3					-	-
	Përgjegjës sektori	1	IIIA				-	-
	Specialist	1	IIIB				-	-
	Specialist	1	IVA				-	-
5.3.3	Spektori i përgatitjes dhe fizibilitetit të projekteve IPA dhe donatorëve të tjerë	3					-	-
	Përgjegjës sektori	1	IIIA				-	-
	Specialist	1	IIIB				-	-
	Specialist	1	IVA				-	-
6	Drejtoria e përgjithshme rregullatore dhe përputhshmërisë në turizëm dhe mjedis	27		27				27
	Drejtor i përgjithshëm	1	IIA					1

6.1	Drejtoria e programimit, standartizimit dhe harmonizimit të kuarit rregullator	13					10	
	Drejtor	1	IIA				1	
6.1.1	Sektori i programimit, hartimit dhe harmonizimit të akteve rregullatore	4					4	
	Përgjegjës sektori	1	IIIA				1	
	Specialist	2	IIIB				2	
	Specialist	1	IVA				1	
6.1.2	Sektori i këshillimit ligjor dhe monitorimit të impaktit të akteve rregullatore	2					5	
						Përgjegjës sektori	1	IIIA
	Specialist	1	IIIB			Specialist	2	IIIB
	Specialist	1	IVA			Specialist	2	IVA
6.1.3	Sektori i standarteve në turizëm	2				-		
	Specialist	1	IIIB			-		
	Specialist	1	IVA			-		
6.1.4	Sektori i standarteve mjedisore	2				-		
	Specialist	1	IIIB			-		
	Specialist	1	IVA			-		
6.1.5	Sektori i përpunimit të informacionit dhe statistikës	2				-		
	Specialist	2	IIIB			-		
6.2	Drejtoria e integrimit, koordinimit, marrëveshjeve dhe asistencës	6			6.2	Drejtoria e integrimit dhe projekteve me financim të huaj	10	
	Drejtor	1	IIB				1	
6.2.1	Sektori i marrëveshjeve dhe kontratave	2			6.2.1	Sektori i marrëveshjeve ndërkombëtare	2	
	Specialist	1	IIIB				1	
	Specialist	1	IVA				1	
6.2.2	Sektori i koordinimit dhe integrimit	3					3	
	Përgjegjës sektori	1	IIIA				1	
	Specialist	1	IIIB				1	
	Specialist	1	IVA				1	
					6.2.3	Sektori i projekteve me financim të huaj	4	
						Përgjegjës sektori	1	IIIA
						Specialist	2	IIIB
						Specialist	1	IVA
6.3	Drejtoria e derregullimit, lejeve, licencave dhe monitorimit	7			6.3	Drejtoria e vlerësimit mjedisor. Lejeve dhe licencave	6	
	Drejtor	1					1	
6.3.1	Sektori për VMN dhe VSM	3			6.3.1	Sektori i vlerësimit mjedisor	3	
	Përgjegjës sektori	1	IIIA				1	
	Specialist	1	IIIB				1	
	Specialist	1	IVA				1	
6.3.2	Sektori i monitorimit të lejeve dhe licencave në fushën e mjedisit	3			6.3.2	Sektori i lejeve dhe licencave	2	
	Përgjegjës sektori	1	IIIA				0	
	Specialist	1	IIIB				0	
	Specialist	1	IVA			Specialist	1	Iva
7	Drejtoria e përgjithshme ekonomike dhe e shërbimeve mbështetëse	31		31			33	
	Drejtor i përgjithshëm	1	IIA				1	
7.1	Drejtoria e buxhetit dhe menaxhimit financiar	7					7	
	Drejtor	1	IIB				1	
7.1.1	Sektori i buxhetit	3					3	
	Përgjegjës sektori	1	IIIA				1	
	Specialist	1	IIIB				1	
	Specialist	1	IVA				1	
7.1.2	Sektori i financës	3					3	
	Përgjegjës sektori	1	IIIA/1				1	
	Specialist	2	IVA				2	
7.2	Drejtoria e prokurimeve dhe partneritetit	5					6	
	Drejtor	1	IIB				1	
7.2.1	Sektori i prokurimeve	2					3	
						Përgjegjës sektori	1	IIIA
	Specialist	1	IIIB				1	
	Specialist	1	IVA				1	

7.2.2	Sektori i tërheqjes së financimit dhe partneritetit në turizëm dhe mjedis	2			7.2.2	Sektori i partneriteteve	2
	Specialist	1	IIIB				1
	Specialist	1	IVA				1
7.3	Drejtoria e mirëadministrimit të burimeve njerëzore, asetev dhe shërbimeve	18					19
	Drejtor	1	IIIB				1
7.3.1	Sektori i burimeve njerëzore dhe arkiv protokollit	4					4
	Përgjegjës sektori	1	IIIA				1
	Specialist	1	IIIB				1
	Specialist (arkiv/protokoll)	2	IVB				2
7.3.2	Sektori i shërbimeve të përgjithshme	11					12
	Përgjegjës sektori	1	IIIA/I				1
	Specialist	1	IVA				1
	Magaznier	1					1
	Shofer	3					3
	Punonjës mirëmbajtjeje	1					1
	Nëpunës informacioni	2					2
	Punonjës pastrimi	2					1
7.3.3	Sektori i ankesave administrative dhe gjyqësore	2					2
	Specialist	1	IIIB				2
	Specialist	1	IVA				1
					8.1	Drejtoria e jetësimit të prioriteteve dhe statistikave	5
						Drejtor	1
						Specialist	4
8.1	Drejtoria e Auditimit	5		5	9.1		5
	Drejtor	1	IIIB				1
	Specialist	4	IIIB				4
	Total	132		132			125

Burimi: MTM, përpunuar nga grupi i auditimit

**Aneksi nr. 2/2: “Punonjësit e transferuar në një kategori pune të ndryshme pas ristrukturimit në aparatit e MTM”.**

Nr	Numri rendor	Punonjësi	Pozicioni mëparshëm		Pozicioni pas ristrukturimit		Ndryshimi
1	34	Sh.H.	Specialist Sektori i Tërheqjes së Financimit dhe Partneritetit në Turizëm e Mjedis(Drejtori e Prokurimeve dhe Partneriteteve)	IVA	Specialist në Drejtorinë e Ndryshimeve Klimaterike	IIIB	ngritje në detyrë
2	38	I.Sh.	Kryetar i Degës Territoriale (Dega Territoriale e Shërbimit të Turizmit)	IIIB	Specialist në Sektorin e Këshillimit Ligjor dhe Monitorimit të Impaktit të Akteve Rregullatore (drejt. E Programimit dhe Harmonizimit për Turizmin dhe Mjedisin)	IVA	ulje në detyrë
3	39	V. D.	Kryetar i Degës Territoriale (Dega Territoriale e Shërbimit të Turizmit)	IIIB	Specialist në Sektorin e Këshillimit Ligjor dhe Monitorimit të Impaktit të Akteve Rregullatore (drejt. E Programimit dhe Harmonizimit për Turizmin dhe Mjedisin)	IVA	ulje në detyrë
4	41	A. L.	Specialist në Sektorin e Marrëveshjeve dhe Kontratave( Drejtori e Integritimit, Koordinimit, Marrëveshjeve dhe Asistencës)	IVA	Specialist në Sektorin e Marrëveshjeve Ndërkombëtare (Drejtori e Integritimit dhe Projekteve me Financim të Huaj)	IIIB	ngritje në detyrë
5	44	K.G.	Specialist në Sektori i koordinimit dhe integritimit (Drejtoria e integritimit, koordinimit, marrëveshjeve dhe asistencës)	IVA	Specialist në Sektori i koordinimit dhe integritimit (Drejtoria e integritimit, koordinimit, marrëveshjeve dhe asistencës)	IIIB	ngritje në detyrë
6	49	A. Sh	Specialist në periudhë Prove Sektori për VMN dhe VSM (Drejtoria e Derregullimit, lejeve, licencave dhe monitorimit)	IVA	Specialist në Sektorin e Vlerësimit mjedisor (Drejtori e Vlerësimit mjedisor, Lejeve, Licencave)	IIIB	ngritje në detyrë
7	51	B.S	Specialist në Sektorin e Monitorit të lejeve dhe licencave në fushën e Mjedisit (Drejtoria e Derregullimit, lejeve, licencave dhe monitorimit)	IIIB	Specialist në Sektorin e Vlerësimit mjedisor (Drejtori e Vlerësimit mjedisor, Lejeve, Licencave)	IVA	ulje në detyrë
8	53	R.J	Specialist Sektori Buxhetit (Drejtori e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar)	IVA	Specialist Sektori Buxhetit (Drejtori e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar)	IIIB	ngritje në detyrë
9	66	E. A	Kryetar i Degës Territoriale (Dega Territoriale e Shërbimit të Turizmit)	IIIB	Specialist Sektori i Sektorit të burimeve njerëzore (Drejtori e Financës dhe Shërbimeve mbështetëse) në AKB	IVA	ulje në detyrë
10	68	I. M	Specialist Sektori i Programeve të Zhvillimit të Turizmit 3S (SEA, SAND, SUN Drejtori e Programeve të zhvillimit të Turizmit)	IIIB	Specialist në Sektorin e Mbarështimit dhe Dokumenteve Planifikues në Drejtorinë e Menaxhimit dhe eKontrollit në AKP	IVA	ulje në detyrë
11	69	S. Z	Kryetar i Degës Territoriale (Dega Territoriale e Shërbimit të Turizmit)	IIIB	Specialist Sektori Juridik dhe Prokurimeve (Drejtori e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse) në AKP	IVA	ulje në detyrë

**Aneksi nr. 2/3: “Punonjës me të drejtë rikthimi në punë viti 2022”**

Nr.	PADITES	VENDIMI I APELIT	DATA E LIRIMIT NGA DETYRA	DETYRA NE MOMENTIN E LIRIMIT/KATEGORIA PAGES	Vendimi Dhjetor 2022	USH	Data e likujdimit
1	I. Q	nr. 89, datë 30.09.2010	15.02.2010	Përgjegjës i informimit te publikut dhe IT, kategoria III a/1	1,038,116	657	27/12/2022
2	Sh. N	nr. 80, datë 21.09.2010	01.02.2010	Specialist i Sektorit të Burimeve Ujore, kategoria III-b	944,678	661	27/12/2022
3	I. S	nr. 1232 (86-2019-1399), datë 23.04.2019	30.01.2006	Specialist i Sektorit të Projekteve, kategoria IV-b	104,593	713	30.12.2022
4	A.T	nr. 83, datë 23.09.2010	1.02.2010	Specialist i Sektorit të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis, kategoria III-b	1,106,624	673	28/12/2022
5	H. C	nr. 1092, datë 20.05.2015	12.11.2013	Përgjegjës në Sektorin e Mbarështimit dhe Trajtimit të Pyjeve, kategoria III-a	1,210,958	662	27/12/2022
6	E. O	nr. 102, datë 19.01.2017	11.04.2013	Drejtor i Drejtorise Juridike dhe Prokurimeve, kategoria II-b	249,980	679	28/12/2022
7	I. G	nr. 3432, datë 26.10.2016	24.10.2013	Drejtor Teknik, Drejtoria e Përgjithshme e Administrimit të Ujrave, kategoria II-b	1,387,793	674	28/12/2022
8	E. B	nr. 736 (86-2019-833) 12/03/2019	04.03.2015	Specialist në Sektorin e Shërbimeve Turistike, kategoria IV-a	751,786	675	28/12/2022
9	J. G	nr. 2703 (86-2019-3081), date 15.10.2019	20.12.2017	Drejtor I Burimeve Njerezore dhe Shërbimeve, kategoria II-b	1,351,178	683	29/12/2022
<b>Totali deri Dhjetor 2022</b>					<b>8,145,706</b>		

**Aneksi nr 3: “Zbatimi i dispozitave ligjore për administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetare” nga faqja 36 deri 47 të Raportit.**

**Aneksi nr. 3/1: “Procedurat blerje e vogël të audituara për vitin 2020; 2021 dhe 2022”**

<b>Viti 2020</b>
"Blerje pjesë këmbimi, goma dhe bateri"
"Rikonstrukcion bodrume"
"Shërbim programi financiar Alfa Web"
"Shërbime e riparime të grilave të jashtme të dritareve MTM"
"Blerje pajisje dhe orendi për mobilim zyrash për MTM"
"Bileta avioni"
<b>Viti 2021</b>
Blerje kondicionerë
Shërbim programi financiar Alfa web
Shërbim riparimi i pajisjeve elektronike (kompjuter, UPS, switche, printera, skanera, fotokopje etj)
Blerje kuti dhe dosje për ruajtje te përhershme
Blerje të biletave të transportit ajror ndërkombëtar
<b>Viti 2022</b>
Shpenzime të tjera për shërbime të ndryshme
Shërbim riparim, mirëmbajtje të sistemit të kondicionimit
"Shërbim riparim automjetesh për Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit"
Blerje materiale kancelarie, letër A4/A3
Shërbim sigurimi për mjetet e transportit të MTM.
"Shërbim riparim dhe mirëmbajtje të automjeteve për MTM"
Mirëmbajtja e mjeteve të transportit të MTM-së
Shërbim riparim dhe mirëmbajtje të automjeteve te MTM
Blerje e biletave të transportit ajror
Shërbim konsulte për hartimin e Termave të Referencës për planin e menaxhimit dhe projektin e zbatimit për Parkun Natyror "Liqeni i Ulzës dhe zona përreth tij"
Shërbim konsulence për hartimin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për shpalljen e Ekosistemit Natyror Detar-Bregdetar të Gjirit të Porto Palermos-Llamani "Park Natyror"
Kolaudim punimesh për objektin "Mbyllja, rehabilitimi i mbetjeve urbane nga venddepozitimet ekzistuese (Burrel, Kukës, Libohovë, Përmet, Krujë)"



**Aneksi nr. 4: “Auditimi i llogarive vjetore” nga faqja 58 deri 76 të Raportit.**

**Aneksi nr. 4/1 “Të ardhurat”**

në lekë

Nr.	Llogaria	Emërtimi	Viti 2022	Viti 2021	Diferenca
1	A	<b>TE ARDHURAT</b>	<b>346,915,219</b>	<b>489,007,626</b>	<b>(142,092,407)</b>
34	71	<b>III.TE ARDHURA JO TATIMORE</b>	<b>453,878</b>	<b>107,928,017</b>	<b>(107,474,139)</b>
39	711	<b>2.Sherbimet Administrative dhe te Ardhura Sekondare</b>	<b>453,878</b>	<b>107,928,017</b>	
43	7113	Te ardhura nga shitja e mallrave e sherbimeve	453,878	107,928,017	
47	719	<b>3.Te tjera te ardhura jo tatimore</b>			
53	72	<b>V.GRANTE KORENTE</b>	<b>346,461,341</b>	<b>382,801,626</b>	<b>(36,340,285)</b>
54	720	<b>1.Grant korent I Brendshem</b>	<b>346,461,341</b>	<b>382,801,626</b>	<b>(36,340,285)</b>
55	7200	Nga Buxheti per NJQP(Qendrore)	322,237,353	363,374,110	(41,136,757)
61	7206	Financim I pritshe nga buxheti	11,903,441	12,156,100	(252,659)
62	7207	Sponsorizime te brendshme( nga te trete)	12,320,547	7,271,416	5,049,131
73	73	<b>VIL.NDRYSHIMI I GJENDJES SE INVENTARIT TE PRODUKTEVE</b>		<b>(1,722,017)</b>	<b>1,722,017</b>

Burimi: MTM/Përpunuar nga grupi i auditimit

**Aneksi nr. 4/2 “Shpenzimet”**

në lekë

Nr.	Llogaria	Emërtimi	Viti 2022	Viti 2021	Diferenca
74	B	<b>SHPENZIMET</b>	<b>351,062,057</b>	<b>533,156,743</b>	<b>(182,094,686)</b>
75	600	<b>LPAGAT DHE PERFITIMET E PUNONJSEVE</b>	<b>105,963,771</b>	<b>124,324,702</b>	<b>(18,360,931)</b>
76	6001	Paga, personel I persheshem	105,963,771	124,324,702	(18,360,931)
80	601	<b>II.KONTRIBUTE TE SIGURIMEVE</b>	<b>37,238,274</b>	<b>20,472,524</b>	<b>16,765,750</b>
81	6010	Kontributi I Sigurimeve Shoqerore	37,238,274	20,472,524	16,765,750
83	602	<b>III.BLERJE MALLRA E SHERBIME</b>	<b>183,286,893</b>	<b>193,775,531</b>	<b>(10,488,638)</b>
85	6020	Materiale zyre e te perqitheshme	5,288,317	4,947,972	340,345
86	6021	Materiale dhe sherbime speciale		1,037,500	(1,037,500)
87	6022	Sherbime nga te trete	17,866,707	12,545,490	5,321,217
88	6023	Shpenzime transporti	1,522,699	8,519,386	(6,996,687)
89	6024	Shpenzime udhetimi	16,114,458	8,696,975	7,417,483
90	6025	Shpenzime per mirembajtje te zakonshme	4,841,904	1,736,990	3,104,914
92	6027	Shpenzime per detyrime per kompesime legale	110,429,404	153,961,065	(43,531,661)
93	6028	Shpenzime te lidhura me huamarrjen per hua			-
94	6029	Shpenzime te tjera operative	27,223,404	2,330,153	24,893,251
101		<b>V.TRANSFERIME KORENTE</b>	<b>20,426,281</b>	<b>16,283,993</b>	<b>4,142,288</b>
107	605	<b>2.Transferime korent me jashte</b>	<b>16,975,049</b>	<b>16,039,668</b>	<b>935,381</b>
111	6059	Transferime Te tjera korrente me jashte shtetit	16,975,049	16,039,668	935,381
112	606	<b>3.Transferime per Buxhetet familjare e Individe</b>	<b>3,451,232</b>	<b>244,325</b>	<b>3,206,907</b>
113	6060	Transferta Te paguara nga ISSH e ISKSH	3,451,232	244,325	3,206,907
125		<b>VILKUOTA AMORTIZIMI DHE SHUMA TE PARASHIKUARA</b>	<b>-</b>	<b>180,022,010</b>	<b>(180,022,010)</b>
126	681	Kuotat e amortizimit te AAGJ, te shfrytezimit		180,022,010	(180,022,010)
130	63	<b>VII.NDRYSHIMI I GJENDJES SE INVENTARIT</b>	<b>4,146,838</b>	<b>(1,722,017)</b>	<b>5,868,855</b>
131		<b>IX.SHPENZIME TE TJERA</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>
132	85	<b>TEPRICA OSE DEFICITI I PERIUDHES</b> (Rezultati I Veprimtarise se vititUshtrimor)	<b>(4,146,838)</b>	<b>(44,149,117)</b>	<b>40,002,279</b>

Burimi: MTM/Përpunuar nga grupi i auditimit

**Aneksi nr. 4/3: “Aktivet qarkulluese”.**

në lekë

Nr.	Llogaria	Emërtimi	Viti 2022	Viti 2021
2		<b>I. Aktivet Afatshkurtra</b>	<b>59,138,693</b>	<b>86,933,981</b>
3		<b>1.Mjete monetare dhe ekuivalent te tyre</b>	<b>40,261,887</b>	<b>37,327,982</b>
6	520	Disponibilitete ne Thesar	40,261,887	37,327,982
11		<b>2.Gjendje Inventari qarkullues</b>	<b>4,948,741</b>	<b>9,095,579</b>
12	31	Materiale	4,948,741	9,095,579
13	32	Inventar i imët		0
21		<b>3.Llogari te Arkëtushme</b>	<b>13,928,065</b>	<b>39,104,400</b>
32	468	Debitorë të ndryshëm	2,024,624	2,024,624
33	4342	Operacione me shtetin(Të drejta)	11,903,441	37,079,776
36		<b>4.Te tjera aktive afatshkurtra</b>	<b>0</b>	<b>1,406,020</b>
41	486	Shpenzime te periudhave te ardhshme		1,406,020

Burimi: MTM/Përpunuar nga grupi i auditimit

**Aneksi nr. 4/4 “Llogaria 520 “Disponibilitete në Thesar” për vitin ushtrimor 2022”**

në lekë

Nr.	Llog.520 “Disponibilitete ne Thesar”	
<b>I</b>	<b>Llog.466.mjete ne ruajtje</b>	<b>40,261,887</b>
1	5%garanci punimesh ,Rikons. zyra laborator v.2015	28,919,425
2	5%garanci punimesh ,Parku kombëtar Lura v.2014	202,131
3	5%garanci punimesh ,Rikonstrukcion I Zyrave v.2016	683,886
4	5%garanci punimesh ,pastrim I lumit Ishem	620,977
5	5%garanci punimesh ,zona Kume v.2019	12,041,146
6	5%garanci punimesh ,zona Kume v.2020	4,538,436
7	5%garanci punimesh ,zona Kume v.2020	2,599,672
8	5%garanci punimesh ,Rikonstrukcion Godina MTM v.2020	44,400
8	5% venddepozitime v.2021	3,866,020

9	5%Mbyllja, rehabilit. I mbetjeve urbane nga venddepozitimet v.2022	2,454,957
10	5% garanci punimesh,Sherbim,riparim stacioneve te ajritv.2022	1,867,800
<b>II</b>	<b>Sponsorizime</b>	<b>11,342,462</b>
1	Sponsorizime 602	320,014
2	Fondi Italian I trashëguar	5,712,000
3	Fondi pyjor i trashëguar	2,656,326
4	Fondi pyjor i trashëguar	2,654,122

Burimi MTM/Përpunuar nga grupi i auditimit

#### Aneksi nr. 4/5: “Aktivet afatgjata”.

(Vlera kontabël neto)

Llog.Kontabel	Përshkrimi i llogarive	Celje 2021 (neto)	Shtesa 2022 (neto)	Pakësime 2022 (neto)	Gjendje në fund 2022 (neto)
	<b>AAGJM</b>	<b>1,742,967,811</b>	<b>31,510,909</b>	<b>(32,988,632)</b>	<b>1,741,490,088</b>
210	Toka ,troje, Terrene	-	-	-	-
211	Pyje, Kullota Plantacione	57,424,204	-	(11,484,841)	45,939,364
212	Ndërtesa e Konstruksione	252,915,734	-	(12,645,787)	240,269,947
213	Rruge, rrjete, vepra ujore	730,966,321	807,684	-	731,774,005
214	Instalime teknike, makineri, paisje, vegla pune	-	-	-	-
215	Mjete transporti	14,417,220	-	(2,883,444)	11,533,776
216	Rezerva shtetërore	-	-	-	-
217	Kafshe pune e prodhimi	-	-	-	-
218	Inventar ekonomik	39,650,915	-	(5,974,561)	33,676,354
24	Aktive të qend.të trupëzuara të dëmtuara	-	-	-	-
28	Caktime	647,593,417	30,703,225	-	678,296,642

Burimi MTM/Përpunuar nga grupi i auditimit

#### Aneksi nr. 4/6: “Caktime”.

në lekë

Projekti	Kodi i projektit	Shuma
<b>Para vitit 2017 - Nuk ka informacion</b>		<b>235,323,285</b>
<b>Viti 2017</b>		
TVSH Kune-Vain UNEP TVSH	M260362	2,554,538
TVSH IPA- 2013, Natyra 2000 (Mbetjet)	M260322	6,000,000
TVSH IPA- 2013, Ndryshimet klimaterike IBECA	M260323	987,474
TVSH IPA- 2013, Mbetjet e ngurta urbane EPTISA	M260164	946,871
TVSH Mbetjet- Ne kuadër te ndryshimeve klimatike-GIZ	M260379	2,007,642
TVSH Përshtatja me ndryshimet Klimaterike ne fushën e menaxhimit ndërkufitar te riskut te përmbytyjeve ne Ballkanin perëndimor-GIZ	M260380	1,461,972
TVSH Ruajtja e Agrobiodiversitetit në zonat Rurale të Shqipërisë (CABRA)-GIZ	M260349	1,142,019
TVSH	M260350	1,106,145
TVSH projekti I zhvillimit te burimeve natyrore	M260324	16,045,465
TVSH Kune-Vain UNEP TVSH	M260362	8,800,000
<b>Viti 2018</b>		
TVSH Parku Biosferik i Prespës	M260248	7,330,574
TVSH IPA- 2013, Natyra 2000 (Mbetjet)	M260322	9,323,146
TVSH IPA- 2013, Ndryshimet klimaterike IBECA	M260323	600,911
TVSH IPA- 2013, Mbetjet e ngurta urbane EPTISA	M260164	4,128,385
TVSH Mbetjet- Ne kuadër te ndryshimeve klimatike-GIZ	M260379	6,000,000
TVSH Përshtatja me ndryshimet Klimaterike ne fushën e menaxhimit ndërkufitar te riskut te përmbytyjeve ne Ballkanin perëndimor-GIZ	M260380	658,140
TVSH Ruajtja e Agrobiodiversitetit në zonat Rurale të Shqipërisë (CABRA)-GIZ	M260349	248,178
Ruajtja dhe përdorimi i qëndrueshëm I biodiversitetit ne tre liqenet e Ohrit ,Prespes dhe Shkodrës (CSLBIII )-GIZ	M260402	757,681
TVSH SANEX Kapitulli 27 - SIDA	M260401	500,000
TVSH projekti I zhvillimit te burimeve natyrore	M260324	34,788,903
<b>Viti 2019</b>		
TVSH Paketa turistike ne dispozicion per nje zhvillim te qëndrueshëm te burimeve natyrore dhe turizmit (Projekti DestiMed)	18BG301	981,821
TVSH Hartë e përgatitur për burimet e mbetjeve të ngurta për prodhuesit industrialë (SĒAN)	18BG901	42,271
TVSH Sistem i ngritur per parandalimin e mbetjeve detare (Projekti Marine Litter-GIZ)	18BH101	1,165,712
TVSH Raporte performace te hartuara (SANEX)	18BH301	4,624,184
TVSH e rimbursuar per projektin (ĒASTE IPA 2013-MBETJET)	M260164	4,203,291
TVSH e realizuar per projektin e (Biosferes Prespes)	M260248	13,519,009
Rimbursim TVSH ( Projekti CABRA FAZA 2-te)	M260349	2,149,875
TVSH e realizuar për projektin e Kune Vainit	M260362	11,757,498
TVSH e rimbursuar për projektin e GIZ (Mbetjet GIZ)	M260379	8,592,501
TVSH e Projektit te GIZ e realizuar (Përshtatja me ndryshimet Klimatike –GIZ)	M260401	439,956
TVSH e rimbursuar për projektin (CSBL III GIZ)	M260402	443,786
TVSH PLASTIK BASTER	18BH001	58,411
TVSH projekti I zhvillimit te burimeve natyrore (Projekti i Shërbimeve Mjedisore ESP)	M260324	69,833,485
<b>Viti 2020</b>		
Përshtatja me ndryshimet Klimaterike ne fushën e menaxhimit ndërkufitar te riskut te përmbytyjeve ne Ballkanin perëndimor-GIZ	M260401	1,014,932
TVSH platforma për ripërdorimin e mbetjeve (SĒAN)	18BG901	59,810
TVSH Sistem i ngritur për parandalimin e mbetjeve detare (Projekti Marine Litter-GIZ)	18BH101	2,647,481
TVSH Kapacitete te ngritura ne fushën e kimikateve (Projekti i kimikateve-SIDA)	18BH201	423,419

Raportet performace te hartuara	(Projekti SANE - SIDA)	18BH301	4,000,000
TVSH e realizuar për projektin e (Biosferes Prespes)		M260248	11,668,885
TVSH për projektin e Kune Vainit-GEF		M260362	868,028
TVSH " Mbetjet e ngurta dhe riciklim-GIZ "		M260379	7,695,807
TVSH Projekti Aquanex - Ruajtja dhe sigurimi I trupave uJOR		18BG401	110,924
TVSH projektin 3 LIQENET (CSBL III GIZ)		M260402	691,877
TVSH PLASTIK BASTER		18BH001	50,702
TVSH ALL TOUR		18CH901	104,645
TVSH IPA -2013 NATYRA 2000		M260322	15,147,214
TVSH IPA 2013 Mbetjet		M260164	1,861,201
TVSH DUE MARI		18CH401	2,891,221
TVSH projekti I zhvillimit te burimeve natyrore (Projekti i Sherbimeve Mjedisore ESP)		M260324	67,514,453
<b>Viti 2021</b>			
Përshtatja me ndryshimet Klimaterike në fushën e menaxhimit ndërkufitar te riskut te përmbyetjeve ne Ballkanin perendimor-GIZ		M260401	1,267,962
TVSH Sistem i ngritur për parandalimin e mbetjeve detare (Projekti Marine Litter-GIZ)		18BH101	777,840
Raportet performace të hartuara	(Projekti SANE - SIDA)	18BH301	8,220,725
TVSH e realizuar për projektin e (Biosferes Prespës)		M260248	13,172,527
TVSH " Mbetjet e ngurta dhe riciklim-GIZ "		M260379	9,991,280
TVSH PLASTIK BASTER		18BH001	24,225
TVSH ALL TOUR		18CH901	152,520
TVSH RESOURCE		18BG901	445,490
TVSH DUE MARI		18CH401	4,930,011
TVSH projekti I zhvillimit te burimeve natyrore (Projekti i Shërbimeve Mjedisore ESP)		M260324	33,337,109
<b>Viti 2022</b>			
Menaxhim I mbetjeve detare TVSH		18BH101	23,719,882
Përshtatja ndej ndryshimeve klimaterike TVSH		M260401	615,000
Projekti Due Mari TVSH		18BH001	627,058
Projekti Due Mari TVSH		18CH401	3,908,885
Projekti Due Mari TVSH		18CH401	1,217,427
Projekti Due Mari TVSH		18CH401	23,560
Raportet performace te hartuara TVSH		18BH301	591,413
<b>Totali</b>			<b>678,296,642</b>

Burimi: MTM/Përpunuar nga grupi i auditimit

## Aneksi nr. 4/7 "Projektet për vitin 2021-2022"

### Viti 2022

Në lekë

Nr	Emërtimi i projektit	Përfitues	Vlera
1	Projekti "Producentë ndërkombëtar te filmave turistike promovojnë destinacionet turistike shqiptare"		964,960
2	Projekti "Krijimi i Identitetit korporativ & Brand Book per 4 bashki"		2,984,000
3	Projekti "Edukimi dhe Trajnimi i hoteleve mbi promovimin e turizmit"		3,000,000
4	Projekti "Shqiperia turstike, tregojë dhe mbroje"		3,000,000
5	Projekti "Promovimi i turizmit mjekesor"		3,397,000
6	Projekti "Ne zbulim te kulinarisë shqiptare II"		1,993,000
7	Projekti "Rivitalizimi I Trashëgimisë Kulturore-porta kryesore e turizmit ne bashkinë Përmet"		1,974,498
8	Projekti "Risi n' Tur"		797,500
9	Projekti "All trails Albania"		1,500,000
10	Projekti "Albania Coast from the Air"		3,676,445
11	Projekti "Nga Antikiteti ne Artin Bashkekohor Shqiptar"		500,000
12	Projekti "Menaxhim destinacioni, Lugina e Lumit Kir		150,000
13	Projekti "Shqipëria në 1 minutë"		2,000,000
14	Projekti "Hos-Cos Albania"		2,480,000
15	Projekti "Gjirokastra Tourism"		500,000
16	Projekti "Shërbejmë ndryshe në Turizëm"		239,400
17	Projekti "Smart Tourism for All"		239,100
18	Projekti "Gjirokastra mirëpret:"		729,200
19	Projekti "Karaburuni, destinacion turistik"		1,490,000
20	Projekti "Kostumografia dhe Fëmijët"		572,950
21	Projekti "Etno-Explore Tirana"		398,000
22	Projekti "Një guidë televizive për Shqipërinë Turistike të çdo stine"		1,000,000
23	Projekti "Harta Digjitale e Shqipërisë qytetet UNESCO Faza e parë"		9,284,678
24	Projekti "VISIT, love and care for Albania Gadgets"		2,491,000
25	Projekti "Organizimi i eventeve kulturore ne Zonën e Konispolit"		239,558
26	Projekti "Shkoder Locka"		947,273
27	Projekti "Gjirokastra in your pocket-Shkodra in your pocket"		3,392,000
28	Projekti "Te ecim përmes Bukurive te natyrës, kulturës dhe trashëgimisë"		999,500
29	Projekti "Take up an Iso"		1,989,000
30	Projekti "Peza Adventure Festival"		999,000
31	Projekti "Uncovering albanian Beauties-Èater tours 2022"		668,880
32	Projekti "Shqiperia ne nje makine"		978,000
33	Projekti "Vjosa n'Fest"		6,792,812
34	Projekti "Turizmi ne tre dimensione- promovimi i turizmit të qëndrueshëm ne Qarkun e Vlorës nëpërmjet dizenimit dhe përjetimit virtual 360 te tureve unike ne HUB-in e Turizmit Vlore"		1,580,000
35	Shqipëria në sytë e mi		10,000,000
36	Aplikacioni Explore Albania		1,700,000
37	Turizmi pasuria e verilindjes se Shqipërisë		2,000,000

38	Promovimi I potencialeve turistike të zonës se Ishmit		1,000,000
39	Homeland II		2,000,000
40	Tourism Knackathon		2,000,000
41	Elbasani Turistik		10,500,000
42	Check in fest Albania		8,441,500
43	Analize dhe vlerësim për ecurinë e sektorit turizmit dhe krijimi I një platforme të integruar		7,994,400
	<b>TOTALI</b>		<b>109,583,654</b>
	Kaluar në llogarinë 218		2,638,754
	<b>Investime në proces</b>		<b>106,944,900</b>

Burimi: MTM/Përpunuar nga grupi i auditimit

Viti 2021

në lekë

Nr	Emërtimi i projektit	Përfitues	Vlera Total
1	Eco-Blue on		3,400,000
2	Strategji e thelluar, integruar dhe e vete qëndrueshme		2,460,200
3	Tradita qe kthehet ne marke		3,000,000
4	Ne zbulim te kulinarisë shqiptare		4,190,000
5	Rritja e promovimit dhe përmirësimi i shërbimeve turistike ne Bashkinë Përmet		629,947
6	Promovim i kalave dhe njohja me historinë e tyre		2,765,000
7	Nxitja e angazhimit rinor ne promovimin e turizmit		770,000
8	Shije dhe eksperiencia nga Jugu i Shqipërisë		157,800
	<b>TOTALI</b>		<b>17,372,947</b>

Burimi: MTM/Përpunuar nga grupi i auditimit

### Aneksi nr. 4/8 “Investime për aktive afatgjata materiale”

Në lekë

Nr	Emërtimi	OE	Vlera
1	Kosto lokale	F. Pr.	5,700,000
2	Kosto lokale	P. B.	800,000
3	Kosto lokale	T.U.	1,500,000
4	Kosto lokale	M.-E.	6,000,000
5	Kosto lokale	R.	8,107,000
6	Rehabilitim i mbetjeve urbane	A. K.	49,099,134
7	Mbikëqyrje punimesh rehabilitim i mbetjeve urbane	IMES	731,800
8	Sponsorizime Bashkia Fushë Arrëz	Gj.	443,520
9	Projekti Berzh	BERZH	178,000,000
	<b>TOTALI</b>		<b>250,381,454</b>

Burimi: MTM/Përpunuar nga grupi i auditimit

### Aneksi nr. 4/9: “Pasivet Afatshkurtra”.

në lekë

Nr.	Llogaria	Emërtimi	Viti 2022	Viti 2021	Diferenca
66		<b>I. Pasivet Afatshkurtra</b>	<b>42,847,469</b>	<b>40,510,418</b>	<b>2,337,051</b>
67		<b>1. Llogari te Pagueshme</b>	<b>42,847,469</b>	<b>40,510,418</b>	<b>2,337,051</b>
69	42	Detyrime ndaj personelit	9,394,213	9,574,996	-180,783
72	431	Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa	808,523	860,067	-51,544
75	435	Sigurime Shoqërore	1,527,023	1,543,846	-16,823
76	436	Sigurime Shëndetësore	173,682	177,191	-3,509
81	466	Kreditorë për mjete në ruajtje	28,919,406	24,923,676	3,995,730
82	467	Kreditorë të ndryshëm		1,406,020	-1,406,020
83	4341	Operacione me shtetin(detyrime)	2,024,622	2,024,622	0

Burimi: MTM/Përpunuar nga grupi i auditimit

### Aneksi nr. 4/10: “Pasqyra e ndryshimeve ne aktivet neto/ fondet neto”.

në lekë

Nr.	Reference	EMERTIMI	Fonde baze dhe Granto	Rezerva	Fonde te Tjera te veta	Rezultatet e Mbartura Teprice/Deficit	Rezultatet e Ushtrimit Teprice/Deficit	GJITHESEJ Aktive/Neto
a	b	c	1	2	3	4	5	6
1	101	LAKTIVET NETO/FONDET NETO	576,331,662					576,331,662
2		I.NDRYSHIMET NE AKTIVET/ FONDET NETO(I+2)	1,835,241,323	0	0	205,537,219	62,053,926	2,105,832,468
3		1.NGA BURIME TE BRENDSHME	1,576,859,776	0	0	205,537,219	323,435,473	2,105,832,468
4	105	Nga grantet e brendshme kapitale(+)	344,717,223					344,717,223
5	1016, 1059	Nga Transferat e brendshme te AAGJ, Dhurata ne natyre, (+,-)	0					0
6	1014, 116	Nga Shitjet e AAGJ(+)	0					0
7	12	Nga Rezultatet e mbartura(+,-)						0
8	05	Nga Rezultatet e vites ushtrimor(+,-)	-44,149,117			40,002,279	-44,149,117	-44,149,117
9	111	Nga Rezervat (+,-)						0
10	115	Nga Fondet e veta te investimeve (+,-)	647,593,417				-647,593,417	0
11	14	Investime ne proces	628,699,253				387,686,073	1,016,384,326
12	15	Shuma te parashikuara per rrezique e Zhvleresime(+,-)	0					0
13	1013	Nga konsumi i AAGJ(-)	0			165,534,940		165,534,940
14	1015	Nga rrezultatet jashtepardorimit dhe demtimet(-)	0					0
15	102	Vlera te AAGJ te Caktuara ne perdorim(+,-)	0					0
16	109	Diferenca nga Rivleresimi i AAGJ(+,-)	0					0
17		2.NGA BURIME TE JASHTME	261,381,547	0	0	0	0	261,381,547
18	106	Nga Grantet e Jashtme kapitale(+)	261,381,547					261,381,547
19	1016, 1059	Nga Transferat e brendshme te AAGJ, Dhurata ne natyre, (+,-)	0					0
20		<b>TOTALI I FONDEVE TE VETA(II+II)</b>	<b>2,414,572,985</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>205,537,219</b>	<b>62,053,926</b>	<b>2,682,164,130</b>

Burimi: MTM

### Aneksi nr. 4/11: “Materialet në dalje për vitin ushtrimor 2022, llogaria nr.218 “Inventar Ekonomik”

Kartela	Përshkrimi	Niësia	Llogaria	Sasia dalie	Vlera
IE580	Kompjuter Desktop Acer Vertion M 430 G çmimi	cope	218	5	379 020
IE1026	Kompjuter Destop Tipi 2 çmimi 119.976 acer	cope	218	6	719 056
IE623	Kompjuter Desktop Dell Oplex 790 çmimi 79014	cope	218	2	158 020
IE569	KOMPJUTER MONITOR 19 LCD çmimi 75316.8	cope	218	2	150 634
IE921	Karrige te thjeshta Çmimi 9360	cope	218	5	46 000
IE890	Kompjuter destop çmimi 91080	cope	218	5	455 400
IE1025	Laptop bazik s/n chd1492fjg çmimi 114300	cope	218	3	342 000
IE861	Kompjuter Desktop Fujitsu Esprima P557005 - Fujitsu P55	cope	218	5	353 616
IE808	TAVOLIME KOMPJ 90X60X70 ÇMIMI 14.640	cope	218	10	146 400
IE804	RAFTE PER DOSJE ÇMIMI 37.200	cope	218	3	111 600
IE800	KARRIKETIP RROTULLUESE ÇMIMI 51.480	cope	218	1	51 480
IE865	Kompjuter.des.DELL.monit 2015 çmimi 81.564	cope	218	1	81 564
IE805	SIRTAR TE LEVIZSHEM ÇMIMI 13.200	cope	218	5	66 000
IE077	Etazher çmimi 79000	cope	218	1	79 000
IE799	KARRIKE RROTULLUESE ÇMIMI 16.800	cope	218	7	117 600
IE430	Tavoline çmimi 42500	cope	218	1	42 500
IE043	KOMPJUTER HARC DISK LENOVA PC THINK CENTER ÇMIMI 70.615.0	cope	218	4	282 461
IE796	DOLLAP METALIK ME SIRTARE ÇMIMI 28.920	cope	218	1	28 020
IE426	Tavolin e rrumbullaket çmimi 100000	cope	218	1	100 000
IE809	TAVOLIME KOMPJ PERGJEGJESI ÇMIMI 16.560	cope	218	3	49 680
IE755	Printer HP jet M79 M521dn çmimi 138.024	cope	218	1	138 024
IE678	Karrike statike çmimi 14400	cope	218	4	57 600
IE814	PC KOMPJUTER ÇMIMI 121869	cope	218	2	243 728
IE1009	KOMPJUTER DESKTOP LENOR THINK CENTER	cope	218	7	836 640
IE797	DOLLAP RROBASH NJE KANAT ÇMIMI 14.400	cope	218	1	14 400
IE531	Piktura ne Kornize çmimi 5480	cope	218	9	49 220
IE1014	PRINTER B & E ADVANCED OKI B512dn ÇMIMI 26,112	cope	218	3	78 336
IE452	Tavoline specialistesh çmimi 38500	cope	218	1	38 500
IE859	UPS PL 10001 ÇMIMI 7.332	cope	218	1	7 332
IE888	UPS 10000VA çmimi 6996	cope	218	4	27 084
IE893	Printer B&E advanced HL-6250DN çmimi 19140	cope	218	1	19 140
IE1012	POLTRON RROTULLUES ÇMIMI 24,000	cope	218	1	24 000
IE801	KARRIKE TE THJESHTA ÇMIMI 3.720	cope	218	1	3 720
IE669	Karrike statike çmimi 20.880	cope	218	4	83 520
IE046	UPS 650 VA ÇMIMI 3.982.8	cope	218	4	15 024
IE804	RAFTE PER DOSJE ÇMIMI 37.200	cope	218	1	37 200
IE543	Poltron një vendesh çmimi 15600	cope	218	1	15 600
IE538	Dollap metalik çmimi 30000	cope	218	2	60 000
IE537	Tavoline pune thjeshte çmimi 21600	cope	218	1	21 600
IE181	Karrike statike çmimi 2800	cope	218	1	2 800
IE923	Tavoline pune e thjeshte Çmimi 13920	cope	218	3	41 760
IE805	SIRTAR TE LEVIZSHEM ÇMIMI 13.200	cope	218	1	13 200
IE540	Dollap një kanat çmimi 12000	cope	218	1	12 000
IE1011	UPS 1000 VA SPS PLI 1000 ÇMIMI 8,730	cope	218	15	130 050
IE174	Karrike rrotulluese çmimi 7500	cope	218	2	15 000
<b>Totali</b>				<b>143</b>	<b>5 752</b>

Burimi: MTM/Përpunuar nga grupi i auditimit

**Aneksi nr. 4/12: "Transferime/pakësime AAGJ".**

në lekë

Nr .rreshti	Nr reference	Emërtimi	Pakësime gjatë vitit 2021
a	b	c	d
	<b>218</b>	<b>II.AAGJ Materiale/ Inventari Ekonomik</b>	
<b>1</b>	<b>218</b>	Pakësim Agjencisë Kombëtare të Pyjeve	915,600
<b>2</b>	<b>218</b>	Pakësim Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura	4,200,000
<b>3</b>	<b>218</b>	Pakësim Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura	7,550,000
<b>4</b>	<b>218</b>	Pakësim Agjencisë Kombëtare të Turizmit	200,000
<b>5</b>	<b>218</b>	Pakësim Agjencisë Kombëtare të Turizmit	16,732,210
<b>6</b>	<b>218</b>	Pakësim Agjencisë Kombëtare të Turizmit	2,100,000
<b>7</b>	<b>218</b>	Pakësim Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura	9,700,000
<b>8</b>	<b>218</b>	Pakësim Agjencisë Kombëtare të Turizmit	1,250,000
		<b>TOTALI</b>	<b>42,647,810</b>

Burimi: MTM/Përpunuar nga grupi i auditimit

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Përfundimtar i Auditimi.

## KONTROLI I LARTË I SHTETIT